



Logos-A

**SALIH BEHMEN**

**PËRGJIGJET ISLAME**

*Logos-A - Shkup*  
1420/1999

---

Biblioteka *Mendimi islam*

**Titulli i originalit  
ISLAMSKI ODGOVORI**

**Botuar nga  
Islamska Zajednica, Zagreb  
1990**

**Përktheu nga gjuha boshnjake  
Mr. Mehmet HALIMI,  
punëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës**

**CIP - Каталогизација во публикација  
Народна и универзитетска библиотека “Климент Охридски” - Скопје  
297:1(081)**

**BEHMEN, Salih  
Përgjigjet islame / Salih Behmen ; [përktheu nga gjuha boshnjake Mehmet Halimi]. - Shkup : Logos-A, 1420/1999. - 318 стр. ; 20 cm. - (Biblioteka Mendimi islam)**

**Превод на делото: Islamski odgovori. – фусноти кон текстот. –  
Ndërmjetthënie / Mehmet Halimi: стр. 9-13. – Shënime biografike për autorin:  
стр. 313-314**

**ISBN 9989-601-82-8**

**a) Ислам – Филозофија - Зборник**

SALIH BEHMEN

---

*PËRGJIGJET ISLAME*

*Kushtuar luftëtarëve të rënë në Rrugën e Zotit*

# PARATHËNIA E BOTUESIT NË BOSHNJAKISHTE

---

*Përgjigjet islame* është titulli i përbledhjeve të artikujve në të cilat Salih Behmeni, i nxitur nga gjendja dhe dukuritë aktuale të shoqërisë në mjedisin musliman boshnjako-hercegovas, analizon në mënyrën e vet çështje të shumta. Ndër këto janë edhe letrat dhe reagimet e autorit për disa ngjarje reale, prandaj për ta kompletuar veprën e tij, me të njëjtin titull, po i publikojmë edhe ato.

Artikulli i parë dhe më i gjatë me titull *Njohuritë shkencore dhe Kur'ani*, është një analizë, që autor i nëntitull e quan *Dialogu ndërmjet mësimit islam dhe ateizmit*. “Argumenteve” të thjeshtë-suara materialiste të bazuara në scientizëm, që do të thotë në besimin se përparimi i shkencës mund t'i zgjidhë të gjitha problemet e gjinisë njerëzore, mandej *agnosticizmit*, që do të thotë mohim i ekzistimit të çdo gjëje që në mënyrë empirike ose shkencore nuk mund të argumentohet, autor i para së gjithash ua kundërvë Shpelljen e Zotit.\* Paqëndrueshmërinë e pikëpamjeve materialiste, Behmeni e ilustron me shembuj të nduarnduart të dukurive natyrore, të cilat mendja njerëzore përpinqet t'i shpjegojë, e kur nuk arrin sukses në këtë, atëherë me papërgjegjësi i shmanget t'i pranojë arritjet e

---

\* Për një numër të konsideruar citatesh dhe ajetesh të Kur'anit, autor i shfrytëzoi përkthimet kur'anore, a) Hfq. Muhamed Panxhës dhe të Xhemaludin Çausheviqit, Kur'an Çasni, edicion i Xh. Çausheviqit, Sarajevë 1936 dhe b) Besim Korkutit, Kur'an s prevodom (Kur'ani me përkthim, botim Starjeshinstvo 17, Sarajevë 1989).

përjetimeve subjektive dhe të shpjegimeve të kufizuara të dukurive në fjalë.

Pjesa dërrmuese e artikujve, më parë u publikuan në periodikët e Bashkësisë Islame, në *Takvim*, në *Gllasnik*, në *Preporod*, madje edhe jashtë vendit, në revistën vieneze *Islam und der Westen*. Këto janë rezultat i prirjeve të jashtëzakonshme të autorit që të spikasë disa sjellje të papranueshme në jetën e përditshme të muslimanëve boshnjakë. Duke gjurmuar shkaqet e shprehive negative dhe të pikëpamjeve të gabuara ndër muslimanët, Behmeni i zbérthen dhe i analizon, e pastaj ato ia nënshton kritikës së rreptë, duke gjetur mbështetje të fortë në Fjalët e Zotit, në traditën islame dhe në edukatën e vet tradicionale në fryshtën islame.

Para jush, të dashur lexues, qëndron libri të cilin autori e shkroi në një periudhë të gjatë kohore, duke filluar që nga bankat shkolllore, ato studentore, duke kaluar nëpër vëtmët e burgut e deri te gjiri i ngrohtë familjar në të cilin, fatkeqësisht, Salko, siç e quanin intimisht miqtë e tij, bashkëvuajtësit e dënimit dhe ata që e donin dhe e nderonin, qëndroi dhe u kënaq pak.

Salko, si musliman konsekuent, e dëshmoi këtë me mënyrën e përditshme të jetesës, kurse të tjerëve me fjalën e tij të folur dhe të shkruar u tregonte se nuk kanë arsyë të turpërohen nga përkatësia dhe tradita e tyre islame. Ai gjithmonë i respektoi bindjet e të tjerëve, mirëpo me argumente i dëshmoi dhe i mbrojti edhe bindjet e veta.

Prandaj, nuk do të gabonim nëse Behmenit i përshkruajmë edhe atributin e misionarit, sepse me bisedimet e tij sugestive dhe me shkrimin e tij, arriti të jetë i këtillë. Në kujtesën e miqve të vet, Salkoja mbeti i paharruar si njeri i urtë dhe i qetë, mirëpo edhe mjaft kritik dhe i rreptë ndaj vërvetes, por jo edhe indiferent ndaj botëkuptimeve dhe mënyrës së jetesës dhe sjelljeve të të tjerëve. Këtë cilësi të karakterit të vet, ndoshta vetë autori e shpreh më së miri në mendimin e tij, të cilin e ndeshim në artikullin “Imani dhe dëshmia e tij”, ku thotë: Besimi në Zotin kërkon që ta *pranojmë situatën, por jo edhe të pajtohem me të!*

Me prirje të mprehtë përvrojtim, duke kërkuar me këtë inspirim në Kur'an, Behmeni, qëndrimet e huaja joislame të muslimanëve boshnjakë, të imponuara nga rrëthanat politike-shoqërore, të krijuara në dhjetë vitet e fundit të historisë më të re boshnjake, ia nënshton një kritike rigorozë. Apo, siç thotë njëri nga recensuesit e këtij libri, nga artikujt e Salkos “lexuesi kuption qartë problemet dhe

dilemat që njeriu ynë (musliman) i ka hasur, madje me të cilat edhe sot e kësaj dite ndeshet në këto hapësira, që nga Lufta e Dytë Botërore. Të përkujtojmë: ajo ishte një kohë e ashpër, me përmasa të gjera të agresivitetit të ateizmit shoqëror.” (Xhemaludin Latiq).

Në këtë vepër origjinale është akumuluar një përvojë e pasur që mund t’i hyjë në punë çdo njeriu, i cili dëshiron të jetojë me dinjitet, që e ngritën mbi mentalitetin konsumues dhe i hap rrugë drejt vlerave shpirtërore që krijojnë harmoni ndërmjet mendjes dhe zemrës, ndërtojnë ekilibrin ndërmjet trupit dhe shpirtit, ndërmjet dëshirave dhe mundësive.

Jemi të sigurt se *Përgjigjet Islame* do të japid sqarime për shumë dilema me të cilat ballafaqohen muslimanët e sotëm, madje edhe diç më tepër nga këto sqarime, sepse edhe shumë jomuslimanë mund të gjejnë në to frysëzim, sepse “tekstet e Behmenit, Islamin nga aspekti aktual e trajtojnë në mënyrë *integrale* dhe të nduar-duartë. Kjo është cilësi dhe vlerë e tyre e veçantë...” (Latiq).

All-llahu xhel-le shanuhu le ta bëjë kabull këtë vepër, të cilën rahmetli Salkoja ua la gjeneratave muslimane që e mbijetuan, si edhe atyre që do të rriten dhe do të linden pas tyre.



## NDËRMJETTHËNIE\*

---

Ndërmjet parathënies e pasthënies ekziston mendimi, ideja dhe vepra e autorit Salih Behmen e titulluar “*Përgjigjet islame*.” Edhe pse shumëkush është përpjekur të shpjegojë se ç’fshihet ndërmjet tokës e qiellit, nuk besoj se ka arritur ta ndriçojë në tërësi misterin e Gjithësisë së pakufishme. Prandaj, as unë me këtë ndërmjetthënie, nuk pretendoj të them diç më tepër se autori i veprës në fjalë. Mirëpo, vetëm desha që me këtë rast të spikas qëllimin e kësaj vepre, idetë e saj dhe rrethanat në të cilat lindi dhe u shkrua.

Autori i librit *Përgjigjet islame*, si arsimtar i fizikës dhe i matematikës i njihet mirë ligjet natyrore, fshehtësitë e natyrës, zhvillimet evolutive të këtyre ligjeve, përjashtimet e tyre, në mënyrë të thollë filozofike e shkencore. Mirëpo, tërë këtë zhvillim të shkencave natyrore ai e ndërlidh edhe me njohjen e thuktë të parimeve islame dhe kur'anore. Këtë ide e zhvillon dhe e thellon në kapitullin “Njohuritë shkencore dhe Kur’ani”, ku zhvillon një dialog sa të rreptë aq edhe të argumentuar e të arsyetuar me logjikën e të menduarit, duke u mbështetur në parimet islame, në njëren anë, dhe idetë ateiste e ateizmin në përgjithësi, që u vjen ndesh parimeve islame, nga ana tjeter. Autori flet edhe për zanafillën e ateizmit, për fazat e zhvillimit të tij dhe qëllimet e ideve ateiste. Ai hyn thollë në analizën psikike të njeriut, duke studuar shpirtin si një fenomen të

---

\* E emërtova kështu vështrimin tim të shkurtër, duke u bazuar se libri hapet me parathënien e botuesit, ndërsa mbylljet me pasthënien e autorit. Libri është i vetëmjaftueshëm, por ne deshëm ta pasurojmë edhe me disa venerime tonë. (Shënim i përkthyesit).

përsosurisë njerëzore. Përsosuria shpirtërore duhet të bëhet synim i pérhershëm i besimtarëve islamë.

Autori në këtë vepër, përveç spikatjes së parimeve të shenja islame, shtron edhe probleme të zbatimit të këtyre parimeve në jetën e përditshme te besimtarët islamë. Ai shpeshherë bën edhe vërejtje, duke dëshiruar që të metat, të cilat paraqiten, qoftë te predikuesit e fesë, qoftë te besimtarët, të përmirësohen. Ai analizon hollësisht e me themel si nga aspekti teorik po ashtu edhe nga aspekti praktik, gjendjen politike të shteteve islame në të kaluarën dhe në të tashmen dhe ofron propozimet e zgjidhjet e veta. Atë e brejnë dhe e mundojnë dukuritë negative të shoqërisë dhe të mjedisit, të cilit i takon edhe vetë, ndaj duke qenë tepër alergjik në to, reagon rreptë në çdo situatë, në çdo rast e për çdo problem aktual. I prirur nga parimi se *atë që e pret prej tjetrit, duhet ta bësh vetë*, ai nuk ngurroi të kapet me probleme të mprehta, qofshin ato edhe me pasoja politike të kohës së monizmit bolshevik, për të e për familjen e tij. Në disa raste pati durim vetëm të kundrojë e të përgjojë zhvillimin e ngjarjeve, në mënyrë pasive, por jo edhe indiferente, duke mos marrë pjesë në to, siç ishte rasti me “Bisedë gjatë rrugës” (taksi-bisëda), por në të shumtën e rasteve nuk mundi të qëndrojë indiferent, por u hodh në vorbullën e çështjeve shoqërore, në luftë e përpjekje për të zgjidhur problemet e popullit të vet.

Salih Behmeni, duke pasur një qëndrim të vendosur dhe të paluhatshëm në zbatimin e përpiktë të parimeve islame dhe duke predikuar e sugjeruar vijimisht në biseda të përditshme e në shkrimet e veta të botuara me pseudonime, u përpoq të përmirësojë imazhin e kulturës islame në nënqiellin dhe truallin musliman të Bosnjë e Hercegovinës. Dhe kështu, dasht e padasht, ra në konflikt me idetë ateiste të sistemit komunist të Perandorisë Jugosllave. Sistemi i përgjimit dhe sistemi i përcjelljes dhe ndjekjes së UDBËS, e akuzoi si “nacionalist musliman” dhe “fundamentalist islam” dhe kështu dy herë u gjet para bankës së zezë të gjyqeve serbo-çetnike, duke e dënuar një herë 12 vjet, kurse herën e dytë 5 vjet. Procesi i gjykimit përshkruhet hollësisht në kapitullin “Procesi i Sarajevës ‘83” dhe polemikat e tij me gazetaren Nagorka Idrizoviq. Arsyet dhe shkaqet përse dënohet autor i veprës “Përgjigjet islame” janë aq naive, pa vend dhe pa kripë, por pasojat janë aq katastrofale e tragjike për të, për familjen e tij, për popullin musliman dhe për kufizimin e lirisë jo vetëm njerëzore, por edhe fetare e kombëtare në përgjithësi.

Autori nuk mund të heshtë paraurrejtjes e sulmit të vazhdueshëm të armiqve kundër popullit musliman, ndaj reagon duke i shkruar letër të hapur sinodit të Kishës ortodokse-serbe të Beogradit, ku kritikon idetë dhe porositë e romanit “Metamorfoza” të Lumbardos në të cilin: “vlon urejtja ndaj turqve, turkoshakëve, muslimanëve dhe fesë së tyre”, që përfaqëson një lidhje zinxhiore të kobshme, që shtrihet nga e kaluara e largët, duke qenë shumë larg nga mësimet ungjillore për dashurinë dhe faljen, kthimin e së keqes me të mirë, saqë është vështirë të vihet në lidhje me çfarëdo forme të humanizmit.

Salih Behmeni me parashikimet e tij largpamëse e intuitive parandjeu skenën e kobshme e tragjike në truallin e Bosnjës, duke aluduar: “Askënd mos ta mashtrojë mëngjesi i mirë e me diell i së sotmes” e as “pranvera e rrejshme” e lirisë dhe askush mos të ngutet të thotë se “asgjë nuk do të ndodhë! Dënim i tmerrshëm i Zotit pa prit e pa kujtar mund të lëshojë të gjitha të këqijat mbi ne.” Me këto fjalë i drejtohet sinodit të Kishës ortodokse-serbe në Beograd: “Ky nuk është kurrfarë profetizimi, por përfundim logjik i nxjerrë nga mësimi themelor i të gjithë librave të Zotit, ato të cilët i pranoni Ju dhe ato të cilët i pranojmë Ne.” Autori nuk e priti që vepra të dalë në dritë sa qe gjallë, mirëpo në mënyrë gjeniale paralajmëroi dramën kombëtare serbo-muslimane në Bosnjë e Hercegovinë, e cila mjerisht u bë realitet që tronditi tërë botën. Edhe për këtë vigjilencë, vepra bëhet edhe më indikative dhe me vlerë parashikimi të së mundshmes, që shpërtheu si vullkan i llahtarshëm, duke trazuar gjithë Ballkanin, Evropën dhe mbarë opinionin botëror. Njerëzit e këtillë janë të rrallë në kulturat e popujve botërorë, që mund të parashohin ngjarjet historike në të ardhmen, jo vetëm të popullit të vet, por edhe të popujve fqinj me të cilët kanë fatin e përbashkët, sepse e mira dhe e keqja nuk njojin kufij, ato mund të arrijnë shumë larg dhe të shtrihen anembanë botës.

Veprën *Përgjigjet islamë* të autorit Salih Salko Behmenit, në sajë të kompozicionit dhe trajtimit të çështjeve që merr në shqyrtim, mund ta ndajmë në dy pjesë përbërëse të saj: 1. *Pjesa e parë*: veprimi dhe rezultati, ndërsa 2. *Pjesa e dytë* - pasojat dhe peripecitë e autorit: 1. Meqenëse autori ishte një njeri i kompletuar, i formuar dhe i pajisur me njoħuri të gjera e të thella fetare e shkencore, i cili duke u përpjekur që rezultatet shkencore të zbuluara nga shkencëtarët botërorë t'i harmonizojë me idetë fetare dhe me parimet islamë, u soll në kuadër të këtyre parimeve si një njeri parimor, fisnik e

guximtar, duke e thënë gjithmonë të vërtetën e lakuriuar. 2. Mirépo, regjimit komunist, nacionalë-shovinistëve serbë nuk i pëlqenin sjelljet e Salih Behmenit, ndaj si pasojë se ishte kundër ateizmit komunist e “vëllazërim-bashkimit” dhe padrejtësive të sistemit totalitar bolshevik jugosllav, ku dominonte hegemonizmi serbomadh, dy herë u gjet prapa grilave të burgut, duke pérjetuar golgotën dhe “xhehennemin” e diktaturës dhe të terrorit serbo-çetnik.

Prandaj, mund të konstatojmë se një pjesë e veprës është një autobiografi e autorit, janë vuajtje dhe pérjetime të hidhura të individit, që simbolizojnë njëkohësisht edhe vuajtjet e peripecitë edhe të popullit të vet si kolektiv.

Ky fat i autorit të veprës “*Përgjigjet islame*” si individ dhe fati i popullit të tij si kolektiv, është i ngjashëm dhe identik me fatin e çdo martiri shqiptar të popullit tonë në përgjithësi, që gjendej dhe gjendet nën okupimin *serbo-malazezo-maqedonas*. Pikërisht përkëtë arsyе dhe përkëtë ngashmëri të rrethanave identike politike edhe në trojet shqiptare nën okupimin e ish-Jugosllavisë komuniste, vepra e Salih Behmenit sa vjen e bëhet më e afërt, më e kuptueshme dhe më e pranueshme për çdo besimtar e lexues shqiptar. Në vuajtjet e Salih Behmenit e pérjetimet e tij të hidhura çdo shqiptar i dënuar i ndërgjegjes sheh vuajtjet e veta, pérjetimet e hidhura personale, familjare e kombëtare të popullit shqiptar. Sepse, pérjetimet e Salih Behmenit, mynxyrat e krajobrazit e tij, fymojnë te çdo shqiptar, në çdo shtëpi, çdo lagje, çdo fshat e çdo trevë të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi e të Preshevës, Bujanovcit e të Medvegjës, sepse kemi të bëjmë me të njëjtin armik dhe me të njëjtin okupator. Jo vetëm besimi, por edhe fatkeqësia e njëjtë dhe rreziku nga i njëti armik, i bashkon njerëzit, i afron popujt e hapësirave të ndryshme gjeografike për të luftuar për lirinë e tyre individuale, kombëtare e fetare. Kuptohet se liria nuk fitohet pa vuajtje e sakrifika. Mirépo, çdo njeri apo çdo popull që i parashtron vetvetes një detyrë dhe një qëllim të caktuar, dhe që gjithnjë përpinqet dhe punon pandërprerë për sendërtimin e këtij ideali të lartë e të shenjtë kombëtar e fetar, një ditë patjetër do ta realizojë qëllimin e vet. Sepse, siç thotë autorit: “Kjo botë vërtet është një sprovë e madhe”, megjithatë fati i njeriut nuk është i pashpresë, sepse besimi ofron shpresë dhe ngushëllim. Meqenësejeta është përplot me kurthe dhe ngarkesa të rënda, ndërsa njeriu shpesh mund edhe të gabojë në ndërmarrjet e veta dhe në sjelljet e përditshme të tij, ndaj ai duhet të jetë i vetëdijshëm përlëshimet e gabimet e veta dhe përkëtë viji-

misht duhet t'i lutet All-lahut për mëshirë dhe falje dhe për udhëzim në rrugë të drejtë.

Thënë shkurt e qartë: autori u përpoq me aftësitë e tij maksimalë intelektuale të japë përgjigje për të sotmen dhe të ardhmen e Islamit, duke mpleksur këtu edhe të ardhmen e popullit musliman të Bosnjës. Ai u rropat që të japë shpjegime të qarta për shumë çështje e probleme të mprehta të botës bashkëkohore islame, për gjendjen e popullit musliman në Bosnjë e Hercegovinë, për parimet islame, duke ia kundërvënë teorisë absurde e naive të ateizmit, u përpoq t'i japë përgjigje konkrete, me argumente bindëse e shkencore me vepren e vet origjinale - *Përgjigjet islame*.

*Përkthyesi*



# NJOHURITË SHKENCORE DHE KUR'ANI\*

## Dialog ndërmjet mësimit islam dhe ateizmit

All-llahu xhel-le shanuhu në Kur'an thotë:

*"All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij. Këtë e dëshmuani edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit."* (3:18)

*"Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsyë dhe intelekt."* (3:190)

*"...Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?' Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim."* (39:9)

*"Po, All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët."* (35:28)

*"Ndërsa atyre që u është dhënë dijenia, e dinë se kjo që të është shpallur ty nga Zoti, është e vërtetë dhe se udhëzon për në rrugën e Fuqiplotit, të Lavdishmit."* (34:6)

*"Në këtë Kur'an Ne shtruam çdo lloj shembulli për hir të njerëzve, po njeriu (jobesimtar), më shumë se çdo tjetër është kundërshtar."* (18:54)

\* Shkruar me pseudonim Hamza Abaz.

*“Por jo, ai është plot argumente të qarta në zemrat e atyre që u është dhënë dituria, e argumentet Tona nuk i mohon kush pos të shfrenuarve.”* (29:49)

*“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre, deri sa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”* (41:53)

## HYRJE

---

Sot kryesisht mbizotëron mendimi se shkenca dhe feja e eliminojnë njëra-tjetrën. Konsiderohet se zbulimet shkencore përjashtojnë mësimin fetar dhe se “ligjet natyrore” rrënojnë parimet themelore të fesë. Dhe vërtet ka shumë sish, që përpiken t’i “pajtojnë” fenë dhe shkencën; kjo përpjekje e tyre lë përshtypje të pakëndshme te besimtari i padëshmuar, sepse e sheh qartë se fryma e shkencës bashkëkohore a priori merret si ateiste.

Si ndodhi kjo? Dhe, në të vërtetë, a është i drejtë një mendim i këtillë?

Perëndimi i sotëm, me mundësitë e veta të mëdha tekniqe, me ekonominë e vet dhe me fuqinë politike, është fryshtuesi dhe bartësi kryesor i mendimeve shkencore. Kështu është sot, por kështu nuk ishte në të kaluarën. Gjatë tërë Mesjetës, Perëndimi ishte në një errësirë shpirtërore, ashtu siç thonë vetë historianët e tij. Tërë kontrollin shpirtëror dhe kontrollin e mendimeve në duar e kishte Kisha, e cila pengonte vazhdimisht çdo gjë që nuk pajtohej me dogmat e saj. Ndërkaq, në të njëjtën kohë, ndër popujt muslimanë të cilët ishin bartës dhe përhapës të saj, lulëzonte shkenca. Në gjirin e tyre shkenca zhvillohej lirisht. Lindjen islame dhe Perëndimin e krishterë, i ndante një jaz i madh por lidhjet e vetme reale të tyre qenë luftërat shekullore ndërmjet tyre. Tërë zhvillimi i popujve islamë nuk pati ndikim të madh në Perëndim, sepse Kisha që më parë dënonte çdo gjë që ishte në çfarëdo lidhjeje qoftë me Islamin dhe me muslimanët. Megjithatë, kontinuiteti i mendimeve shkencore prej Lindjes në drejtim të Perëndimit, u ruajt me disa fije të holla nëpërmjet Spanjës.

Tutoria mesjetare e Kishës mbi shkencën nuk arriti të qëndrojë për kohë të gjatë e të përhershme. Shkenca filloi të lirohet nga kontrolli kishtar dhe filloi të zhvillohet krahas, por edhe kundër doktrinës kishtare. Shkenca ‘u laicizua’, ‘u liberalizua’, ‘u materializua’, por edhe ‘u ateizua’.

Kisha - me pikëpamjet e veta ndaj botës, me dogmat e veta, me hierarkinë e të shenjtërve të panumërt (të cilëve u atribuonte fuqi mrekulluese), me ikonat dhe me statujat e veta - e vuri veten në konfrontim me njohuritë shkencore. Meqë e kishte monopolin mbi religionin, ajo fliste në emër të tij dhe për të padashtas e në mënyrë të tërthortë shkaktoi krizën e pikëpamjeve religjioze mbi botën, krizën e atillë që rritej gjithnjë e më tepër përballë sukseseve gjithnjë e më të mëdha që arrinte shkenca në zbulimin e fshehtësive të natyrës.

Ngritja e shkencës në Perëndim ishte në lidhje të ndërsjellë me përparimin ekonomik dhe teknik të popujve të tij. Gjendjet e Perëndimit dhe të Lindjes ishin historikisht reciproke. Kur Perëndimi filloi të përparojë, Lindja muslimane filloi të ngecë.

Shkatërrimi politik i shteteve muslimane, humbja e lirisë, shpejtuan rënien e gjithanshme muslimane. Në një mënyrë të përgjithshme, nuk mund të dallohej shkaku nga pasojat e një gjendjeje të këtillë. Nuk mund të gjendej shtegdalje, por e tërë kjo përfundoi me akuza të ndërsjella, sepse mendimet ndaheshin në dy drejtime. Të arriturat e kulturës islame, e me këtë edhe sukseset e muslimanëve në fushën e shkencës, qenë të humbura për muslimanët, e nëse ndokush pati dobi nga kjo - ata ishin vetëm disa individë nga Perëndimi.

Mendimi i zënë ngoje se feja është kundër shkencës dhe përparimit shkencor, tanë u përhap edhe në Islam. Si argument merrej gjendja e përgjithshme e popujve muslimanë, ndërsa në mënyrë të vazhdueshme injorohej qëndrimi i Kur'anit dhe i haditheve ndaj shkencës dhe kontributi i muslimanëve në shkencë në të kaluarën. Që situata të keqësohej edhe më tepër, vetë muslimanët, politikisht të nënshtruar dhe të zhveshur nga trashëgimia kulturore, humbën fuqinë shpirtërore, ndaj në raport me Perëndimin i kaploj shpirtngushtësia dhe ndjenja e inferioritetit. Muslimanët e shkolluar (mendojmë në ata të shkolluar me standarde perëndimore) ranë viktima e propagandës antiislamike dhe e mendimeve të trilluara dhe të dhënavë të shtrembëruara historike. Ajo që nuk mund të heshtej - faqet më të ndritura të historisë islame, të kulturës dhe të civilizimit

- shpjegohej si rezultat i instinktit barbar, i fanatizmit dhe i sistemit skllavo-feudal, duke ua mohuar të gjitha vlerat morale. Dhe kështu këta muslimanë, duke qenë të ndarë shpirtërisht nga e kaluara e vet islame, nuk gjetën në të nxitje, por e mohuan atë, filluan të turpërohen me atë me të cilën të tjerët do të krenoheshin. Duke kërkuar shtegdalje nga shkatërrimi material dhe nga varfërimi kulturor i bashkësisë së tyre, e meqë kishin humbur kontaktin ideor me Islamin dhe me të kaluarën islame, muslimanët i pranuan idetë e Perëndimit, e bashkë me këto ide ata pranuan edhe pikëpamjet skeptike në mësimin fetar dhe përgjithësisht qëndrimin kritik ndaj religionit. Megjithatë, ata që dëshironin të jenë besimtarë të mirë, në mënyrë instinktive dhe me dyshim u sollën ndaj çdo gjë që vinte nga Perëndimi, dhe meqë largimi nga feja e të arsimuarve bashkëkohorë nxiti të besimtarët mosbesim edhe më të madh ndaj shkencës së Perëndimit dhe rezultateve të saj - u krijuar një pasqyrë e pakëndshme në raport ndaj dëshmive dhe arsimimit fetar, e po ashtu edhe një mendim negativ në marrëdhëni e fesë dhe të shkencës.

Nga kjo buron ndjenja e gjysmëvetëdijshme që në njeriun e arsimuar, sipas rregullit, presim njeriun liberal dhe ateist. A nuk është kështu? A thua ne edhe në mënyrë të pavetëdijshme nuk krijojmë që më parë bindjen për dikë, për të cilin na thonë se është besimtar i mirë, si për njeriun që ka një horizont të kufizuar kulturor dhe shkencor?

Kuptohet se një mendim i këtillë është jo vetëm i padrejtë, por edhe i marrë, mirëpo kjo ndjenjë si pasojë e një realiteti të hidhur për një kohë të gjatë është rrënjosur thellë në ndërdijen tonë.

Ndoshta ndokush do të na e zë për të madhe se kështu është tepruar dhe thjeshtësuar pak. Në të vërtetë, sot qëndrimi i besimtarit ndaj arsimit ka ndryshuar dukshëm, me rezultate të dalluara, mirëpo raporti i fesë ndaj shkencës është ende larg asaj që në mënyrë të përgjithshme dhe pa diskutim të jetë i pranuar si i përshtatshëm. Prandaj, shi për këtë, qëllimi i përmendim qëndrimin e përgjithshëm që mbizotëronte në mënyrë invaduese ndërmjet muslimanëve në periudhën e dekadencës së tyre historike, për arsyet e vetë këtij shqyrtimi në marrëdhëni e fesë dhe të shkencës.

Botëkuptimet bashkëkohore ateiste të përhapura anembanë botës, nuk lindën në mjedisin musliman. Ky mjedis do të mund të ishte larg mësimit islam (historia shënon rëniet e këtilla) mirëpo ateizmi në të, kurrë nuk qe ai që ishte në Perëndim.

Ai gjithnjë ka besuar - nëse dëshironi, ka menduar se beson, sepse ka mund t'i bëhet vërejtje, përkatësisht nga aspekti islam. ‘Ateizmi shkencor’ - siç e quan ai veten - lindi në gjirin e Perëndimit të krishterë, si reagim ndaj doktrinës kishtare, ndërsa në Botën islame depërtoi në fazën e fundit të fuqisë së vet historike para vetë zgjimit.

Njeriu i nënshtrohet primitivizmit në dy mënyra: nga mosdija e plotë ose nga mashtrimi. Së pari, kur besintari me dyshim shikon në sukseset e shkencës. Qëndrimi i tij ndaj shkencës është i parasyeshëm, kurse ndaj fesë i padrejtë dhe i dëmshëm, edhe pse ai këtë as nuk e dëshiron e as nuk e vëren. Meqenëse shkenca po bëhet armë e fuqishme për ndërmarrjet njerëzore, vërtet fantastike, në mesin e besimtarëve mund të gjenden të atillë që janë të prirur që veprimet e këtilla t'i gjykojnë si akte ateiste, si përzierje në caktimin e fatit, si përzierje në punët e Zotit, ashtu siç ngjet dhe dëgjohet shpesh. Madje historia shënon raste të çuditshme, si për shembull rezistencën e botëkuptimit mesjetar lidhur me rrrotullimin e Tokës, refuzimin për t'i dhënë ilaçe të sëmurit, kinse me këtë mos të ndërhyhet në punët e Zotit dhe në dëshirën e Tij, vendosjen e kryerjes së punëve në natyrë me frikë, se me këtë veprim zhduket vepra e Zotit.

Në çdo shoqëri mund të gjendeshin pikëpamje të këtilla, e mund të gjenden edhe sot. Ky është rezultat i mosnjohjes së kërkuesave reale të fesë!

Së dyti, ateistët në sukseset e shkencës shohin verifikimin e qëndrimit të tyre ateist. Mirëpo, pikërisht ata janë të hutuar, sepse shkenca nuk u jep kurrfarë dëshmie për to, por është diç tjetër që i shtyn në vetëharresë dhe në mosbesim. Kur’ani herët e ka tërhequr vërejtjen për këtë, prandaj pas analizave të njohurive shkencore dhe të mësuarit e fesë, kësaj çështjeje do t'i qasemi në fund të këtij shqyrtimi.

### *Apel i fesë drejtuar arsyes njerëzore*

Detyra e të gjithë pejgamberëve të Zotit gjithmonë ka qenë e vështirë. Ata zakonisht kanë vepruar në mjjedise moralisht plotësisht të shkatërruara, që ishte vështirë të bindeshin në vërtetësinë e pejgamberllëkut të tyre, ndaj disa prej tyre si argument patën muhxizet (mrekullitë) si për shembull te Musa a.s. shkopi që shndërro-

hej në gjarpër, ndërsa Isa a.s. shëronte të zgjebosurit dhe të verbërit dhe ngjallte të vdekurit. Këto nuk ishin aftësi mbinatyrore të lindura të tyre, por vepra të kufizuara në kohë dhe për të cilat Kur'ani tregon qartë se janë bërë me lejen dhe urdhrin e Zotit. Veçanërisht është interesant se askund në Kur'an nuk garantohet shprehimisht se Muhammedi a.s. ka pasur muxhize të karakterit të tillë si Musa dhe Isa a.s. Madje, siç shihet, jobesimtarët këtë e kërkonin me muhxize, e pastaj - njësoj, ata nuk u besonin, ndaj në një vend theksohet se besimtarët janë të tillë që edhe sikur ta shihnin vetë xhehen-nemin (e nuk do ta ndjenin), përsëri nuk do ta besonin, por do të pohonin se kanë qenë të hipnotizuar. Kur'ani u nis rrugës tjetër: ai i qaset arsyes njerëzore, duke u përpjekur që me anë të logjikës ta shpie njeriun ta njohë të vetmin Zot të përhershëm, Krijuesin e Gjithëfuqishëm. Në tërë Kur'anin theksohet se ai (Kur'ani) u është dedikuar njerëzve të arsyeshëm, e këto janë udhëzime për ata të cilët mendojnë.

Para së gjithash Kur'ani iu drejtua njeriut, kulturës dhe dijes së atyre kohëve. Me argumente i qaset nga shumë anë që ta bindë për mashtrimin e tij. Isa tërheq vërejtjen se Zoti është vetëm një. I afron të dhëna të thjeshta se nuk ka mundësi të ketë shumë zota, sepse në atë rast secili prej tyre do ta merrte atë që ka krijuar, e pastaj do të bënин gara ndërmjet vete. Toka dhe qelli do të shkatërrohen. Ua tërheq vërejtjen idhujtarëve se idhujt e tyre nuk vlejnë asgjë e as nuk sjellin dëm, se këto gjëra janë më të ulëta se vetë ata, ndaj i pyet se si mund të adhurojnë gjëra të tilla.

Edhe pse për botën e arsimuar sot paganzimi nuk është më aktual, megjithatë, janë mjaft të përhapur ateizmi dhe agnosticizmi. Prandaj argumentet e Kur'anit për ekzistimin e Zotit meritojnë gjithmonë kujdesin tonë. Edhe pse kanë kaluar shekuj, argumentet e tij nuk humbin aspak rëndësinë e tyre. Kur'ani vazhdimisht e udhëzon njeriun në gjërat që qëndrojnë afër tij, gjëra me të cilat është në kontakt të pandërprerë, të cilat shërbijnë si argumente për ekzistimin e një Fuqie shumë të madhe e të arsyeshme, e cila udhëheq me të gjitha këto. Ai ia tërheq vërejtjen për bimët të cilat mbijënnë nga fara, ia kujton se njerëzit dhe kafshët zhvillohen nga një embrion i vogël, i sinjalizon për qumështin, e udhëzon te bleta dhe në punën e saj, në ndërrimin e ditës dhe të natës, në yjet, Diellin, Hënën dhe Tokën... si rezultate të vendimit, dëshirës, fuqisë dhe urtësisë së Një Fuqie të Arsyeshme. Thekson se shfrytëzimi i bimëve,

i kafshëve dhe i gjërave nga njeriu është mëshirë e madhe e Zotit, ndaj e fton që t'i falënderohet Dhuruesit të vet.

Përse këto nuk mund të jenë argumente edhe për ateistët e kohës së sotme? Përse ngjarjet e përditshme në natyrë, manifestimet e jetës dhe ndryshimet e saj nuk do të ishin dëshmi edhe për agnostikun bashkëkohor për ekzistimin e një Fuqie, e cila me dëshirën dhe mençurinë e vet udhëheq me të gjitha këto.

### *Dukuria e verbërisë*

Thelbi i të gjitha religjioneve monoteiste është mësimi i varshmërisë së njeriut dhe i çdo gjëje, që varen prej një Fuqie, të arsyeshme, të vetëdijshme për pushtetin dhe vullnetin e vet. Megjithatë, esenca e kësaj Fuqie nuk është plotësisht e kuptueshme e as e njojur për arsyen njerëzore, sepse ajo është jashtë mundësisë së shqisave tona. Ndërkaq, njeriu për t'i kuptuar gjërat mbështetet në shqisat e veta, me ndërmjetësimin e të cilave identifikon botën e përditshme rrëth vetes dhe rrëth nesh-botën tonë materiale.

Arsyeja njerëzore posedon aftësinë e argumentimit-ndoshta e vëtmja aftësi që e dallon njeriun në natyrë - intelektin me ndihmën e të cilil ai qëmoti kuptoi se ka gjëra ‘të paprekshme’ për shqisat tonë, ekzistencën e të cilave e dëshmoi duke konstatuar ngjarje të nduarduarta dhe duke hulumtuar shkakun e tyre.

Ta paraqesësh këtë botë ‘të paprekshme’ është shumë vështirë. E vëtmja mundësi është analogja, krahasimi me gjëra të njoitura. Kjo shumë lehtë mund të shpiente në paraqitjen e gabueshme të gjërave, në parafytyrimin e gabueshëm të qenësisë së këtyre ngjarjeve, e kjo në të vërtetë ka ndodhur (gjë për të cilën edhe ne gjatë historisë së shkencës shpesh jemi bindur), madje sigurisht ndodh edhe sot.

Realiteti, të cilin e njohim me anë të shqisave, me rezistencën e pranisë së vet të përhershme vepron në arsyen tonë, dhe ne definitivisht e pranojmë si argument të përvojës që nuk mund të mohohet. Në të vërtetë në filozofi kanë ekzistuar (por edhe tanë ekzistojnë) drejtime të cilat dëshirojnë ta zhvlerësojnë realitetin që na rrethon, duke dyshuar në transmetimin adekuat të realitetit nëpërmjet organeve tona shqisore deri në vetëdijken tonë. Megjithatë, kjo edhe më tej mbetet analizë e meditimit të mirëfilltë pa ndonjë vlerë praktike, sepse njeriu në mënyrë të detyrueshme biologjike reagon ndaj

ngjarjeve rrëth vetes, që edhe më tepër cytë manifestimet psikike dhe emocionale, e me të edhe argumentimin moral dhe intelektual.

Neve këtu na intereson, dhe posaçërisht dëshirojmë të flasim për atë - se si veprojnë argumentet e përvojës sonë të përditshme në psikën tonë, e me këtë edhe në arsyen tonë, aq verbërisht saqë është vështirë të kuptojmë të menduarit e diçkaje tjetër jashtë realitetit, që ne tërë atë e quajmë realitet, të cilin jemi në gjendje ta vërtetojmë me anë të shqisave tona. Për arsyen tonë, çdo gjë jashtë përvojës sonë është supozim pérderisa nuk bëhet objekt i eksperimentit tonë. Për shqyrtimin tonë kjo është shumë e rëndësishme, ndaj kemi lirinë që këtë dukuri ta quajmë ‘dukuri e verbërisë’.

Ekziston tregimi se si një ardhacak nga periudha pioniere e Amerikës hasi në një vendës, i cili ia tregoi varrin e ‘krijuesit të Tokës’. Kur ardhacaku shprehu habi për këtë, indiani ia ktheu: “O-o..., po ai nuk ka mundur të jetojë aq gjatë, Toka është krijuar në kohë të lashta!.” Ky është një shembull i qartë se si në vetëdijen e pangritur vepron fakti se kudo në natyrë mbretëron vdekja.

Mësimi themelor i fesë është se Zoti është i amshueshëm - i pérhershëm dhe i pérjetshëm. Ky qëndrim është i pakapshëm për arsyen e njeriut, prandaj ka qenë objekt shqyrtimi i vazhdueshëm filozofik. Arsyja jonë është mësuar se ajo që ekziston mund të mendohet se ka një ekzistencë të amshueshme në ardhmëri, mirëpo hutohet kur duhet ta mendojë të kaluarën e amshuar, të mendojë diçka që nuk ka fillim. Arsyja e njeriut është e verbuar nga argumentet të cilat është në gjendje t'i identifikojë, dhe këto për të bëhen masë dhe rregull në vlerësimin e asaj që ekziston jashtë ekspozimit të tij. Jemi mësuar ashtu që në ndërrime dhe në kalime të shohim fillimin e çdo gjëje dhe thjesht konkludojmë: Ekziston, do të thotë se dikur është krijuar. Këtu rezonimi njerëzor gjendet ngusht, dhe ndoshta më së miri shpjegoi Kanti se ku qëndron vështrësia e përsiatjes njerëzore lidhur me Zotin, për botën tjetër, përfundin dhe pafundësinë e botës, për amshueshmërinë ose për kufizimin kohor etj. (Kalimthi të përmendim se Kanti përfundoi se ekzistimi i Zotit dhe domosdoshmëria e botës tjetër janë bërë për shkaqe morale). Analiza subtile na shpie në palogjikshmëri, mirëpo kjo palogjikshmëri nuk qëndron në thelbin e vetë gjërave (siç do të bindemi më vonë), por në kuptimin e mundësive të arsyses sonë, që në të kuptuarit e saj vepron me koncepte të njobura.

Kjo ndodhje vijimisht gjatë historisë së meditimit njerëzor, kur ai fluturonte përtëj kufijve të përvojës në fushën e spekulimit të

mirëfilltë, duke bërë supozime mbi bazën e rregullave të verifikuar, që ai i quan ligje natyrore. Kjo ndodh edhe sot.

Këtu ekziston rreziku i vërejtjeve të materialistit dhe agnostikut që t'i përshkruajmë Zotit, kur flasim për Të, atributet me të cilat arsyja jonë nuk është në gjendje të veprojë e të mos bie në paralogjikshmëri. Kjo vërejtje është krejtësisht e pavend. Të kujtojmë vetëm se në çfarë kundërthëniresh na sollën zbulimet në fund të shekullit XIX, të cilat i demantuan të gjitha parimet e deriatëhershme që fizika i konsideronte se mbretërojnë në natyrë, si p.sh. parimi i harmonizimit të shpejtësive dhe parimi i zbulimeve mbi shpejtësinë konstante të dritës dhe mendimi i sotëm i Ajnshtajnit për to.

### *Interpretime të gabuara të fakteve eksperimentale*

Nuk do të thotë se vetëm njeriu i kufizuar shpirtërisht mund të mashtrohet dhe të verbërohet nga faktet. Viktimë e tyre mund të bëhen edhe njerëzit më të ditur. Historia e shkencës është përplot me shembuj të këtillë.

Aristoteli, duke vërejtur zënien (errësimin) e Hënës dhe duke menduar për të, nxori përfundim plotësisht të drejtë se Toka është e rrumbullakët. Mirëpo, ai hodhi poshtë mendimin e të tjereve se Toka sillet, duke e shpjeguar këtë me vërejtjen se sikur Toka vazhdimisht të sillej do të hetonim erën që do të frynte në drejtim të rrotullimit të saj - njësoj si kur vozitemi dhe e ndjejmë rrymën e erës në fytyrë-dhe kur kërcejmë lart në vend, do të na ikte një pjesë nën këmbë, e që kjo nuk ndodh, sepse gjithmonë kthehemë në të njëjtin vend. Ne të gjithë sot e dimë se Toka sillet - pra, në këtë rast Aristoteli nuk ka pasur të drejtë, edhe pse vërejtjet e tij kanë qenë plotësisht me vend. Toka vërtet sillet, e se ne nuk e hetojmë erën në drejtimin në të cilin sillet dhe se kur kërcejmë përpjetë gjithmonë kthehemë në të njëjtin vend-për këtë ekziston arsyet tjetër, për të cilën Aristoteli nuk ka ditur, madje nuk ka mundur as të supozojë. Ai ka qenë i verbuar me faktet e përvojës së përditshme, pasojat e rrotullimit ai i ka zbatuar krejt logjikisht në sjelljen e Tokës, duke pritur efekte të njëjta. Meqenëse efekte nuk kishte, për të pohimi për rrotullimin e Tokës ishte i paqëndrueshëm.

Ta kujtojmë vetëm Kolombon se si kaloi me kokat më të ditura të kohës së vet, të cilëve u detyrua t'u drejtohej për bekim që ta realizojë mendimin e vet - të shkojë në Indi, duke lundruar gjithnjë në

Perëndim - dhe kur ua dëshmoi se Toka është e rrumbullakët, e me këtë edhe plani i realizueshëm. Ne sot mund të qeshim pa të keq me mosnjohjen e tyre të gjërave, mirëpo Kolomboja nuk diti t'u përgjigjet vërejtjeve të tyre. Derisa disa menjëherë e lëshuan tubimin, duke pandehur se kishin përparrë një budalla me të cilin nuk vlen të bisedohet, të tjerët - disa duke u tallur, e disa të tjerë seriozisht, bënin vërejtje në pohimin e tij se Toka është e rrumbullakët.

“Pra - konstatonin ata - në anën tjetër të Tokës njerëzit ecin me kokë te poshtë si mizat në tavan. Si mund të ndodhë të mos bien nga Toka në humnerë të pafund?”

Edhe sot fëmijët në shkollë bëjnë vërejtje të ngjashme, ndërsa mësuesit e tyre kanë përgjigje për to, kurse Kolomboja nuk pati përgjigje për kritikuesit e tij. Ai asgjë nuk dinte për gravitacionin, e nuk dinin as të tjerët. Prandaj vërejtjet e veta atyre u dukeshin të mençura, të logjikshme dhe me vend. Ata qenë viktima të faktit se të gjithë trupat bien tatëpjetë. Ata janë verbuar me këtë fakt. Nuk çuditeshin me këtë, kjo për ta ishte realitet, eksperiment i fakteve të përditshme dhe ata e kanë pranuar si të këtillë.

Ne sot e dimë se ato “poshtë” e “lart” të tyre shkenca i konsideron plotësisht të pakuptimta në vlerat absolute, se këto mund të merren vetëm si vlera relative, ndërsa si shprehje teknike nuk na obligojnë në kurrfarë vlerash reale, absolute të këtyre koncepteve.

Ata kanë mundur t'ia sqarojnë vetes përsë trupat bien poshtë: për shkak të peshës. Për konceptin ‘peshë’ mësuan nga përvoja dhe qenë të mashtruar! Ata e konsideronin plotësisht normale që të gjithë trupat të kenë ndonjë peshë, dhe shi për këtë, është plotësisht e logjikshme që të bien poshtë. Ndërsa shkenca e sotme na thotë se pesha nuk është kurrfarë cilësie e materies; kjo është bindja jonë si pasojë e veprimit të fuqisë së peshës në trupat materialë.

Të kujtojmë vetëm parafytyrimet klasike të Njutnit (Newton) për hapësirën dhe kohën (të cilat Njutni nuk i shqyrton, por i pranon a priori si argumente dhe në to vendos trupat e vet materialë), pastaj për materien dhe energjinë dhe në thelb për ndarjen e tyre rigorozë. E ç’ka mbetur nga gjithë kjo? Meqë shumë koka të ditura refuzuan ta pranonin Teorinë e relativitetit - sepse me pranimin e saj detyroheshin të braktisnin shumë gjëra të qarta, por të vjetëruara në shkencë - përvoja shkencore më në fund na bindi se zgjidhje tjetër nuk ka.

Përderisa Njutni heshtazi e pranoi hapësirën si të pafund, që do të thotë në kuptimin euklidik e pakufishme, si diçka që i imponohet

njeriut si argument i qartë, për mendimin subtil filozofik kjo paraqiste vështirësi, të cilën hollësisht e përpunoi Kanti. Kanti shprehte mendimin se parafytyrimet tona për hapësirën, e po ashtu edhe për kohën, janë kategori që lindin bashkë me njeriun, sepse mendja e njeriut nuk është në gjendje t'i parafytyrojë gjërat jashtë hapësirës dhe kohës. Kur u paraqit kriza në shkencë lidhur me zbulimin se shpejtësia e dritës nuk i nënshtronhet parimit të harmonisë së shpejtësisë - parim që deri diku është i logjikshëm dhe ligj i verifikuar eksperimentalisht - mendja e njeriut ra në dilemë të thellë si t'ia shpjegojë vetes "palogjikshmérinë" që bashkekziston në natyrë. Atëherë me mendjemprehtësi hetuan se themelet e ndërtesës shkencore u shkatërruan, mirëpo për çudi ndërtesa e shkencës edhe më tutje mbeti, prandaj pasoi arsyaja e shqetësuar njerëzore se në çka qëndron ajo ndërtesë. Sa befasi njerëzore pati kur Teoria e relativitetit e Ajnshtajnit (Einstein) e zgjidhi nyjën, duke u nisur pikërisht nga argumentet e zbuluara në shpejtësinë konstante të dritës dhe në parimin e harmonizimit të shpejtësisë - si në të vërtetë, nga aksionet fizikale (pa marrë parasysh se arsyaja njerëzore i ka konsideruar të palogjikshme, që në mënyrë të ndërsjellë përjashtohen), dhe prej tyre nxori pikëpamje të pamohueshme matematikore, të cilat rrënuan të gjitha parafytyrimet e deriatëershme për hapësirën dhe kohën si dhe për materien dhe energjinë. Zbuluam se kemi medituar me nocione dhe për nocione të cilave u kemi dhënë kuptime krejtësisht të gabuara, sepse kemi qenë të mashtruar nga imagjinata. Atëherë na ka rënë ndër mend se nuk kemi pasur parafytyrim të qartë as për hapësirën as për kohën, edhe pse nga përvoja kemi ditur për to, dhe - sa e çuditshme është kjo! - tanë është dëshmuar se këto janë realitetë fizikale aq sa janë edhe atomet. U dëshmuar se koha dhe hapësira nuk janë domosdoshmëri mendore - siç kishte menduar Kanti - por janë fakte të ndjeshme eksperimentale.

Tash po shohim se sa e pabazë ka qenë pyetja me të cilën është kërkuar që Qenia e Zotit të lokalizohet nga aspekti kohor dhe hapësinor. "Ku është Zoti dhe prej kur ekziston?" - pyetje të këtilla dhe një varg nënpyetjesh zinxhirore, me të cilat synohej që mësimi fetar të vihet kinse në palogjikshmëri, e me këtë të mohohet ekzistenca e Zotit - ndërsa në realitet fjala ishte për konstruktimin e lirë të cilësive hapësinore dhe kohore, e në ç'drejtim kemi qenë të mashtruar nga imagjinata.

Natyrisht, njeriu mund të thotë se në thelb nuk është aq e rën-dësishme se ne kohë pas kohe duhet t'i ndërrojmë parafytyrimet për

ngjarjet reale, sepse njeriu përfundimisht gjithnjë e më tepër po hyn në thelbin e dukurive dhe të objekteve dhe po zbulon shkakun e tyre të mirëfilltë. Pikërisht ashtu le të jetë (e në të vërtetë është), mirëpo po shtrojmë këtë pyetje: si kanë mundur njerëzit në të vërtetë ta konsiderojnë Tokën pllakë të rrafshët - dhe këtë e kanë konsideruar të natyrshme dhe normale vetëm për atë arsyen sepse e këtillë u është dukur! Si kanë mundur njerëzit të mendojnë se trupat janë të rëndë, se çdo trup ka ndonjë peshë, dhe këtë e kanë konsideruar të natyrshme, normale, dhe nga kjo kanë nxjerrë përfundime (natyrisht të gabuara), e kjo ka qenë vetëm iluzion dhe mashtrim pas të cilit është fshehur fakti tjetër. Si ka qenë e mundshme që dijetarët, kohës dhe hapësirës t'i jasin cilësi të vlerave absolute, duke i marrë vetveti si diçka plotësisht e qartë, e natyrshme, normale, ndërsa kjo ka qenë shumë larg nga e vërteta? Si ka qenë e mundshme të vlerësojmë se ekziston lëvizja absolute dhe këtë ta pranojmë si diç normale dhe të natyrshme, ndërsa sot po shohim se ekziston vetëm lëvizja relative?

Për ne është e kuptueshme - por vetëm sot - përsë Toka ka formën e topit dhe përsë në pole është pak e shtypur. Ajo ndryshe as që ka mundur të formohet derisa ka qenë në gjendje të lëngët. Së pari është dashur të ndodhë nga shtypja sipërfaqësore e lëngut, ndërsa pastaj nga fuqia centrifugale.

Tash nuk mund të çuditemi nga mendimet primitive për shkak të aq shumë palogjikshmërive reale kur kanë menduar se Toka është një pllakë që qëndron mbi diçka, e kjo diçka patjetër do të duhej të ketë një mbështetje tjetër dhe kështu vazhdon në paskajshmëri, ndërsa në realitet zgjidhja është shumë më e thjeshtë dhe më e urtë: Toka rri pezull në gjithësinë hapësinore dhe ka forcën têrheqëse në mënyrë që e tërë ajo që është e lëvizshme në të të mos ndahet nga ajo dhe të zhduket në absurditetin e gjithësisë.

Neve sot, shumë lehtë na fle në mendje Teoria e relativitetit, jemi mësuar të mendojmë brenda kornizave të saj; na është e kuptueshme dhe e afërt si peizazh, i cili qartësohet gjithnjë e më tepër derisa të zhavaritet mjegulla.

Mirëpo pyesim, si është e mundshme që mendjes së njeriut t'i duket diç normale dhe e natyrshme kur s'është aspak e saktë?

Mendja e njeriut shpesh është mashtruar në dukje të parë, duke menduar se kjo është fakt, se është realitet, ndaj është mësuar me të. Kurse ne jemi bërë robër të fakteve. Ato (faktet) na impresionojnë, shpirtërisht na verbojnë. Për ne fakti nuk mund të jetë i pa-

logjikshëm, sepse ai ekziston dhe ne mbështetemi në të, ashtu siç ndodh me aksiomat kur ndërtojmë ndërtesën e logjikës së rezonimit tonë. Kjo fle në psikën tonë aq thellë saqë edhe mendjen tonë e detyrojmë ta pranojë si një gjë e natyrshme dhe normale dhe vetveti e kuptueshme.

E Kur'ani pikërisht tërheq vëmendjen që mos të pranojmë gjithçka ashtu siç na duket, por të meditojmë çka fshihet pas këtij realiteti.

### *Gjurmimi i shkaqeve të ndodhive. Çështja e kritereve tona*

Ne sodisim bimën që rritet, duke e pasur plotësisht të qartë se si ndodh kjo: fara, e cila bart në vete embrionin e jetës, në një shkallë të caktuar të temperaturës dhe të lagështisë, nga faktorët e caktuar gjenetikë të trashëguar, zhvillohet në bimë të llojit përkatës.

Kjo na duket e kuptueshme, logjike dhe e natyrshme-ne në mënyrë ideore i jemi përshtatur plotësisht kësaj dukurie. Ky realitet është aq i qartë dhe aq i pranishëm, ndaj as nuk e hetojmë se si e mashtrojmë veten me faktin se si me këto argumente e përshkruajmë thelbin e përgjigjes, përse ndodhi kjo. Në të vërtetë ne jemi të hutuar, ku hedhemi në çdo hap nëse mendojmë se kjo është përgjigje në pyetjen përse ndodh diçka. Me këtë ne vetëm mësojmë kushtet dhe rrethanat se si ndodh diçka, por jo edhe shkakun e vërtetë të ngjarjes përse ndodh diçka.

(Rreth kësaj “përse” është krijuar gjithë ai pështjellim, ndaj vetvetiu ka edhe kuptim të pacaktuar, meqë përgjigjet janë dhënë në kuptimin shkakor, në kuptim *për ç'arsye*; përkatësisht në kuptimin entelehik, *për çfarë arsyen* ndodh diçka).

Koncepti bashkëkohor i ndodhive dhe i shkaqeve të këtyre ngjarjeve u formua duke mënjanuar postulatet e dikurshme klasike për primaritetin e materies, kështu që i gjithë realiteti u ngërthye në pasurimin e energjisë dhe në veprimin e fuqisë (së gravitacionit, fuqisë nukleare ose elektromagnetike). Mirëpo, mos mendoni se me këtë keni marrë përgjigjen në pyetjen *përse* (ose më mirë të themi *për çka*) ndodh diçka, meqë nuk e dimë esencën e këtyre fuqive, edhe pse shohim pasojat e veprimit të tyre. Ne i kemi emërtuar, por esenca e veprimit të tyre nuk na është e njojur.

Ne e dimë Ligjin e rënies së lirë, mirëpo ky ligj nuk është shkak i rënies së trupave, por në mënyrë të përbledhur matematikore tregon *se si* ndodh kjo. Po kështu tekstualisht gabojmë edhe kur themi se dy elektrone e tërheqin njëri-tjetrin, sepse njëri është pozitiv, ndërsa tjetri negativ. Ne në të vërtetë e dimë se disa elektrone tërhiqen, ndaj sipas disa veçorive, njërin e kemi quajtur pozitiv, ndërsa tjetrin negativ, mirëpo përsë ata e tërheqin njëri-tjetrin, ne nuk e dimë shkakun kryesor. Sigurisht që vepron ndonjë fuqi - e këtë ne e kemi quajtur fuqia elektrike; e dimë *se si* ndodh kjo, mirëpo thelbi i kësaj fuqie për ne është i panjohur. Të gjitha ato që ne i quajmë ligje natyrore kanë të bëjnë me faktin e përshkrimit të kushteve dhe të mënyrës se si veprojnë proceset në natyrë.

Nuk duhet harruar vetëm se sa kohë të gjatë jemi mashtruar me *eterin*, sepse kemi qenë të shtrënguar ta mendojmë-sipas analogjisë së zërit-se edhe drita përhapet me anë të mediumeve. Madje *eterit* i kemi atribuar cilësi nëpërmjet zhvillimit logjik të mendimeve, ndërsa sot jemi të shtrënguar që këtë mendim për eterin ta braktisim plotësisht, sepse nuk arritëm ta argumentojmë, ndërsa zbulimet flasin kundër këtyre argumenteve me cilësi të konstruktuara lirisht nga ana jonë.

Mendja jonë sot kundërshton kundër pikëpamjeve të pakontestueshme të formuara matematikisht, se ne kurrë nuk do ta arrijmë e as nuk do ta tejkalojmë me çfarëdo shpejtësie të sillemi pas saj, shpejtësinë e dritës, që don të thotë se drita e dërguar largohet prej nesh me shpejtësi konstante prej rrëth 300.000 km/sek. Kjo akoma është e pakapshme për mendjen tonë dhe tërë dija njerëzore ngrihet kundër kësaj-mirëpo, ky është fakt që bie ndesh me atë që ne e quajmë logjikë. Duket sheshazi se ne duhet patjetër t'i ndërrojmë nocionet e deritanishme dhe kuptimin e tyre. Këtë e kemi bërë bashkë me revolucionin e botëkuptimeve tona. Me këtë, ndër të tjera, Teoria e relativitetit zgjidh çështjen e stërlashtë filozofike: a është hapësira e gjithësisë e kufizuar apo e pakufizuar - duke na shpjeguar se gjithësia është ‘definitive’, por e ‘pakufishme’ - dhe duke u dhënë këtyre koncepteve kuptime të reja në atë mënyrë që të mund t'i harmonizojmë dhe t'i përshkruajmë besnikërisht me zbulimet e të vërtetave të reja shkencore.

Kështu, ka ndodhur shpesh që gjatë zgjerimit të kufijve të përvojës sonë kemi hasur në palogjikshmëri në raport me njohuritë tona të deriatëhershme - që na ka shtrënguar t'i korrigojmë kriteret dhe vlerësimet që kanë qenë në përdorim deri në atë kohë.

Ne ende i shikojmë natyrat valore dhe korpuskulare të dritës si argumente të cilat e demantojnë njëri-tjetrin. Megjithatë, edhe njërin edhe tjetrin duhet domosdo t'i pranojmë si përvojë e së vërtetës së verifikuar. Me anë të ekuacioneve të papërcaktuara të Hajsenbergut përpinqemi që t'ia sqarojmë vetes dhe t'ia bëjmë sa më të pranueshme.

Kur i kujtojmë të gjitha këto gjatë historisë së shkencës dhe të njoħurive shkencore, atëherë shumë më të qetë dhe më të arsyeshëm mund t'i shqyrtojmë çështjet e stërlashta të religionit-të cilat e mundojnë mendjen e njeriut-për përgjegjësinë morale të njeriut, pér veprat e veta dhe pér fatin e paracaktuar, ku që të dyja këto në tèrë Kur'anin theksohen qartë. Nga ana e logjikës së njeriut kjo gjithmonë ka qenë vështirë të kuptohet dhe s'ka dyshim se ne gjendemi në mundësinë e fundit të meditimit tonë. Këtu kemi të bëjmë me kriterin e rezonimit tonë.

Se me të vërtetë kemi të bëjmë me kriteret tona, ja edhe një shembull: filozofia ka pranuar paaftësinë e vet se si t'i shpjegojë njësitë e pandara të menduara të materies. Duke e thërrmuar matieren (e menduar), domosdo arrijmë në një skaj, sepse është e pamundshme të shkojmë në paskajshmëri. Në të vërtetë, e tèrë kjo botë është e ndërtuar nga disa njësi, njësi të diçkasë. Këto njësi kanë vlerë të caktuar-zënë një pjesë të hapësirës në gjithësi dhe kanë njëfarë trajte - dhe si të tilla përsëri mund t'i ndajmë. E kjo na shpie në pafundësinë e pamundshme. A do të thotë kjo se nga ky paradoks mund të nxjerrim përfundim pér mosekzistimin e botës, ose çkado qoftë tjetër, si pamundësi logjike? As këtë nuk mund ta pohojmë, sepse duke nxjerrë ndonjë përfundim ne pranojmë realitetin ndaj vvetves dhe ndaj mendimeve tona. E vëtmja çështje që na mbetet është të merremi me saktësinë e kritereve tona.

### *Nuk kemi të bëjmë me të kuptuarit, por me të mësuarit*

Njeriu gjithnjë është viktimë e koncepteve dhe faktave të fitura, ndaj gjithnjë sillet në kuadër të tyre.

Pér shembull ne në momente edhe mund të çuditimi me funksionimin e radios, telefonit, televizorit. Edhe pse parimet e veprimit të tyre i kemi mësuar në shkollë, megjithatë kjo ende është e çuditshme pér ne. Mirëpo, fëmija i vogël, që i përket civilizimit bashkë-kohor nuk çuditet pér këtë, po ashtu siç nuk çuditet fëmija i katundit

për rritjen e bimës. As ne nuk çuditemi kur shikojmë se si rriten grunajat, sepse ne këtë e kemi vërejtur që nga fëmijëria, ne këtë e pranojmë si fakt dhe në të nuk shohim asgjë që do ta hutojë mendjen e njeriut. E do të duhej të çuditemi.

Vëreja njëherë se si një fshatar, i cili kishte jetuar larg çdo civilizimi, edhe pse nuk ishte i marrë, u tremb dhe u hutua kur dëgjoi zërin e njeriut, të qeshurit dhe këngën nga kutia e gramafonit. Si mund të ndodhë që ky njeri plotësisht i pjekur, në të vërtetë anal-fabet, por megjithatë inteligjent, ishte i habitur nga një risi teknike, ndërsa një fëmijë i vogël që i përket civilizimit bashkëkohor nuk çuditet për këtë? Ky është një shembull i mirë i dukurisë së verbërisë. Ky fshatar është mësuar nga përvoja jetësore se vetëm njerëzit flasin, ndaj është hutuar nga ky realitet, e për këtë nuk është as i vetëdijshëm, ndaj ai domosdo do të çuditej.

E shikoni - që është jashtëzakonisht interesante -ai nuk çuditet aspak për zhvillimin dhe rritjen e bimëve dhe të kafshëve, ndonëse shikuar objektivisht kjo për shkencën ende është e paspjegueshme, e jo gramafoni.

Sot fëmija i qytetit gjithnjë e më pak është në kontakt me natyrën. Madje edhe lodrat e tij janë makina mekanike në botën e të cilave ai do të punojë dhe do të jetojë edhe kur të rritet. Natyra për të bëhet gjithnjë e më e huaj. Para do kohe gazetat njoftuan se si fëmijët e një shkolle të Nju-Jorkut vizituan një fermë që të shohin, siç u është thënë, kafshën, lopën, nga e cila marrim qumështin. Kjo për ta gjithsesi ishte një përjetim i rrallë!

Që ta shpjegojmë këtë edhe më mirë, po sjellim ndërmend një eksperiment të këtillë:

Një fëmijë edukohet kryesisht në mjedisin e aparateve elektrike dhe elektronike. Është krejtësisht i izoluar nga natyra: as nuk ka mësuar e as nuk ka përvojë për njojuritë e botës bimore dhe shtazore. Ai, duke mos pasur kurrfarë përvoje, gjithë pajisjen teknike e cila e rrëthon, vetvetiu e pranon si diçka krejtësisht të arsyeshme. Kjo për të është argument i cili nuk kundërshtohet me ndonjë imajinatë, sepse ai ende nuk ka njohuri as shkencore e as të përfituar nga përvoja.

Duke u shkolluar, tek ai lind kureshtja, ndaj ai mund të interesohet për disa gjëra të caktuara dhe për origjinën e tyre. Me kalimin e kohës ai do të fitojë sqarime shkencore për funksionimin e botës së tij.

Mirëpo, çdo mëngjes ai blen bukë dhe qumësht nga shitorja përdhese, që gjendet aty pranë rrrokaqellit të tij. Një mëngjes kthehet pa blerë bukë me arsyetim se i kanë thënë se ende nuk ka ardhur buka. Meqë është tepër kureshtar, do të pyesë se prej nga vjen buka. Dhe në përgjigjen se buka vjen nga furra, ai do të shtrojë pyetjen tjeter: "E qumështi?"

Prindërit janë në dilemë dhe nuk dëshirojnë të lëshohen në sqarime të hollësishme, sepse fëmija nuk do të pushojë duke shtruar një varg pyetjesh tjera. Ata e ndjejnë veten të paaftë se nuk janë në gjendje t'ia shpjegojnë fëmijës këto gjëra. Që ta kuptojë fëmija këtë, domosdo duhet shpjeguar me anë të termave për të cilët ai ende nuk di asgjë. Prandaj, prindërit i përgjigjen shkurt, se buka vjen nga furra, kurse qumështi nga qumështorja. Ata intimisht e hetojnë se kjo nuk është përgjigje e drejtë dhe në një masë të caktuar e kanë mashtruar fëmijën. Në të vërtetë ky nuk është shpjegim i mirëfilltë, edhe pse formalisht është i drejtë. Mirëpo, prindërit ngshtëllohen, sepse ai më vonë, kur të rritet, kur të bëhet më i mençur, do të njihet me gjendjen reale, e veçanërisht me anë të përvojës jetësore.

Me siguri, në të shumtën e rasteve, fëmija nuk do të pyesë më tutje.

(Mos dyshoni në të! A ju ka pyetur fëmija ndonjëherë se prej nga vjen rryma ose se si bëhet televizori? E nëse ju ka pyetur, si i jeni përgjigjur?). Ai vetë do të imagjinojë parafytyrimin për furrën dhe për qumështoren, si vende ku gatuhet buka dhe ku përpunohet qumështi. Në të njëjtën mënyrë edhe në shkollë mësojnë se nga fuqia e peshës trupat bien në Tokë dhe se Dielli me gravitacionin e vet i detyron planetët të sillen rrith tij, e që ai të mos pyetë se ç'janë nga vetë natyra e tyre këto fuqi, madje as nuk i shpjegohet se kjo ndodh për shkak të përthyerjes së hapësirës, siç na mëson Teoria e relativitetit; njohja me këtë teori është paraparë në klasat më të larta.

Po ashtu, fëmija mëson se rrufeja shkaktohet nga zbrazjet elektriqe, por ai nuk pyet se ç'janë sipas cilësisë së tyre elektronet positive dhe negative. Ai vetëm e di se ato ekzistojnë - i sheh efektet e ekzistimit të tyre; këto janë argumente për të, ndaj ai nuk lodh kokën për to. Të gjitha këto janë dukuri 'normale' për të. Parafytyrimi i tij është se ato janë disa toptha (ndërsa ai topin e njeh fort mirë) por shumë, shumë të vegjël, që nuk mund të shihen me sy.

Paramendoni se ky fëmijë është bërë djalosh me arsimim të plotë, me njohuri të gjera nga matematika, nga fizika dhe nga kimia, dhe tani e dërgoni në natyrë, në ndonjë ekonomi bujqësore. Ja tregoni atë qenie të çuditshme katërkëmbëshe nga e cila fitohet qumështi, ia tregoni insektet e vogla prej të cilave fitohet mjalti, ia tregoni shpezën e çuditshme që bën vezë, tregoni diç të mrekullueshme që sjell fruta - molla aq të këndshme për të, tregoni në fushë grurin që rritet dhe piqet, dhe sjell fryt nga i cili bëhet buka. A mund ta parafytyroni habinë e tij, përkundër arsimimit dhe intelektit të tij?

Shtrojmë pyetjen se a ka ai të drejtë të çuditet, kurse ne të mos shprehim habi? Ne do të themi se ai nuk i kupton proceset se si zhvillohen gjërat. Dhe, do të shtojmë: "Për ne është e qartë, ne e dimë se ç'ndodh." Mirëpo, këtu ne mashtrohemë keq. Ne këtë nuk e dimë, në të vërtetë, dimë shumë pak. Ne nuk habitemi, sepse jemi mësuar me to dhe jemi pajtuar me faktet, e kurrsesi për arsyen se na është i qartë thelbi i ngjarjes.

Të kujtojmë njohuritë shkencore të periudhës së Sokratit dhe t'i krahasojmë ato me njohuritë tona! Sokrati ka mundur të thotë: "Di që asgjë nuk di." Megjithatë edhe atëherë pjesa dërrmuese e njerëzve nuk kanë shprehur habi si edhe sot! I kanë pranuar gjërat ashtu siç janë ose thënë më saktë, ashtu si janë dukur dhe si i kanë mësuar, duke i pranuar si të vërteta. Natyrisht se ata janë përpjekur që të japid shpjegime dhe t'i zbulojnë shkaqet e kësaj, siç përpinqemi edhe ne sot. Edhe ata kanë qenë të befasuar, por vetëm atëherë kur një gjë ka qenë e pazakonshme. Masa dërrmuese është tmerruar nga zënia e Diellit, edhe pse në thelb është si perëndimi i përditshëm i tij në mbrëmje. Mirëpo, të perënduarit nuk i ka frikësuar, sepse nga përvoja e kanë ditur se të nesërmend Dielli përsëri do të lindë, ndërsa errësimi i tij u ka ardhur pa pritur. Sikur pozita e Diellit, Hënës dhe Tokës të ishte në një rrafshirë gjeometrike të përpiktë, zënia e Diellit do të bëhej në mënyrë simetrike si edhe fazat e Hënës, ndaj do të mësoheshin në këtë dukuri; kjo ngjarje vetveti do t'u ishte e kuptueshme.

E çdo t'i thoshit ju këtij djaloshi? A do t'i thoshit edhe ju: "Këtu s'ka asgjë të çuditshme, kjo është e natyrshme, të gjitha këto ndodhin sipas ligjeve natyrore."

E përse atëherë çuditet ky, kur të gjitha këto janë të natyrshme, kur ai i di ligjet natyrore?

Në të vërtetë, ai ato ligje i njeh në formë tjetër dhe në manifestime tjera, por ky nuk është arsyetim për një mosbesim të këtillë të tij.

Ju gjithsesi do të përpinqeni t'ia shpjegoni, edhe pse kjo çështje kërkon kohë dhe mund. Do t'i shpjegoni se ekzistojnë farat (dhe do t'ia tregoni), se ato nën ndikimin e lagështisë dhe nxehësisë së Diellit (ose siç thuhet: në kushte të volitshme) mugullojnë, e kjo nën ndikimin e peshës së Tokës lëshon rrënjenë në dhë, ndërsa kërcyelli me gjethë, synon drejt dritës dhe Diellit. Do t'i tregoni përfrytnimin, përkromozomet dhe përgjenet, përasimilimin, përndikimin e CO<sub>2</sub>, përklorofilin etj.

Në qoftë se ai pyet si është e mundur që të ndodhë kështu, ju do t'i përgjigjeni se kjo ndodh nën ndikimin e ligjeve natyrore, si pas atyre ligjeve të ngjashme në bazë të të cilave zhvillohen proceset edhe në botën e tij të elektroneve.

Mirëpo, në të vërtetë në njëfarë mënyre ju e mashtroni, po në atë masë siç e kanë mashtruar prindërit kur i kanë thënë se buka vjen nga furra, kurse qumështi nga qumështorja. Ju i përdorni fjalët ‘ligje natyrore’, duke u dhënë kuptim krejtësisht të gabuar.

Ju i tregoni përrrethanat në të cilat ndodh krejt kjo, përmënyrën se si ndodh kjo, ndërsa për shkakun e mirëfilltë ju nuk i flitni, por edhe nuk dini. Këtu mund të përdoren shumë drejt ajetet kur'anore: “...Juve u është dhënë vetëm një pjesë e dijes” dhe “...Zoti e di, por ju nuk e dini.”

## C’është ligji kulminant i ngjarjeve

### *Paqëndrueshmëria e interpretimeve ateiste*

Sot çdo besimtar është i befasuar nga batica e fortë e ateizmit, ndaj shumë prej tyre mendojnë se ateizmi ka argumente të forta përvveten. Mirëpo, kjo është shumë larg nga e vërteta. Ateizmi nuk ka fare argumente. Ai madje as nuk ka pasur kurrë. Kështu që edhe ateizmi bashkëkohor nuk është frysht i shkencës e as i njojurive shkencore, siç pohojnë ateistët. Ai në thelb është i njëjtë me ateizmin e atyre njerëzve, të cilëve u drejtohet Kur’ani. Kur’ani u drejtohet njerëzve, të cilët nuk kanë ditur as për Teorinë e Darvinit përkrijimin e llojit, as për Teorinë e Mendeleut pëtrashëgiminë, e as

për kurrfarë njohurish shkencore, ndërsa për arsyet e ngjashmërive me reagimin e ateistëve bashkëkohorë në mësimin e fesë, ata kanë refuzuar besimin në mënyrë që befason.

Karakteri i ateizmit ka qenë gjithmonë i njëjtë. Kjo dëshmohet edhe në Kur'an, i cili - kur u përgjigjet ateistëve dhe vërejtjeve të tyre - thotë: "...po kështu, thëniet e tyre në mënyrë të njëjtë i patën përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemrat e tyre." (2:118).

Shkenca bashkëkohore nuk u ka ofruar argumente ateistëve, por vetëm kontribuoi në shkatërrimin e idhujtarisë, magjive, besëtytnive dhe kulteve ndaj sendeve dhe njerëzve-që të gjitha këto nuk kishin kurrfarë lidhjeje me mësimin e mirëfilltë të monoteizmit të shpallur me besimin e vërtetë i cili i gjykoit të gjitha këto në të njëjtën mënyrë siç e kishte gjykuar edhe ateizmin.

Njohuritë shkencore vetëm e zgjeruan "fushëbetetjën" ndërmjet ateizmit dhe fesë dhe me përparimin e shkencës, kjo fushë gjithnjë e më shumë zgjerohet. Gjatë historisë së gjinisë njerëzore me shekuj u zhvillua një dialog i madh ndërmjet besimit dhe mosbesimit. Ky dialog vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Mirëpo, edhe pse ateizmi jo fort moti konsideronte se zhvillimi shkencor shpie në triumfin e materializmit në shkencë dhe me këtë paralajméronte fitoren e vet përfundimtare, megjithëkëtë në fund të shekullit të kaluar mund të dyshohej në të, ndërsa sot është krejtësisht e qartë se po e humbë pozitën e vet. Materia, jo vetëm që e humbi primatin që ai vazhdimesht e ka predikuar, por nocioni materie - aq i qartë, aq i dukshëm - u shkatërrua, ndërsa mbeti vetëm nocioni i fuqive. Zbulimet shkencore dëshmojnë se cilësitë e materies, që na janë prezantuar, kanë qenë një mashtrim i kulluar. Realiteti është krejtësisht ndryshe. Derisa ateizmi deri dje lidhej për argumente shkencore, me të cilat e argumentonte qëndrimin e vet, tani u tregua se këto argumente në esencën e vet janë krejtësisht diçtjetër.

Prandaj, për njëfarë 'ateizmi shkencor' as nuk mund të bëhet fjalë. Për dallim nga feja, çdo feje të shpallur, mësimet e të cilave janë identike dhe përfundimisht janë dhënë në Kur'an për të vërtetën, për atë që ka qenë, që është dhe që do të jetë, ateizmi i sotëm nuk është si ateizmi i djeshëm, edhe pse karakteri i tij ka mbetur i njëjtë.

Meqenëse ateizmi pranon vetëm atë që mund ta identifikojë, ndaj ai duhet patjetër t'i ndërrojë parafytyrimet e veta për sendet

dhe ngjarjet, ashtu siç ndërrohen në shkencë botëkuptimet për realitetin. Me këtë, ateizmi e demanton vetveten.

Ateizmi i shekullit XIX është i vdekur; ateizmi i sotëm duke qenë i shtrënguar ta pranojë primaritetin e fuqisë, nga forma e tij i afrohet mësimit të fesë. Në fryshtë e njohurive bashkëkohore dhe drejtimeve të zhvillimit të mendimit shkencor, duke definuar hollësisht qëndrimet, do të mund të thuhej se edhe ateistët edhe besimtarët pajtohen në konceptin se në gjithë këtë realitet për ateistët sundon ‘njëfarë fuqie’, kurse për besimtarët ‘një fuqi’. Për ateistët ajo është ‘njëfarë’, sepse për ata janë të paqarta cilësitë e kësaj fuqie. Ata për të mund të thonë vetëm aq sa u duket e arritshme. Mirëpo, ateistët për fenë mbeten të atillë siç tregon edhe vetë emri i tyre, sepse ata kësaj fuqie ia mohojnë vullnetin, që implikon edhe nocionin inteligjencë; që është thelbi i mësimit të fesë.

Sado që t’i thyejmë shtizat me ateistët, i gjithë rezonimi i tyre do të reduktohet në këtë: Jashtë këtij realiteti nuk ka asgjë. Këtu është natyra - këto janë ligje natyrore - këto janë fakte, ndërsa çdo gjë tjetër është trillim.

Nëse i pyetni se çfarë argumenti kanë se ‘çdo gjë tjetër’ na qenka trillim, ata nuk do ta kenë. Përse nocioni Zot do të ishte trillim? Apo ndoshta për arsy se është i pakapshëm për shqisat tonë? Ose ndoshta ky është argument pseudoshkencor i ateizmit?

“Por jo, ju lutem, - do ta kthejë ateisti i ofenduar - Zoti nuk mund të dëshmohet objektivisht.” Mirëpo, pikërisht vërejtjet ateiste janë joobjektivitet ekstrem.

Ateisti përafërsisht kështu rezonon: Kur ta lëshoj topin nga duart, ai do të bie në tokë. Kjo do të ndodhë gjithnjë, sa herë ta përsërisim këtë. Ja edhe tash do ta përsëris dhe përsëri do të ndodhë njësoj. E ku është këtu Zot? Ku është vullneti i Tij? Ai pra mendon se vullneti i Zotit do të duhej të manifestohej në lëvizjen e paparaparë të topit ashtu siç e shpreh vullnetin bashkëlojtari juaj me atë se topit i jep drejtimin dhe shpejtësinë në mënyrë të papritur drejt jush.

Ateisti është i mashtruar me përsëritjen e vazhdueshme të një procesi; ka zbuluar ligjshmëritë e tij dhe është mësuar me të ashtu që në ndërdije mendon: Nuk është e domosdoshme të ekzistojë Zot; kjo do të ndodhë edhe pa Të. Nëse Ai ekziston, ja, pikërisht tani le ta çrrugullojë këtë ligj natyror kur ta lëshojë topin nga duart.

E ç’mondoni, sikur ky top pikërisht në atë moment të mos sillet në atë mënyrë siç e pret ai, a thua për të do të ishte provë e intervenimit pikërisht të Atij, të cilin ai e provokon që t’ia reprezen-

tojë vullnetin dhe fuqinë e Vet, dhe me këtë ta dëshmojë ekzistencën e Vet?

Dyshoj! Kujtoni vetëm se ç'thotë Kur'ani për jobesimtarët të cilët kërkonin muxhize (mrekulli) nga Pejgamberi. Po kështu edhe ky ateisti ynë, do të kërkonte shpjegim 'shkencor' përsë kësaj here topi nuk u soll siç duhej. Do të bënte llojlloj supozimesh madje edhe të atilla se dikush ka bërë shaka me të me ndonjë koincidencë të rastësishme, e ky dikush do të mund të ishte edhe vetë qenia nga Marsi (nga planeti), i cili nga anija kozmike ia ndërroi topit drejtimin, ndoshta me ndihmën e ndonjë rrezeje antimateriale të laserit. Ndoshta më parë do të mendonte se diç nuk është në rregull me mendjen e tij, se sa të pranojë se si ky "dikush" pikërisht është Ai, në të cilin ai nuk do të besojë.

Ja ku i ka fatet njerëzore - ato janë të paparashikueshme, me gjithatë nuk do të besojë se ato janë rezultat i dëshirës së dikujt. "Këto janë rastësi, janë fryt i rastësive", do të përgjigjet ai, e nuk do të shohë se sa joobjektiv është nga i njëjtë qëndrim në të cilin ai thirret.

Ateistët shumë lehtë e hedhin poshtë nacionin Zot. Mirëpo, atë të cilën ata e ofrojnë në vend të Zotit, që tanë paraqet vështirësi reale për arsyen e njeriut.

Materialistët bashkëkohorë pranojnë varshmërinë njerëzore nga fuqitë jashtë fuqisë së kontrollimit dhe ndikimit të njeriut, të ashtuquajturat fuqi natyrore. Të gjitha këto fuqi, së bashku me materien emërtohen natyrë, në të cilën bën pjesë edhe njeriu. Lidhja ndërmjet natyrës dhe ligjeve natyrore është e qartë, edhe pse nuk ka mendim unik se si duhet kuptuar ky raport. Andaj, nuk është e qartë si këto nocione duhet të përkufizohen. Mirëpo, të përpinqemi ta mbrojmë faktin se natyra sillet sipas ligjeve natyrore ose u nënshtronhet atyre. Materialistët nuk duan të shkojnë më larg nga ky mendim. Ky për ta është i qartë, por edhe i mjaftueshëm.

Megjithatë, shumë ateistë dhe agnostikë nuk i përbahen gjithnjë rreptësisht qëndrimit materialist. Vetë atyre u duket i pa-qëndrueshëm besimi i thjeshtë në natyrën dhe në ligjet natyrore. U duket si qëndrim i pashprehur, mendim i cunguar, degradim i dicakaje që ekziston.

Meqenëse në të gjitha anët bëhen keqpërdorime me qëndrimin se ky është ligj natyror në vend të shpjegimit real, tanimë askush nuk e di se sa është numri i këtyre ligjeve natyrore. Shpirti dhe mendimi njerëzor janë të prirë që këtë shumësi të ligjeve natyrore

t'i parafytyrojnë si manifestime të nduarduarta: të një *Ligji universal natyror*. Njeriut kjo i duket më e logjikshme dhe më e kuptueshme. Në të kundërtën, duhet të kërkojë sqarim se si krijohet harmonizimi i një numri aq të madh ligjesh. Se a thua fuqitë evidente, vërtet janë trajta të ndryshme të një fuqie të vetme-shkenca ende nuk e ka dhënë vlerësimin e saj përfundimtar.

Kjo pyetje për besimtarin në thelb nuk është aq me rëndësi, mirëpo nga aspekti formal shkon në favor të mësimit të fesë. Sepse, nga nocioni i një ligji, i një fuqie, deri te nocioni i besimit në një Zot, qëndron vetëm një hap.

Mirëpo, pa marrë parasysh a funksionon një ligj apo disa sish, është e plotfuqishme vërejtja se të gjitha këto ligje janë të shurdhëta, të verbëta dhe memece, ndërsa vetë natyra është pa vullnet dhe pa arsy. (Kuptohet se ata nuk marrin guxim ta parashohin këtë sepse pikërisht me këtë, do të pranonin se pikëpamjet e fesë janë të drejta.). Nëse natyra është kuptimi dhe qëllimi i tyre i fundit, atëherë asaj nuk mund t'i atribuohet as drejtësia - sepse ajo na qenka pa arsy dhe pa vetëdije për ekzistencën e vet, e po ashtu as mirësia, sepse natyra nuk ka vullnet. Njeriu është tepër inteligjent që të mund të pajtohet me një qëndrim të këtillë, si shkak përfundimtar i të gjithave.

Kjo gjë i duket e marrë-ndaj përpinqet që ngjarjet t'i sjellë në suaza që do të kishin njëfarë fryme shpirtërore. Përdorë nocionet: elan vital, instinkt, dialektikë etj., që në shikim të parë mund të na mashtrojnë, - mirëpo, nëse lëshohemi në analizë - do të shohim se ato nuk dëshmojnë e as nuk shpjegojnë asgjë.

Këtu çdo gjë nga paqartësia dhe hamendja sillet vërdallë, por që kryesisht mund të përmblidhet në këtë: ngjarjet mund të kuptohen si rezultat i veprimit të fuqive, të cilat veprojnë sipas ndonjë parimi ose në emër të ndonjë parimi. Këto parime do të kishin fuqinë hyjnore të përcaktimit, vendimit dhe fatit, mirëpo vetveti janë pavetësore, pa vetëdije dhe pa intelekt.

Mirëpo, për pikëpamje të këtilla askush nuk ofron argument, e as nuk ka çka të ofrojë. Në të vërtetë fjala është për nocione të konstruktuara lirisht, që u atribuohen ngjarjeve, ndaj shpirtërisht na ofrohen si shkaqe të këtyre ngjarjeve. Fjala është për mashtrim. Mashtrimi pason kur këto parime kuptohen si kategori të pavarura prej askujt, si të mjaftueshme për vetveten, ndaj u jepen kuptime shpirtërore-pikërisht të tillë që do t'i gëlltitnim më lehtë, që do të

thotë sa më lehtë t'i kontrabandojmë nëpër shoshën e kritikës së logjikës njerëzore.

Nëse pranoni dialektikën e tezave, të antitezave dhe të sintezave hegeliane, me to nuk keni siguruar as shpjegimin e as argumentin përsë një gjë është e tillë. Në pohimin se këto janë argumente, kjo ende nuk do të thotë se duhet t'i pranojmë si parim, si ligj suprem i ngjarjeve në natyrë. Ç'na garanton se kemi zbuluar të vërtetë? Kjo do të ishte-por edhe është - mashtrim i madh, në të njëjtën mënyrë sikur argumentin se uji rrjedh tatëpjetë - ta shpallnim si parim. Nxënësit qysh në shkollën fillore njihen me të vërtetën se te kafshët ekziston lufta biologjike për vetekzistim dhe ruajtjen e llojit. Analizoni se si prezanton shpjegimi - sejeta ekziston sipas ligjit të vetekzistimit dhe ruajtjes së llojit - dhe do të shihni se kjo është njësoj sikur njeriut të uritur t'i jepet ushqim jokalorik.

Fjalët se embrioni ka fuqi jetësore dhe se zhvillohet në bimë me frute që bartin fara, e këto fara kanë aftësinë e mbirjes, dhe se kjo ndodh sipas një fuqie (elan vital), ofrojnë pikërisht aq sqarime sa edhe pohimi se dy elektrone tërhiqen ndërmjet vete nëse njëri është pozitiv ndërsa tjetri negativ.

Ose shpjegimi se bleta bën hoje sipas shtytjes, sipas instinktit, është pikërisht aq i saktë sa ishte edhe mendimi se trupat bien në tokë për shkak të peshës së tyre. Ne sqarojmë një argument, hojet e bletëve, me diçka që më vonë do të duhej ta argumentojmë.

Cili është argumenti ynë se pikërisht ky është instinkt – mungesë e lëvizjes së pavetëdijshme të çfarëdo qoftë intelekti, por me qëllim të caktuar? Këtu njeriu e demanton vetveten.

Nëse bleta në mungesë të intelektit vepron si ndonjë automat, si ndonjë robot i përsosur - meqë puna e saj është gjithmonë e njëjtë - duket sheshazi se ky veprim do të ketë pasur mundësi të programohej nga ndonjë vullnet inteligjent me fuqi dhe dituri. Natyrisht, ateisti nga frika që të mos ballafaqohet me Zotin, tërhiqet në qëndrimin e thjeshtuar materialist dhe me gjëzim bërtet: "Ligje natyrore!"

Në qoftë se pranojmë evolucionin e llojit të kafshëve, atëherë bleta ka arritur përsosurinë e vet matematikore, të huallit të paraparë me intelektin e vet ose me ndonjë intelekt të huaj: meqenëse të afërmit e saj nuk bëjnë hoje aq të përkryera, atëherë paraardhësi i tyre i përbashkët, i ka bërë më pak të përkryera në krahasim me hojet e sotme të bletës. Supozimi se në variante të shumta rastësisht kanë hasur në hoje, të cilat me material minimal ofrojnë hapësirë

maksimale, domosdo nxit përfundimin për ekzistimin e intelektit dhe të vullnetit. Përndryshe, si do ta shpjegonim mundësinë që ky zbulim të vërehet dhe të ndalet?

Në zgjua mbretëron një rregull i përkryer, një organizim dhe një racionalitet: grumbullimi i ushqimit, kujdesi për trashëgimtarët dhe asgjësimi i brumbujve. Aty, në zgjua, mbretëron një rregull - një ligj karakteristik vetëm për bletët, sipas të cilët qeverisin ato. Ky është fakt. Emërtoni atë si të doni, instinkt ose shpirt i zgjoit, mirëpo ky nuk është kurrfarë shpjegimi përsë ato sillen kështu.

Pohimi se ky është fryt i racionalitetit dhe i ekonomizimit që mbretëron në natyrë, shpie në mashtrim. Mendimi i ateizuar përpinqet t'ju shpie, në mënyrë të pahetueshme, prej argumentit se gjithkund në natyrë hetohet racionaliteti dhe ekonomizimi deri në definicjonin: "Natyra është rationale dhe ekonomike", e pastaj edhe një hap dhe: "Në natyrë mbretëron parimi i racionalitetit dhe i ekonomizimit." Ai nuk guxon të niset rrugës së drejtë logjike, që të pyesë prej nga dhe si është e mundshme, që prej shumë zgjidhjeve të mundshme gjithkund në botën bimore dhe shtazore ndeshet pikërisht vetëm ajo, e cila sipas intelektit tonë është caktuar si ekonomike dhe rationale.

Përfundimi që do të imponohej në mënyrë të paevitueshme do të ishte: përkundër intelektit tonë i cili e ka zbuluar këtë, ekziston edhe intelekti që e ka caktuar këtë.

Shembull më të mirë se si mund të mashtrohet njeriu, tregon përpjekja se si të harmonizohet dukuria e procesit njëkahësh të nxehësisë me proceset e përgjithshme fizike, që nuk njojin kurrfarë procesesh njëkahëshe. Thuhet se fizika nuk i jep kurrfarë përaparësie ardhmërisë ndaj së kaluarës, dhe se për të nuk ekziston fakti se duhet shkuar patjetër diku 'përpara' - sepse për të është krejt e barabartë edhe lëvizja prapa. Ky argument është gjithkund i pranishëm, prandaj njeriu e shpalli parim të fizikës. Mirëpo, proceset termodinamike shpien drejt ekuilibrit të nxehësisë, të ashtuquajtur entropi dhe paraqesin përashtim të pashpjegueshëm. Orvatja për t'i pajtuar këto dy argumente të kundërtat përmblidhet përafërsisht në këtë: Vërtet entropia ekziston dhe duhet ta kuqtojmë si gjendje më të besueshme nga të gjitha gjendjet e mundshme. Entropia mund të konstatohet në gjëra të vogla, e askush nuk është i sigurt se a vlen ky parim në matjen e gjithësisë ose - shpjegimi tjetër - nëse edhe pason kjo 'vdekje e gjithësisë', ekziston mundësia dhe besueshmë-

ria se do të prishet ekuilibri dhe se e tërë kjo gjithësi të fillojë rish-tas jetën e vet.

Ky mendim është një supozim i rëndomtë, që çdokujt i duket i pabesueshëm. Kjo është vetëm një përpjekje që të tregohet një anomali në formën ekzistuese të ligjeve natyrore, e ç'është e vërteta, atë ende nuk e di askush. Ndoshta një ditë do të gjendet zgjidhje në mënyrë befasuese, ashtu siç u shpjegua dukuria e shpejtësisë së dritës me Teorinë e relativitetit. Mirëpo, për ne këtu është interesante verbëria psikologjike: rregullat e ngjarjeve fizikale i shpallim parim sipas të cilës *patjetër* duhet të sillet natyra, prandaj shqetësohami kur hasim në përjashtim të paspjegueshëm. Natyrisht, për ne është logjike - aq herë jemi bindur-se ka arsyë që ngjarjet të përmblidhen në një rregull. Mirëpo, parashtronhet pyetja: prej nga e drejta jonë që dukuritë t'i reduktojmë në parime me të cilat duhet të barazohet natyra? Në ç'mënyrë dhe prej nga që këto parime të kenë fuqi - thënë tekstualisht - t'i detyrojnë ngjarjet në natyrë, e me këtë edhe tërë natyrën, në një rrugë të njëtrajtëshme?

Procesi i përsëritur vazhdimesht nxit te njeriu mendimin: "Sikur mos të duhej, kjo as nuk do të ndodhë", pastaj përfundon: "Domethënë, duhet të ndodhë kështu." Kjo është gabim. Këto nuk janë përfundime identike. Fjalët 'kjo duhet të ndodhë', nuk janë njësoj sikur edhe 'kështu patjetër duhet të ndodhë'.

Vërejtja shkencore për mendimin primitiv lidhur me Tokën, nuk qëndron në atë siç mendohej dikur se Toka ka ndonjë mbësh-tetje. (Në të vërtetë mund të kishte ndonjë zgjidhje të këtillë, siç është në realitet, vetëm në një mënyrë të kundërt nga ajo e paramenduar: Toka gjithnjë gjendet në largësi të caktuar prej Diellit, sepse Dielli me fuqinë e vet të gravitacionit e detyron të sillet në rrugë eliptike-pothuaj rrethore - rreth tij).

Gabimi i mirëfilltë i mendimit primitiv qëndron në atë se nga argumenti se të gjithë trupat bien në tokë nxori rregullën se të gjithë trupat duhet *patjetër* kështu të bien te poshtë. Më tutje ai u zhvillua logjikisht: për të ishte e qartë se Toka duhet patjetër të ketë mbështetje, në mënyrë që të mos bie në humnerë të pakufishme. Mirëpo është ndalë në këtë. Sikur ai të vazhdonte logjikisht ta zhvi-lloente mendimin, do të përfundonte në një varg pikëmbështetjesh të pakufishme absurde, që do të ishte shenjë se diku është bërë gabim.

Rregullsinë e vërejmë si rregull sipas së cilës zhvillohen proceset, të cilat matematikisht i definojmë si ligje të ndodhive. Përhershëmërë e gjendjes reale dhe ngjarjet i definojmë si parim, kup-

timi i të cilët në shpirtin njerëzor zhvillohet në mënyrë të pakontrolluar në konceptin e diçkaje krahas fatumit antik, të cilët, sipas mendimit të romakëve të vjetër - as zotat e tyre nuk kanë mundur t'i bëjnë ballë.

Nëse në këtë drejtim filloni t'ia zhvilloni mendimin ndonjë ateisti dhe nëse ai seriozisht e pranon diskutimin (e mos të jetë i atillë, çfarë ndoshta janë shumica, dhe çfarë pothuaj kanë qenë gjithmonë, e çfarë i ka paraqitur edhe Kur'ani - të cilët paraqiten indiferentë, të cilët do të përpiken t'ju përqeshin dhe t'ju përbuzin), pra, nëse ndesheni me ndonjë bashkëbisedues serioz, ai do të jetë i shtrënguar ta braktisë qëndrimin e vet: Ose do të pranojë se këto parime të frymëzuara me kuptim të atillë nuk janë asgjë tjeter, por vjedhje, gjyntim dhe çhyjnizim i mendimeve religjioze, që disa veti të caktuara të Zotit i pavarësojnë, eventualisht i shtrembërojnë, ndaj mendojnë se sipas tyre ose në emër të tyre ndodh e gjithë kjo, ndërsa vetë Zotin e mohojnë në kuptimin e cilësive të vetëdijes së Tij, të dijes dhe të vullnetit:

Ose-nëse këto parime reduktohen në kuptimin e rregullave të zakonshme - se atëherë do të mund të ishin të ofruara vetëm nga ndonjë fuqi, e në instance të fundit nga një fuqi e arsyeshme;

Ose, se ato do të ishin vetëm konstruktimet tona mendore me të cilat i përshkruajmë dukuritë, kështu që kjo nuk do të ishte përgjigje në atë pyetjen tonë *përse*.

Në këtë rast, materialisti rigoroz do të thoshte: përdorimi i nocioneve të këtilla është idealizëm i kulluar, që në mënyrë të pashmangshme shpie drejt idësë për Zotin, edhe në qoftë se mbrojtësit e nocioneve të këtilla vetveten do ta konsideronin ateistë, dhe do të vazhdojnë: Jo, natyra nuk duhet të sillet ashtu, atë askush nuk e detyron, por ajo thjesht sillet sipas atyre rregullave, sipas ligjeve natyrore. Ato janë pjesë përbërëse të vetë natyrës, ndaj nuk duhet t'i trajtojmë pjesërisht si argumente që do të mund të ekzistonin të pavarur nga njëri-tjetri.

Ky gjithsesi është kthim në qëndrimin e përparmë, i thjeshtë dhe i padurueshëm për logjikën njerëzore, sepse askush nuk mund të argumentojë se pikërisht është ashtu, ndaj çdo mendim objektiv njerëzor e bren dyshimi se fjala është për vlerësimë sipërfaqësore të dhëna kuturu:

Të bëjmë një krahasim:

Të paramendojmë disa qenie të arsyeshme të Wellsit! (në anën tjeter të këtij realiteti), të cilat do të jenë në gjendje t'i identifikojnë

vetëm objektet me cilësi elektromagnetike të intensitetit të lartë. Kjo do të thotë, se ato do të jenë në gjendje t'i zbulojnë hekurudhat tonë, por jo edhe vetë ne. Gjithsesi - sikur të fillonin të përcillnin lëvizjen e trenave, do të zbulonin njëfarë njëtrajtshmërie. Në një pështjellim krejtësisht formal, do të zbulonin rregullat e përsëritjes, do të zbulonin itinerarin e udhëtimit, të cilin mund ta hasim në çdo stacion hekurudhor. Ato do të mahniteshin me këtë rregullshmëri dhe do të ishin të entuziazmuara me zbulimin e vet: gjetën ligjin sipas të cilit zhvillohet komunikacioni hekurudhor. Çdo mendim për qeniet inteligjente, që do të qëndronin pas gjithë kësaj, ato do të ishin të gatshme ta hedhnin poshtë si diçka e tepërt, por edhe e pa-argumentuar. Për dëshmi do ta merrnin mundësinë e parashikimit të lëvizjes së trenave, të cilët qarkullojnë sipas itinerarit të udhëtimit, prandaj vullneti i ndonjë qenie inteligjente për to do të ishte kontestues dhe kontradiktor.

A thua mund të kënaqet edhe arsyaja jonë njerëzore, se botës sonë dhe ‘itinerarit të saj të udhëtimit’ nuk i është i nevojshëm Planifikuesi?

Botëkuptimet e thjeshta të ngjarjeve të deritanishme dhe të ligjeve natyrore ngadalë po braktisen. Kibernetika lidhur me shpjegimin e proceseve të natyrës, ka ndikuar edhe në pikëpamjet filozofike të njeriut, e po ashtu edhe në përpjekjet e arsyeshme shkencore. Nga aspekti teorik se fenomenet natyrore në botën e vdekur dhe në botën e gjallë qysh më parë kanë vepruesit e fiksuar, informacionet e programuara, lindi mendimi sikur tërë gjithësinë e ka rregulluar ndonjë llogaritar gjigant. Tani kërkohet të dihet se ç’janë ata dhe kush janë ata ‘konstruktues të mëdhenj’ të natyrës. Përderisa në këto pikëpamje më të reja, besimtari sheh afrimin e konceptit religjioz të Zotit, ateistët vazhdimisht dhe në çdo mënyrë do t’i ikin këtij realiteti.

Mirëpo, arsyaja në mënyrë të pashmangshme na shpie drejt besimit në Zot. Besimi në Zot është të besuarit e njerëzve të mençur dhe dëshmia e atyre që meditojnë. Koncepti për Zotin nuk është kurrfarë absurd shkencor. Kjo është dëshmia për *Fuqinë e Arsyeshme*. Nacioni *fuqi* nuk është i huaj për mendjen e njeriut, ky është argument eksperimental i shkaqeve dhe i ngjarjeve; kjo është evidente. I tërë ky realitet material është rezultat i ndonjë fuqie. Po ashtu nacioni intelekt është kategori e pranuar. Kur vërejmë se kjo botë është e rregulluar në mënyrë tepër inteligjente, na imponohet pa kusht mendimi se kjo është vepër e ndonjë mençurie. Të men-

dosh në drejtim të kundërt, duket mendim i paarsyeshëm dhe i marrë.

Nëse tani feja na porosit se ajo fuqi është Zoti-Fuqi e arsyeshme dhe me vullnet-atëherë përse të dyshojmë në të?

Nëse feja na mëson për domosdoshmërinë e ekzistimit të Fuqisë së arsyeshme, si krijues dhe kujdestar-e që për mendjen e njeriut kjo është shumë më e pranueshme se sa të pandehej se krejt kjo është rezultat i fuqive të pavetëdijshme të shurdhmemecëve-atëherë përse ateistët e mohojnë vazhdimisht këtë Fuqi?

Duket sheshazi se shkaku nuk qëndron në logjikë.

### *Mohimi i paarsyeshëm i botës tjeter*

Në mësimin themelor të të gjitha besimeve të shpallura, bën pjesë edhe ringjallja pas vdekjes. Për ateistët kjo është pakuptimësi e plotë. Fjalët e tyre të para janë se ligjet natyrore nuk na zbulojnë se do të bëhet kjo ringjallje, e kjo as nuk mund të ndodhë fare. Kur të analizohet pikëpamja e tyre, shihet se ajo është e privuar nga kriteri i vërtetë shkencor.

Pohimi i tyre se ky mendim është një mashtrim njerëzor, shpresë e rrejshme, me të cilën njeriu ngushëllohet se atje do të jetë më mirë, se ajo është kështjellë psikologjike ku njeriu tërhoqet pas disfatave të kësaj bote - e gjithë kjo akoma nuk është ajo që quhet argument shkencor. Kur kujtojmë vetëm shpjegimet e ndryshme në shkencë që në dukje të parë (por vetëm në dukje të parë) kënaqin kureshtjen njerëzore për njohjen e shkaqeve të ngjarjeve në natyrë dhe kur e krahasojmë këtë me atë që është zbuluar më vonë-e për të cilën kemi folur këtu-atëherë del se orvatja e ateistëve që pohimet e këtilla të afrohen si argumente shkencore, thjesht paraqet ofendim të intelektit njerëzor.

Asnjë degë e shkencës nuk ka eksperimente që me argumente të verifikuara ta rrëzojë këtë mësim të fesë. Për tërë atë që shkenca di, me asnjë fjalë nuk flet kundër një mundësie të tillë. Ateistët dyshojnë vetëm në mundësi, dyshojnë në vërtetësinë e kësaj; u duket si tregim fantastik, ndaj nuk besojnë, e pastaj mohojnë. Kur’ani kur bën fjalë për të, thotë: “*Thuaj: Askush veç All-llahut, as në qiej, as në tokë, nuk e di të fshehtën, as nuk e di se kur ringjallen!*” (27:65), prandaj menjëherë pas kësaj jepet gradacioni i mendimeve ateiste; “*Por, dijenia e tyre arrihet në botën tjeter (kur të përjetojnë çka u*

*është premtuar). Ja, ata dyshojnë për këtë (për botën tjetër), madje janë të verbër ndaj saj.”* (27:66).

Përgjigjja e besimit për ateistët mund të përmblidhet në këtë:

A thua me ekzistencën tonë nuk argumentojmë se mund të lindemi dhe të përftohem? Nëse tanimë ekzistojmë, përsë nuk do të mund të ndodhë kjo përsëri? Çfarë arsyesh, çfarë pengesash ekzistojnë që pikërisht ne, me këtë vetëdije tonë, përsëri një ditë të mos ekzistojmë? Kush është ai dhe çfarë argumenti mund të sjellë kundër kësaj mundësie?

Shkencës i mungon një argument i këtillë.

Përgjigjja më e sinqertë e një ateisti do të ishte e këtillë: “Kjo do të ishte e mundshme, mirëpo mua po më duket tepër e pabesueshme, prandaj edhe nuk e besoj. Kjo do të ishte një rastësi e thjeshtë, ndonjë rast i vëtmuar, ndonjë rast individual. Jeta e sërishtme e të gjithë individëve, tërë gjinisë njerëzore është pamundësi totale.”

(Ndërsa Kur’ani - pikërisht sikur përgjigjet në këtë, thotë se është njësoj sikur të krijosh të gjithë njerëzit, sikur të krijosh një njeri (31:28)).

Rezonimi ateist sipas rastit reduktohet në krahasim të këtillë:

Mundësia që dy objekte, të cilat lirisht fluturojnë në hapësirën e paskajshme të gjenden së bashku, teorikisht është e mundshme, mirëpo praktikisht kurrsesi, ndërsa matematikisht mund të shpjegohet sipas ligjeve të numrave të mëdhenj. Gjithsesi, kjo do të mund të ishte vetëm rezultat i vullnetit të vetëdijshëm, e meqë ateisti e mohon Zotin, ajo për të konsiderohet si mundësi e rastit të pabesueshëm. Kjo për të do të ishte një ndryshim i papritur, të cilin ai nuk është në gjendje ta shohë dhe ta parafytyrojë në konstatimin e radhitjes së ndodhive.

Këtu del në shesh tërë rezonimi jokritik ateist, për të cilin ateistët shumë pak çajnë kokën. Ata me vetëpushtet i ndërrojnë kriteret në vlerësimin e ngjarjeve. Fillimi i jetës, krijimi i qelizës së parë, ishte ndryshim i befasishëm në një radhitje të ndërrimit të materies së vdekur. Edhe pse shkenca na njofton me kalimet kontinuitive, megjithatë nga grumbulli i disa elementeve të materies së vdekur, deri te i njëjtë grumbull, që reprezentohet si qelizë e gjallë, është e kuptueshme se ekziston një dallim thelbësor. Për pikëpamjen materialiste kjo do të duhej të ishte jo vetëm rast pak i besueshëm, por një pamundësi e plotë, siç është përtërirja eventuale e jetës tanimë njëherë ekzistuese.

Vetë materialistët pranojnë se më së vështiri e kanë të shpjegojnë fillimin e krijimit të qelizave të para, ndërsa për të tjerat, sipas mendimit të tyre, është lehtë. E nëse i pyetni se kujt duhet falënderuar për fillimin e jetës, a thua është kjo rezultat i disa ligjeve, është pasojë e veprimit të ligjeve të tyre natyrore, apo thjesht një rastësi, do të merrni përgjigje të paharmonizuara. Ata flasin herë për ligjshmérinë e herë për rastësinë, e herë-herë njëkohësisht edhe për njérën edhe për tjetrën. Atyre vetë nuk u është qartë se cila duhet të jetë përgjigja e drejtë e tyre. Cilësdo rrugë që të nisen, ndeshin në vështirësi të pakapërcyeshme. Mirëpo, me siguri ‘takimit’ me Zotin i shmangen qëllimisht. Nëse kjo ka ndonjë kuptim, atëherë qëndrimi i tyre mund të përkufizohet kështu: Jeta filloi rastësisht, e pastaj filluan të veprojë ‘ligjet e jetës’.

Ata nuk dinë se si duhet shpjeguar që një grumbull i konsideruar elementesh, të cilat e përbëjnë qelizën, krijoit atë që quhet jetë. Mirëpo, sikur ateizmi të ishte i logjikshëm - e ai pretendon pikërisht të jetë i këtillë - kjo nuk do të ishte ndonjë vështirësi. Të gjithë ateistët, që nga i pari deri tek i fundit janë mashtruar me realitetin, me argumentet e dukshme, ndaj heqin të zitë e ullirit me shpjegimin e krijimit të qelizës së parë - pikërisht për arsyen se kjo dukuri nuk është përvojë e argumenteve të përshtatshme. Ata nuk shohin, ata nuk janë dëshmitarë se si nga jo e gjalla fillon jeta, prandaj, tani janë të shqetësuar nga argumentet eksperimentale se vetëm nga e gjalla lind jeta, të cilën ata me vetëdëshirë e kanë shpallur si parim që mbizotëron në natyrë, e tani nuk mund ta zbatojnë në krijimin e qelizës së parë. Prandaj, pjesa dërrmuese e tyre ofrojnë përgjigje se fillimi i jetës është një rastësi e mirëfilltë. Këta as që janë të vetë-dijshëm se nga vetë pikëpamjet e tyre sa jokritik është ky gjykim.

Në mbështetje të asaj që deri më tanë e dimë, mund të supozojmë: Në lëvizjen kaotike të materies së lëngët, e cila ftohet, në një moment gjenden në një grumbull (sipas disa supozimeve) katërmbëdhjetë elemente në një përpjesëtim të caktuar dhe në organizim të caktuar, të nënshtruar ndaj një presioni të caktuar, në temperaturë përkatëse, nën veprimin e fuqive elektromagnetike, rrezeve të dritës dhe rrezeve kozmike me intensitet të caktuar dhe lejojmë, gjithsesi - disa fuqive për ne të panjohura dhe ... u krijuat qeliza e parë që paraqet një tërësi, e cila filloi të rritet, e pastaj të ndahet: kështu filloi jeta. E me këtë, pikërisht sipas pikëpamjeve materialiste, a thua nuk e kemi shprehur ligjin se si filloi jeta? Kur plotësohen të gjitha këto kushte të njohura dhe të panjohura për ne, nga materia jo

e gjallë lind qeliza e gjallë. Të theksojmë shkarazi, ky nuk ishte kaos; kaosi është në kokat tona ngaqë nuk kemi ide për veprimin e atyre fuqive. Prandaj, materialisti i lejon vetes që të thotë se kjo është rastësi. Kjo njëkohësisht i ofron mundësi të kontestojë se bëhet fjalë për një vullnet të caktuar, i cili me vetëdije i drejton ngjarjet në qëllim të caktuar.

Pikërisht këtu shihet paqëndrueshmëria e doktrinës materialiste. Ajo është e shqetësuar, sepse është e pafuqishme të shpjegojë krijimin e një qelize të vetme të kryehershme, ndërsa dukuritë shumë më të ndërlikuara i duken të qarta. Kur vetëm e kujtojmë drurin grandioz *Sequaria gigantea*, i cili rritet në lartësi marramendëse dhe trungun e të cilit nuk mund ta përthëkojnë disa njerëz, ndërsa lashtësia e tij mund të arrije në disa mijëra vjet - dhe se një gjigant i këtillë është rritur nga një farë e vogël si pluhur në të cilën janë përshkruar të gjitha ato cilësi, njeriu medoemos mbetet i habitur dhe i shtangur. Ose le ta kujtojë njeriu vetveten, se ai është një grumbull elementesh pa ndonjë vlerë të madhe. Mirëpo, meqë atomet tona u treguan se nuk janë të pandashme, të bëjmë një supozim të këtillë krejtësisht të lirë, por në analogji me përvojën e deritanishme (pa pretendime për saktësi shkencore), se edhe ‘guri përbërës’ i grimcave atomike është i ndërtuar nga grimcat elementare të energjisë, t’i quajmë ashtu - nga njësitë e energjisë. Atëherë vlera materiale e njeriut do të binte edhe më tepër. Natyrisht, asnjë materialist nuk do të pajtohej që në trupin e vet të shohë një grumbull të njësive të pavlefshme të energjisë. Ai sheh vetëm ngritje cilësore, që e bëjnë atë të vlefshëm. Me numrin sasior të protoneve, neutroneve dhe elektroneve bëhet dallimi cilësor ndërmjet disa elementeve të caktuara kimike. Me formimin e tyre të mëtejshëm në molekula, ndërsa këto në grupe më të mëdha, me raportet e veta të shumta dhe me organizimin e tyre krijojnë cilësi të reja. Në këtë mënyrë formohen organe me veti të caktuara që t’i përgjigjen destinimit të vet. Ndërkaq, këto organe duke iu nënshtuar njëfarë qendre jetësore përbëjnë një tërësi organike. Dhe të gjitha këto organe të shumta me organizimin e tyre dhe me funksionet e tyre të sakta, duke përfshirë këtu edhe cilësitë intelektuale dhe psikike, të gjitha janë të caktuara që më parë në embrionin e panjohur njerëzor. Mirëpo, edhe pse neve neve nuk na është e qartë se si ndodh kjo, e lëre më që të dimë përsë ndodh kështu, materialisti për këtë nuk çuditet, e as nuk do të çuditet. Kjo për të është argument eksperimental, të cilin ai e pranon si të tillë, mirëpo tani para qelizës së thjeshtë të

kryehershme ai është i pafuqishëm. Ai gjithsesi do të dëshironte që të mund të argumentojë se jeta fillon në mënyrë të natyrshme nga materia jo e gjallë dhe si fitimtar do të klinthe: "Ja shikoni, këtu nuk ka Zot!" Mirëpo, meqë ai nuk e heton se ç'po ndodh në natyrë, madje nuk është në gjendje ta prodhojë as në laborator, ai nuk guxon të thotë: "Kjo është e natyrshme", por thotë "Kjo është e rastësishme."

E më tutje?

"Më tej jeta vazhdon rrugës së natyrshme, me evolucion u krijuan lloje të reja..."

Kështu pra, ateistëve nuk u nevojitet Zoti. Sa për fillim atyre u është i mjaftueshëm rasti, e për më vonë u kujdes - Darvini (Darwin). Mirëpo, ateisti që do të jetë objektiv, le të jetë vetëm korrekt në shpjegimin e tij materialist, dhe do të konstatojë se edhe qeliza e parë edhe jeta e saj, u formuan në sajë të fuqive të caktuara, e jo me anë të ndonjë rastësie. Dhe e gjithë kjo që është, në të vërtetë, është dashur patjetër të jetë, e kurrsesi diç tjetër, sepse edhe të gjitha format e kaluara kanë qenë gjithashtu rezultat i fuqive të caktuara, qoftë për ne pjesërisht ose plotësisht të panjohura.

Kjo vlen edhe për të ardhmen. Ajo objektivisht është caktuar me ligjshmërinë e fuqive, mirëpo neve kjo na duket e paqartë, sepse nuk kemi parafytyrim të plotë për to, madje as karakterin e fuqive evidente nuk e kemi të njohur rrënjosht.

Nëse pranojmë se ekzistojnë ligjet dhe fuqitë natyrore, atëherë mund të themi se ne jemi plotësisht prodhim i caktuar i këtyre ligjeve. Ne që më parë jemi të paracaktuar njësoj siç është e paracaktuar që topi i lëshuar nga duart të bie në tokë. Të gjithë jemi pajtuar se me veprime të njëjta në kushte të njëjta pasojnë pasoja të njëjta; këtë na e ka mësuar përvoja. Andaj edhe besimtari edhe ateisti që më parë e dinë se ç'do të ndodhë me topin e lëshuar nga dora. Mirëpo, në çështjet siç është jeta dhe format e saj, ne nuk e dimë se çka do të ndodhë, jo për arsy se kjo do të ishte pasojë e ndonjë rasti, por për arsy se nuk i dimë të gjithë faktorët që veprojnë në të. Sikur shkenca t'i njihte të gjithë faktorët (për të cilët kemi ndjenjën se janë të shumtë) dhe intensitetin e tyre, do të nxirrnim ndonjë rezultantë; pra do të dinim rezultatin. Atëherë do të mund të 'profetizonim' njësoj sikur me fatin e topit të lëshuar nga duart e tophedhësit.

Ne nuk i dimë vetitë e fëmijës së palindur, mirëpo e dimë se këto veti janë të përshkruara në gjene. Të gjitha këto janë të caktu-

ara që më parë: vjetitë e tij fizike, psikike dhe intelektuale. Nga përvoja e dimë se do të ketë disa ngashmëri me prindërit ose sipas vijës vertikale me disa të tjerë me të cilët ka lidhje gjaku. Mund të ndodhë ndonjë ndryshim i papritur; veçanërisht kur ndodh ndonjë ndryshim në gjene. (Dihet se me ekspozimin ndaj rrezatimit intensiv të rrezeve gama shkaktohen ndryshime në bartësit e veticë trashëguese). Pra, rastësi nuk ka.

Gjithçka është rezultat i veprimit të disa fuqive.

Është e paarsyeshme të shpallim një gjë të rastit, vetëm për shkak se nuk e dimë shkakun e vërtetë ose pse nuk e dimë mënyrën se si ka ndodhur kjo.

Po kështu qëndron puna edhe me çështjen e jetës përtej varrit - *a do të jetë apo nuk do të jetë* - kjo tanimë është çështje e caktuar, është caktuar me anë të veprimit të fuqive ekzistuese e nuk i është lënë ndonjë rasti.

Tani pyesim, nëse jeta jonë është prodhim i këtyre fuqive-dhe të pandehim se karakteri i këtyre fuqive është pikërisht i tillë çfarë ia caktojnë materialistët-atëherë përsëri se këto fuqi të njëjtë nuk do të mund të përsëriteshin? Prej nga mund të pohojë dikush se veprimi i këtyre fuqive është i atillë se nuk do të prodhojë atë jetë? Baza shkencore për një pohim të tillë nuk ekziston.

Ateistët, duke folur për rastësinë, njëkohësisht flasin edhe për ‘ligjin jetësor’, ndërsa nuk e pyesin veten a është kjo inkonsekuençë shkencore. Nëse i pyetni se a ka ekzistuar ky ligj para fillimit të jetës, ata do të përgjigjen se gjithsesi ka ekzistuar edhe më parë. Kur u plotësuan kushtet për jetë, ata filluan të veprojnë. E nëse i pyetni se a lejon ky ligj përsëritjen e një jete tanimë ekzistuese, ata këtë kategorikisht do ta mohojnë.

Mirëpo, kjo askënd nuk duhet ta mashtrojë. Ata flasin për këtë ligj jetësor si diç e sigurt, në të vërtetë si diçka për të cilën ata janë të njojur mirë, ndërsa kjo qëndron larg realitetit.

I tërë ky tregim për ‘ligjin jetësor’ është fryt i një imagjinate të kulluar; dëshmia për diçka, që është përsituar me analogji, me diç tanimë të njojur. E tërë kjo është e kotë, hamendje e paverifikuar. Se sa është kjo një vështirësi mendore, shihet nga kjo: Nëse parafytyrojmë se ky ligj jetësor ka ekzistuar para fillimit të jetës, pyesim prej çka ka qenë i përbërë, në çka ka qenë i ‘shkruar’, me çka ne mund të dimë se vërtet ky ligj ka ekzistuar para fillimit të jetës?

Para një pyetjeje të këtillë mendja e njeriut është e hutuar. Është e qartë se pse. Ne nuk dimë se ç’është ai ‘ligj jetësor’. Kurr-

sesi nuk mjafton të themi: "Ky është ligji sipas të cilit zhvillohen proceset e botës së gjallë" ose "Ky është shkaku i jetës." Ne nuk e dimë - e ky është rast mjaft i shpeshtë - karakterin real, cilësitë themelore të asaj që ne e vlerësojmë si shkak i ngjarjes.

S'do mend se ateistët nuk guxojnë të mendojnë se ky ligj jetësor u lind bashkë me jetën ose se është në gjendje të përtërijë një qenie tanimë të zhdukur, sepse kjo do të paraqiste katastrofë për pikëpamjet e tyre të ndërtuara për botën.

Duhet pranuar se na duket i logjikshëm rendi se vec ka ekzistuar ligji jetësor, siç deklarohet ateisti; ose se ai ligj është caktuar më parë, siç do të shprehej besimtari, ashtu siç për lëvizjen e trenit ekzistojnë binarët. Mirëpo, duhet të jemi të kujdeshëm: në nocionin e definuar në mënyrë të paqartë, të cilin e pranojmë si të vërtetë, por nuk jemi në gjendje ta argumentojmë, ndërtojmë hipoteza të reja. Nuk duhet harruar se si na ka ngjarë me eterin dhe me nocionet e hapësirës dhe të kohës...

Se për çka është fjala në të vërtetë - kjo i mbetet ardhmërisë që të ofrojë përgjigje. Edhe sipas peshës edhe sipas ndërlikueshmërisë së problemeve mund të përfundojmë që më parë se njohuritë evenuale do të na shpien në kthesa të mirëfillta të pikëpamjeve shkençore, sesa pohimet e deritanishme të paramenduara analoge me to.

Mirëpo, derisa për besimtarin nuk ekzistojnë probleme për shkakun e mirëfilltë themelor të të gjitha ngjarjeve, ateisti në mënyrë të pashmangshme zhytet në një rrëth mendor nga i cili nuk ditë dalë. Ai pranon vetëm të tashmen, duke shikuar ngjarjet nga aspekti i periudhës kohore në të cilat njeriu ka shpjegim shkencor. Mirëpo, e tashmja nuk është i tërë realiteti, ajo është vetëm një pjesë e vogël e ngjarjeve të kaluara dhe e ngjarjeve të ardhme. Njeriu është i shtrënguar të nxjerrë konstatime në bazë të realitetit eksperimental, mirëpo të përgjithësosh ngjarjet (që nga aspekti hapësinor dhe kohor janë të kufizuara, e madje jemi të vetëdijshëm edhe për kufizimin e shqisave tonë) - kjo semantikisht është diç krejtësisht tjeter. Njeriu nuk ka të drejtë në këtë. Shkencërisht - ky është naivitet i madh. Për këtë jemi bindur shumë herë.

E pikërisht ateistët i përgjithësojnë gjendjet dhe ngjarjet. Prandaj ateisti edhe mund të konsiderojë se vdekja - është fund, fund i çdo gjëje, sepse nuk ka parafytyrim, ndaj ofron deklaratë të paverifikuar, pra, plotësisht joshkencore se nuk ekzistojnë kurrsfarë ligjesh që do të përtëritnin jetën identike ose se ata për të cilët dimë janë të tillë që nuk duan ose nuk mund ta bëjnë këtë.

Deklaratat e këtilla janë fryshtat qëndrimi të tyre ateist, e jo fryshtat i dijes së sigurt.

## Mbi shpirtin

Mendimi i ateizuar nuk mund të argumentojë se vdekja në të vërtetë është fund i atij që *quhet njeri*. Ajo diçka, që është *ai*, ‘*uni*’ i njeriut, atë ‘*diçka*’ feja e ka emërtuar me emrin *shpirt*. Ky gjithmonë ka qenë objekt i polemikave. Shumë është folur, por pak është thënë për esencën dhe cilësitë e tij, sepse njeriu ka ditur për të vetëm aq sa i është shpallur.

Paraqitni ateistëve vetëm disa ajete kur'anore, siç janë për shembull këto:

“... *dhe nga ana e vet i jep shpirt atij dhe Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të pamurit dhe me zemër...*” (32:9)

“*Ai është që ju krijoi (filloi) prej një njeriu...*” (6:98)

“*All-lahu ju krijoi, pastaj Ai ua merr shpirtin...*” (16:70)

“*Kur t'i vijë ndonjërit prej jush vdekja, atij ia marrin shpirtin të dërguarit Tanë (të tjerë) dhe ata nuk bëjnë kurrfarë lëshimi.*” (6:61)

“*Zoti ua merr shpirrat në çastin e vdekjes së tyre, por edhe ata që nuk kanë vdekur (ua merr) në gjumin e tyre, e i mban ata që i ka caktuar të vdesin, kurse i lë (i kthen) ata të tjerët deri në afatin e caktuar.*” (32:42)

C'mund t'i kundërshtojë ateisti kësaj?

Ai mund të jetë i pakënaqur, mund të konsiderojë se kjo është e pamjaftueshme (me ç'rast ai me fjalën të mjaftueshme nënkupton që t'i ofrohet në thelb provë e plotë e cilësisë dhe fatit të nocionit shpirt), mirëpo, ai nuk ka të drejtë ta injorojë këtë mësim. Ajo që feja e thotë për këtë - sado që i duket pak - nuk është absurditet, ndërsa shkenca ende as nuk e ka shqyrtuar këtë fushë, prandaj mohimi i tij nuk është as i arsyeshëm, as shkencor.

Edhe pse vdekja dhejeta janë argumente të përvojës së përditshme, megjithatë është shumë vështirë të definohen këto nocione, shumë më vështirë sesa kemi menduar në shikim të parë. Ateistët

konsideronin - si edhe për çështjet tjera - se kjo nuk është kurrfarë vështirësie. Ata kënaqeshin me definicionet që i konsideronin të përshtatshme dhe që nuk kundërshtoheshin me pikëpamjet e tyre ateiste, ndaj i konsideronin plotësisht të drejta. Për shembull vdekjen kanë mund ta definojnë si ndërprerje e ndryshimit të materies në organizëm, ose ndërprerje e punës së organeve, e meqë kjo është në marrëdhënie funksionale me qarkullimin e gjakut, ndaj për këtë mund të thonin se vdekja është ndërprerje e qarkullimit të gjakut. Mirëpo, edhe këtu shihet se si ateistët i nxjerrin shumë lehtë përfundimet kur në mungesë të kritikës së tyre, definicioneve formale u japid kuptimin e qenësisë. Ndërprerja e qarkullimit të gjakut, nëse nuk vazhdon pas një kohe të shkurtër - me të vërtetë shkakton vdekjen, mirëpo vdekja nuk është ndërprerje e qarkullimit të gjakut.

Transplantimet më të reja të zemrës kanë shkaktuar probleme morale dhe juridike të llojit të veçantë. Pas befasisë dhe duartrokitjes së parë u shfaqën edhe dyshimet, protestat, madje edhe akuzat. U soll në dyshim edhe qëndrimi etik i mjekut. Në të vërtetë, meqë kjo kishte të bëjë me transplantimin (mbëltimin) e zemrës së padëmtuar pra, sipas mendimit laik bëhej fjalë për zemrën e ‘gjallë’, u shtrua pyetja: A mos ka të bëjë kjo me shpejtimin e vdekjes (e kjo është vrasje!) së një jete - dhënësit (të zemrës) që ta shpëtojë tjetrin - marrësin (e zemrës).

Polemika solli deklarimin e nocionit të ri të fillimit të vdekjes: se vdekja fillon në tru, por që kjo ende nuk do të thotë ndërprerje e punës së disa organeve.

Po i sjellim të gjithë këta shembuj që të shohin ateistët se sa i pasigurt ka qenë qëndrimi i tyre i deridjeshëm.

Ateistët tanë mund të pohojnë - e këtë sigurisht edhe do ta bëjnë - se vdekja është dëmtim i qelizave trunore dhe kështu do të vazhdojnë të japid shpjegime materialiste për vdekjen. Megjithatë të gjithë ne ndjejmë se s’kemi përgjigje të saktë se ç’janë në thelb *jeta* dhe *vdekja*. Edhe vetë ateistët duhet patjetër të dyshojnë se a thua zbulimet e nesërme nuk do ta demantojnë qëndrimin e tyre të sotëm, ashtu siç e përgënjeshtroi i sotmi të djeshmin. Nuk ekziston kurrfarë dyshimi se çfarë karakteri do të ketë përgjigjja e shkencës së nesërme.

Ateistët mendojnë se njeriu me manifestimet e veta fiziologjike, psikike dhe intelektuale është përfaqësuar vetëm biologjikisht.

Mirëpo, kjo na shpie në paradoks.

Nëse evitojmë disa pjesë të njeriut në mendime, pyesim - në stilin e Zenonit! - ç'është e nevojshme të evitojmë e të mos ekzistojë njeriu. Sot edhe mund të hiqen disa organe e të zëvendësohen artificialisht. Kështu u arrit deri te mundësia teorike se koka do të mund të jetojë e pavarur nga trupi, në të njëjtën mënyrë si edhe koka normale me trupin.

Vizion i tmerrshëm, por për shkencën shumë interesant. Tani mund të mendojmë se edhe në kokë mund të heqim disa organe dhe disa pjesë, e pastaj të pyesim: ç'duhet lënë nga ajo, e që të mund të themi se është i pranishëm, se 'ai' është i gjallë. Mund të themi se njeriu është gjallë gjithnjë derisa është e pranishme vetëdija, që do të thotë derisa të qëndrojë në jetë ajo pjesë e trurit, ku formohet mendimi dhe vetëdija, ku shprehet ai *uni* ynë. Meqenëse shqisat kanë rolin e ndërmjetësit ndërmjet këtij *uni* dhe botës së jashtme, nëse i largojmë ato, ajo vetëdije do të ishte e izoluar nga rrathi, nuk do të pranonte kurrfarë përshtypjesh nga bota e jashtme, e as nuk do të mund ta shprehte as praninë e vet, e as çfarëdo rezonimi qoftë, megjithatë do të mund të thuhej se është e pranishme vetëdija edhe pse praktikisht është e pamundshme të argumentohet.

Nuk e dimë se ç'është vetëdija dhe mendimi. Madje nuk e dimë as si formohen. Përderisa për shembull kemi njëfarë parafytyrimi përfushën elektrike dhe magnetike, sepse dimë disa veti të tyre, dimë se si formohen dhe kemi shpjegim përvimin e tyre, edhe pse vetë esenca e këtyre fushave është jashtë arritjes së njohurive tona, formimi i vetëdijes dhe mendimit dhe filli i tyre mbeten për ne si dukuritë më të çuditshme dhe më enigmatike të qenies njerëzore.

Mirëpo, ateisti nuk do të çuditet. Ai i pranon si argumente. Në botën e tij pa Zot, kjo është 'përsosuria më e madhe e natyrës', e cila në dashurinë e vet amtare apo ndoshta në harresën njerkore i dhuroi njeriut atë, që nuk e posedon vetë. Ai thotë: "Ky është stadi më i lartë i ekzistimit të materies", apo, "Mendimi dhe vetëdija janë format më të larta të lëvizjes së materies." Një shpjegim i këtillë nuk është madje as hipotezë e rëndomtë shkencore, e lëre më të jetë teori, e sa përfshihet shkencore as nuk mund të flitet. Sepse ne nuk e dimë ç'është 'stadi më i lartë i ekzistimit të materies', e as cila do të ishte 'forma më e lartë e lëvizjes së materies'. Është e pamundshme të shpjegohet një gjë me diçka që vetë është e paspjegueshme.

Ateisti këtë e krahason përafërsisht kështu: Nëse i shkatërroj cilësitë fizike dhe kimike të çelikut, ai pushon të jetë magnet. Në të

njëjtën mënyrë ose të ngjashme me shkatërrimin material të trurit zhduken mendimi dhe vetëdija. Mirëpo, ne nuk kemi kurrfarë argumentesh që t'i jepin vetes të drejtë të bëjmë një krahasim të këtillë. *Së pari* edhe pse ne - për magnetizmin kemi teori të mjaftueshme - megjithatë nuk jemi plotësisht të kënaqur, sepse akoma mbisin shumë gjëra të paqarta dhe të pathëna. *Së dyti*, ne mund të supozojmë se në tru zhvillohen procese biokimike dhe biofizike, e pastaj edhe bioelektrike, madje ndoshta edhe disa procese biomagnetike, por me çka në realitet do të ndeshemi në kërkime - këtë akoma askush nuk e di. Në baza shkencore kjo ende është fushë e paprekur. A thua nuk mund të ndodhë që zbulimet eventuale të mos i ndryshojnë plotësisht botëkuptimet dhe pikëpamjet tona shkencore. Kjo njeriut i ka ndodhë shumë herë.

Sipas koncepteve të sotme lidhur me ngjarjet e përgjithshme, jemi të shtrënguar që vetëdijen dhe mendimin t'i kuptojmë si një energji dhe - sipas pikëpamjeve të njëjtë se asgjë nuk mund të shkatteredohet, por energjia vetëm e ndryshon trajtën e vet, atëherë parimi që duhet ta pranojmë qëndrimin se as mendimi e as vetëdija nuk janë zhdukur në mënyrë të thjeshtë, por kanë "rënë" për shikimin tonë, ndërsa vazhdojnë që të ekzistojnë në ndonjëfarë mënyre, në ndonjë trajtë të panjohur për ne.

Kjo vlen edhe për atë, që ne e quajmë *jetë*. Ndërprerja e procesit jetësor, vdekja, zhduk vetëm një tërësi të organizuar, por nuk e zhduk atë që ne tash e quajmë materie; ajo vetëm shpërbëhet, ndahet fizikisht dhe kimikisht. Mirëpo, pyesim ç'bëhet me atë që e quajmë fuqi jetësore. As ajo nuk zhduket në mënyrë të thjeshtë. Këtu nuk do ta marrim si një shprehje figurative (jo në kuptimin e ndonjë parimi në emër të cilit ose sipas të cilit zhvillohen proceset e jetës organike në natyrë), por se kjo vërtet është diçka, është njëfarë energjie, fuqi - marrë irreptësisht në kuptimin materialist. (Ne këtë mund ta emërojmë edhe me ndonjë emër tjetër - kjo është çështje e konvencionit).

Nëse qelizën më themelore të jetës e parafytyrojmë si grumbull atomesh dhe molekulash, sipas përvojës së deritanishme, mund t'i parafytyrojmë se janë të sistemuara, të shifruara, kështu që rezonojnë nga ndonjë shtyrje nga jashtë, në këtë 'fuqi jetësore', dhe kështu filloj jeta. Ç'ndodh me atë energji të shtuar të organizmit, i cili pushon të funksionojë?

Ateisti, konsekuent në qëndrimin e vet, do të mund të thoshte se ajo (energji) është shndërruar për shembull në valë elektromag-

netike ose në energji termike, e cila lirohet nga e posavdekura, ose shndërrohet në atë që ende e quajmë materie, mirëpo ai këtë vetëm mund ta mendojë, por mos ta dijë. Këtë askush nuk e di, sepse nuk na është e njohur ç'është në thelb ajo fuqi, ndaj nuk kemi as të drejtë ta krahasojmë me diçka të njohur. Thënë tekstualisht, ne nuk kemi as ide se për çka është puna.

Nëse materialisti përballë shkatërrimit të aq pikëpamjeve materialiste në shkencë, i lejon vetes të japë të ashtuquajtura supozime materialiste përfatim e mëtejmë të vetëdijes, të mendimeve dhe të energjisë jetësore, atëherë mund të bëhet edhe një supozim i këtillë: sikur të ishte e tërë kjo - sipas parimit të moszhdukjes së energjisë - do të mbetej e deponuar diku në një mënyrë, e ndoshta shkapërderdhet në rreze, duke u tretur dhe zhdukur në mënyrë të përhershme. Një hipoteze të këtillë nuk mund t'i bëhet kurrfarë vërejtje as logjike e as shkencore. Sepse, nëse jeta, jeta individuale, kujdeset aq shumë që ta ruajë llojin e vet dhe në farë e lë porosinë dhe energjinë përvillimin e të ngjashëmve me vetveten, atëherë përsë nuk do ta linte edhe përvetveten, për regjenerimin e vet personal, përiinkarnimin e vet personal!? A është kjo pamundësi apo absurditet vetëm për atë arsy se ne nuk dimë asgjë konkretisht përkëtë? Prej nga ideja se ne duhet të informohemi përtë gjitha fshehtësitë e natyrës? Tekefundit, njeriu përvetveten është një i panjohur. Shumë organe tonë veprojnë jashtë vetëdijes dhe vullnetit tonë dhe pakurrfarë njohuri tonë. Ai që e urdhëron dhe rregullon punën e tyre, madje nuk pajtohet që ta njoftojë mendjen tonë me këtë punë.

Kur polemizon me jobesimtarët, të cilët pohojnë se me vdekjen njeriu definitivisht shkatërrohet, ndërsa prej tij mbetet vetëm pluhuri dhe eshtrat, Kur'ani thotë: "... *Ne më së miri e dimë se ç'do të mbetet prej jush.*"

Për çdo ditë njeriu zbulon fshehtësi të reja të natyrës, e kjo do të thotë se këto fshehtësi përnjeriun kanë ekzistuar dhe ekzistojnë. Se sa fshehtësi të panjohura ka, ne nuk i dimë ato. Është e qartë se edhe në të ardhmen pjesa dërrmuese e këtyre përnjeriun do të mbeten të panjohura, sigurisht shumë më tepër në krahasim me atë që do ta dijë.

Njohuritë e shkencës bashkëkohore sollën deri në shumë pikëpamje relative, të cilat e rrënuan vlerën absolute të botëkuptimeve materialiste. Sot nuk kemi më fuqi intelektuale të mohojmë diçka që momentalisht ende është jashtë mundësisë së përvojës dhe njohurive tonë shkencore. A thua vetë përparimi fantastik i shkencës

nuk i mohon pikëpamjet e deridjeshme materialiste? A thua të gjitha mrekullitë e sotme të teknikës-numri i madh i tyre dhe dallimet cilësore - nuk do të ishin absurde edhe për kokat më të ditura të antikës klasike? E gjithë kjo do të ishte fryt i fantazisë, ndërsa çdo pohim serioz se kjo në të vërtetë do të ndodhë, do të shpjegohet si rezultat i çrrregullimit mendor. E gjithë kjo do të binte ndesh me përvojën e tyre dhe me njohuritë e tyre shkencore, pra edhe me parafytyrimet e ekzistencës së objekteve dhe të pikëpamjeve ndaj botës.

Ta bashkojmë në mendime kohën e tyre dhe kohën tonë.

Tregojni atyre Hënën e plotë dhe pyetni ç'mendojnë, sa është ajo larg nga Toka. Pas shpjegimit ftoni: "Eni shikoni se ç'po ndodh atje." Dërgoni në sallë të kinemasë që t'i shohin në madhësi natyrore dhe në ngjyra figurat tredimensionale të njerëzve, të cilët lëvizin dhe flasin, dhe u thoni: "Kjo nuk ndodh këtu para jush, por atje lart, në Hënë?

Ç'do të thonin ata për këtë?

Dhe menjëherë pas kësaj tregojni disa incizime të tjera dhe theksoni se kjo nuk po ndodh në kohën e sotme, por në një kohë të shkuar; se këta njerëz që i shohin dhe i dëgjojnë - kaherë kanë vdekur.

Ç'do të thonin ata për këtë?

Me siguri ata në mosbesim e dyshim do të thonin: "Vërtet, si është e mundur kjo?!"

Po kështu edhe njeriu i kohës së sotme me mosbesim dëgjon porosinë e shpalljes për ardhmërinë e vet, ende të paparë dhe të papërjetuar dhe pyet: "Vërtet, si është e mundur kjo?"

Ndërsa ne nga ana jonë shtojmë: Vërtet, shembull didaktik, krahasim që flet dhe thotë shumë.

### *Ateizmi nuk ka doktrinë të veten*

Pas analizës që i bëmë, shihet se ateizmi është shumë larg nga ajo që të mund të jetë një kështjellë solide dhe e pamposhtur e logjikës njerëzore. Qëndrimi themelor i tij, me të cilin ai e definon vetveten, tregon dobësinë e tij themelore, tregon se ai nuk ka doktrinë të veten: ateizmi vetëm dyshon dhe refuzon atë që feja e udhëzon. Ndonjë doktrinë tjetër mund të jetë ateiste, por vetë ateizmi

nuk është kurrfarë doktrine, sepse çdo doktrinë niset nga pikëpamjet për diçka që ekziston, e jo për diçka që nuk ekziston.

Feja është burimore, ndërsa ateizmi është paraqitur si rezistencë e mësimit të saj.

Ateisti mund të thotë se ajo është vërejtje formale, që vetveti nuk do të thotë shumë, dhe se qëndrimi parësor i ateizmit mund të definohet ndryshe, p.sh. kështu: “Ekziston vetëm...”

Çka vetëm?

Ateisti që është pakëz inteligjent, nuk do të marrë guxim ta shprehë atë që mendojnë të gjithë ateistët, sepse tani e ka të qartë se sa jokritik është qëndrimi atheist.

Thënia: ‘Vetëm kjo botë’ nuk mund të arsyetohet me mençuri, sepse ajo është botë e shqisave tona, ndaj menjëherë imponohet pyetja: A thua është e mundshme të ekzistojnë botë, të cilat ne nuk jemi në gjendje t’i identifikojmë? Shqisat tona nuk kanë aftësi absolute të konstatimit të argumenteve, kjo sot është e qartë për të gjithë.

Thënia: “Jashtë këtij realiteti eksperimental, nuk ekziston asgjë tjeter” është e paqëndrueshme, sepse atë që njeriu e pranon sot për realitet, atë deri dje nuk do ta pranonte. Askush nuk është i sigurt se çka do të zbulohet nesër, ndërsa për fenë realiteti më i madh është Zoti.

Kushdo që përpinqet ta definojë, kuptimi është i njëjtë. Ateisti përsëri do të gjendet në qëndrimin e vet fillestar, për ç’arsye në realitet edhe i bëhet vërejtje.

Në argumentet tuaja për qëndrimin e këtillë joshkencor, atij (ateistit) i mbetet vetëm të zbrapset, por këtë zrapje do ta përdorë si kundërmë. Do të vazhdojë ta mbrojë mendimin atheist, përafërsisht kështu: “Dhe vërtet, kjo nuk ka kurrfarë kuptimi që unë ty të të dëshmoj se nuk ka Zot. Po shoh se kjo është metodë e gabuar. Kjo do të ishte njësoj sikur prej meje të kërkohet që të dëshmoj se atje larg diku në gjithësi, me qindra mijëra vjet drite, në ndonjë sistem yjor, nuk ekziston jetë e qenieve inteligjente siç ekziston në Tokë. Është e pakuptimtë të dëshmoj se diç e tillë diku nuk ekziston. Edhe unë edhe ti e dimë që nuk ekzistojnë shtrigat, jo për shkak se jemi në gjendje të dëshmojmë se nuk ekzistojnë, por për arsyen se askush nuk është në gjendje të argumentojë se ekzistojnë. Unë mund të argumentoj se nuk ekziston askush, përreth nesh të dyve në këtë dhomë, sepse ekziston metoda dhe mjeti i sigurt ta argumentojë ekzistimin e atij që quhet njeri. Shtrigat konceptohen pikërisht ashtu

që qysh më parë mohohet çfarëdo mundësie për identifikimin e tyre.

Nëse ti e definon Zotin pikërisht ashtu, që më parë ma mohon mundësinë që Ta identifikoj me shqisa, qoftë edhe tërthorazi, tanë kush mund të kërkojë që unë ta argumentoj se nuk ekziston. Unë e di se rrezet radioaktive kanë ekzistuar edhe para se të zbuloheshin, mirëpo për një objekt sot mund të konstatoj se nuk është radioaktiv, vetëm për atë se kam mjete të sigurta objektive ta argumentoj radioaktivitetin eventual.

Më dëshmo ti se ekziston Zoti dhe Bota tjeter, pastaj unë do të gjykoj për vlerat shkencore të argumenteve tua. Që më parë bëj vërejtje parimore, të njëjta me të cilat ti e akuzon ateizmin: feja nuk është fryt i shkencës, e si mund të presësh atëherë që ta çmoj fenë? Dhe po të pyes: Cilin besim? Ju, të cilët besoni, as vetë ndërmjet jush nuk keni mendim unik”, do të përfundojë ateisti.

### *E vërteta fetare*

Ky mendim, që Zoti të definohet në atë mënyrë, që është e pamundshme Ta identifikosh, është fryt i mosmarrëveshjes dhe mashtrimit. Ne mund ta konstatojmë praninë e Tij, qoftë edhe pse nuk mund Ta identifikojmë me anë të shqisave tona. Kjo nuk duhet të jetë burim i polemikës. Mosmarrëveshja lind me përdorimin e disa nocioneve në kuptime të ndryshme, ndërsa këtu edhe më tepër - kur është fjala për Zotin - mendimi i ateizuar shtron kushte se çfarë duhet të jetë Zoti që të mund Ta identifikojë, e pastaj ta pranojë.

Nga aspekti fetar, njeriu mbiçmohet tepër; ai nuk ka të drejtë të bëjë vërejtje. Ai duhet të kuptojë se këtu kemi të bëjmë për një të metë njerëzore.

Shembull: Sikur të gjithë njerëzit të vuanin nga sëmundja e Daltonit, nocioni i ngjyrës do t'u ishte i panjohur. A do të kishim të drejtë të thonim: Ngjyrat nuk ekzistojnë nëse do të gjendeshin individë që janë të ngarkuar me verbëri për ngjyra nga njëra anë, ndërsa fillojnë të flasin për to, nga ana tjeter? A thua pjesa dërrmuuese nuk do të pohonte se diç nuk është në rregull me këta individë? Të kujtojmë vetëm tregimet e Velsit (Welsit) për luginën e të verbërve ku banorët e saj dëshironin ta shpienin në gjendje ‘normale’, njërin ndër ta të humbur, njeriun jo të verbër - të cilin ata e shpallën të së-

murë, sepse u fliste për sendet jashtë përvojës së tyre, ndaj ata vendosën ta verbonin.

Cili do të duhej të ishte kriteri për gjykim - A është kjo shumica?

Një njeri i sëmurë mental, të afërmit të vet që e vizitoi në spital, i thotë: "Kur të bëhem ne shumicë, juve do t'ju shpallim të çmendur, dhe do t'ju vendosim këtu."

Të dashur lexues, ju sigurisht do të qesheni! Mirëpo, ne këtu nuk po tregojmë barcoleta. Ne këtu po ekspozojmë me seriozitet të plotë. Ne e dimë se të sëmurët mentalë edhe më tutje do të mbeten të sëmurë, sado qofshin në numër ata. Verbëria për ngjyra është e metë, pa marrë parasysh shtrirjen e saj. Ne me rrugë të tërthortë konstatojmë ekzistimin e rrezeve ultravjollce dhe të rrezeve infra të kuqe, por pa marrë parasysh se ato sipas natyrës së tyre janë të njëjta si ato nga spektri i shikimit, syri ynë nuk reagon në gjatësinë valore të tyre, ato për të janë të padukshme - kjo është e metë e syrit. Dy copa hekuri, sipas vlerësimit të të gjitha shqisave tona, mund të janë krejtësisht të njëjta. Nëse vërejmë se një copë e sistemon pluhurin e hekurit në një radhitje deri diku të drejtë, këtë ia atribuojmë ndonjë fuqie, që e kemi quajtur fuqi magnetike. Në mbështetje të këtij sistemimi e konstatojmë veprimin e drejtimeve të tij dhe formojmë parafytyrimin për vijat e forcës magnetike. Kështu pra, kjo fuqi është argument eksperimental, ne mund ta konstatojmë praninë e saj, mirëpo ajo vetveti gjendet jashtë shqisave tona. Kjo është e metë jona.

Vetë Zoti është jashtë shqisave tona, mirëpo ne dimë për Të sipas veprave të Tij, kurse për Të, për cilësitë e Tij, dimë nga shpallja.

A thua kjo nuk është e mjaftueshme për njeriun? Ç'ka do të dëshironë ai? Ndoshta nuk e parafytyron ai Zotin se do të duhej të ishte i një kategorie të njëjtë si edhe objektet e eksperimentit të tij? Ndoshta nuk fantazon se Zoti duhet t'i shfaqet kur t'i bie dikujt ndër mend, e që Zoti të argumentohet në mënyrë ashtu siç argumentohet se uji është i përbërë nga hidrogjeni dhe oksigjeni?

Megjithatë, Zoti nuk mbeti i panjohur për njeriun; Ai iu shfaq njerëzve me vullnetin e Vet, me shpalljen e Vet nëpërmjet të të zgjedhurve.

Mësimi setar është mësim për të vërtetat, edhe atë për ato më të rëndësishmet për njeriun, të cilat janë jashtë të pamurit dhe të prekurit të njeriut.

Fakti se besimi i ka paraprirë shkencës, nuk duhet të jetë ndonjë minus përfshinë fenë. Shkenca ka filluar prej asgjëje, degëzohet dhe përfshinë fusha gjithnjë e më të mëdha, ndërsa kur do ta thotë fjalën e vet përfundimtare - kjo është jashtë vlerësimit real. Të presish këtë fjalë, do të thotë të jeshë i pafe. Mirëpo, qëndrimi i besimit është se shkenca e vërteton dhe se gjithnjë e më tepër do ta argumentojë mësimin fetar.

### *Ku duhet kërkuar të vërtetën fetare*

Në qoftë se ateisti tërheq vërejtjen se edhe vetë religionet nuk pajtohen ndërmjet vete në të gjitha mësimet, kjo nuk do të thotë se nuk duhet kërkuar të vërtetën në mesin e tyre. Ne ia propozojmë Kur'anin. Dëshirojmë që kjo thirrje në Kur'an të mos shpjegohet si fryt i anueshmërisë fetare, por si rezultat i vlerësimit të njohjes së përgjithshme se Islami është monoteizmi më i pastër i njohur deri më tanë. Ne nuk pretendojmë që mësimi islam të merret për arsyen se do të trajtohej (kinse) si fjalë përfundimtare në evolucionin e mendimeve religjioze, nëpërmjet dukurive dhe afirmimit që nga historia e religjioneve të mëdha, sepse kjo plotësisht do të largohej nga mësimi islam dhe do të ishte e kundërt me të. Duhet respektuar parimin se interpretuesi më kompetent i ndonjë mësimi është vetë mësimi, dhe se vlerësimi objektiv merret me vlerësimin e kritereve dhe të argumenteve me të cilat vetylën e argumenton dhe e arsyeton.

Janë të paktë ata ateistë që pajtohen me këtë. Kështu edhe ky yni, që e zumë ngoje pak më parë, ndonëse në shikim të parë lëshon pe me fjalët: "Po mirë, urdhëro ti ma argumento mua...", sigurisht se nuk heq dorë nga vlerësimi i tij ateist përfenë.

"Dallime thelbësore ndërmjet religjioneve - sipas mendimit të tij - nuk ka. Ato janë fryt i pasigurisë, i frikës para ndjenjave të pafuqisë dhe para fatkeqësive të panjohura. Dëshira përfshin të sukcesshëm dhe përfshin të lashta të fytshme është formësuar në ceremonitë religjioze. Nderimi i të merituarve dhe i të shquarve është shndërruar në kult të të vdekurve, që shërbimin e tyre është dashur t'ua sigurojnë fisit edhe pas vdekjes së tyre. Zhvillimi shoqëror ka ndikuar në religionin. Me bashkimin e fiseve, zotat e tyre të veçantë u zëvendësuan me zotin e përbashkët. Prej më shumë perëndive antropomorfe shkohej në drejtim të konceptit abstrakt të një zoti absolut. Zoti i hebrenjve ende gjithnjë është vetëm i hebrenjve. Te

koncepti i krishterë për një zot janë të dukshme gjurmët e politeizmit. Mendimi brahman për Brahmën, Vishnën dhe Shivën, dhe ai latin për Janusin me tri fytyra, janë reflektuar në dogmën e krishterë për trininë. Kremtet e Krishtlindjeve dhe të Pashkëve janë vazhdim i festave pagane me petk tjetër. Bashkë me këto kremte shumë hyjni pagane kanë arritur të mbajnë pjesërisht famën dhe ndikimin duke njojur Zotin e kryqëzuar. Si kompensim për shërbimin vazal ndaj kryqit, fituan statusin e “shenjtë”, do të përfundojë me ironi ky ateist.

Nëse kërkon që t'u japë vlerësim të veçantë për Islamin, do t'ju përgjigjet në mënyrë të përgjithshme se mendimi religjioz edhe nga aspekti historik-shoqëror është mbizotëruar, e me këtë edhe nga aspekti ideor; ndoshta do të lejojë të ketë pasur ndonjë rol pozitiv, mirëpo ajo i përket të kaluarës historike. Në vend të tij hyn në fuqi shkenca.

Për Islamin do t'ju flasë pak: Islami është shumë i panjohur.

Nëse si nxënës e ka mësuar historinë, të shpjeguar në fryshtë e materializmit historik, atëherë do të thotë se Islami ka qenë shprehje e interesave tregtare të borgjezisë mekase, se asaj i është nevojitur një Arabi e bashkuar, e po ashtu edhe religjioni me një zot të përbashkët. Se sa individë prej tyre i kanë shtruar pyetje vetes se a është e gjithë kjo e vërtetë, kjo ende nuk është interesante as përveteten, por: Sa ka logjikë në atë se në të njëjtat tekste, menjëherë pas pohimit të mësipërm, konstatohet se pikërisht po ajo borgjezi nuk e ka parë dobinë që ia ka ofruar Islami, mirëpo dy dekada rresht luftoi për jetë a vdekje derisa përfundimisht u mposht.

Nëse është njojur me ngjarjet historike të ekspozuara atmosferës së nënçmimit të Islamit, të formuar me shekuj nga ana e Kishës, do t'ia mohojë Islamit çfarëdo qoftë origjinaliteti të tij: Muhammedin a.s. do ta akuzojë si plagjiator të rëndomtë, i cili huazoi mendimin hebraiko-kristian mbi Zotin, tregimet biblike, emrat dhe nacionet.

Si përgjigje në këtë po sjellim sjalët e një apologjeti islam:

“Dorën në zemër dhe të jemi objektivë: Në qoftë se Bibla është shpikje dhe vepër e filozofëve, e ligjdhënësve të ndryshëm, të cilët sipas fryshtës së kohës në të cilën jetuan dhe sipas nevojave të popullit, sipas fuqisë së mendimit të tyre dhe thellësisë së intuitës, sollën ligje dhe shprehën maksima morale në formë të dogmave fetare, atëherë përsë e njëjtë gjë nuk i pranohet edhe

Muhammedit? Përse pikërisht atij iu desht t'i kopjojë mendimet dhe idetë e huaja? Pa dyshim Muhammedi a.s. ka qenë arabi më inteligjent i të gjitha kohëve; njeri i mbarë dhe i matur, me talent vrojtimi të jashtëzakonshëm, prandaj pa ndikimin e askujt ka mundur të sjellë ligje për arabët e vet, ligje këto që do t'i përgjigjeshin frysë së kohës në të cilën janë marrë dhe botëkuptimeve të popullit të cilit i janë dedikuar.

Në qoftë se autorët e Biblës kanë qenë udhëheqës të popujve, te të cilët kohë pas kohe është shfaqur fryma e Zotit, nëse këta udhëheqës, të cilët përndryshe i quajmë Të dërguarit e Zotit dhe Pejgamberë vërtet qenë të inspiruar nga qielli, atëherë nuk ka arsyë përse i njëjtë qiell nuk do t'i shfaqe edhe Muhammedit a.s. i cili u ngrit që në mesin e njerëzve më të braktisur dhe jobesimtarë, të proklamojë idenë e bashkimit absolut në një Zot dhe moralin e lartë? Përse ky i njëjtë qiell nuk do të mund t'i shfaqe Muhammedit a.s. i cili erdhi gjashtë shekuj pas shfaqjes së Krishtit, ta “përtërijë besimin në Abrahamin dhe Krishtin” në kohën kur nxënësit e Krishtit në këto vise e kryqëzuan në kryq mësimin e tyre më të lartë? A thua Muhammedi a.s., i cili vuri themele më solide në besimin e një Zoti, themele, të cilat për plot trembëdhjetë shekuj nuk lëvizën as për një milimetër, të mos ketë të drejtë të pretendojë në zanafillën hyjnore të frysëzimeve të veta? Nëse njerëzit çmohen sipas rezultatit të punës, atëherë Muhammedi a.s. mund të dalë faqendritur para gjykatësit më kompetent të kësaj bote: “para historisë objektive.”

Nga ana jonë mund të shtojmë vetëm këtë: ai që dëshiron të dijë ose të gjykojë për Islamin, le të njihet me të nëpërmjet burimit origjinal, nëpërmjet Kur'anit. Shumica do të befasohen se sa pak kanë ditur për të, madje edhe atë njohuri të paktë, shpeshherë e kanë përvetësuar gabimisht.

Edhe te historianët, të cilët dëshirojnë të jenë objektivë, përvidhen gabime. Kështu Hiti në veprën e vet “*Historia e arabëve*” nxjerr konstatimin e vet se All-llahu ka qenë ndonjë Zot i fisit ndërmjet shumë zotave të tjera. Një sqarim i këtillë jep një pasqyrë krejtësisht të gabuar.

Nacionin lidhur me një Zot, All-lahun, arabëve ua ofroi Ibrahimi a.s., Abrahami biblik. Ai me djalin e vet Ismailin ngriti faltoren e Zotit - Qabenë dhe themeloi ceremoninë e pelegrinazhit (haxhxhit) në shenjë feste dhe falënderimi Zotit xh.sh. Gjeneratat e mëvonshme (pasardhësit e Ismailit - arabët) u katandisën në politizëm dhe e stolisën Qabenë me idhuj dhe me viktima të tyre. Mirëpo në mesin e arabëve, koncepti për All-lahun mbeti, por vetëmse ata edhe idhujve të tyre u dhanë cilësi hyjnore. Idhujt atyre iu bënë më të afërt, më të pranishëm dhe më të prekshëm, kurse All-lahu më i largët, më i paarritshëm dhe më abstrakt në definimin e cilësive të Tij. Kjo kthesë e mendimeve njerëzore pasqyrohet në Kur'an:

*"Thuaj: "E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse jeni që e dini?" Ata do të thonë: "E All-lahut".*

*Atëherë thuaju: "Përse pra nuk mendoni?" Thuaj: "Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të madh?" Ata do të thonë: "All-lahu!" Thuaju: "E pse nuk frikësoheni pra?" Thuaj: "Në dorën e kujt është i tërë pushteti i çdo sendi, dhe Ai është që mbron (kë të dojë), e që prej Atij nuk mund të ketë të mbrojtur; nëse jeni që e dini?" Ata do të thonë: "Në dorë të All-lahut!" Thuaj: "E si mashtroheni pra?" (23:84-89)*

*"(Idhujtarët e dinë për All-lahun pse) Kur hipin ata në anije (u këputet lidhja me tokë, dhe frikësohen) i luten sinqerisht All-lahut, e kur i shpëton ata (dhe dalin) në tokë, qe, po ata të njëjtit lusin idhuj!"*

*(29:65)*

*"E kur e godet njeriun ndonjë e keqe (ndonjë dëm), ai e lut Zotin e vet duke kërkuar ndihmë vetëm prej Tij, e kur nga ana e Tij i jep ndonjë të mirë (ia largon të keqen), ai e harron atë që më parë i është lutur Atij, dhe i përshkruan shokë All-lahut për t'i larguar (njerëzit) nga rruga e Tij. Thuaj: "Kënaqu për pak kohë në mosbesimin tënd, se ti, pa dyshim je nga banorët e zjarrit!"*

*(39:8)*

Paraqitja historike e Muhammedit a.s. ishte përtëritja e besimit në një Zot, i definuar me deklaratën themelore të Kur'anit: "Vetëm Zoti (All-lahu) është hyjni."

Muhammedi a.s. arriti sukses në misionin e vet që monoteizmin ta afirmojë përsëri. Nga Qabeja u larguan idhujt dhe ajo iu kthye atij misioni që ia kishte dedikuar Ibrahimi a.s.

Qëndrim themelor i mësimit islam është: Edhe njeriu i parë, e pastaj edhe çdo popull, janë të njoftuar me paraqitjen e monoteizmit. Ky mendim vazhdimisht është përsëritur kur ishte i harruar ose i mohuar. Të dërguarit biblikë kanë qenë vetëm përtëritës të këtij mendimi dhe të moralit të tij. Edhe Muhammedi a.s. ishte i tillë.

### *Paqëndrueshmëria e teorisë mbi evolucionin e mendimeve religjioze*

E gjithë kjo që u zu ngojë më lart nuk përputhet aspak me atë që sot shkruhet dhe mësohet gjerësisht, prandaj secili që dëgjon për herë të parë për të gjitha këto, në njëfarë mënyre është i befasuar, ndërsa ateisti edhe më tepër, sepse i duket plotësisht i logjikshëm zhvillimi i imagjinatës njerëzore, i shkaqeve dhe i ngjarjeve transcedente nga politeizmi nëpërmjet monoteizmit deri te ateizmi në kuptimin e përgjithshëm të evolucionit të njeriut. Mirëpo, ky mendim nuk mund të argumentohet historikisht e as të arsyetohet logjikisht.

Në mbështetje të asaj që dimë nga historia, në bazë të trashëgimisë kulturore të qytetërimeve të mëdha, mund të përfundojmë se ateizmi ka ekzistuar gjithmonë. Në botën antike ka qenë i njohur siç kanë qenë të njohura pikëpamjet e një Demokriti dhe Lukrecies. Megjithatë, pas tyre u paraqiten dy religjione të mëdha monoteiste.

Nga ana tjetër, duke ndjekur këtë rregull nga e kaluara dhe duke ndjekur gjurmët e evolucionit njerëzor, ndeshim në religjiozitet gjithnjë e më të madh, këtu marrë - jo në kuptimin e thellësisë së ndjenjave, të bindjes dhe të përkushtimit ndaj ndonjë mësimi religjioz, por në kuptimin e botëkuptimeve ateiste të largimit gjithnjë e më të madh nga arsyaja. Në shtegun e rrahir mirë të evolucionit, pa ndonjë vështirësi arrijmë në botën shtazore dhe atje përnjëherë, përkundër pritjes logjike - nuk gjejmë asnjë gjurmë nga religjioziteti. Ndërkaq, edhe kafshët posedojnë ndjenjën e frikës, madje edhe të lidhshmërisë dhe të falënderimit!

Nga kjo del se religjioni, si kategori plotësisht e kundërt me arsyeshmërinë kudo të pranishme në natyrë, u paraqit në mënyrë të pashpjegueshme në ekstremitetin e vlerës së vet të lartë te njeriu. Kur ndodhi kjo - në fazën kalimtare (të majmunit njeri ose të njeriut-majmun) ne nuk e dimë, sepse ende kemi ndonjë kockë tënofullës ose të kofshës në bazë të të cilave nxirret përfundimi për vetitë

e tij morfoloژike, ndoshta në fazën kur jemi të gatshëm ta pranojmë për njeri, historia këtë nuk na e tregon, por kjo edhe nuk është me rëndësi. Mirëpo, përfundimisht është e qartë: teoria mbi radhitjen e politeizmit-monoteizmit është e paqëndrueshme.

### *Me ç'kriter ta ćmojmë njeriun*

Ekziston një mosmarrëveshje e madhe se a duhet ndarë njeriun nga bota tjeter e gjallë apo jo. Vijimisht zhvillohet luftë ç'duhet të jetë kriter, cili është i drejtë e cili është parësor. Edhe ndërmjet vetë ateistëve ekzistojnë pikëpamje të ndryshme; qëndrimi i kulluar materialist është në kundërshtim me pikëpamjet fetare. Për materialistin, kriteri biologjik është i vetmi i drejtë dhe sipas tij, njeriu është shtazë, lloj i veçantë i saj. Të tjerat për të janë të parëndësishme ose të parregullta me përjashtim të nocionit të punës, sipas të cilët njeriu bën pjesë në lloj të veçantë. Zogoria shtazore u shndërrua në grumbull njerëzish dhe në shoqëri atëherë kur filloi të punojë, mirëpo kjo punë ishte rezultat i vetëdijes, apo ndoshta thënë më saktë, me pjesëmarrjen e vetëdijes, ndërsa te kafshët mbeti rezultat i instinktit.

Mirëpo, të marrësh kriterin biologjik si të vetmin kriter të drejtë, është qëndrim i paargumentuar; ai është krejtësisht arbitrar. Ta kualifikosh një punë si rezultat i vetëdijes, ndërsa tjetrën si rezultat i instinktit, është e paqëndrueshme. Prandaj duhet njojur me mjeshtërinë dhe shkathësinë e kastorëve gjatë kryerjes së punës së tyre, e pastaj për praninë e përfundimit inteligjent t'i lihet njeriut të fitojë bindje gjatë punës së tij dhe me vetëdije të vet të drejtar nga qëllimi i caktuar. Natyra është përplot me shembuj të këtillë.

Përdorimi i mjeteve për punë nga ana e njeriut është çështje e argumentimit të një shkalle më të lartë.

Në botë ekzistojnë shumë lloje insektesh, të cilat me një organizim të lartë të shoqërisë së tyre lënë përshtypje të thellë te ne, me ndarjen e punës, mandej - edhe në mënyrë befasuese - të adaptuar llojit të përshatshëm të punës individuale edhe atë në masë të caktuar. Prandaj, s'është e mundshme që kuptimin e shoqërisë së organizuar t'ia atribuojmë vetëm njeriut, duke e dalluar kështu nga kafshët. Të konsiderosh se shprehja artistike është cilësi vetëm e njeriut, është çështje e dyshimtë. Ndjenja ndaj të bukurës mund të hetohet edhe në anën tjeter. Në familjen e shpezëve ćmohen ngjyrat

dhe pasuria e tyre. Zërat e tyre i kapërcejnë kufijtë e nevojës së domosdoshmërisë, si shprehje e ndjenjave, e jo vetëm të nevojës së rëndomtë të vetekzistimit. Nëse ne kënaqemi me këngën e tyre dhe çmojmë vlerën e saj artistike, përse të dyshojmë në disa kritere të këtilla edhe te vetë shpezët, meqë e tërë kjo na shpie në një përfundim të tillë. E kësaj duhet shtuar edhe atë, se jemi të privuar nga kënaqësia e bukurisë së plotë të këngës së tyre: shumë zëra të tyre janë jashtë arritjes së dëgjimit tonë.

Sa u përket instinkteve, ato i posedon edhe njeriu. Kështu pra, meqë të gjitha këto që i përmendëm nuk janë cilësi të vecanta, qoftë të njeriut, qoftë të kafshëve, dhe meqë shkallëzimi i tyre sipas cilësisë dhe sasisë nuk është qenësor për këtë shqyrtim, mbetet – përfundimi dështues për ateistët - se religjioni (pa marrë parasysh a e çmon dikush këtë si virtyt ose marri) është pikërisht ajo që e dallon njeriun homo sapiens nga llojet tjera.

Në Kur'an thuhet: "*Ne amanetet (e besimit) ia kemi drejtuar qiellit, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta pranojnë këtë barrë, sepse u frikësuan se nuk do të mund t'i kryejnë, ndërsa njeriu këto i mori mbi vete. Vërtet ai është i fortë dhe i paditur.*"

### *Mbi religjiozitetin*

Religjioziteti - marrë si kategori e ndjenjës për njëfarë respekti të obligueshëm ndaj diçkaje transcendentë, si adhurim - është fakt. Edukimi, arsimimi dhe shoqëria ndikojnë si faktorë të formimit të këtij religjioziteti në ndonjë sistem. Mirëpo, burim i mirëfilltë i tij është shpirti njerëzor. Ateizmi sot është bukur i përhapur, mirëpo praktikisht nuk ndeshim në ateistë, të cilët janë të privuar nga ajo që ateizmi e emerton si besëtytni (supersticion). Në këtë mund të bindet gjithkush. Përpiquni të thelloheni në gjykimet interne të atyre që deklarohen si ateistë, e do të shihni se sa e vërtetë është kjo.

Ja se ç'më tregoi një mik:

“Shkoja te një familje ateiste, si instruktor i fëmijëve të tyre. Prindërit kishin hequr dorë nga besimi si ngarkesë shoqërore. Fëmijët në familje, në shoqëri dhe në shkollë vinin në kontakt vetëm me pikëpamjet ateiste.

Një ditë vajza e tyre 17 vjeçare më priti me një varg tregimesh të vogla se si e ka përmirësuar notën e dobët. Në atë tregim të vetin çuditërisht më ka habitur vërejtja se si vetë profesori ia ka “ruajtur

fatin.” Asgjë nuk kuptoja se përse ishte puna. U interesova. Pas pyetjeve të shumta mora vesh se ajo kishte pasur një hajmali, që ia kishte dorëzuar shoqes së bankës ‘t’ia ruajë fatin’, kur kjo filloi t’i përgjigjet profesorit. Duke e vërejtur këtë, profesori, me buzë në gaz, ia kërkon - siç thotë - t’ia ruajë derisa të përgjigjet ajo.”

Edhe ky mik nuk mundi t’ia sqarojë vetvetes si vetëmbiu kjo besëtytni.

Vërtet, si të gjykojmë për këtë? Vetë profesori me siguri ka shikuar në këtë dukuri si në një naivitet fëmijëror ndaj të cilit mund të sillemi më tepër si në shaka e ngazëllim se sa në mënyrë kritike. Mirëpo, kjo marrë në vetvete do të thotë shumë, sepse gjëra të ngjashme ndeshim në çdo hap, madje edhe te njerëz të arsimuar dhe të moshuar.

Njëherë, nëpërmjet televizionit, ndoqa një ndeshje sportive, dhe një sportist, pasi arriti sukses, në shenjë të dashurisë dhe falën-derimit (këtë kanë mundur ta shohin miliona shikues) u kap për maskotën e vet, një figurë mbirealiste.

Gjykimi i fesë për këtë dhe të ngjashme si kjo është i njojur. Mirëpo, ç’thonë ateistët, ç’farë është gjykimi i tyre?

Ta parafytyrojmë këtë sportist se si e ka vënë maskotën e vet në vendin e nderuar në shtëpinë e tij, në raft dhe e ka stolisur këtë vend me lule dhe pranë saj ka vendosur medaljet e veta.

Ku mbaron këtu - sipas mendimit ateist - naiviteti, e ku fillon ajo që duhet gjykuar.

Zhvisheni njeriun nga besimi, ai do të lidhet për besëtytni. Mendimi i ateizuar nuk do të mund të pengojë zemrën e njeriut që ta përqafojë atë atëherë kur ndjenë vuajtje dhe frikë të paqartë. Nëse ua zhdukni njerëzve besimin në Zot, ata do të fillojnë ta adhurojnë atë që nuk është i denjë për adhurim.

Ky fakt ishte i pranishëm në të kaluarën historike, por edhe në të sotmen.

Glorifikimi i të gjallëve dhe i të vdekurve, përmendoret e tyre, fotografitë dhe shtatoret-të gjitha këto i ka gjykuar feja, mirëpo, është e paqartë se kur mendimi ateist do të jetë i gatshëm t’i gjykojë këto. Ndoshta gjeneratat e ardhshme të një kulture tjetër do ta vlerësojnë këtë në të njëjtën mënyrë siç gjykojmë ne për religionin e romakëve dhe grekëve? A thua nuk është kjo e njëjtë gjë? Rreth viteve tridhjetë të këtij shekulli një shkrimtar nga Perëndimi, pas kthimit të tij nga BRSS shkroi se atje nuk e adhurojnë më të mbërthyerin në kryq (Krishtin), por të balsamuarin.

Nëse ateizmi konsideron se religjioni është besëtytni e kultivuar e shartuar në llojin e vet të egër, përvoja e deritashme ka treguar se ta zhdukësh religjionin nuk do të thotë në të njëjtën kohë edhe të pengosh mbirjen e filizave të egër nga fara dhe rrënja e tij. Thuajse besimi është ngulitur në fatin dhe në shpirtin njerëzor.

Kur'ani pyet: "...Atëherë, cilës bisedë pos kësaj (Kur'anit) do t'i besojnë?" (7:185).

### *Islami*

Feja për mësimin e vet i ka argumentet e veta. Këto argumete janë të natyrës intelektuale dhe morale. Ateizmi është përplot vërejtje ndaj fesë dhe mësimit të saj, mirëpo, kjo nuk është njësoj sikur argumenti shkencor dhe arsyetimi shkencor për qëndrimin e tij me të cilin ai e mohon ekzistencën e Zotit.

Njeriu heton se diç e tërheq nga besimi, mirëpo shumë sish sinqerisht janë të shqetësuar nga shumë religjione, ndaj pyesin: "Cila hyjni është Zot i vërtetë?" Dilema e shpie në mosbesim, ndërsa kritika e pamjaftueshme në besim të gabuar.

Ateistët mendojnë se Islami është i ngjashëm me çdo religion tjetër. Materialistët gjithashtu. Kjo për ta është e padiskutueshme. Meqë materializmi është ekskluziv, ai në të njëjtat korniza e fut edhe fenë - besimin e vërtetë të shpallur në një Zot - dhe të gjitha religionet, edhe politeizmin, edhe animizmin, edhe idhujtarinë, edhe magjinë, duke i shpallur të gjitha si besëtytni dhe si të tilla i hedh poshtë. Pikërisht një qëndrim i këtillë ndaj fesë është jo-shkencor, e veçanërisht i padrejtë ndaj Islamit, në të njëjtën mënyrë sikur ta krahasonin medicinën me sharlatanizmin, kiminë me alkiminë, ndërsa astronominë me astrologjinë.

Islami është unikat në mësimin e vet. Ateistët do të duhej të vërenin se mësimi islam nuk është reduktuar në nivelin e çfarëdo tregimi, magjie dhe besëtytnie, se ky nuk është kult i objekteve, i kafshëve dhe i njerëzve, se ky nuk është religion i figurave, idhujve dhe hajmalive, se kjo nuk është lutje drejtuar të shenjtëve të vëtëshpallur ose të pagëzuar, por është pranim i një Fuqie, dhe quani atë si të doni-por vetëm me emrat më të bukur, sepse ajo Fuqi është e vetmja Fuqi e denjë për adhurim, për famë dhe për falënderim - ja, ky mësim është Islami. Le t'i kushtojnë kujdes Kur'anit se ai e fton Muhammedin a.s. që mos të pranojë asgjë për të cilën nuk ka

argumente të forta, dhe të mos e ndjekë rrugën për të cilën nuk ka njohuri të sigurta: ndërsa kjo nuk është magji, as besëtytni, ky është parim i shkencës.

Islami është i jashtëzakonshëm në paraqitjen e tij. Kur'ani - kur polemizon me pjesëtarët e religjioneve tjera - i thërret që të sjellin argumente të besimit të tyre, argumente të të mësuarit të religjioneve të tyre, duke ia lënë ndërmjet këtyre mësimeve dhe Islamit vendimin arsyes. Për këtë i porositi vetë Zoti xh.sh. Ai i porosit që mos të teprojnë në të besuarit e tyre, që mos të trillojnë gjëra të paqena.

Për Islamin, angazhimi konfesional është i huaj. Kanti, Gëte dhe shumë të tjerë, të njohur dhe të panjohur, të cilët me anë të meditimit kanë arritur të mësojnë për domosdoshmérinë e ekzistimit të Zotit dhe për domosdoshmérinë e ditës së dhënies së llogarive për të mirat dhe të këqijat e bëra, në kuptimin e mësimit islam janë besimtarë të pakontestueshëm.

Kur'ani thotë:

*“Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudi, krishterë, sabejë (kishin lëshuar fenë dhe i adhuronin engjëjt), kush besoi prej tyre (singerisht) All-llahun dhe botën tjetër, dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre...”* (2:62)

*“Thuaju (o i dërguar): ‘O ihtarë të librit, (Tevratit e Inxilit), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë askë pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij askë shok, të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos All-llahut! ...’* (3:64)

Islami nuk paraqitet me mrekulli, me të cilat dëshiron t'i shtang njerëzit. Qëndrimi kur'anor është se i tërë ky realitet, dëshmitarë të të cilit jemi, vetvetiu për mendjen që mediton është një mrekulli.

Kur'ani porosít njeriun se e gjithë kjo është rezultat i diturisë së një Fuqie të vetme dhe të jashtëzakonshme, të pakufishme dhe të pakrahasueshme me askë. Thërret arsyen njerëzore që të meditojë pak - ai nuk frikësohet për njeriun që mediton - sepse me anë të përsiatjes domosdo do të zbulojë këtë të vërtetë. Ai kërkon prej atyre që mendojnë ndryshe, t'i sjellin argumentet e veta. Dhe vërtet, ç'mund të sjellin ateistët si argument, se ajo Fuqi nuk posedon intelekt? - Asgjë! Çfarë argumenti kanë ateistët se e gjithë kjo na qenka

fryt i fuqive të pavetëdijshme? - Kurrfarë. Jobesimtarin e habitur, Kur'ani menjëherë e njofton kategorikisht se pas vdekjes do të ringjallet - ky është vendimi dhe vullneti i kësaj Fuqie. Jobesimtarit të hutuar dhe të shtangur, që me pabesim e dëgjon këtë, i thotë se kjo Fuqi është aq e mençur dhe aq e fuqishme saqë është në gjendje ta bëjë këtë. Dhe e pyet, përse ai dyshon, kur ajo është e njëjtë Fuqi e cila e krijoj edhe herën e parë; kërkon prej tij arsyen, përse ai e mohon këtë ringjallje.

### *Dyshimet ateiste dhe përgjigjet në to*

Ateizmi është krejtësisht i pafuqishëm në konfrontimin me një doktrinë të këtillë. Ateisti mund të thotë vetëm: "Këto janë gjepura dhe dokrra të popujve që kanë qenë dhe kanë kaluar", mirëpo... ky nuk është argument. Ai vetëm mund të dyshojë, të mos besojë. Ai tërhiqet, por dyshimin e vet e vërteton në mënyrë të tërthortë: "Në qoftë se Zoti e ka krijuar këtë botë, kush e krijoj Atë? Në qoftë se dikush është dashur patjetër ta krijojë këtë realitet, atëherë kush e krijoj atë Krijues?"

Kështu pra, ateisti i lejon vetes të pohojë se kjo botë ekziston pa krijuesin e vet, ndërsa kërkon që Zoti i religionit patjetër të ketë krijuesin e vet - dhe këtë ai e quan logjikë! Ateisti i pezmatuar në gjithë këtë, do të thotë se besimtari e konsideron si të domosdoshme - e jo ai - se e tërë kjo botë materiale e ka Krijuesin e vet, dhe tanë kërkon që kjo *rregull* të zbatohet edhe në krijuesin 'e vet'.

Është e ditur se me këtë zhytemi në vështirësi mendore. Nëse i përbahemi *rregullës* se çdo gjë ka krijuesin e vet, përfundojmë në një varg të pafund krijuesish, e meqë kjo për arsyen njerëzore është e pakuptimitë, atëherë, duhet të konstatojë se nuk ekziston asgjë; prej asgjëje nuk mund të dalë diçka, e as kurrfarë krijuesi, por vetëm asgjë, e sipas kësaj nuk ekziston as kjo botë. (Në të vërtetë, duhet patjetër të mendojë se në fillim nuk ka pasur asgjë, ndërsa *rregulla* e përmendur më lart na pengon të supozojmë ekzistencën e çfarëdo gjëje).

Natyrisht se kjo për ateistin është qesharake, sepse ai është i vetëdijshëm se besimtarët dhe jobesimtarët pa dilemë janë marrë vesh për realitetin e ekzistimit të vet dhe të botës rrëth tyre. Njeriu përnjëherë braktis diskutimet e këtilla dhe i duken të pakuptimta, mirëpo nuk e ka të qartë për ç'arsye shkaktohet një përshtjellim i

këtillë mendor; e ky pikërisht shkaktohet për shkak të rregullës se “Çdo gjë që ekziston, patjetër duhet të ketë krijuesin e vet.” Prej nga na takon neve kjo e drejtë që këtë premisë ta shpallim *rregull*, *ligj*, *parim*, e pastaj ta zbatojmë edhe në Zotin? - Ne nuk kemi kurfarë të drejte në këtë. Ja një krahasim:

Në një numër boshtesh krijohet lëvizje me të cilën dy madhësi matematikore  $Q$  dhe  $O$  dalin njëra nga tjetra në një interval të caktuar kohor. Shtrohet pyetja se cila nga këto dy madhësi është primare, fillestare. Ju do të përgjigjeni se kjo është pyetje absurde, se në mënyrë të drejtpërdrejtë e mohon qëndrimin e mëparmë, sepse është e pamundur ta paramendosh cilëndo qoftë si fillestare meqë ajo - sipas qëndrimit të shprehur - na del nga ajo e dyta. Në vërejtjen se një rezonim i këtillë na shpie në pakufi, ju do të përgjigjeni se kjo është pasojë e pashmangshme e qëndrimit të mësipërm, dhe se këtu nuk ka asgjë të palogjikshme: matematika pranon pafundësinë. Pérndryshe, në kundërshtim me këtë, nëse duam që pyetja e shtruar të ketë ndonjë kuptim, atëherë qëndrimi për madhësitë  $Q$  dhe  $O$  duhet të tingëllojë (disi) ndryshe, edhe atë në atë mënyrë që ta lejojë pyetjen e shtruar më parë. Qëndrimi dhe kushti i shprehur në njëfarë kufizimi kohor janë të paqëndrueshëm përballë njëritjetrit.

Përgjigjja juaj është plotësisht me vend, por përse ju jeni aq të hutuar nëse ju thuhet se këto madhësi nuk janë asgjë tjetër, pos pyetja e njohur - me të cilën fëmijët vihen në dilemë, por edhe të mëdhenjtë - ç’ka ekzistuar më parë: pula apo veja? (Këtu nuk ndihmon gjë përpjekja që të arsyetoheni me tregimin përvolucionin dhe teorinë përfomimin e llojit, sepse është e qartë se në aspektin e të menduarit nga e kaluara ne mund të ndjekim edhe atë diçka që do të ishte paraardhëse e vesë, sikur edhe ajo diç që i përngjet pulës). Kjo neve tani na duket aq paradoksale: mendimi na hepohet në pakufi; ndërsa është e qartë se mund të veprohet vetëm përbrenda kufijve kohorë. Arrijmë në përjashtime të atilla që në një moment - kur të harrojmë - të mohojmë se ekzistojnë edhe pula edhe veja, sikur të mos ishim nisur pikërisht nga ato, si argument.

S’ka dyshim se diku është bërë gabim. Gabimi qëndron në atë se faktin që pula dhe veja rrjedhin njëra nga tjetra, e kemi pranuar si parim. E kush na ka thënë se ky raport është *rregull*, se ai është *ligj*, se është *parim*? As që e kemi pyetur logjikën!

Gabimi qëndron pikërisht në faktin se përsëritjet e rregullta i kuptojmë si rregulla - karakteri i të cilave do të ishte i pamohue-

shëm; i pranojmë si ligj - i cili posedon qëndrueshmëri dhe pandryshueshmëri; e shpallim parim - i cili sipas kuptimit të vet do të ishte i parevokueshëm dhe i pavarur prej kujtdo qoftë. Njeriu u jep kuptim të atillë pa kurrfarë vlerësimi. Qëndrueshmëria e tyre në një masë, në çfarëdo intervali të gjatë kohor, në të njëjtën kohë nuk do të thotë qëndrueshmëri e amshueshme. Kjo shihet qartë nga pyetja e mësipërme për pulën dhe venë.

Në të njëjtën mënyrë të dhënat e eksperimentuara se çdo gjë ka krijuesin e vet, se çdo veprim ka shkakun e vet, nuk kemi kurrfarë të drejte t'i shpallim si ndonjë rregull mbinatyrore nën të cilin kriterium do të duhej ta fusim edhe kuptimin e Zotit.

S'do mend se ateisti mezi pret të kuptojë se nuk është i detyruar të pranojë rregullën se ‘çdo gjë ka krijuesin e vet’, sepse atëherë me kënaqësi do të pohojë se edhe realitetit tonë eksperimental nuk i është i nevojshëm Krijuesi - Zoti si supozim i domosdoshëm. Megjithëkëtë, ai mashtrohet. Pikërisht këtu qëndron mashtrimi themelor i ateizmit. Feja nuk mëson se Zoti ekziston për shkak të ndonjë rregulli se ‘çdo gjë ka krijuesin e vet’, por se realiteti i këtillë çfarë është, domosdo sipas esencës duhet të ketë Krijuesin dhe Kujdestarin e vet. Zoti, ashtu siç nuk është trillim i arsyes primitive, nuk është as supozim mendor i ndonjë filozofie. Zoti është e Vërteta e pranishme e shkencave ekzakte. Edhe ateistët edhe besimtarët shpesh flasin për këtë të Vërtetë, vetëm se ata nuk mund të pajtohen me karakterin dhe cilësitë e saj.

Feja e ka definuar qartë këtë të Vërtetë në mënyrë kategorike, të padyshimtë dhe të parevokueshme, mirëpo, imaginata e ateistëve për këtë të Vërtetë ndërrohet: ata nuk kanë njohuri të sigurt, të qëndrueshme dhe të caktuar për Të.

### *Realiteti i përvojës sonë kujt duhet t'i falënderohet për ekzistencën e vet*

Për ateistin paraqet njérën nga vështirësitet më të mëdha (krahas asaj për krijimin e qelizës së kryehershme) edhe pikëpamja e krijimit të kësaj bote materiale. Ai kuptimisht ik në paskajshmëri. Materies i jep cilësi të amshueshmërisë, do të thotë cilësinë që seja e rezervon vetëm për Zotin. Mirëpo, shumë ateistë e ndjejnë absurditetin e vërtetë të një qëndrimi të këtillë - e shohin se për këtë nuk ka kurrfarë argumentesh. Ateisti është i shtrënguar të rezonojë a

priori në këtë mënyrë nga qëndrimi i vet ateist, sepse nëse mendon se bota kishte ndonjë fillim, domosdo i imponohet pyetja çka i ka paraprirë këtij fillimi si shkak. Ateisti, ndoshta më me kënaqësi do të pranonte se Zoti i fesë i ka kriuar të gjitha këto, vetëm sikur të kishte mënyrë dhe mundësi që pastaj ta largojë Atë. Tani i duket i panevojshëm. Këtu qëndron parimi i ruajtjes së energjisë, i cili sqaron ekzistencën e kësaj bote, ndërsa ndryshimet pasojnë sipas ligjeve natyrore, ndaj Zoti i duket i tepërt.

Mirëpo, ateisti është viktimë e vetëmashtrimit. Ai Zotin e ka zëvendësuar me nocion të gabueshëm të karakterit parimor për ruajtjen e energjisë, në të njëjtën mënyrë siç i ka konceptuar gabimisht ligjet natyrore si shkaqe të ngjarjeve.

(Shpesh ndeshim edhe besimtarë, të cilët janë të hutuar nga prania e vazhdueshme e ligjeve natyrore dhe nuk dinë ta harmonizojnë këtë nocion me vullnetin e Zotit. Pernjëherë u duket se si Zoti me ato ligje të veta ia ka kufizuar vvetesë vullnetin dhe fuqinë e vet. Kështu dëgjohet se besimtari thotë: "Zoti nuk do ta ndërrojë rrjedhën e ligjeve natyrore për shkak ose për arsy..." etj. - që sipas mësimit fetar është interpretim i gabuar. Ne nuk e dimë çka do Zoti e çka nuk do. Sipas mësimit fetar, e vëmja gjë e drejtë është të kuptojmë se çdo gjë që ndodh - madje edhe ato që i emërojmë si ligje natyrore, - në të vërtetë ndodh me vullnet dhe paracaktim të Zotit).

Të gjithë ne në shkollë jemi njojur me parimin e ruajtjes së energjisë. E gjithë kjo na dukej e qartë, natyrisht edhe e logjikshme. Na ka prishur pak disponimin kur jemi detyruar që definicionin e Njutnit për ruajtjen e masës dhe të energjisë ta korrigojmë në konceptin e ruajtjes së energjisë. I kemi shpjeguar vvetesë se parimisht nuk ka ndryshime, vetëm jemi detyruar ta ndërrojimë botëkuptimin për materien, e me këtë edhe për ekuivalentin e saj matematikor-masën, duke e sjellë në konceptin e energjisë. Tekefundit, kjo është më afér mendësh që tërë këtë realitet ta konceptojmë si një formë, e jo si një dualizëm.

Kurrë nuk do të harroj përshtypjen kur më është drejtuar interesimi në qëndrimin kategorik kur'anor: *se sikur të mos ishte Zoti, toka dhe qelli do të shkatërrohen*. M'u duk si një porosi drejtuar njeriut bashkëkohor. Më ndriti mendimi se ne me nocionin e parimit të ruajtjes së energjisë e kemi mashtruar vveten. Ai në psikikën njerëzore është zhvilluar deri në pikën e paqëndrueshme.

Supozojmë se ky parim nuk ekziston. Çka do të ndodhte? Kurrë nuk do të ishim të sigurt se një trajtë të energjisë do të mund ta shndërronim në tërësi në trajtë tjetër. Thjesht, do të mund të humbte gjatë rrugës. Ose kështu: energjia e madhe e Diellit në kuptimin tekstual të fjalës, do të mund të shkatërrrohet pa shkak. Dhe e tërë kjo botë materiale, thjesht do të mund të zhdukej në asgjë, e po ashtu ndonjë energji e re në trajta të nduarduarta të krijohej prej asgjëje. E gjithë kjo do të ishte e paparashikueshme. Një gjendje kaotike, nëse në përgjithësi edhe do të mund të emërhohej si ndonjë gjendje.

Para logjikës njerëzore paraqiten aq shumë vështirësi, saqë njeriu nuk di se në ç'rrugë ta drejtojë mendimin e vet. Zhytet në fu-shë jashtëfaktike, jashtë përvojës, ndërsa konceptet treten dhe zhduken.

Për një shpjegim të këtillë një materialist do të ofrojë një gjykim krejtësisht të papërshtatshëm. Ai do të thotë: "Një meditim i tillë nuk ka kurrfarë kuptimi. Ky parim është realitet dhe falë këtij realiteti ekziston e gjithë kjo. Do të ishte e pakuptimtë të bëhet pyetje se 'ç'do të bëhej sikur mos të ishte ky parim?', sepse do të ishte marri të supozohet se ai nuk ekziston, prandaj edhe se do të zhduket."

A thua kjo nuk është cilësi e Atij për të cilin bën fjalë feja?! Të parashtrojmë një maksimë kësisoj: Sikur mos të ishin parimet e ruajtjes së energjisë, të gjitha trajtat e energjisë, e tërë gjithësia, gjithçka do të shkatërrrohet. Sa e çuditshme duket kjo. Kësaj maksime nuk mund t'i bëhet vërejtje logjike. A thua është e mundur që ky të jetë realitet definitiv i çdo gjë që ekziston i caktuar nga aspekti hyjnor, i mjaftueshëm për vetveten dhe prej askujt dhe prej asgjëje i përcaktuar. Fuqia hyjnore mbështet çdo gjë që ekziston, mirëpo për vetveten është shurdhëmemece dhe hyjni e verbër, që nuk duhet adhuruar, sepse është pa vullnet dhe pa vetëdije për vete dhe për këdo tjetër. Plotësisht pa vetveten dhe pa personalitet, nuk përfaqëson askënd. Sikur mos të ekzistonte energjia, nuk do të ekzistonte as ajo. Ajo manifestohet nëpërmjet ekzistimit të energjisë.

Dhe derisa mendimi njerëzor merr guximin që të mendojë shkatërrimin dhe asgjësimin e energjisë (edhe pse e dimë qartë se ky mendim është jashtë kufijve shkencorë, megjithatë një mendim i këtillë paraqitet te njeriu si pasojë e mashtrimit psikik, sepse energjia, format e saj të ndryshme janë objekt i vullnetit njerëzor), deri atëherë për asnjë çast nuk na ka rënë as ndër mend që për parimin e

ruajtjes së energjisë të mendojmë si për ndonjë send që lejon të zhduket. Hyjni johyjnore.

A thua nuk është ky një fiksion i rëndomtë, absurd i vërtetë shkencor? Thjesht, një abstraksion jashtë logjikës, i privuar nga çfarëdo argumenti!

A nuk e shihni edhe ju lexues, paqëndrueshmérinë e një qëndrimi të tillë? A e shihni ju se ku bëhen gabime?

Paramendoni veten se jeni në tubimin para të cilit flet Kolomboja, se me lundrim të vazhdueshëm në drejtim të Perëndimit, mund të arrihet në Indi. Ju gjithsesi e shihni të arsyeshme t'i ndihmoni. Tubimit i drejtoheni kështu: "Ju pohoni se trupat për shkak të peshës, patjetër duhet të bien në anën tjetër të Tokës. Shpjegoni përsë janë të rëndë trupat; prej nga e kanë këtë cilësi?" - dhe pastaj dinakërisht shton: "Ndoshta ata janë të rëndë vetëm në këtë anë të Tokës, por jo edhe në anën tjetër."

Ju që në fillim triumfoni, sepse e dini se të vetmit ju posedoni çelësin për përgjigje të mirëfilltë. Mendoni se u keni parashtruar pyetje me të cilat më së miri do të argëtoheni dhe do t'i mundoni. Mirëpo, që tani ata do t'ju përgatisin befasitë vërtetë.

"I dashuri mik, - u drejtohet juve njëri ndër ta, - ti ose je i marrë ose je aq i pafytyrë që të ka shkuar ndër mend të na bësh budallenj."

Derisa ju ende nuk jeni këndellur nga zhvillimi i papritur dhe toni i diskutimit, ai ju përgatiti befasitë edhe më të madhe. Me lejen e përgjithshme të tubimit ai vazhdon:

"Pesha është cilësi e materies - ky është argument i pranishëm gjithkund në natyrë, ai është ligj i saj, është parim..."

Theqafje të këtilla mendore bëhen edhe sot. Kur të arrijmë në fund të mundësive tona eksperimentuese, atëherë bëjmë nyjen shkencore. E kjo nuk është asgjë tjetër por çzotim i Zotit, zbërthim i konceptit Zot dhe atribuim i cilësive të Tij dikujt tjetër.

(Në ekzistimin e të drejtës në këtë 'trashëgimi', njeriu nuk e ka harruar as veten. Për vete ka paraparë një pjesë bukur të madhe, por për këtë do të flasim më vonë).

Gjykoni vetë: A ka farë pengesash logjike për pyetjet: "Prej nga ky parim për ruajtjen e energjisë?" dhe "Si është e mundur që të gjitha proceset të ndodhin brenda kufijve të tij?" - atëherë në mënyrë të pashmangshme do të vijmë deri te përfundimi për ekzistimin e shkakut, i cili me vetitë e tij mbetet jashtë mundësisë së provave

tona, mirëpo feja na ofron përgjigje të arsyeshme dhe të bindshme, të vërtetë, madje edhe të garantuar nga vetë ai shkak.

Ne besojmë në këtë të vërtetë! E ju, të dashur lexues?

### *Ateizmi pa materializëm*

Materializmi, ky ateizëm konsekuent, niset nga hipoteza se i gjithë ky realitet besnik shprehet besnikërisht në vetëdijen tonë. Kjo për të nuk është hipotezë, por e vërtetë e pakontestueshme. Me këtë koncepti për Zotin do të duhej të ishte trillim në të njëjtën mënyrë si tregimet për zanat. Një qëndrim i këtillë mund ta hutojë njeriun dhe vërtet shumë sish i ka shpjerrë në mosbesim. Mirëpo, u desht shumë kohë që të dalë në shesh metoda e gabuar e konkludimit të tyre. Kjo definitivisht doli në shesh kur iu dobësua baza e ndërtuar në përfytyrime të forta të fizikës klasike.

Të dëshmosh se ekziston kjo botë, dhe të argumentosh se ajo është realitet, nuk është kurrfarë shkence. Këtu nuk nevojiten kurrfarë argumentesh, kjo është aksiomë dhe prej këtu fillon shkenca: gjurmimi për thelbin e këtij realiteti. Në shikim të parë dukej se materializmi është në rrugë të drejtë që tregon realitetin e kësaj bote, sepse kanë ekzistuar drejtime në filozofi, të cilat kanë dyshuar se a është esenca e këtij realiteti, e materies dhe e manifestimeve të saj në kuptimin e lëvizjeve dhe ndryshimeve, vërtet e tillë siç e shohim apo vetëm na duket si e këtillë.

Për të dëshmuar realitetin e kësaj bote, materializmi përdori kriteret të cilat i përgjigjeshin, ato që i ishin të përshtatshme. Meqë me to dëshmoi në të vërtetë atë që është aksiomë, atë e ka pandehur se është e drejtë ndaj këtyre kritereve, i ka dhënë karakter të vlerave absolute-e ky është gabim-dhe i ka zbatuar në mësimin e religionit.

Njohuritë e shkencës bashkëkohore i kanë zbuluar njeriut tërë karakterin relativ të asaj që ai e quan realitet. Zbërvimi i materies e ka habitur: deri më tanë ka besuar në paprekshmërinë e saj. Me të kanë shkuar në pakthim edhe të gjitha kriteret materialiste të ateizmit.

Edhe pse materializmi i shekullit të kaluar shkencërisht është shkatërruar, megjithatë ende ndeshim pikëpamje të pastra materialiste. Këto janë reflekse, recidive të një mendimi të vdekur. Vetë ateizmi pa materializmin vazhdoi jetën e vet. Ndryshime thelbësore nuk ka. Vetëmse momentalisht ai është në pozitë të pavolitshme,

sepse është zhveshur, sepse guaska materialiste i është thyer. Ai është i pambrojtur. Është privuar nga mbrojtja efikase, me të cilën për një kohë të gjatë shumëkë e ka impresionuar. Ai gjithsesi do të përpinqet ta përjetojë metamorfozën e vet, të fitojë petkun e vet të ri, ta quajmë ‘energjetik’, në kuqimin e zbulimeve të njohurive të reja shkencore. Mirëpo, ky edhe më tutje do të jetë petku, e jo thelbi i tij. Ai edhe atëherë nuk do të jetë frysht i shkencës, ashtu siç nuk ishte edhe deri më tash. Njeriu do të mësohet në realitetin e ri, në këtë ‘relativ’ ose ndoshta në ndonjë tjeter, ashtu siç ka qenë i mësuar në atë ‘materialist’.

Përsëri do të dëgjohen fjalët: “Jashtë kësaj dhe realitetit të kë-tillë nuk ka asgjë...”, fjalë të njohura të atyre që nuk duan të besojnë. Ateizmi ka ekzistuar gjithmonë, ndaj do të ekzistojë edhe në të ardhmen. Këtë vetë feja e mëson.

E sa i përket kohës sonë - përkundër argumenteve se ka dalë në shesh e gjithë lakuriqësia shkencore e botëkuptimeve ateiste, dhe si për inat-madje edhe në lëvizjet ideore të shoqërisë, gati hetohet prania superiore e qëndrimeve ateiste. Sepse, rrënjet e ateizmit nuk qëndrojnë as në kulturë, as në zhvillimin historik, as në sistemet shoqërore; ato mund të janë vetëm kushtet e volitshme dhe të pavolitshme dhe nxitjet e tij. Shkaqet e tij janë krejtësisht të një natyre tjeter.

### *Zanafilla e ateizmit*

Ateizmi, çfarëdo shprese religjioze, falënderim ose lutje e pandeh të tepërt. “Duhet njohur natyrën, ligjet dhe fuqitë e saj, t’i shfrytëzojmë dhe t’i mbizotërojmë ato” - këto janë fjalët e mbrojtësve të tij dhe në to shihet karakteri i tij i vërtetë; këto na shpien në burimin e tij të mirëfilltë. Ateizmi është frysht i *mendjemadhësisë* njerëzore.

Kjo mund ta befasojë atë që nuk e njeh mësim-besimin. Ateistëve më së paku ky u duket si pohim i çuditshëm. Megjithatë, gjatë gjithë historisë së gjinisë njerëzore ky është shkak i mirëfilltë i çdo ateizmi. Të gjitha fetë e shpallura kanë tërhequr vërejtjen në të.

Deri te mendimet dhe disponimi ateist ka shumë rrugë. Mosdija shpie në mosbesim dhe në besëtytni, por njëkohësisht edhe në ateizëm. Tekanjozët ikin nga qortimet e fesë dhe kërkojnë ngushë-

llim në mendime të ateizuara, - ata e pëlqeijnë dhe i përshtaten njëritjetrit.

Shpeshherë rrethanat e njëjta, një njeri e shpien në besim, kurse tjetrin në mosbesim. Fatkeqësinë, sëmundjen dhe varférinë njeriu mund t'i kuptojë si prova. Mirëpo, kjo te disa njerëz mund të shkaktojë dyshime ateiste. Fatkeqësitë e vazhdueshme shpeshherë mund të shpiejnë në dëshpërim dhe në mosbesim.

Ateizmi shprehet në forma indiferente ekstreme ndaj asaj që ne e quajmë e vërtetë fetare.

Për të gjitha këto tregon Kur'ani.

Por, nga ajetet e poshtëshënuara:

*“Ata që kundërshtojnë shpalljen e All-lahut pa pasur argument, nuk kanë tjetër në zemrat e tyre vetëm se një mendjemadhësi, me të cilën nuk do t'ia arrijnë qëllimit, e ti kërko mbrojtje te All-lahu, se Ai të gjitha i dëgjon dhe i sheh.”* (40:56)

*“Për arsyen se kur u thuhej atyre: “Nuk ka Zot tjetër përveç All-lahut, ata e mbanin veten lart.”* (37:35)

*“Dhe kur i thuhet atij: “Ke frikë All-lahun!”, atë e kap eufori për punë mëkatit.”* (2:206)

*“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjemadhësi, pra shikoje se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve.”* (27:14)

*“Zoti juaj (që meriton adhurim) është një Zot, e ata që nuk e besojnë botën tjetër, zemrat e tyre janë mohuese (të njëjësisë së Zotit) dhe ata janë kryelartë. Është e vërtetë se All-lahu e di atë që e fshehin dhe atë që e shfaqin haptazi dhe se Ai nuk i do arrogantët.”* (16:22-23)

*“Vetëm e Tij është çdo gjë që është në qiej e në tokë! E ata që janë pranë Tij (engjëjt), nuk shprehin mendjemadhësi në adhurimin ndaj Tij, e as nuk u bëhet (ibadeti) monoton.”* (21:19)

*“Ata mburreshin me fodullëk dhe u bënë popull kriminel.”*

Dhe nga ajetet e ngjashme kur'anore shihet zanafilla e mirëfilltë e ateizmit. Është karakteristike se sipas Kur'anit, shejtani - nga arroganca dhe nga mendjemadhësia - refuzoi t'i kryejë urdhrat e Zotit dhe t'i përulet njeriut të parë.

Nga transmetimet e dimë se nga lutjet e Muhammedit a.s. ishte edhe lutja që Zoti ta ruajë nga mendjemadhësia.

### *Burimet e mendjemadhësisë*

Mendjemadhësinë nuk e stimulon asgjë më tepër sesa pasuria dhe fuqia. Për këtë besimtarët gjithmonë kanë qenë të vetëdijshëm, sepse gjithnjë u është tërhequr vërejtja që kjo mos t'i mashtrojë e t'i shpie në vetëharresë. Prandaj janë paraqitur gjykimet religioze të pasurisë materiale dhe të pushtetit dhe heqja dorë prej tyre si nga një e keqe e ndytë. Mirëpo, Islami na mëson se as njëra as tjetra vetvetiu nuk janë të këqija, se janë dhurata të dhëna njeriut nga Zoti, por ia tërheq vërejtjen se këto janë sprova me të cilat mund të fitohet xhenneti ose xhehennemi.

Kur'ani nuk kërkon nga njeriu që të heqë dorë nga mundësitë e veta, por që të mos rebelohet me mendjemadhësi e arrogancë dhe mos të bëjë dhunë dhe padrejtësi; nuk kërkon që njeriu të heqë dorë nga të mirat e kësaj bote, por mos ta rrudhë tepër dorën, e kursimi të kalojë në kopraci në raport me skamjen e të tjerëve, nuk predikon varfërinë, por kërkon kursim në kërkeshat personale: ia tërheq vërejtjen njeriut që të ruhet nga dalldisja, nga luksi i shfrenuar dhe nga shpenzimet e panevojshme.

Pasuria dhe fuqia e njeriut të sotëm rrjedhin nga dituria, që i ofron atij shkenca. Prandaj shumë njerëz nga mosdija e tyre e kanë shpallur shkencën si punë djalli.

Mirëpo, sipas mësimit islam, shkenca është imperativ për besimtarin dhe bekim i mirëfilltë i Zotit. Fjalët e para drejtuar Muhammedit a.s. në Shpallje ishin:

*“Lexo, në emër të Zotit tënd... Lexo, Zoti Yt është më fisnik. Ai e mësoi njeriun të shkruajë dhe e mësoi njeriun për atë që nuk e dinte.”* (96:1-5)

Dituria është burim i mençurisë, ndërsa Kur'ani thotë:

*“Zoti ia jep mençurinë kujt të dojë. Atij që i është dhënë mençuria, ka fituar pasuri të madhe. Vetëm të mençurit e kuptojnë.”*

All-llahu në Kur'an na fton të meditojmë, na nxit në kërkime shkencore në mënyrë që me anë të shkencës të fitojmë njohuritë për ekzistimin e Zotit dhe se gjithçka që ndodh në ne dhe rrëth nesh, është rezultat i vullnetit dhe mençurisë së Tij. Ai na lejon ta shfry-

tëzojmë shkencën sipas gjindshmërisë sonë. Ai nuk frikësohet - e as që mund të ndodhë kjo! - se ne mund të intervenojmë në kompetencat, në përcaktimet dhe në krijimet e Tij. Do të ishte marri e madhe nëse mendojmë kështu. Ai është Zot absolut me fuqi të pakufishme. Shfrytëzimi i shkencës nga njeriu, nuk e çrregullon rregullin dhe rendin e Zotit. Gjithçka që posedon jetë (e këtu bën pjesë edhe njeriu), me jetën dhe me punën e vet bën ndryshime, e kjo është - siç na mëson feja - sipas përcaktimit të Zotit. Këtu bëhet fjalë për diç tjeter: vlerësohet qëndrimi moral i sjelljes sonë.

Feja na përkujton se shkencën nuk duhet shfrytëzuar për të keq, por në të mirën tonë, ndaj kërkon prej nesh që për këtë t'i jemi mirënjoës Zotit. Kërkon që njohuritë tona (si dhe çdo e mirë që e posedojmë) të janë në interes edhe të të tjerëve, duke e bërë këtë vetëm nga dashuria ndaj Zotit - pa kurrfarë interes i njerëzor - duke e premtuar për këtë dhuratën e Zotit.

Edhe diç: Na tërheq vërejtjen që të mos lavdërohem i mburremi me krenari. Kur'ani me bujë të madhe u kërcënohet fodullëve - sepse të tillë mund të janë vetëm jobesimtarët. Xhehennemi është vendtakim i arrogantëve!

Në Kur'an thuhet:

*"U thuhet: "Hyni nëpër dyer të Xhehennemit, aty do të jeni përgjithmonë. Sa vend i keq është për kryelartët!"* (39:72)

*"Këtë (dënim) e keni për shkak se gëzoheshit pa të drejtë në dynja (duke bërë mëkate etj.), dhe për shkak se krenoheshit (me mendjemadhësi)." (40:75)*

*"Çdo gënjeshtar e shumë mëkatar është i shkatërruar. Që i dëgjon ajetet e All-lahut të cilat lexohen, e pastaj vazhdon prap si mendjemadh, sikur nuk i ka dëgjuar ato. Atë lajmëroje për një vuajtje të dhembshme."* (45:7-8)

*"Zoti juaj ka thënë: "Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem."* (40:60)

*"Jo, ty të patën ardhur argumentet e Mia, e ti i përgënjeshtrove ato, u bëre kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besuan. E ata që bënë gënjeshtër ndaj All-lahut, do t'i shohish në Ditën e Kijamitetit, fytyrat e*

*tyre tē nxira. A nuk éshtë nē Xhehennem vendi i kryelartëve?"* (39:59-60)

*"Atyre që i përgënjeshtrojnë argumentet tona dhe sillen me arrogancë ndaj tyre, nuk u hapen dyert e qiellit."*

## Vetëharresa e njeriut

Pikërisht njeriu bashkëkohor éshtë bërë mendjemandh. Kjo nuk éshtë pasojë e asaj që atë e mëson shkenca, por e asaj që i ofron shkenca. Ai lavdërohet: "Këtë e kam arritur me diturinë time. I kam ditur rrugët dhe mënyrën që ta arrijë këtë." Këto janë fjalët e mos-mirënlohësve dhe si tē këtilla janë tē shënuara në Kur'an.

Njeriu shpjegon se ka filluar prej asgjëje si prodhim i natyrës, mirëpo evolucioni i ka mundësuar që gjithnjë e më tepër tē lirohet nga kontrolli i saj. Shpallja e korrigjon, e këshillon se Zoti éshtë Ai i cili e ka ngritur njeriun, mirëpo njeriu nuk çan kokën për këtë; ai éshtë i privuar nga mirënlohja dhe nga modestia religjioze. Dhe - meqë éshtë trimëruar me sukseset e deritashme nē shkencë dhe nē teknikë - entuziazmohet me mundësitë e mëdha, që nē dukje tē parë i ofron e nesërmja. Ai deklaron se - kur t'i njohë tē fshehtat e panjohura deri më tani tē jetës - atëherë do tē bëhet definitivisht 'Zot i vetvetes' dhe Zot i vetë natyrës, e jo më rob i saj.

Perspektiva éshtë impresionuese:

Nuk do tē ketë uri dhe sëmundje nē botë. Organet e dëmtuara me anë tē intervenimeve kirurgjike do tē zëvendësohen me organe tē shëndosha ose me organe plastike. Jeta e njeriut do tē zgjatet. Dihet se zhvillimin e njeriut e rregullojnë disa gjëndra. Duke i njohur sekretet e funksionimit tē tyre, që do tē thotë se çka ndikon nē funksionimin e tyre tē rregullt ose nē funksionimin e parregullt, do tē thotë se njeriu - shpreson nē mundësinë - që sipas dëshirës së vet nga aspekti intelektual do tē krijojë gjeni ose idiotë ndërsa nga aspekti fizik shkurtabiqë ose viganë.

Duke i njohur gjenet mund tē ndikohet nē cilësitetë trashëgues. Në retorta do tē kultivohet embrioni njerëzor me cilësi tē paracaktuara psikike, fizike dhe intelektuale - gjë që krijon një vizion total tē revolucionit biologjik tē gjinisë njerëzore.

Hulumtimet më të reja lidhur me kujtesën dhe përcjelljen e përvojave në trashëgimtarë si cilësi trashëguese (që shumë prej tyre deri më sot janë konsideruar si instinkt) kanë shpjerrë deri te botë-kuptimi se deponimi i dijes është ruajtur në një mënyrë në strukturën kimike të molekulës së ashtuquajtur ARN, ndërsa kujtesa e stërgjyshërve në molekulën ADN. Kjo hap hipoteza teorike përmundësinë e injektimit artificial të dijes, thënë tekstualisht, me injeksione, e jo me mund e shkollim shumëvjeçar. Ai pranon se që tani ka hapur pakëz derën e botës se re fantastike të mundësive njërezore, por konsideron se ka bërë hap vendimtar edhe ai paraardhësi i njeriut kur për herë të parë e përdori shatin si mjet pune.

Mirëpo, sa i përket teknikës - këtu njeriu është në hovin më të madh. Në dukje po nxjerr krye periudha e ashtuquajtur e re pas-industriale e bollëkut material, kur puna e mundimshme e njeriut do të zëvendësohet me punën e makinave automatike të drejtuara nga truri elektronik. Mandej mundësitë e shumta të qarkullimit dhe të komunikacionit. Ka zbuluar dhe po e shfrytëzon energjinë bërthamore, ndërsa është në vigilje të njohurisë së proceseve subatomike, të antitrupthave-të antimateries, të cilët zbulojnë burime të mëdha të energjisë në të ashtuquajturin anihilim i materies, që do t'ia lehtësojë rrugën deri te planetët tjera, dhe do t'ia mundësojnë mbijetimin në to, si dhe rrugën në sistemet tjera yjore - rrugën në kozmos.

Gjykuar sipas sukseseve të deritashme, tanimë të gjitha këto nuk janë fantazi, por mundësi reale. Njeriu mendon se tani është vetëm çështje e faktorit kohë. Madje edhe ajo sikur është e favorshme; deri më tani shumë më shpejt janë zgjidhur probleme të shumta sesa ka menduar ai vetë.

Mirëpo, kur, si dhe sa do t'i realizojë dëshirat e veta - kjo varet nga vullneti i Zotit. Synimet e veta do t'i realizojë - nëse do Zoti. Të gjitha sukseset dhe mossukseset e deritashme janë realizuar vetëm sipas urdhrit të Zotit.

Kështu predikon Shpallja.

## Faktet udhëzojnë në modesti

Feja na mëson modestinë. Modestia nuk është mungesë e dëshirave, e synimeve dhe e punës, por falënderim, falënderim Zotit për rezultatet e arritura - pa marrë parasysh se a thua kjo (që e kemi

krijuar ne), sipas vëllimit të vet nxit entuziazmin ose dëshpërimin tonë. Feja ia tërheq vërejtjen njeriut që dëshirat mos ta shpien në lakmi dhe në smirë, ose në grykësi, në padrejtësi dhe në dhunë.

Edhe shkenca e mëson njeriun për modesti. Në çdo hap ajo na paralajmëron në kufizimin e dijes dhe të fuqisë dhe varshmërinë tonë nga forcat që janë jashtë arritjeve dhe jashtë mundësive tona. Për çdo ditë na zbulon se vlera jonë është gjithnjë e më e vogël sesa mendojmë ne. Derisa qellin deri dje e kishte menjëherë mbi krye, tash zbulohet se ai shtrihet në hapësirë me miliarda vjet drite. Sa më tepër që ta njohim atomin ose qelizën, e njohim atë shumë më të ndërlikuar sesa e kemi paramenduar. Makrokozmosi dhe mikrokozmosi na shfaqen me ligjet dhe me lëvizjet e veta të çuditshme, që e impresionojnë mendjen njerëzore. E gjithë kjo është tepër e ndërlikuar që të guxonim të mos e përfillim mësim-besimin.

Edhe pse dija njerëzore, fuqia dhe pasuria vazhdimisht po shtohen, ato kanë vetëm vlerë relative. Prandaj, fjalët që dëgjohen se para njeriut qëndron një ardhmëri e mundësive të pakufizuara, nuk duhet kuptuar tekstualisht. Sado që të jenë këto mundësi të mëdha, megjithatë ato janë të kufizuara dhe do të mbisin si të tilla.

Kur dëgjojmë për të gjitha këto supozime fantastike të ardhmërisë njerëzore, na befason fakti se si nuk dëgjohet edhe mendimi se njeriu do të triumfojë mbi pleqërinë dhe vdekjen.

Ai nuk guxon të mendojë për këtë - ndoshta më mirë të themi - ende nuk merr guximin. Ai hëpërhë pajtohet me to si gjëra të pa-shmangshme. Madje nuk e ka të qartë se ç'kuptim ka vdekja, e as si pason pleqëria.

Mirëpo, nocioni i fitores mbi sëmundjet ka vetëm vlerën statike. Sëmundja nuk është e lidhur vetëm me konceptin e skamjes dhe mjerimit. Edhe standardi i lartë i jetesës i ka sëmundjet e veta. Nga përvoja jetësore dimë se disa sëmundje evitojen, ndërsa në mënyrë të paspjegueshme shfaqen të tjerat. Njeriu thjesht pyetet a është e mundshme dhe reale që të përjetojë një kohë pa këto mynxyra. Thjesht, sikur na imponohet përfundimi filozofik nga këto fakte - se çdo kohë i ka problemet e veta, vuajtjet dhe shkaktarët e vdekjes, e kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen si kundërpeshë e dëshirave dhe sukseseve njerëzore. Është e çuditshme se si njeriu faktin e ndryshimit dhe të shkatërrimit të vazhdueshëm, nuk e shpalli parim të natyrës. Ndërsa për besimtarin është i mjaftueshëm shpjegimi kur'anor se çdo gjë u nënshtrohet ndryshimeve dhe shka-

tërrimit, ndërsa vetëm Qenia e Zotit është e përhershme - është e amshueshme.

Kultivimi i embrionit në epruvetë nuk është njësoj sikur edhe ta krijosh këtë embrion.

Nuk është vështirë të grumbullosh një numër të caktuar elementesh në një masë të caktuar dhe prej saj të krijosh qelizën - jetë, e cila rritet dhe shumohet?

Ekspertët, të vetëdijshëm për kufijtë e dijes dhe mundësisë së vet, janë shumë më modestë sesa njerëzit me mendim laik.

Mirëpo, përparimi dhe zhvillimi teknik sikur nuk njeh përkusfizime. Makinat e sotme elektronike i ofrojnë njeriut zgjidhje për një afat shumë të shkurtër kohor, shumë më shpejt sesa është në gjendje ta bëjë vetë këtë.

Për provë është bërë makina-robot, e cila në mënyrë automاتike i përterinë pjesët e veta të vjetruara dhe të konsumuara dhe i prodhon vvetvetes pjesë të ngjashme, ndërsa këto në të njëjtën mënyrë vazhdojnë punën e tillë - që e gjithë kjo nuk ka ndonjë vlerë praktike, por për mendimin filozofik është interesante.

Pastaj robotët, të cilët reagojnë në dritë dhe në zë, e robotët që përgjigjen në pyetje - veprimet e tyre janë ndërtuar në imitim e sistemit nervor të njeriut. Nuk ka pengesa teorike që të konstruktohen robotë, të cilët do të mund të shfaqin emocionet - të gëzohen ose të hidhërohen- që do të jetë imitim dhe programim i mirëfilltë nga ana e njerëzve.

E gjithë kjo lë përshtypje të thellë, ndërsa ne gjendemi në fillim të periudhës elektronike! E çdo të bëhet nesër? Përparimi i deritashëm e ka joshë imagjinatën njerëzore. Kështu kanë lindur edhe parashikimet për problemet eventuale të botës së nesërme të robotëve, ndaj janë dëgjuar edhe këso mendimesh:

A thua robotët e përsosur të së nesërmes, të cilët do të janë në gjendje të sjellin përfundime logjike, do të mund të revoltohen dhe të ngrihen kundër pushtetit dhe eksplotimit njerëzor? Është pyetje pak jo e rëndomtë, por nuk është edhe krejtësisht e marrë, siç mund të gjykohet në shikim të parë.

Mirëpo, ekziston përgjigje krejtësisht e thjeshtë dhe e bindshme: robotët - sado që të janë të përsosur - kurrë nuk do t'i arrijnë njerëzit, e as nuk do të janë në gjendje të bëjnë atë që mund ta bëjë njeriu, sepse nuk kanë vetëdije dhe vullnet.

Literatura fantastike robotëve të vet u jep vetëdije. (Kështu p.sh. në një roman flitet për robotët, që kanë parafytyrim për vete

dhe atë mjaft lajkatar dhe miklues: mendojnë se janë të fuqishëm dhe të mençur dhe se veprimi i tyre është rezultat i dëshirës personale dhe konkludimit intelligent, që një ditë - të befasuar dhe të hutuar - të zbulojnë se janë lodra të rëndomta në duart e qenieve më të përsosura, në duart e njerëzve.) Megjithëkëtë, të gjithë ne e kemi të qartë se ata këtë vetëdije nuk do ta kenë kurrë. Kjo është ajo që e dallon njeriu. Ndërsa besimtari me ndërgjegje të pastër mund të pohojë se ata nuk kanë vetëdije e as njeriu nuk mund t'ua japë këtë.

Prandaj, do të ishte e tepërt të zëmë ngoje papërgjegjësinë morale të këtyre makinave, kur nuk duhet theksuar se njeriu do të jetë përgjegjës moral për pasojat e veprimit të tyre.

## Ardhmëria e pasigurt tërheq vërejtjen

Intelekti njerëzor gjithnjë përpinqet të arsyetojë ekzistencën e njeriut. Nëse vdekja është fjala e fundit e natyrës, e ligjeve dhe fuqive të saj, atëherë jeta për vetë njeriu është një absurditet i madh. Jeta për hir të jetës është një mashtrim i rëndomtë. Nëse vdekja është amshim i mosekzistimit, atëherë suksesi ose mossuksesi jetësor, fitorja ose disfata, pasuria ose varfëria, fuqia ose mjerimi, autoriteti ose përbuzja - të gjitha këto, pas vdekjes janë gjëra të pavlefshme. Intelekti, atëherë porosit që të ngutet në këtë drejtim të pashmangshëm. Megjithatë, njeriu këtë nuk e do. Shfaqet diçka e kundërt nga e pritura.

Nëse i lëmë anash fjalët që i ndeshim aq shpesh në jetën e përditshme, fjalët vulgare: "Më lejo të jetoj këtu", njeriu përpinqet të jetë i ndershëm ndaj vetvetes, do ta arsyetojë ekzistencën e vet personale. Mendimi i ateizuar vërteton atë që është - gjendjen dhe proceset, shkaqet e prekshme të tyre dhe pasojat e dukshme - dhe këto i ofron si shpjegime, ndërsa këto sqarime i interpreton si arsyetim. Këtu edhe qëndron gabimi i mendimeve ateiste, sepse në përpjekjet që t'i shpjegojë njeriut natyrën e karakterin e tij dhe ngjarjet në natyrë, kërkon arsyetimin e ekzistencës së tij. Faktin e ekzistimit të synimeve biologjike, pasioneve dhe dëshirave, përpinqet ta kuptojë si diçka e mjaftueshme për vetveten. Prandaj edhe ka mund t'i ndodhë mendjes së ateizuar njerëzore që për vetveten t'i duket e kuptueshme se individët pasi të shkatërrohen definivisht, zhduken, ndërsa deri atëherë lloji i tyre - homo sapiensi shkon

gjithnjë papengueshëm përpara, si zhvillim i pakthyeshëm dhe i pandalshëm. Ajo nuk pyet mos vallë është kjo pamje e mashtrueshme.

Feja na mëson se vdekja ekziston edhe për popujt. Nga historia dimë se shumë popuj kanë jetuar dhe kanë perënduar. Ne në mënyrë retrospektive parashtrojmë kushtet se si do të kenë mundur t'i shpëtojnë shkatërrimit, mirëpo Kur'ani na korrigjon: “*Çdo popull (që i përgënjeshtroi pejgamberët) ka afatin e vet, e kur t'u vijë afati atyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përshpejtohet më parë.*” (7:34)

Në të vërtetë, edhe Kur'ani parashtron kushtet e veta dhe këto janë vetëm të natyrës morale. Në tregimin për Junusin thuhet: “*Përse nuk pati vendbanim që të ketë besuar e besimi i tij të ketë ndihmuar (në shpëtim), pos popullit të Junusit, që pasi që besoi, Ne e larguam prej tyre dënimin shëmtues në jetën e kësaj bote dhe i lejuam të jetojnë deri në një afat të caktuar.*” (10:98)

Meqenëse shkenca di se në të kaluarën tokën e kanë zotëruar lloje tjera të gjallesave, p.sh. dikur zvarranikët gjigantë, ndaj nga aspekti shkencor nuk përjashtohet mundësia që edhe në të ardhmen të ndodhë diç e ngjashme, ndërsa njeriu të mposhtet ose të shfaroset krejtësisht. Rrugët mund të jenë të nduarduarta dhe të kundërtat.

Ruga e zotërillëkut mund të jetë njëkohësisht edhe rrugë e shkatërrimit. Kjo është e njohur për shkencën dhe është shënuar si ‘çrregullim i ekuilibrit biologjik në natyrë’. Me shfarosjen e luajve në disa savane të Afrikës, së shpejti këto vise u shndërruan në shkretëtira. Bimëngrënësit u shtuan aq tepër saqë e zhdukën tërë vegjetacionin. E kjo solli edhe shkatërrimin e tyre.

Përvoja e hidhur me lepurin e egërsuar dhe qenin e egër në Australi, pastaj me një lloj të kaktusit, i cili me naivitet u mboll në një oborr si bimë dekorative dhe prej tij u përhap, duke mbuluar një të tretën e kullotave të atij kontinenti, u bë problem nacional, e detyruan njeriun të ketë kujdes për pasojat negative të veprimtarisë së vet. Kështu nga të gjitha anët përhapet alarmi për ndotjen e ujit dhe të ajrit, për shkak të shfrytëzimit joracional të pasurisë së xehes, për shkak të shtimit të tepërt të gjinisë njerëzore, me çka njeriu e rrezikon vetveten, për shkak të zbulimit të helmit në organizmin e njeriut, i cili ka qenë i dedikuar kundër dëmtuesve të bimëve, ndërsa me rrugë të tërthortë ka arritur në organizmin e njeriut. Fuqia njerëzore shpeshherë paraqitet si shpatë me dy tehe.

Dihet se shumë vende në Tokë janë të pabanuara. Insektet ia pamundësojnë njeriut ekzistencën. A thua nuk mund të ndodhë që

këto insekte t'u përshtaten edhe nënqiejve tjerë dhe të fillojnë ta shtyjnë njeriun edhe nga këto vise ku është duke jetuar?

Në këtë mendim mund të shikojmë si në përbajtjen e ndonjë tregimi, por që nuk thuhet se kjo, ose diç e ngjashme, nuk mund të ndodhë. Miza e patates (patatorja e artë), e cila që nga kohët më të lashta ka jetuar krejtësisht e izoluar në një trevë të kufizuar të Amerikës Veriore si insekt i padëmshëm, përnjëherë u stërkeq, doli nga vendlindja e vet në udhëtim rrëth botës, dhe sulmoi fushat e punuara.

Të paramendojmë se natyra dhe ligjet e saj të evolucionit, ose vetë ai evolucion, ose ligjet e jetës-shkurt, ajo që gjithmonë ka udhëhequr me natyrën, e që njeriu ende nuk e ka njojur dhe nuk e ka zotëruar plotësisht, përnjëherë me tekot ose papërkulshmérinë e vet, pa kurrfarë ndërgjegjeje, me vetëdije ose pa vetëdije, me njëfarë logjike kompjuterike, ta ndërprenë simpatinë ndaj njeriut, ndërsa t'ua dhurojë p.sh. termitëve: t'u mundësojë një shkallë edhe më të lartë të organizimit të jetës, t'ua ndërrojë mënyrën e të ushqyerit, t'u mundësojë përshtatshmérinë ose mbizotërimin e kushteve të ndryshme klimatike, kështu që fillojnë të përhapen në të gjitha gjëritë gjeografike - qetë, në nëntokë, në errësirë dhe kështu të padukshëm, ta rrezikojnë tërë civilizimin njerëzor dhe burimet ushqimore, e me këtë biologjikisht ta rrezikojnë edhe vetë njeriun.

I gjithë ky tregim nuk është i pamundshëm, nuk është fantazi e kategorisë së përrallave të fëmijëve për lugetërit. Kujtohuni në vitet kur vinin lajme alarmante nga India e uritur, se sa sasi ushqimi të njerëzve kishin hëngër minjtë. Ndërsa njeriu gjithnjë mendon se është fjala për zgrapcimin e pakëndshëm, e jo për brejtjen e rrezikshme të atij hajduti të vogël të natës.

Njeriu i civilizuar mund ta dëgjojë tërë këtë tregim për rrezikun e tij eventual, madje me njëfarë disponimi të mirë, sikur një bajlozi t'ia mbushnim veshët për kinse rrezikun që i kanoset nga ana e ndonjë liliputi, ndaj, kjo më tepër e argëton sesa e nervozon. Ndërkaq, për ndonjë frikë as nuk mund të bëhet fjale.

Vërtet, njeriu posedon fuqi të jashtëzakonshme - intelektin e vet - dukshëm më superior mbi të gjitha të njojurat në natyrë. Mirëpo, njeriu nuk mund të jetë i sigurt se kjo armë e jashtëzakonshme do të jetë gjithmonë në anën e tij. Dihet se njeriu nga embrioni i vet deri në formimin e plotë e kalon tërë atë rrugë të evolucionit të llojit shtazor. Madje, edhe fëmijët në shkollë njihen me këtë fakt nëpërmjet definicionit: "Ontogjeneza është filogjeneza në vogëli."

Meqenëse njeriu është i prirur që përsëritjet e rregullta t'i shpallë për rregulla, pér ligje, pér parime, e që ateistët këtë e bëjnë me dëshirë, e nëse njeriu kështu vpron edhe këtu, përfundon në konkludime krejtësisht të pakëndshme. Meqë në pleqëri fuqia intelektuale bie, ndaj do të mund të konstatohej se kjo do t'i ndodhë tërë gjinisë njerëzore kur të ‘plaket’: është i pashmangshëm dhe i pakthyeshëm seniliteti i *homo sapiensit*, që ngadalë do ta kthente në nivelin intelektual të - sipas shkencës - stërparrashësit të tij, i cili pikërisht u drejtua në këmbët e veta të sprasme. Kështu vendin e vet të zotërueshit të Tokës do t'ia lëshojë ndonjë lloji tjetër shtazor, derisa një numër i vogël i individëve të mbijetuar, të cilët do të arrijnë t'i përshtaten situatës së re, do të silleshin nëpër gërmadhat e civilizimit njerëzor, duke mos i kuptuar më porositë as të shkencës e as të kulturës së këtij civilizimi.

Askush nuk pohon se do të ndodhë kjo, e më së paku ne (sepse askush, përveç Zotit nuk e di se ç’do të ndodhë në të vërtetë në të ardhmen), mirëpo askush nuk mund ta demantojë shkencërisht mundësinë e zhvillimit të këtillë, pikërisht pér arsyen se shkenca nuk e di saktësisht se çfarë zhvillimi do të pasojë.

## Katastrofat kërcënuese sinjalizojnë

Feja gjithashtu na mëson se tërë kësaj bote materiale, kështu siç është, do t'i ndodhë një ndryshim i vrullshëm dhe i papritur, katastrofa me përmasa kozmike. Kjo do të shënojë edhe fundin e kësaj bote. “*Cdo gjë që gjendet në qiej dhe në tokë do të vdesë, përveç asaj që Zoti e veçon...*” thuhet në Kur'an. Në tërë Kur'anin flitet pér të si pér çastin, i cili është i caktuar, e pér të cilin di vetëm Zoti.

Ateisti nuk i kushton kujdes kësaj; ai në ardhmërinë shikon ashtu që zhvillimi i sotëm në gjithësi do të ecë edhe nesër i papenguar me të njëtin temp dhe në të njëtin drejtim. Mirëpo, shkenca nuk e inkurajon as këtë mendim ateist. Ajo udhëzon në shumë procese të mundshme, të cilat do të paraqisin shkatërrim pér gjininë njerëzore. Thjesht na befason sa i madh është numri i këtyre rreziqueve, e që ende asnjë nuk ndodhi. Si dhe prej nga kjo? Njeriu nuk di ta shpjegojë këtë fenomen, mirëpo pér besimtarin ky është argument i bindshëm se jeta mbahet me vullnetin dhe fuqinë e vetë-

dijshme të Atij në të cilin beson. Ai e di se gjithkund është rreziku, por ka përshtypjen se edhe pse ec në shteg të ngushtë, ec në rrugë të sigurt. Ai nuk e sheh, por ndjen se Dikush po e udhëheq në të. I duket sikur gjendet në një urë të varur, e cila dridhet dhe luhatet nga goditjet e fatkeqësive të vazhdueshme, mirëpo tërë kësaj i është përshtatur dhe psikikisht është qetësuar, sepse e sheh se për këtë kujdeset vetë Ndërtuesi i saj.

Vërvshimet, dhe përkundër tyre, thatësitë, goditjet e nxehësisë dhe të stoftësisë së madhe, çrrëgullimet tektonike, epidemitë dhe fatkeqësitë e ngjashme, të cilat e sulmojnë njeriun-të gjitha këto për besimtarin kanë aspekt moral, ndaj prej tyre edhe nxjerr përfundime morale. Ndërsa ateistit kjo as nuk i shkon ndër mend. Ai i kundron si të kufizuara në hapësirë dhe në kohë dhe si të tilla i kuption dhe i pranon; kërkon mënyra të ikë nga to, e nuk don as të dijë për paralajmërimet e fesë. Ndërsa, ai duhet vetëm në mendime në aspektin hapësinor dhe kohor t'i zgjerojë ato fatkeqësi, dhe ja, katastrofa reale për mbarë gjininë njerëzore. Mirëpo, ai sillet në atë mënyrë sikur kjo kurrsesi nuk mund të ndodhë, edhe pse e di se shkenca nuk i ofron kurrfarë garancioni për një sjellje dhe për një qëndrim të këtillë.

Zbulimet më të reja na kanë besuar se të ashtuquajturat njolla në Diell, ushtrojnë ndikim të madh në jetën nervore të njeriut. Të paramendojmë se papritmas paraqiten njolla më grandioze se ato të rëndomtat, të cilat do ta nervozonin tërë popullsinë e Tokës. Po, kjo duket qesharake, mirëpo shkenca nuk thotë se një gjë e këtillë në aspektin nervor është e pamundshme, që do të mund të na shkatërronte të gjithëve.

Ose, sikur Dielli vetëm 1% ta rriste nxehësinë e vet, atëherë çdo gjë do të digjej në Tokë; ndërsa sikur ta zvogëlonë për 1% çdo gjë do të ngrihej. Kurse Dielli gjithmonë rrezaton me intensitet të njëjtë dhe pikërisht kjo mundëson jetën në Tokë. Edhe pse shkenca ka shpjegimin e vet, megjithatë këtë më së paku do ta prisnim.

Ateisti përafërsisht kështu do të përgjigjej: "Nuk e shoh të arsyeshme përse do të *duhej* të ndodhë diç jashtë të zakonshmes që veç po ndodhë."

Nga aspekti fetar, kjo është tragjedia e ateistit: Ai nuk e sheh Zotin, prandaj mendon se bota është e mjaftueshme për vveten.

Pasionet ekzistojnë dhe synimet për kënaqjen e tyre janë fakt objektiv, e ai tanë nuk sheh përse duhet të ekzistojnë nocionet ves dhe virtyt. Moralin e kuption si normë ekskluzivisht religioze dhe

kufizim i diçkaje që ekziston. Prandaj gjithkund ndeshim shfrenimin seksual dhe rënien e vlerave të përgjithshme morale.

Ekzistojnë fatkeqësi sporadike për njeriun, mirëpo ai nuk kupton përsë duhet të ndodh përbrytja universale (kijameti), uria e përgjithshme, epidemja e përgjithshme, vdekja e përgjithshme e gjinisë njerëzore. Triumfuesit vdesin - ai e sheh këtë; njerëzimi jeton - ai e sheh këtë. Këto janë fakte dhe ai i pranon si fakte të masave ligjore.

Dukuritë në natyrë tregojnë luhatje dhe dallime të tilla, që njeriu u përshtatet si qenie biologjike; ai jeton si në vende të nxehtha, ashtu edhe në vise të akullta. Madje si qenie me një intelekt jashtëzakonisht të fortë, i krijon vetes kushte të volitshme artificiale – nëse dëshiron, mund të jetojë edhe në Hënë. Ai nuk sheh shkaqet përsë natyrë mund të paraqitet ndonjë skajshmëri (ekstreme) e cila do ta zhdukte.

Vërtet, ai nuk e kupton këtë argument. Ky është motivi i vërtetë.

Feja ka doktrinën e vet dhe ofron argumentet e veta. Shkenca po ashtu. Ato nisen nga drejtime plotësisht të kundërta; feja nga një botëkuptim dhe qëndrim moral, kurse shkenca nga të ashtuquajturat fakte materiale. Feja jep fjalën përfundimtare, kurse shkenca niset nga rastet individuale dhe me sintezën e tyre përpinqet të arrijë në fjalën përfundimtare.

Shkenca ka aq shumë fusha të pahulumtuara, mirëpo pikëpamjet e fesë dhe të shkencës ofrohen, thënë saktë, pikëpamjet shkenccore gjithnjë e më tepër përputhen me qëndrimet e fesë. Bën përashtim - edhe atë mjaft të dukshëm, çështja dhe koncepti i kohës.

Përderisa për të gjitha ngjarjet e kaluara, për të cilat flet feja, keni përshtypjen e një të kaluare të afërt, ndërsa për ngjarjet e ardhme flet po ashtu si për të ardhmen e afërt, por duke ia kufizuar kategorikisht njeriut njohuritë për caktimin e saktë kohor, në anën tjetër shkenca flet për mileniume.

Përse bëhet fjalë këtu, a duhet t'i japim kësaj rëndësi të vlerave relative apo kemi të bëjmë me diç tjetër, kjo kërkon shqyrtim të veçantë, por gjithsesi kur shkenca të fitojë më shumë elemente. Mirëpo, kjo nuk është qenësore për këtë analizë, por vetëm domosdoshmëri dhe gjasë e zhvillimit të ardhshëm.

Shkenca na mëson se edhe Dielli po e humb energjinë e vet dhe se ka kaluar në periudhën e vet të pjekurisë, në gjysmën e dytë të jetës së vet dhe po ec drejt fundit të vet. Meqenëse është fjala për

miliarda vjet, kjo nuk e shqetëson askënd, e më së paku ateistin, mirëpo ai nuk mund vetëm me anë të mendimit ta arsyetojë të ashtuquajturin amshim të jetës së kësaj bote. Megjithatë, rreziku është afër. Në gjithësinë e pafund çdo çast shkatërrohen sisteme të tëra diellorë të ngjashme me tonin. Këta janë yjet ‘Nova’ - siç i quajnë në shkencë. Dhe çka do të bëhet nëse Dielli ynë në një moment bëhet ‘Nova’ dhe shpërthen? Është e kuptueshme se ky do të ishte fundi i njeriut në Tokë dhe fundi i mburrjes së tij. E ky është plotësisht rrezik real; këtu nuk ka asgjë të pabesueshme, por kjo mund të ndodhë-sipas disa llogarive, sipas ligjit të probabilitetit (të besueshmërisë) - pas 10.000 vjetësh.

E çka do të bëhet sikur kjo të ndodhë nesër? Kush mund ta dijë këtë? Por edhe sikur ta dinim, kush mund ta pengonte këtë ose kush mund t’i ikë kësaj kataklizme?

Njeriu, i cili është i prirur t’i bëjë çakla e shpifje fesë dhe mësim-besimit, nuk vendos ta bëjë këtë edhe në vërejtjen e shkencës.

Mirëpo, meqë këto shqyrtime shkencore u afrohen pikëpamjeve të fesë, ai i shmanget në këtë mënyrë: Gjinia njerëzore do të vendoset nëpër kozmos, do të shkojë nëpër sisteme të tjera yjesh, më të reja se sa sistemi ynë diellor, dhe atje do të vazhdojë jetën. Një rezonim i këtillë mund të na bëjë të qeshemi, sepse krejtësisht na përkujton në sjelljet e djalit të Nuhit, i cili kur filloi të vërshojë uji, refuzoi të hyjë në anjen e babait dhe duke ikur në maje të malit mendoi se do të shpëtojë nga përmbytja.

## “Pushtimi” i kozmosit

Gjinia njerëzore, e cila deri më tanë është zvarritur nëpër Tokë, hapëroi në kozmos. Entuziazmi njerëzor është i madh dhe i kuptueshëm, sepse sipas vlerësimit të tij, kjo është arritja më e madhe që nga lashtësia.

Për herë të parë arriti të shkelë me këmbë në truallin e një planeti tjetër qiellor. Njeriu nuk duhet të jetë i padrejtë ndaj vërvetes dhe ta nënçmojë këtë sukses. Kjo nuk është punë e vogël. Edhe-sipas normave të fesë-ai këtë duhet patjetër ta çmojë si dhuratë të madhe të Zotit dhe duhet t’i falënderohet. Dhe nuk guxon të mos jetë modest dhe të harrojë se kush është Zot i vërtetë. I tërë ky sukses është edhe një sprovë, prandaj nuk duhet të dehet nga mendimet

djallëzore. Ai duhet të ketë parasysh se udhëtimi i tij në kozmos-sado larg që të arrijë - nuk do të thotë se është zotëruar i gjithësisë.

Këtë ia porosit feja, e për këtë e mëson edhe shkenca. Ja disa të dhëna (për përcjellje më të lehtë) të rrumbullakuara në vija të trasha të ofruara në shifra:

Me raketat e sotme udhëtimi deri në Hënë zgjat disa ditë, por këto raketa nuk hyjnë në punë për udhëtime në planetë. Këto udhëtime njeriu i planifikon me mjete më të shpejta. Distancat ndërmjet largësive janë të mëdha, ndërkaq ekspertët laikë i harrojnë ato.

Largësia e planetit më të largët të njojur (Plutoni) nga Toka është 5.756 milionë km. Këtë rrugë drita e kalon për diç më tepër se 19.000 sekonda, e kjo është më tepër se 5 orë, ndërsa largësinë ndërmjet Tokës dhe satelitit të saj natyror e kalon për diç më tepër se 1 dhe 1/4 sekondë. Për raketën me shpejtësi rreth 200 km/sek. të vënë në veprim me ndihmën e ‘plazma-motorëve’, udhëtimi deri te Plutoni do të zgjaste gati një vjet. Raketa me shpejtësi prej rreth 10.000 km/sek. me anë të motorit me veprim ‘fisionues’ këtë rrugë do ta bënte për 6 deri më 7 ditë. Këto janë largësitë e sistemit tonë diellor dhe gjasat për zotërimin e tyre.

Mirëpo, sa i përket kozmosit të mirëfilltë të yjeve, për ne ylli më i afërt është Alfa Kentauri, i cili gjendet në largësi më se 4 vjet udhëtim të dritës. Sa janë këto largësi shihet sipas asaj se në këtë largësi raketa me veprim ‘fisionimi’ veprimi do të sillej 120 vjet.

Duke pasur parasysh se Teoria e Ajnshtajnit nuk lejon kurrfarë shpejtësie, e cila do ta arrinte dhe do ta tejkalonte shpejtësinë e dritës, atëherë udhëtimi më i shpejtë deri te sistemi më i afërt yjor nuk do të mund të ishte më i vogël se 4 vjet. Duke vazhduar rrugën në gjithësi, në çdo anë ndeshim në zbrzetirë, e vetëm aty-këtu në yje e në sistemet e tyre. Largësitë arrijnë në mijëra, në milionë, e pastaj ngjiten deri në miliardë vjet dritë. Derisa Ajnshtajni me llogari ka fituar diametrin e gjithësisë rreth 2 miliardë vjet dritë, më vonë u bë korrigjimi në 6 miliardë, kurse sot arrin në 10 miliardë, por fjala e fundit ende nuk është thënë.

Njeriu shpesh s’arrinë të shohë se me çfarë largësish kemi të bëjmë këtu. Ai sheh vetëm shifra, të cilave ua shton zerot.

Kur natën sodisim qiellin të mbushur dendur me yje, ne pa qëllim harrojmë se gjithësia, në të vërtetë është jashtëzakonisht rrallë e mbushur me materie. Megjithatë, numri i yjeve është i pakufishëm, sepse hapësira e paparaparë është me dimensione shumë të

mëdha, dhe ne për një moment humbim parafytyrimin e qartë të përmasave për të cilat është fjala.

Para vetes të parafytyrojmë se Toka jonë paraqet topin me diametër 12,5 cm, atëherë Hëna do të ishte top me diametër 3,5 cm në largësi afér 4 metrash. Ndërsa Dielli do të ishte top me diametër 14 metra në largësi 1,5 km. Të gjitha këto janë të zvogëluara për 100 milionë herë. Drita udhëton prej Diellit deri në Tokë më se 8 minuta.

Nëse dimë se ndonjë yll është larg 100 mijë vjet dritë, në psikikën tonë nuk kemi ndjenjën përkatëse çka do të thotë kjo në të vërtetë, se kjo është rrugë p.sh. që e kalon drita për 1000 herë më e gjatë sesa ështëjeta e një qindvjeçari. Nëse konstatojmë paraqitjen e papritur të yllit "Nova" dhe konstatojmë se largësia e tij është 2000 vjet dritë, ne harrojmë se kjo katastrofë me këtë yll ka ndodhur në kohën kur Roma e vjetër ka qenë dëshmitare e vrasjes së Qesarit dhe luftës për pushtet ndërmjet Antonit dhe Oktavianit. Me supozimin se ai ka qenë ndonjë sistem në të cilin kanë ekzistuar qenie të arsyeshme, të cilat kanë arritur disi ta përjetojnë këtë katastrofë dhe me dëshirën që të vemë kontakt me ta, t'u dërgojmë radio-sinjale, do të duhesin 2000 vjet që kjo radio-porosi të udhëtojë deri te ta, ndërsa edhe 2000 vjet të tjera të na arrijë përgjigjja e tyre.

Nëse zbulojmë se ndonjë mjegull qiellore është larg nesh 100 milionë vjet dritë, kjo do të ishte pamja e saj para 100 milionë vjetësh, e çfarë është sot, do të duhej të jetonim 100 milionë vjetët e ardhshëm që ta dinim këtë, gjegjësisht të nisemi në vizitë të asaj mjegulle, do të duhej të lëviznim me shpejtësi drite - asgjë më pak - që të arrijmë atje pas 100 milionë vjetësh. Ndërsa diametri i gjithësisë është së paku 100 herë më i madh se ky.

Nëse bëjmë një supozim të përafërt se në gjithësi ka me miliona galaktikash, kurse çdo galaktikë me miliona yje-sic është Dielli ynë, ose yje shkurtabiqë në krahasim me Diellin, në të cilin do të mund të sillej i tërë sistemi ynë diellor - dhe çdo diell të ketë planetët e vet, dhe nëse parashikojmë kohën që i është e nevojshme rrezes së dritës t'i kalojë këto largësi ndëryjore, do të kapë me dhjetra, qindra, mijëra dhe miliona jetëra njerëzish, ndoshta edhe shumëfish më tepër, atëherë - kur dëgjojmë mburrjen e lëvdatën e njerëzve se si njeriu u nis në pushtimin e gjithësisë - vërtet shkaktohet dilemë se me çfarë emri ta emërtojmë këtë. Fjalë adekuate nuk ka.

Meqë krahas kësaj duhet pasur parasysh se kushtet dhe format jetësore në planetët edhe të sistemit tonë diellor, por edhe të siste-

meve tjera yjore, më parë do të jenë të pavolitshme se sa të volitshme për njeriun nga Toka, prandaj tërë këtë tregim entuziast për pushtimin dhe popullzimin e kozmosit nuk duhet kuptuar tekstualisht. Tekefundit, ende nuk i kemi popullzuar as polet e Tokës, nga se kushtet klimatike janë shumë të ashpra. Ndërkaq, kushtet në gjithësi janë edhe më të ashpra. Në Hënë nuk ka as ajër, as ujë, kurse amplitudat e temperaturës janë shumë të mëdha. Temperaturat në Merkur dhe në Venerë, për shkak të afërsisë së Diellit, janë jashtëzakonisht të larta.

Gravitationet e Saturnit dhe të Jupiterit janë aq të mëdha saqë thjesht mund të ngjitesh për sipërfaqen e tyre. Vërtet, Marsi është diç më i volitshëm, por as për së afërmë siç fitohet përshtypja nga romanet.

Duke mos e marrë parasysh mendimin e pesimistëve, të cilët lejojnë parafytyrimin dhe supozimin për takimin me qenie më intelligente dhe më të civilizuara - kështu që ëndrra për pushtimin e kozmosit të shndërrohet në dëshpërim dhe në poshtërim, rënje nën tutori, ose ballafaqim me diçka që është jashtë përvojave të klasifikimit tonë, e që do të ishte fatale për gjininë njerëzore, pra duke përjashtuar qoftë kthesat shpirtërore, qoftë vizionet e errëta të skeptikëve, gjasat, në mbështetje të asaj që deri më sot dimë, janë shumë më modeste.

## Kur'ani tërheq vërejtjen

Mirëpo, pikërisht mendimi i ateizuar i njeriut fodull nuk çan kokën për argumentet që i sjell shkenca, por mendon se ai - njeriu - është në rrugën që të bëhet diç edhe më i lartë - *mbinjeri*, zot i vetvetes dhe i natyrës. Botëkuptimi i tij është çrregulluar, shpirti i tij është dehur me verën joshëse të suksesit. Mendimi për Zotin i duket i tepërt. Që tani e sheh veten pronar të atributit, që feja ia përkruan të vetmit, Absolutit. Mburret me vetveten se është triumfues i pakontestueshëm në Tokë dhe pushtues i afërt i gjithësisë, ndaj e ngren kokën lart në qiell dhe pa turp bërtet:

“Nuk ekziston! Nuk je!”

Ndërsa Kur'ani e porosit:

“A nuk e ke ditur se vetëm All-llahut i takon sundimi i qiejve e i tokës, dhe se pos All-llahut nuk keni as mbrojtës as ndihmëtar.” (2:107)

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnje send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbih), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptioni atë madhërim të tyre (pasi nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i Butë dhe fal shumë.” (17:44)

“Ai është që ju bëri sundues (zëvendës) në tokë (pas shkatërrimit të atyre që ishin më parë) dhe lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët, për t’ju sprovuar në atë që ua dha.” (6:165)

“Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe diellin e hënën. Edhe yjet janë të nënshtruar me urdhrrin e Tij. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon.” (16:12)

“Ne, vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit... i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.” (17:70)

“Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej All-llahut...” (16:53)

“Dhe Ai ua dha gjithë atë që e kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t’i numëroni të mirat e All-llahut, nuk do të mund të arrini t’i përkufizoni (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës.” (14:34)

“Si e mohoni All-llahun, e dihet se ju ishit të vdekur e Ai ju ngjalli, mandej ju bën të vdisni e pastaj ju ringjall, e mandej te Ai do të ktheheni?” (2:28)

“A menduat se Ne ju krijuam kot dhe se nuk do ktheheni te Ne?” (23:116)

“Ata edhe thanë: “Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë jona në këtë botë, po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër pos kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm fantazojnë.” (45:24)

“A mendjet (iluzionet) e tyre po i urdhërojnë përkëtë, apo ata janë popull renegat? A mos u krijuan prej kurrgjësë, apo ata vetë janë krijues? A mos ata i krijuan qiejt e tokën, jo, por ata nuk janë të bindur.”

(52:32,35,36)

“Ata nuk e madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij tē vërtetë që e meriton, All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjes.” (22:74)

“Ai është që jep jetë dhe sjell vdekje, e kur dëshiron ndonjë gjë, Ai vetëm thotë: “Bëhu”, e ajo menjëherë bëhet.” (40:68)

“Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë tē cilat i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare.” (12:105)

“Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri tē qëndrojë (pa shtyllë) qielli e toka, mandej kur t'ju thërret juve me një thirrje prej tokës, ju menjëherë dilni.” (30:25)

“Edhe në tokë ka argumente për ata tē bindurit. Po edhe në veten tuaj. A thua nuk e shihni?”

(51:20-21)

“O ju njerëz, juve ju erdhi I dërguari me tē vërtetën (fenë e drejtë) nga Zoti juaj, pra ta besoni se është më e dobishme për ju.” (4:170)

“E mos bëni mendjemadhësi ndaj All-llahut, unë sjell argument tē sigurt!” (44:19)

“Po ju nuk mundeni, por vetëm nëse dëshiron All-lahu, Zoti i botëve!” (81:29)

“A nuk e ke kuptuar ti se All-lahu krijoi qiejt dhe tokën me urtësi, e nëse Ai do, juve ju zhduk e sjell kriesë (popull) tē re. E kjo, nuk është e vështirë për All-llahun.” (14:19,20)

“A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që tē mos ju shafojë (tē mos ju lëshojë) toka kur tē dridhet. A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që tē mos lëshojë kundër jush ndonjë stuhi me rrebesch gurësh. A jeni tē sigurt nga Ai, i cili sundon qiellin, se nuk do t'ju fusë në tokë, kur ajo do tē fillojë tē dridhet? Ose, a keni garanci nga Ai, i cili sundon qiellin, se nuk do tē lëshojë mbi ju furtunë dhe gurë.” (67:16,17)

“Kush është ai që ju ushqen, po qe se Ai ua ndërpret furnizimin e vet?” (67:21)

“A mos keni ndonjë zotim tē fortë prej Nesh që vazhdon deri në Kijamet, se do ta arrini atë që e dë-

*shironi? Pyeti ata se cili është prej tyre që ua garanton atë?"* (68:39,40)

*"A mendon ai se atë nuk mund ta mposhtë askush?"* (90:5)

*"Ne shpartalluam sa vendbanime që ishin mizore, e në vend të tyre sollëm popull tjetër."* (21:11)

*"E sikur All-lahu t'i kapte njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnje gjallesë, por Ai i afatizon deri në momentin e caktuar, e kur të vijë afati i tyre, s'ka dyshim se All-lahu i ka parasysh robërit e vet."* (35:45)

*"Prandaj, ti vetëm All-lahun adhuroje dhe bëhu mirënjoës!"* (39:66)

*"Kush i mbyllë sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqerojmë një djall që nuk i ndahet kurrë."* (43:36)

*"Ky (Kur'an) është kumtesë për njerëzit, që me të të këshillohen dhe të dinë se Ai është vetëm një zot, dhe që t'i këshillojë ata që kanë mend."* (14:52)

*"Vërtet njeriu është jofalënderues ndaj Zotit të vet, mirëpo ai këtë nuk e sheh vetë dhe nuk e pohon..."*

Dhe ja kështu Shpallja, nga ajeti në ajet, nga faqja në faqe, zhvillon betejën intelektuale kundër mendimeve ateiste.

Kur'an është libër i cili tërheq vërejtjen, paralajmëron dhe frikëson. Mirëpo ai është dërguar edhe t'i gjëzojë ata që besojnë në Zotin dhe vetëm Zotin e adhurojnë, prandaj nga dashuria ndaj Tij, në emër të Tij, bëjnë vepra të mira.

Kjo është porosia themelore e besimit.

E madhërishme dhe e shenjtë është vetëm Qenia e Zotit, dhe më e pastër se çdo gjë nga ajo që jobesimtarët - injorantët, të paditurit - ia përshkruajnë!

E gjithë madhështia dhe fuqia, lavdia dhe falënderimi janë tek All-lahu, sundues i të gjitha botëve.

O Zot, na dhuro dije dhe  
na forco besimin;  
na udhëzo rrugës së Dinit Tënd.

O Zot, na ruaj nga paudhësitë  
që Ti i ke mallkuar;  
na ruaj nga mendjemadhësia dhe injoranca!  
Amin!



# SUGJERIM REDAKSISË “PREPOROD”\*

---

Më në fund ja edhe revista jonë!...

Disa e kanë pritur me entuziazëm, kurse disa të tjerë me frikë. Të parët dëshirojnë shumë, por frikësohen nga dëshpërimi - frysht i përvojës së keqe.

Shanset për revistë, për kushtet dhe rrethanat tona vërtet janë fantastike - ajo nuk ka konkurrentë!!! Këtë mos e harroni! Me dekada te muslimanët ekziston vakuumi shpirtëror (islam) dhe kulturor (musliman). Kurrfarë literature jomuslimane, as shund as kic literatura nuk kanë mundur ta plotësojnë atë vakuum. Bota jonë muslimane i ka refuzuar të gjitha këto. Ka dëshiruar diç të veten. Dhe përfundimisht, ajo mendon se këtë edhe e ka fituar.

Shikoni mirë që të mos dështon. Populli është kritik i rreptë... Kur shkruani mos mendoni t'ua bëni qejfin atyre "lartë." Mos i nxitni ata të fortit, por as mos u bëni lajka - mos shkruani për ta! Shkruani për popullin, për popullin musliman. Ai pret prej jush fjalën islame. Nëse këtë fjalë ia ofroni sinqerisht, ai do ta ndjejë këtë, populli është psikolog i pagabueshëm - dhe do ta pranojë këtë. Kjo është ajo që fati ia ofron revistës, në këto kohë ky është shans historik.

Vetë revista në opinion do të formojë gjykimin dhe vlerësimin përvete ndaj përbajtjes dhe për këtë duhet kohë - ashtu siç e theksioni edhe ju vetë në hyrje. Do të thotë, thelbësore është përbajtja, dhe kjo do të jetë përpjekje e vazhdueshme për ju dhe për ne lexuesit. Mirëpo, megjithatë mund të thuhet, se nëse te të gjithë ne

---

\* Është publikuar në "Preporod" nr. 7 të 15 dhjetorit, 1970 Sarajevë

ekziston dëshira islame dhe vetëm islame, mund të shpresojmë të mirën. Është e vërtetë se rruga deri te e mira shpesh është plot me gjemba dhe sprova.

Dilema është e shpeshtë: Ose për atë që është e ‘urtë’ ose për atë që është e ndershme. Mirëpo ju përbajuni rregullave: ka momente kur duhet heshtur e vërteta, por kurrë nuk guxon të thuhet gjenjeshtra. E vërteta mund të thuhet më vonë, por gjenjeshtra e thënë një herë, kurrën e kurrës nuk mund të përmirësohet.

Lexuesi juaj

## **DISA SHPREHI TONA TË KËQIJA\***

---

Besimtari është i preokupuar me çështje të mëdha të imanit të vet, ndaj shpesh harron disa gjëra të vogla, dhe nuk e heton se sa e brejnë ato pastërtinë e emrit të tij.

Këto janë gjëra të përditshme, që bëjnë pjesë në jetën tonë dhe ne jemi mësuar me to. Pothuaj as nuk i hetojmë, sepse janë bërë pjesë e jetës sonë, janë bërë pjesë e fjalorit dhe sjelljeve tona të përditshme, janë bërë shprehi jona. Prandaj duhet t'i vërejmë, e megjithë janë të këqija, duhet t'i evitojmë.

### *Betimi*

Të nisemi nga një shprehi e keqe, të cilën e ndeshim më së shpeshti. Ne vazhdimisht, për çdo imtësi, betohemi në Zotin. Edhe kur duhet edhe kur nuk duhet. “Pasha Zotin”, kjo është shprehje e përditshme jona. Ne as nuk e hetojmë se sa lehtë e përdorim këtë betim. Ne më as nuk e vërejmë se betimin e përdorim edhe në të pavërteta të vogla, naive dhe të parëndësishme të jetës. Jemi mësuar me to që nga vegjelia. Besimtari duhet ta kuptojë se këtë betim duhet ta përdorë kur kemi të bëjmë me punë të mëdha, natyrisht, kur është fjala për të vërtetën, qoftë edhe atëherë kur kjo nuk është në interes tonin dhe të njerëzve tanë, siç urdhëron Kur’ani. Ai (besimtari) duhet definitivisht t'i largojë prej vetes gjërat e cikërrimta dhe të pavërtetat, të cilat kufizohen me mahinë. Besimtari duhet ta

---

\* U publikua në Takvim, Sarajevë 1990.

mësojë dhe ta disiplinojë vetveten që gjithmonë ta thotë vetëm të vërtetën. Ajo që është le të jetë “po”, kurse ajo që nuk është le të jetë “jo.” Ky është një virtyt, virtyti themelor njerëzor, të cilin besimtari duhet ta mbjellë thellë në vete. Për besimtarin duhet të jenë shembull pejgamberët e Zotit. Besimtari mund të pohojë se ka arritur sukses në kuptimin e plotë të fjalës, nëse mjedisi i tij, që kur e njeh mirë, i beson në fjalë: çka është - është, çka s'është - s'është! Mos luani me besimin e njerëzve. Mos u arsyetoni më vonë: “Unë jam mahitur!” Pasuria më e madhe që mund ta fitoni nga të tjerët është besimi. Nëse ju e konsideroni këtë gjë të parëndësishme dhe luani me njerëz, në të vërtetë ju luani me vetveten. Mësoni më parë veten me shprehi të mira, e me këtë pastaj ndikoni edhe te të tjerët, ta thoni të vërtetën pa u thirrur në nderin, shëndetin tuaj dhe të afërmve tuaj, madje edhe pa betim.

Betimi mund të përdoret vetem në raste të domosdoshme e të jashtëzakonshme.

### *Falënderimi*

Njeriu ka nevojë edhe për njerëz tjerë, të jetojë me ta, të punojë dhe të ketë marrëdhënie me ta. Ne e dimë se në këto marrëdhënie duhet të udhëhiqemi jo vetëm nga interes, por edhe nga parimet e larta të etikës dhe të moralit, të cilat asnjëherë nuk guxojnë të vihen në dyshim, ky është urdhër i besimit. Këtë e pret All-llahu prej nesh, dhe për këtë na premton shpërblim. Kur’ani posaçërisht na urdhëron t’u bëjmë mirë të tjerëve, por vetëm nga dashuria ndaj Zotit, e jo të presim shpërblim ose falënderim. Një sjellje e këtillë është konfirmim i emrave. Këtë çdo besimtar e di.

Mirëpo, praktika jonë e përditshme është që kur të kërkojmë prej dikujt shërbim, atë e lusim dhe për këtë shërbim i falënderohemi. Në të vërtetë kjo është formë e njerëzishmërisë në kulturën e sotme të sjelljes reciproke, por kjo është larg përvojës së mirëfilltë islamë. Sepse, vetëm All-llahu është Ai që duhet ta lusim. Si t’u drejtohem i atëherë njerëzve prej të cilëve kërkojmë ndihmë? Nukjeni të detyruar t’u luteni. Për shembull “Më falni, ma jepni këtë dhe këtë!” ose “Më falni që po ju pengoj, dua të kaloj!” ose “Më lejoni të ulem!” e të ngjashme. Kërkesa e drejtë është thirrja në Zot, p.sh. “Pashë All-llahun, bëne këtë dhe këtë!”, “Në emër të Zotit”, “Për dashuri ndaj Zotit” etj. Mirëpo, ne e dimë se kjo në praktikë

nuk përdoret gjithmonë. Kjo do të viente vetëm në mjedisin e besimtarëve. Prandaj, mund të drejtoheni në një formë tjeter, p.sh. "A doni të më bëni një shërbim, që është i madh për mua, kurse për ju është barrë e vogël." - Keni njëqind mënyra t'i shëmangeni asaj: "Ju lutem."

Dhe kur t'u ofrohet ndihma... Ne në mirësjellje të rëndomtë, kur dikush na pyet për shëndetin, përgjigjemi: "Ju falemnderit për pyetjen!" Po si do t'i falënderohemi për vlerën e vërtetë të shërbimit?

Analizoni se ç'do të thotë ta falënderosh dikë për shërbimin e bërë. Kjo s'është asgjë tjeter, përveç pranimi i pafuqisë personale, në pamundësi që t'ia ktheni në të njëjtën mënyrë.

Ndërsa, në të vërtetë, ne jemi të varur vetëm nga Zoti, nga fuqia e Tij, nga mëshira e Tij. Dhe kur e falënderojmë ne All-llahun për bollëkun e Tij, pikërisht me këtë falënderim ne e pranojmë atë. Ky është imani.

Ai është i përkryer, i pavarur prej nesh, ose prej kujtdo qoftë, ose për çkado qoftë. Këtu qëndron kuptimi i porosisë se falënderimi dhe urimi i takon vetëm All-llahut.

Prandaj; kur i thoni dikuj: "Faleminderit" mendoni pak për këtë! Sepse ju asgjë nuk i keni thënë dhe asgjë nuk i keni pranuar. Në dukje, kjo është e njerëzishme, por në të vërtetë është plotësisht e zbrazët, e pakuptimtë dhe joreale. Disa njerëz e ndjejnë. Prandaj mund të dëgjojmë: "Çdobi kam unë nga ky falënderim?!

A thua nuk është më mirë t'i përgjigjeni: "Le t'ua pranojë All-llahu këtë si vepër të mirë!"; "Me këtë e ke arritur kënaqësinë e Zottit"; "All-llahu ua shtoftë juve dhe të dashurve tuaj!"; "Prej All-llahut ju dëshiroj çdo gjë të mirë", ose "Zoti ua shtoftë këtë në shëndet dhe në rehati."

Kështu flisnin prindërit tanë.

Një shprehje e këtillë, ndoshta sot duket tepër e gjatë dhe e mundimshme ndaj shprehjes së shkurtër "faleminderit." Kjo është çështje e shprehisë. Përpinquni të thoni shkurt: "Ju dëshiroj çdo të mirë nga All-llahu."

Kjo ka kuptim të plotë. Dhe nga aspekti islam është e pranueshme. T'u dëshirosh njerëzve të mirën, kjo është pjesë përbërëse e besimit tonë.

## *Të lavduarit*

Dihet fare mirë se sa është i prirur njeriu për t'u vetëlavduar. Të lavduarit nuk është aq larg nga mendjemadhësia, kurse mendjemadhësia - në të vërtetë - është burim i mosbesimit. Kur'ani vazhdimi shët i përmend ata, i qorton që të mos lavdohen me astësitë e veta, me dijen, satin, fuqinë, pasurinë... Të gjitha këto janë dhuratë e Zotit, ndaj i fton që të jenë falënderues ndaj Dhuruesit. Besimtari duhet të jetë modest edhe ndaj Zotit edhe ndaj njeriut. Dhe të gjithë ne e dimë këtë. Por megjithatë, bëjmë gabim kur flasim për të miratona, lavdohemi e mburremi, e ndonjëherë as nuk jemi të vetëdijshëm për këtë.

Dhe shikoni se sa e shëmtuar është kjo! Shikoni se sa keq ndjehen dëgjuesit përballë mburravecit. Kjo është aq e dukshme. Dhe krejt njësoj, ne e përsërisim këtë. Kjo është mungesa e vetëkontrollit dhe e vetëdisiplinës. Vetë djalli na shpie në këtë. Është e njobur rregulla që kur flet njeriu për vete (si për çdo gjë tjeter), duhet të ketë kujdes që mos ta shpie në mëkate tjetrin. Me tregimin tuaj mund të nxitni te tjetri varshmërinë, ose nëse asgjë tjetër, do të nxitni ofshamë e psherëtimë. All-llahu nuk e do këtë. A dëshironi ta hidhëroni All-llahun? A nuk ju kaplon frika se All-llahu mund t'ua marrë këtë, ose nuk ua merr pasurinë dhe bekimin e Vet, por mund t'ua kthejë në peripeci, në vuajtje e në fatkeqësi atë me të cilën lavdoheni e mburreni. Bëhuni modest! Edhe në shoqëri edhe në vetmi! Falënderimin mos e braktisni në asnjë moment! Ky është imani. E meqenëse imani është dhuratë e Zotit, Kur'ani urdhëron që ta lusim All-llahun të na drejtojë në rrugën e falënderimit dhe të mirënjosjes. Prandaj, kur njeriu është i lumtur për shkak të fatit të tij, mos të mburret, por në vetmi dhe në qetësi le t'i bëjë zikër Krijuesit të vet, Atij le t'i falënderohet dhe Atij në sexhde le t'i bie. All-llahu kështu dëshiron. Dhe të nesërmen të mos e prishë këtë. Mos t'ju lavdohet njerëzve me zikrin e tij. Si dëshmitar është i mjaftueshëm All-llahu. Devotshmëri e mirëfilltë është kur dëshmitar të veprave tona të mira e kemi vetëm All-llahun.

Prandaj: kini kujdes se ç'bisedoni për çkado qoftë që ka të bëjë personalisht me ju. Është vështirë të flasësh për vete me maturi dhe paanshmëri. Kjo pothuaj është e pamundshme. Ju nganjëherë mund të jeni kundër vetvetes. Mirëpo, kjo është shprehje e përkohshme e pezmit në vetvete, e kurrsesi e gjykimeve të arsyeshme e gjakfohta.

Prandaj është më mirë që për vete të flisni sa më pak, e më së miri aspak!

Përkundër vetëlëvdimit, njeriu në halle e derte di t'u ankohet të tjerëve për fatkeqësinë e vet, edhe pse kjo asgjë nuk i ndihmon. Dhe kjo di të jetë tejet e neveritshme. Këtë nga përvoja të gjithë ne e dimë. Për t'u dëgjuar kjo, nevojitet durim i madh. Mirëpo duhet pasur kujdes. Duhet kuptuar se kjo është një mënyrë e shkarkimit psikik të atij që është në hall. Duhet të kuptioni edhe një gjë: Nëse, ruana Zot, ju gjen ndonjë fatkeqësi, mos iu ankonitë tjerëve!

Për fatin tuaj mos iu ankonit askuj, përveç Famëlartit. Kujtoni Jakubin a.s. dhe Ejubin a.s.! Kujtoni se si Resulullahu a.s. në një rast porositi të pikëlluarit ta ndërprenjnë vajtimin për të vdekurin, që këtë porosi ta përsëriste edhe një herë, atëherë u hidhërua dhe urdhëroi t'ua mbyllë gojën me dhe. Në durim dhe në namaz njeriu duhet të kërkojë ndihmë prej Zotit - kjo është porosi kur'anore. E mira dhe e keqja vinë nga All-llahu!. Vetëm Atij vlen t'i drejtohem. Dhe besimtari për hallin e vet aty duhet të gjejë strehim dhe lehtësim shpirtëror.

### *Mallkimi*

Mallkimin e përdorim në jetën tonë të përditshme. Muslimanët gjithmonë mallkojnë, në çdo hap dhe në çdo rast e në çdo fatkeqësi. Mallkojnë prindërit që i kanë lindur. I mallkojnë vëllezërit dhe motrat kur kanë probleme me ta. I mallkojnë fëmijët kur nuk i dëgjojnë. "Zoti të bëftë kështu! Zoti të bëftë ashtu...!" është ky mallkim e namë që e dëgjojmë në shtëpitë tona, në fshatrat tona, gjatë takimeve tona. Dhe kur shohim se për çka, për asgjë! Kur nervozohemi shumë pak kujdesemi se ç'thami. Ne atëherë, harrojmë porosinë kur'anore: ta përbajmë hidhërimin. Kjo është sjellja e besimtarëve të vërtetë.

Edhe ne nuk mendojmë se çdo të thotë mallkimi. Nuk kujdeseimi sa gjë serioze është ai. Ne mallkojmë pikërisht sikur qëllimi ynë është që të tregojmë se në ç'shkallë të lartë është hidhërimi ynë. Dhe asgjë tejtë! Sa të palogjikshëm jemi dhe sa joseriozisht e kuptojmë, do ta shohim nga një shembull i përditshëm në familjet tona.

Fëmija luan me diçka, rrëzohet, lëndohet ose prehet, kurse nënat tona me atë rast mallkojnë: "Zoti dhashtë, e ti plassh!" Ndërsa, para dhjetë minutash pikërisht atë fëmijë e përkëdhelte me për-

zemërsi të dashurisë prindore të nënës, e pas dhjetë minutash do të qajë për të. Ndërsa nëna harron se nama e mallkimit mbetet! Dhe nëse atë fëmijë e zë mallkimi, ajo (nëna) nga pikëllimi do të vdiste për të. Nga dashuria e tepërt ajo nuk dëshiron as t'i mëshojë me thupër atij, por vepron edhe më keq, do të thotë e mallkon!

Ne aspak nuk jemi të vetëdijshëm për tmerrin e mallkimit. Ndërsa ndeshim në shembuj, dhe themi: "E ka zënë nama!" Mund të tregohen tregime për këtë. Gjithsesi do të mund të sillnim nga një shembull ngajeta e përditshme. Të gjitha këngët populllore të të gjithë popujve kanë shënuar mallkimin dhe kjo nuk është përrallë e rastit. Gjithashtu, edhe e gjithë literatura që është e afërt për popullin.\*

Në gjirin e botës sonë muslimane është i njohur mallkimi tradicional: "Dheu eshtrat ja përzift!" Prandaj, shikoni se çfarë është fati i pjesës dërrmuese të haremeve tona!

Kuptohet se në gjirin e popullit tonë kaherë që nga kohët e lashta është ditur për gjërat e këqija dhe të shëmtuara. Ata të mirët dhe të virtytshmit nuk kanë lejuar që t'i rrëmbejë tërbimi. Ka ndodh të jenë të rreptë, dhe kanë qenë, por i janë shmangur mallkimit. E kanë bekuar, dhe e kanë lutur All-llahun për mëshirë dhe dashamirësi:

"Fali, o Zot!"

"O Zot, shpëtoi!"

"O Zot, jepu mend!"

"O Zot dhurou mençuri dhe dituri!"

"Nxjerri n'rrugë të selamitet o Zot!" Këto kanë qenë lutjet e tyre të përhershme. Për çdo ditë, për çdo natë, pesë herë në ditë, pas çdo namazi: dhe që t'u pranohen lutjet kanë bërë vepra të mira. Ndoshta kjo vërtet ka qenë vështirë. Mirëpo, qetësia, maturia dhe

\* Çdo popull ka shprehjet specifike të mallkimit. Edhe te shqiptarët ndeshim namë e mallkime, madje ato dallohen me specifika karakteristike për çdo trevë shqipfolëse, për çdo fshat, e shpesh edhe për çdo individ p.sh. Zoti t'marrë; Toka t'hankt; Dheu t'mbloft; T'shtifsha n'dhe; T'preksha t'ftohtë; Hoxha t'laftë; Emni t'u harroftë; etj. Këto janë shprehje mallkimi të panumërtë në çdo trevë, por janë të kufizuara në individë. Ka individë e prindër, që shumë rrallë mallkojnë ose nuk mallkojnë fare, sepse i frikësohen mallkimit.

E ka zanë haku i nanës; E ka vra nama e nanës; e ka vra buka e gjini i nanës; E ka vra nama e mysafirit. Sipas kultit të mikpritjes dhe bujarisë shqiptare, ai që nuk e pranon mysafirin në shtëpi, mund ta zë mallkimi i mysafirit, e të fiket e të dalë fare ajo shtëpi me rob e fëmijë.

(shën. i përkthyesit)

qëndrueshmëria - a thua këto nuk janë virthyte të besimtarit? Gjërat e pamenduara mirë dhe nxitimi - a nuk janë këto punë të djallit?

Njeriu nuk mund të mos komprometohet; A thua në kohët e sotme të shkencës nuk na habisin sjelljet e veprimet e një numri aq të madh njerëzish: punojnë atë që është kundër mendjes së njeriut dhe ligjeve të Zotit. E kush e di - Zoti më së miri e di! - a nuk i zuri mallkimi këta njerëz, mallkimi me të cilin i janë dorëzuar djallit t'i udhëheqë dhe t'i mashtrojë, nama e lashtë dhe e stërlashtë, të cilën e dëgjojmë ne sot.

Dëgjojmë edhe mallkim të këtillë "Qostë i mallkuar!" Çka do të thotë "I mallkuar qoftë!" Do të thotë se Zoti e ka humbur. E kur dënon All-llahu, dënim i është i tmerrshëm. Mirëpo, All-llahu është mëshirëplotë, Ai falë shumë!

Mallkimi është shprehje e pafuqisë. Mirëpo, ne nuk jemi të pafuqishëm. Nëse fëmija nuk ju dëgjon për ndonjë punë, p.sh. nuk do të mësojë, mos i thuani fjalë të shëmtuara, mos e qortoni dhe mos e mallkon! Dënojeni me dënim të arsyeshëm, merrjani lodrën me të dashur, mos e lejoni të shkojë në kinema, shkyçjani televizorin. Keni njëqind mënyra tjera, por mos e mallkon! Që një ditë të mos ankoheni me hidhërim. Që të mos pendoheni. Mos lejoni t'ju mashtrojë djalli se All-llahu deri tani nuk i ka plotësuar mijëra mallkimet tuaja. E sikur vetëm njëri të realizohej... A thua dëshironi që edhe në varr mos të jeni të qetë, duke shikuar më të dashurit tuaj se si i përcjell mallkimi juaj? Më i llahtarshmi është mallkimi prindor!

### *Nderimi i prindërve*

Nga ana tjetër, të gjithë ne jemi fëmijë. Pa marrë parasysh moshën tonë. Vërtet, ne sot jetojmë larg atyre kohëve kur kjo është kuptuar krejt seriozisht. Po tregojmë një anekdotë nga kohët e lashta:

Ali pashë Rizvanbegoviqi në rrugëtim, jo fort larg nga vendi i vet Stoci, sheh një plak se si po rrinte pranë murit dhe qante:

Ali pasha e pyeti:

- Sa vjet ke?
- Shtatëdhjetë!
- E përse po qan?
- Më ka rrahur gjyshja.
- E përse?

- Se nuk kam dashur ta dëgjoj gjyshen e saj.

Pa marrë parasysh e pranojmë këtë ose jo, obligimet tona ndaj prindërve mbisin edhe atëherë kur ata nuk gjenden në mesin e të gjallëve. Sa njerëz do të gjeni, që kur binden se janë të pjekur në jetë, që atëherë e shohim se kurrë nuk mund t'u dalin borxhit prindërve të tyre. Në realitet, i tërë ky borxh mund të përmblidhet në një fjalë të vetme - *nderim*. Ky është thelbi i çështjes, qëndrimi i fëmijëve ndaj prindërve, dhe jo dashuria ose obligimi. E tërë kjo bën pjesë në nderim, nëse ky nderim ekziston. Ky është qëndrim subtil, ky është thelbi i problemeve. Jo vetëm sot, por gjithmonë. Mund të dëgjohet konstatimi se dikur ka pasur më tepër respekt se sa sot. A është vërtet kështu, është vështirë të dihet e të thuhet.

Kuptohet qartë, se dikur ka pasur më tepër mundësi që të imponohet dëgjueshmëria. Mirëpo, kjo ende nuk është respekt (nderim). Sepse te njeriu i ri shihet qartë prirja t'i nënçmojë më të vjetrit, t'i akuzojë për shkak të të metave dhe lëshimeve - gabimeve. Të gjitha këto ai do t'i bënte më mirë. Dhe do t'i bëjë! Ai është më i mirë! Edhe më i mençur! Prindërit nuk dinë asgjë. Ndërsa, më vonë, kur të plaket vetë, kur t'i kujtojë prindërit, i dalin lotët. Do të thotë: "Kanë qenë të mrekullueshëm." "Kanë pasur aq shumë derte, aq shumë flijime, aq shumë ngrohtësi!"

Kujtimi do të jetë aq më i dhembshëm, sa më shumë t'i ndjejë gabimet ndaj tyre.

Shkenca ofron shpjegime të pakta për një sjellje të këtillë të të rinjve. Më së miri që mund të dëgjohet është se instinkti është ai ligj biologjik, synim i qenies së re që bëhet më e pjekur, dhe e cila dëshiron të pavarësohet. Ndërkaq, religjioni nuk shpjegon, ai kërkon nderim (respekt). Me vendosmëri! Mirëpo, ç'do të bëni nëse nuk keni respektin e merituar dhe e shihni vetë këtë? - Kërkoni gabimin në vetvete! Luteni Zotin t'u japë ndjenja, mëshirë dhe respekt ndaj tyre. Dhe këtë vazhdimisht pas çdo namazi! Edhe kjo është mëshira e Zotit, qoftë edhe të përgjigjeni një ditë për shkak të mungesës së kësaj ndjenje. Mos u arsyetoni se si ata nuk ju kuptojnë juve dhe synimet tuaja. Arsyetimet e këtilla janë të vjetra sa edhe vetë njerëzimi. Duhet të jeni të durueshëm në të gjitha, siç thoni ju, predikimet e tyre morale. Mos e mbroni veten para vetvete me atë se djalli ua vë përpara atë që nuk ju pëlqen te prindërit tuaj, dijeni se All-llahu kërkon që të pranoni dhe mos e refuzoni asnjë punë, me përjashtim të atyre që ju çojnë të bëni mëkat.

Shumë fëmijë i drejtohen babës dhe nënës me fjalët “plak” dhe “plakë”, e nuk e hetojnë se sa ofenduese është kjo për ata? E më vonë kur ta shohin këtë, nuk mund të largohen nga kjo shprehi. Kjo u rëndon, madje edhe nuk u vjen mirë. Duhet të vihesh në pozitën e tyre, në ndjenjat e tyre, sikur të kenë pranuar ndonjë disfatë, sikur të jenë nënshtuar e pastaj të jenë poshtëruar. Prej nga kjo?

Ndoshta rrënjët e një qëndrimi të këtillë gjenden në përpjekjet që të fshihen ndjenjat ndaj prindërve. Qëllimi isht paraqitet kinse indiferent, gati i ashpër, mbase shprehje e fuqisë burrërore. E nuk është ai i atij soji, që u nënshtrohet ndjenjave të dhembshme dhe të buta! Por mund të jetë edhe rezultat i përkulshmërisë. Kështu veprojnë edhe të tjerët. Ose, ndoshta është vërtet humbje e respektit ndaj prindërve. Madje edhe kjo me arsy. Nëse vërtet është ashtu, nëse te prindërit ka diçka që edhe All-llahu nuk e do, atëherë le të bëhet ky mësim për ju se si ju personalisht nuk duhet të bëheni, as si fëmijë sot, e as nesër - nëse Zoti do - si prindër. Pikërisht kjo është ajo, për të cilën njeriu ka shumë pak kujdes.

Pérndryshe, kur shohim te të tjerët diç që nuk na pëlqen, ne shpejtojmë ta dënojmë atë, kurse e harrojmë veten. Harrojmë t'i drejtohem i Zotit xh.sh. që të na ruajë nga sprovat dhe nga fatke-qësitë e ngjashme. Harrojmë Ta lusim që edhe ata t'i lirojë nga ato telashe dhe t'i falë. Kjo është puna e parë që si besimtarë duhet ta bëjmë.

E pastaj të gjitha punët tjera, sipas rastit dhe mundësisë.

A thua nuk po e shihni inkonsekuençën njerëzore dhe fatin hakmarrës.

Njeriu, ruana Zot, në sprova të vështira është i dobët.

Vështroni njerëzit që sot i gjykojnë të tjerët, e ata këtë punë të njëjtë e bëjnë edhe nesër. Nxisin me gisht turpin e huaj, ndërsa nesër ky turp i mbulon ata. I njollozin të tjerët, edhe ata të njëjtën ditë i gjen kjo. Mençuria e popullit nga përvoja jetësore ka farkuar fjalën e urtë:

“Haku kthehet në të njëjtat opinga.”

T'ju tregoj një rrëfenjë të thjeshtë dhe pa të keq sipas kohës së vjetër.

Në Bagdad na ishin dy shokë. U martuan, njërit prej tyre i lindën dy fëmijë, ndërsa tjetrit i lindi fëmija pas një kohe të gjatë. Ishte tepër i lumtur, por nuk e dinte se vetë All-llahu ka dashur t'i tregojë se sa i padrejtë ka qenë ndaj shokut të vet, sepse vazhdimisht fliste me zë dhe plot qortim: “Dy fëmijë, një dhomë përplot

me lodra!” Ndërsa ai tash: një fëmijë, kurse dy dhoma përplot me lodra.

Prandaj kini kujdes në fjalët tuaja - dhe në sjelljet tuaja ndaj të tjërëve. Filloni nga prindërit, mos i poshtëroni! As ata, e askënd tuajin. Dhe ky le t’ju jetë parim në jetë, të cilin do ta zgjeroni e ta shtrini te të gjithë njerëzit.

### *Sjellja e ndërsjellë*

Djalli kurrë nuk pushon. Ai me mijëra mënyra përpinqet të na shtyjë në mëkate. Ai gjurmon tek ne farën e urrejtjes, të varshmërisë, shpirligësisë dhe të poshtërsisë. Ndërsa prirjen për shaka dëshiron ta kthejë në fyerje.

Kur kritikoni të tjerët, kini kujdes se prej çfarë fare mbin kritika juaj dhe ç’dëshironi të thoni me të! Çfarë fryti kërkoni? Dhe mos u mahitni tepër. Sado që të jeni të disponuar, gjithmonë shtroni vetes pyetjen: “Çfarë do të thotë All-llahu për këtë?” - Ai është *iman*. Dhe mos i thumboni njerëzit, mos i përqeshni e mos i përbuzni! Ndoshta ata te Zoti janë më të mirë se ne. Mos ia vini veshin as vetes as të tjërëve në fyerjet e huaja të prekshme dhe të ndjeshme. Poshtërimi është vuajtja më e madhe njerëzore. Sa punë e madhe është kjo për All-llahun, shihet nga ajo, sepse Ai të përbuzurve, nëse e tejkalojnë poshtërimin ua premtoi xhennetin.

Në kontaktet tona të përditshme me të tjerët, vazhdimisht ndeshemi me shprehje dhe me sjellje të pakripë e të pahijshme. Këto fillojnë nga ato kukëzat tona tradicionale: “I gjorë qofsh!” dhe “E gjorë qofsh!” e deri te fyerjet më të shëmtuara. E në të vërtetë, të gjitha këto janë të panevojshme. Na rrëmben zemërimi, ndaj nuk mund të përbahemi e as të kontrollohem. E këtë do të duhej ta bënim: Ne të gjithë dimë për shprehjen: “Të jeshë fisnik”, dhe ne të gjithë do të dëshironim të jemi të tillë. Por nuk e dimë se si mund të arrihet kjo. Harrojmë se të jeshë fisnik dhe i sjellshëm do të thotë të jeshë i qetë. E pikërisht kjo është cilësia e besimtarit. Kur’ani, kur e paraqet besimtarin në kriza të mëdha p.sh. në vigjilje të Betejës në Bedër dhe pas disfatës në Uhud, tregon në maturinë e tyre. Lidhshmëria për All-llahun dhe dorëzimi në atë që na është pëcaktuar - ky është Islami.

## *Përfundim*

E gjithë kjo që u zu njojë, është vështirë të përkufizohet dhe të shkallëzohet sipas peshës së rëndësisë. Kjo është pjesë përbërëse e jetës sonë, që nuk lejon të futet në kallëp. Vështroni Kur'anin. Ç'duhet çmuar aty si gjë të madhe ose të vogël, ku Kur'ani thotë që mos t'i përgojojmë të tjerët dhe këtë e krahason sikur ta hamë trupin e vëllait të vdekur, ose prindërve mos t'u themi as "uf", ose në shoqëri t'u bëjmë vend të tjerëve, me paralajmërim se edhe neve All-lahu na bën vend në xhennet. Ky nuk është ligj indiferent i ndarë në paragrafe. Ai në pasionin e njeriut, i mirë dhe i keq përgjigjet po ashtu jetësish dhe ngrohtësish garanton, kërcënohet, premtion, inkurajon, dezinkurajon, paralajmëron mëshirë, dhuratë dhe dënim, paralajmëron shpëtimin dhe shkatërrimin, paralajmëron xhennetin dhe xhehennemin. Ai i drejtohet sa mendjes së njeriut, aq edhe zemrës së njeriut. Ai kërkon nga njeriu që t'i rrëfehet shokut. Ai kërkon që njeriu t'i kthehet vetes. Ai kërkon që njeriu ta disiplinojë vetveten.

Nga bindja dhe nga ndjenjat. Kjo më s'është ngarkesë. Pra, rregullat e besimit janë të vështira... vetëm për ata të cilët presin kënaqësinë e Zotit dhe takimin me Të.

Mirëpo, ka shumë njerëz, të cilët me dëshirë do të bëheshin të mirë por e shohin qartë se sa vështirë është të mbikëqyrish vetveten. Shumë më lehtë është të vërehen të metat dhe gabimet e tjerëve se sa tonat personale. Megjithatë, mund t'ia parashtroni vetes disa rregulla dhe të caktoni dënim nëse i shkelni. Dënimet ekzistojnë vetëm për atë që vazhdimisht të përkujtoheni se keni bërë diç të palejueshme.

Le të jetë p.sh. për çdo gabim një ditë agjërim. Nëse ju vjen rëndë, e gjithsesi nuk është lehtë, atëherë le të mënjanohet monedha më e vogël, dhe kohë pas kohe të shpérndahet si sadaka.

Ky do të ishte përkujtues shpëtimtar për gabimet personale, provë për zhvillimin e personalitetit si mumin. Do të befasohemi se sa shumë do të jenë në fillim. E pastaj gjithnjë pak e më pak. Vërtet, këtu nuk ka ndonjë fund, fund është fundi i jetës sonë - *vdekja*. Mirëpo, njeriu duhet të ketë besim të vërtetë, ndaj duhet t'i përmbarhet fjalës së dhënë dhe do të ketë kontrollin ndaj sjelljeve të veta. E që të arrihet kjo, është puna më e vështirë në jetë.

Të gjitha këto rregulla njeriu vetyves duhet t'ia parashtrojë vetë në fryshtë e paraqitur. Ato mund të klasifikohen në mënyrën e poshtëshënuar:

1. Mos i thuaj askujt: "Të lutem!", por vetëm Zotit!
2. Mos i thuaj askujt: "Faleminderit!", por vetëm Zotit!
3. Mos iu anko askujt për fatkeqësinë tënde, përveç Zotit!
4. Mos u lavdëro me të mirat tua, por falëndero Zotin!
5. Mos u beto çdo çast dhe pa nevojë!
6. Mos fol shumë për vete, sa më pak, aq më mirë!
7. Mos mallko!
8. Mos refuzo shërbimin e kërkuar!
9. Mos lejo të të pushtojnë shqetësimet!
10. Mos fol nëse nuk je i qetësuar!
11. Mos e tepro në shaka!
12. Mos i përqesh të tjërët!
13. Mos e poshtëro askënd!
14. Mos fol fjalë të shëmtuara!
15. Mos nxit zemërimin e prindërve!
16. Mos e përhap turpin e huaj!
17. Mos e treng emrin e mëkatarit derisa ai e fsheh mëkatin e vet!
18. Mos i dëno veprimet e të tjërëve, para se ta lusësh sinqe-  
risht Zotin që ty dhe farefisin tënd t'ju ruajë nga mëkati i ngjashëm!  
Vetëm All-lahu është Zot!  
Le të jetë Ai i kënaqur me ne!

# VËSHTRIM ROMANIT “DERVISHI DHE VDEKJA”\*

Romani “Dervishi dhe vdekja” i Mesha Selimoviqit ka zgjuar një interesim të madh te publiku ynë lexues. Originaliteti i një fati dhe mënyra se si është ofruar, thellësia e mendimeve dhe e përfundimeve që vihen në pah në këtë roman, thirrja për veprim ose arsyetimi për mosveprim, e gjithë kjo është paraqitur, është endur ashtu ndërgjegjshëm, ashtu intimisht saqë personazhi paraqitet në mënyrë plastike të gjallë dhe besnikë para lexuesit.

Është çudi se si vetë personazhet veprojnë me mendimet e veta dhe me sjelljet e veta në mënyrë të drejtpërdrejtë, që në mendimet tona, në veprimet t’i shikojmë me dyshim duke pyetur a thua mos jemi vetë ne. Kemi përshtypjen, e kjo përshtypje na mban gjatë tërë librit, se ata janë njerëz të gjallë, të cilët diku i kemi dëgjuar dhe i kemi parë, sikur këta të janë artistë të maskuar në rroba të modës së vjetër, të cilët kinse duhet të na paraqesin dhe të na evokojnë kohët e ngrysura se si dikur është jetuar dhe punuar, ndërsa në realitet roli i tyre paraqet njeriun bashkëkohor, dilemat dhe kundërthëniet e tij.

Kështu pra, në vend të analizës së një kohe të kaluar me shpejtësi, në vend se mendimet, fryma dhe ndjenjat ta tërheqin lexuesin në atë botë të perënduar (e në asnjë moment nuk mund të hetohet se ai përpinqet ta bëjë këtë), shkrimitari personazhet e veta, si aktorë të historisë, i shkëput nga skena e kohëve të ngrysura dhe i vë në mesin tonë, në të sotmen, dhe ne shpejt shohim se si këto personazhe,

\* U publikua në Glasnik BI nr. 78.1967, Sarajevë.

kaherë të vdekura, aspak nuk dallohen prej nesh, ata mendojnë, ndjejnë dhe veprojnë pikërisht si edhe vetë ne - as më mirë e as më keq. Ai nuk na ka ofruar dhe parafytyruar mënyrën e jetës së dikurshme, që i përket historisë. Ai ka përshkruar ngjarjet përbrenda njerëzve, ka përshkruar të mirën dhe të keqen, të cilat lindin në njeriun, jetojnë dhe vdesin. Kështu ne, me befasi e shohim romanin “Dervishi dhe vdekja” si një pasqyrë në të cilën shohim vetveten, rrethin tonë dhe kohën tonë. Dhe këtë plotësisht në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme: mendimet tona të turbullta janë definuar qartë, ndjenjat tona të mjegulluara janë ndriçuar qartë, pëshpëritja jonë është thënë haptas.

Kjo është karakteristika e romanit “Dervishi dhe vdekja”, dhe tërë ai interes që zgjoi, është rezultat i aktualitetit të tij për kohën tonë. Pikërisht fakti se personazhet e romanit mund të kenë jetuar kurdo qoftë dhe kudo qoftë, është ajo që romanit i jep vlerë të përhershme.

## II

Kritika njëzëri e ka lavdëruar romanin. Të gjithë janë të befasuar. Është i befasuar edhe vetë Mesha Selimoviqi me suksesin e vet. Në intervistën dhënë shtypit dhe televizionit, ai thotë: “Jam i befasuar me unanimitetin me të cilin kritika e ka pritur veprën time dhe me shpjegimet e nduarduarta. Kjo është dukuri, të cilën nuk mund ta shpjegoj”:

Dhe vërtet: nga të gjitha anët arrijnë shpjegime të ndryshme, secili prej tyre është interesant. Edhe vetë autor i përpinqet që më përsë afërm i konkretizoje mendimin e vet dhe të ofrojë shpjegimin e vet. Në shumësinë e komentimeve të nduarduarta, komentimi i tij është posaçërisht interesant dhe pikërisht ky është qëllimi ynë të cilit duam t’i qasemi.

Ai thotë: “Secili ka murin e vet me të cilin mbrohet, ruhet nga të tjerët. Për kadiun ky mur është Kur’ani, për policinë ashpërsia, për myftinë vdekja, monotonia nga e cila vdes i gjalli. Dhe këtu nuk ka mundësi të depërtohet. Nga ana tjeter, ndeshim mbylljen e institucioneve, fetishizimin e tyre, mistifikimin, diç që për njeriun nuk është e afërt.”

Në pyetjen: Ku është atëherë zgjidhja, shkrimitari përgjigjet: Sipas Kur’anit, zgjidhja është në Zotin, te unë në dashuri, në humilitet, jo në humanitetin e kuptuar në aspektin abstrakt, por në dashurinë ndaj njeriut, individit të cilin duhet ta pranojmë me të metat

dhe virthytet e tij. Humanizmi nuk qëndron në dashurinë për shumicën, por për individin. Madje avancimi i një regjimi, humanizmi i tij, çmohet sipas asaj se sa e çmon ai lirinë e personalitetit të njeriut.”

Ta analizojmë këtë:

Nga ky mendim mund të përfundojmë se besimi në Zot dhe në humanitet janë kategori të ndryshme, që mund të ekzistojnë njëra jashtë tjetrës, ose madje edhe të përjashtohen njëra nga tjetra.

Nga historia e dimë se feja ka qenë burim dhe predikues i moralit dhe i të gjitha virthyteve, prandaj edhe i humanizmit. Islami po ashtu. Duke lexuar Kur'anin ndeshim në begati ajetesh, të cilat menjëherë pas të besuarit, kërkojnë edhe vepra të mira. Ky qëndrim aq tepër theksohet saqë plotësisht na lë të besojmë se sipas Kur'anit pa vepra të mira nuk ka besim të mirëfilltë.

Të tjerët mendojnë se këto dy kategori nuk përjashtohen detyrimisht, por lejojnë, dhe duket plotësisht e kuptueshme, se humanizmi mund të ekzistojë edhe pa besim. E pikërisht ky është mashtrim. Humanizëm të vërtetë nuk ka dhe nuk mund të ketë pa besim:

Ja përse:

Të përpinqemi së pari t'i definojmë virthytin dhe humanizmin. Sipas definicionit më të përgjithësuar, virthyi dhe humanizmi nënkuqtojnë: t'ia dëshirosh tjetrit atë që ia dëshiron edhe vetes, të sillësh ndaj të tjerëve ashtu siç dëshiron të sillen edhe të tjerët ndaj teje. Kjo është pikërisht ajo domosdoshmëri e çdo feje të shpallur. Njeriu i painformuar mirë është i gatshëm që humanitetin dhe virthytin t'i konsiderojë rezultat të arsimimit dhe të civilizimit, edhe pse praktika dhe përvoja jetësore këtë e demantojnë haptas.

Vërtet, pa sakrifica nuk ka vepra të mira. Sakrificat janë dëshmi e vlerës së tyre. Derisa sakrifica është e vogël, ndërsa dobia e madhe, ne jemi të gatshëm ta paguajmë këtë çmim. Mirëpo kur të zvogëlohet masa, ndërsa sakrificat paraqesin për ne barrë të rëndë, atëherë pason dilema dhe hamendja. Njeriu pyet vetveten: “Përse të sakrifikoj interesat e mia, pasurinë time ose ta ngarkoj veten me vështirësi dhe me të papritura” - Parimisht të gjithë jemi për virthyte, ndërsa në jetën reale jemi krejtësisht tjerë. Sa e sa herë e zëmë veten se humaniteti nuk është edhe aq jovetjak? Nëse asgjë tjetër, kërkojmë kënaqësi së paku në pranim dhe në falënderim, me dëshirë që të ngrihem mbi të tjerët, edhe pse jemi të vetëdijshëm se me këtë vlera e sakrificës sonë zvogëlohet. Në njeriun nuk ekziston vetëm e mira, por edhe e keqja, dhe këto gjenden në konflikt të përvetësuar.

hershëm njëra me tjetrën. Që të fitojë e mira, është e nevojshme mbështetja e fortë, sepse sprovimet janë tepër të mëdha. Njeriu dëshiron pasuri, famë, autoritet dhe jetë të rehatshme, ndërsa rruga e virtuteve dhe rruga e humanitetit shpesh shpie në rrugë të kundërt: në vetëmohim dhe në falimentim. Prandaj, a është e mjaftueshme për njeriun vetëm njohja e rrugës së humanitetit e të niset në atë drejtim? Jeta e përditshme na flet qartë se kjo nuk është e mjaftueshme, por është e nevojshme një mbështetje shumë më e fortë. Një mbështetje të këtillë mund të ofrojë vetëm besimi.

Përkujtojmë Kur'anin, i cili thekson se është mirë që e mira të bëhet publikisht, kurse është edhe më mirë që e mira të bëhet fshehurazi. Ku mund të gjenden parime të këtilla jashtë fesë? Njeriu nuk duhet të mashtrohet. Humaniteti nuk është produkt i mendjes sonë, e nuk është as kategori historike që është zhvilluar me njeriun, kinse me zhvillimin e tij biologjik nga ai shtazor drejt një zhvillimi më të përsosur. Feja është ajo e cila ia mësoi njeriut humanitetin dhe e nxiti në rrugën e virtutit. Të gjitha veprat e mirëfillta humane, që nuk janë të motivuara nga fama dhe reklama, gjithmonë kanë qenë rezultat i ndjenjave fetare.

Pra, përse të bëhem i të mirë dhe njerëzorë? Në emër të kujt përbahemi nga egoizmi dhe nga e keqja, veçanërisht në emër të kujt të veprojmë në atë mënyrë, kur shumë shpesh, pothuaj sipas rregullit, interesit ynë personal kërkon që të veprojmë kundër kësaj.

A duhet të udhëhiqemi nga interesit personal, interesit i përgjithshëm apo nga obligimi? Prandaj t'i analizojmë këto tri mundësi.

Mendja dhe të menduarit shpesh janë në shërbim të interesit personal, ndihmojnë që më mirë të mësojmë ku qëndron interesit ynë personal dhe rruga më e suksesshme deri tek ai. Sikur virtuti të varej nga mendja, do të ishte rregull që personat më inteligjentë të ishin njëkohësisht edhe pjesëtarët më të moralshëm të shoqërisë. Jeta reale qëndron larg nga ky parim.

Interesi i përgjithshëm nuk mund as me motivet e veta, as me pasojat e veta të largohet shumë nga interesit personal, sepse ai nuk është gjë tjetër pos interesit personal i ngritur në nivelin shoqëror. Interesi i përgjithshëm i një bashkësie të ndarë mund të lejojë ose të kërkojë madje edhe të eksploatohen, të robërohen ose të zhduken pjesëtarët e bashkësisë ose ajo bashkësi që në tërësi përbëhet nga krijesat krejtësisht të njëjta çfarë jemi edhe ne vetë. Veçanërisht historia më e re është plot me shembuj se si interesit i përgjithshëm

nganjëherë mund të marrë karakter kriminalistik. Pikërisht gjenocidin e arsyeton si interes të përgjithshëm:

Mbetet parimi detyrimor, veprimi sipas së drejtës dhe të vërtetës, si në çështje të vogla ashtu edhe në çështje të mëdha, pa kurrfarë interes i personal, por në emër të Zotit *fisebilil-lahi*. Një veprim i këtillë dhe një kërkesë e këtillë, mund të ndërtohet dhe ndërtohet vetëm në themele të fesë. *Ose besojmë në Zotin dhe moralin e kuptojmë si e vërtetë e Tij ose nuk besojmë në Të, ndaj moralin e pandehim si hutim.* Secili vetë në zemrën e tij duhet të kërkojë përgjigje në pyetjen, a thua krahas interesit të kësaj bote, të mbyllur në kohë dhe në hapësirë, ekziston edhe një botë në të cilën detyra, morali dhe drejtësia kanë kuptimin dhe arsyetimin e vet. Prandaj, humaniteti pa Zot është vetëm jehona e shkëputur nga ajo botë në të cilën nuk besohet më. Nëse nuk ekziston kjo botë, nuk ekziston as humaniteti.

### III

Kjo ishte përgjigja jonë Mesha Selimoviqit, ashtu siç e kemi kuptuar shpjegimin e romanit të tij “Dervishi dhe vdekja.” Që ta ilustrojmë më mirë këtë qëndrim tonin, po marrim shembull fatin e personazhit kryesor të tij: Dervishit Ahmed Nuredinit.

Fati i Ahmed Nuredinit është tragjik, mirëpo gjendja e tij shpirtërore dhe mënyra se si e pranon ai këtë tragjedi, janë edhe më tragjike. Ai është plot frikë dhe tmerr në mendimet për vdekje, të cilat afrohen në mënyrë të pamëshirshme. Ai e di se do të ekzekutohet në kështjellë. Kjo njojuri shkakton tek ai tronditje të thellë, mbi të gjitha, plotësisht të kuptueshme, por mbi të gjitha më i tmerrshëm është fakti, dhe kjo është tragjedi e vërtetë, që në këto momente ai nuk gjen e as nuk përpinqet të gjejë mbështetje psikologjike që vertikalisht ta presë fundin dhe ta pranojë fatin e vet, i cili më nuk mund të ndryshohet. Ai është hedhur plotësisht jashtë çdo ekuilibri shpirtëror dhe në këto momente të dëshpërimit dervishi Ahmed shpall mendimin se vdekja dhejeta janë të pakuptimta. Nga sureja kur'anore ‘ASR’, ai në vete shqipton ajetin, ose më mirë të themi një pjesë të ajetit, i cili thotë:

“*Betohem në kohën, e cila tregon fillimin dhe mbarimin e çdo gjëje, se është e sigurt se çdo njeri është në humbje të madhe..., por nuk e përfundon. Pikërisht në këtë ajet të papërfunduar qëndron nyja dhe shpjegimi i çdo gjëje. Vazhdimi i ajetit thotë. “...përveç atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe të cilët njëri-tjetrit i pre-*

*ferojnë të vërtetën dhe durimin.*" Shtrohet pyetja: përse ai nuk e shqipton tërë mendimin kur'anor? Është plotësisht e sigurt se dervishi Ahmed Nuredini e di këtë vazhdim të rëndësishëm, sepse këtë e di qartë edhe babai i tij letrar Mesha Selimoviqi. Megjithatë, ai nuk e sheh të nevojshme ta vazhdojë këtë mendim, por ndalet në gjysmë të rrugës, që i jep krejtësisht mendim tjetër. Kjo në shikim të parë e befason lexuesin. Mirëpo, meqë nuk ka shpjegim, vetë lexuesi do të duhej të ishte krejtësisht tjetër, nga ai që është menduar. Nga kjo del se tragjedia e dervishit Ahmed nuk është rezultat i pa-sojave personale të parimeve të përvetësuara, që e ka tradhtuar vetveten, por është tragjedia reale, pikërisht shkelja e parimeve më të larta në vetvete, me të cilën ky personazh i pafat i Selimoviqit e ka privuar veten nga baza morale.

Të kuptohemi: dervish Ahmed i do të përfundojë në të njëjtën mënyrë siç përfundoi edhe vëllai i vet Haruni. Fatet i kanë të njëjta. Megjithatë, vdekja e dervishit është më e tmerrshme, Haruni së paku ka pasur ngushëllim moral për atë që ka rënë viktimë e dhunës dhe e padrejtësinë. Pësoi në drejtësinë e Zotit, sepse ai atë që ia ka thënë mikut me pëshpëritje, ajo ka qenë e vërtetë. Ndërgjegjja e tij ka qenë e pastër. Ai ka mund të vdesë e të mos ketë se përse ta qortojë veten, sepse nuk ka qenë mëkat që rastësisht ka mësuar për padrejtësinë e bërë.

E ç'mund të thotë Ahmed Nuredini? Edhe ai mund të thotë se ka dëshiruar mirë. Ka pasur qëllim fisnik, të zhdukë tiranët dhe të evitojë anarkinë. Ndërsa në të vërtetë, ajo është hakmarrje, vetë atij kjo i është e qartë, dhe ai këtë nuk e fsheh para vetes. Ai e refuzon mendimin e mëshirës dhe të durimit, të cilat, sipas dëshmisi së tij islame, janë më të mira se hakmarrja. Jo, ai nuk e do këtë, ai do ta kthejë të keq me të keq, sepse kjo është e drejtë, ndërsa hakmarrja në këtë rast nuk bie ndesh me ndërgjegjen e tij. Mirëpo në ç'mënyrë?

Të mbrosh drejtësinë haptas, do të thoshte, duke pasur parasysht rrethanat, të salimentosh shumë më herët sesa t'i afrohesh qëllimit. Në këtë ai është dëshmuar. Duhet pra të shfrytëzohen mënyrat dhe mjetet me të cilat shërbehen edhe ata. Kjo rrugë është e ndytë dhe e poshtër, mirëpo së paku ofron mundësi për sukses dhe siguri relative personale. Ndonëse kjo e shqetëson, ai megjithatë vendos atë rrugë dhe zgjedh metodën dhe armët e armiqve të vet. Mirëpo, me vringëllimën e armës së njëjtë, ai e përjashton veten nga shtresa e fortë e moralit dhe e virtytit. Në të vërtetë, këtu edhe

qëndron tragjedia e vërtetë e dervishit Ahmed Nuredinit, e sa më tepër afrohet fundi, kjo shihet gjithnjë e më mirë.

Përse dervish Ahmedi nuk u qëndroi besnik parimeve të cilat i predikonte? Çdo gjë filloi me arrestimin e vëllait të tij Harunit. Kjo e ka shqetësuar, sepse vëllain ia arrestuan ata, të cilët sundonin në emër të parimeve të njëjtë që kishte edhe ai. Dëshironte t'i ndihmonte vëllait, por si, në ç'mënyrë, kur ai, si dervish, konsideronte se besimi e stolis dhe e farkon me dëgjueshmëri. Ky ishte ai hutimi tragjik i dervish Ahmedit. A thua këtu nuk kemi të bëjmë me pushtetin arbitrar të tiranit dhe me anarkinë e rëndomtë, ku qëndrimi i Kur'anit dhe ndërgjegjja janë të qarta dhe të pandërdymta. Kur'ani nuk është teori e prejardhjes së panatyrshme, që do të duhej të mbahej me anarki e dhunë. Ai kërkon disiplinë personale, por kjo nuk është tirani shoqërore. Ky është në të vërtetë problem kyç, që duhet zgjidhur? Dhe ai, Ahmed Nuredini, ka mund dhe është dashur ta dije këtë.

T'i kthehem i dilemës së tij. Ai megjithatë do t'i ndihmojë vëllait të vet si vëlla, nga ndjenjat më të larta humane dhe gjithënjerëzore. Për këtë ai pra, nuk kërkon nxitje dhe mbështetje në Kur'an. Në këtë mënyrë, këtu dervishi filloi t'i presë shtyllat e fuqisë së vet morale, të dëshmisi së vet. Këtu qëndrojnë rrënjet e tragedisë së tij edhe më të tmerrshme. Duke iu afruar qëllimit më të lartë, ai bie në situatë që të shërbehet me mjete të pahiqshme e të padenja. Ai është i vetëdijshëm për këtë, ndaj turpërohet para vëvetes. Vëveten e qorton që lëshohet në një punë kaq të ndytë, e cila do ta privonte të njoburin e tij Hasanin nga e drejta trashëguese e babait. Ngushëllohet se qëllimi fisnik do t'i fisnikërojë mjetet: për kundërvlerë, shpreson se do të fitojë lirinë e vëllait.

Ai nuk mund të qëndrojë në nivel të duhur, mjetet e ulëta e tërheqin tatëpjetë. Kur në një moment thotë se është bërë tjetër, ky është vendimi se nuk e mundon vëveten duke e qortuar që shërbehet me mjete të padenja, mirëpo ato i përdorë pa hamendje. Qëllimi është i drejtë - tani kjo për të është e mjaftueshme. Armiqve të vet u përgatit grackën, i josh dhe i tërheq ata që të bëjnë hap të gabuar, hap ky i cili do t'i shkatërrojë. Dervishi pajtohet me faktin se do të jetë fajtor, sepse në tërë këtë situatë pëson edhe miku i tij argjendar, por kjo tani për të s'është me rëndësi, me rëndësi është se njëkohësisht pësojnë edhe armiqtë e tij.

Më vonë, dervishi Ahmed si kadi mbetet i njëjti njeri, parashtrur i nënshtrohet gjendjes momentale: ai me këtë vazhdimisht

rrënon themelet e veta morale. Në vend se ta mbrojë trimërisht mikun e vet Hasanin, nëse e konsideron që kjo moralisht është e drejtë, ai përpinqet ta shpëtojë vetëm për shkak se është miku i tij. Atij i mungojnë fuqitë e brendshme. Ai i tërë është ngatëruar në intrigat dhe ndërkëmbjet njerëzore. Prandaj shkatërrimi bëhet i pashmangshëm.

Fatkeqësia e tij qëndron në çështjen se rrëthanat e caktuara e kanë tërhequr dhe e kanë futur në ngjarje që ndodhin jashtë teqesë, ku ai nuk ka pasur forcë të përdorë masën e vet morale të Kur'anit. Mendoi t'u përshtatet rrëthanave, kurse pësoi në absurditet shpirtëror pa shtegdalje.

#### IV

Çështja e arsyetimit, e kuptimit dhe e qëllimit të jetës e mundon njeriun e ditëve tona. I vetmi është besimi që i ofron përgjigje. Ne gjëzohemi se ideja e humanitetit po ia hap rrugën vetes, sepse nëse njeriu është i singertë ndaj vvetes, kjo rrugë do ta shpie në besim. Nuk ka rrugë tjetër! Vetë humaniteti është lule e bukur, por është bimë e dobët, e cila duhet të ketë truall që të përforcohet për të dhe, nga ai truall të thithë fuqi dhe ushqim. Ky truall mund të jetë vetëm feja. Ne duhet të mbështetemi për besimin si për spirancën, sepse besimi është mbështetje e sigurt nga shtrëngata bashkëkohore që i kanoset njeriut për t'ia marrë mendtë dhe ndjenjat e ta shpie në rrugë pa shtegdalje. Kur'ani thotë: "*Ai që beson dhe bën vepra të mira, atë e presin falja e mëshirshme dhe mirëqenia.*"

Pra, a ështëjeta e pakuptimitë dhe a është bilanci i çdo njeriu, pa marrë parasysh se në ç'rrugë ka ecur, gjithmonë edhe pa kusht negativ? Në këtë pyetje, që nuk është vetëm pyetje e dervish Ahmed Nuredinit, por e shumë miliona njerëzve në çastet e dëshpërimit, përgjigjemi si gjithherë me Kur'an:

*"Pasha kohën! Nuk ka dyshim, njeriu është në një humbje të sigurt, me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm."* (sureja 'Asr)

## DISA FJALË PËR XHAMITË TONA\*

Në saje të asaj që dimë për të kaluarën e njerëzimit dhe për natyrën njerëzore, mund të përfundojmë se faltoret janë ndërtesat e para publike të gjinisë njerëzore. Kjo është krejtësisht e kuptueshme. Njeriu është qenie e pajisur me ndjenja dhe me vetëdije në praninë e një bote të papeshuar, botë që ekziston jashtë shqisave tona. Faltoret janë shprehje e besimit të njeriut. Në to pasqyrohet shpirti i tij, botëkuptimi i tij ndaj jetës dhe ndaj vdekjes. Përfundimisht, kjo kështu duhet të jetë. Besimi është njëri nga përjetimet më të nevojshme dhe më emocionuese të qenies njerëzore. Ai është unikat në natyrë. Ai nuk ndeshet askund gjetiu. Kur'ani thotë se ndër të gjitha krijesat e Zotit, vetëm njeriu e pranoi amanetin e besimit.

Edhe xhamitë tona bëjnë pjesë në kuadër të konceptit të përgjithshëm, *faltore*. Mirëpo, çdo bashkësi i jep faltores tipare të veta të veçanta, që e karakterizojnë atë, mësimin e saj, botëkuptimin e saj, besimin e saj. Prandaj, këto faltore edhe dallohen aq shumë ndërmjet tyre. Kjo vlen edhe për xhamitë tona në krahasim me faltoret tjera.

Ka faltore të stolisura dhe - në kundërshtim me këto - ka edhe faltore të thjeshta, të errëta dhe të ndritshme, dhe më në fund ka edhe të atilla, të cilat lënë përshtypje të keqe në ne, edhe pse sigurisht këtë nuk e kanë dëshiruar ndërtuesit e tyre. Të gjithë ata dë-

\* Është publikuar (diç në vëllim të shkurtuar) në Glasnik BI nr. 5. 1987, Sarajevo.

- Këtu është fjala për xhamitë boshnjake, meqë autor i është me përkatësi boshnjake, ndaj lexuesi shqiptar vëren tiparet e përbashkëta, por mund të hetojë edhe tiparet e veçanta me xhamitë në trojet shqiptare. (Shën. i përkthyesit).

shirojnë të lënë përshtypje të mirë, mirëpo, janë të paktë ata të cilët e arrijnë këtë qëllim.

Çfarë janë xhamitë tona? Çfarë do të duhej të ishin ato dhe në realitet a u përgjigjen kërkesave të veta? Për këtë ka se çka të thuhet. Xhamia duhet të *plotësojë kërkesat ideore të Islamit*, pastaj *nevojat funksionale*, dhe më në fund edhe *përshtypjet estetike*.

Nëse thelloheni në një analizë më të përimëtuar, do të shihni se sa të meta kanë xhamitë tona, madje kanë edhe gabime, që duken sheshazi. Do t'ju befasojnë vërejtjet dhe të metat e shumta të tyre.

## I

Parimisht, xhamia është vendi ku besimtari duhet të ketë mundësi të përqëndrimit të plotë në një mendim dhe në një disponim të papenguar prej askujt.

Prandaj, në radhë të parë, duhet të realizohet ndarja e saj nga bota e jashtme. (Natyrisht, këtu nuk duhet shikuar kurrfarë simbole, sepse Islami nuk ndërpren lidhjet me rrjedhat e jetës as nga aspekti ideor e as nga aspekti emocional, madje, - këtë duhet theksuar - nuk lejon që këto rrjedha të ndikojnë në pastërtinë e mendimeve religioze, por vetëm në rrjedha të kundërtta.)

Këtu duhet të krijohet atmosfera e qetësisë. Xhamia duhet të krijojë përshtypjen e hapësirës dhe të lirisë-mungesën e çfarëdo shtrëngimi dhe ngushtimi.

A duhet thënë këtu se xhaminë duhet bërë të bukur? Ndoshta më mirë është të thuhet: Mos e bëni të shëmtuar! Filloni më parë nga pastërtia ideore: çdo gjë që pengon pastërtinë e mendimeve dhe të ndjenjave islame – Islami e quan të shëmtuar dhe të neveritshme. Këtu besimi ynë është i pakompromis. Për shembull, do të ishte e papranueshme ta rregullojmë xhaminë ashtu siç i rregullojnë falotret e veta disa kitabije. Fotografitë, afreskat apo shtatoret janë plotësisht të kundërtta me mendimet islame. Ajo që në këto gjëra shumë njerëz kanë parë dhe shohin vlera artistike, historike dhe materiale, ato tek All-llahu xh.sh. nuk kanë kurrfarë vlere. Ai gjërat e këtilla i ka konsideruar të shëmtuara dhe të neveritshme. Prandaj, xhamitë tona janë të pastra nga këto gjëra dhe-falënderojmë All-llahun! - të tilla le të jenë.

Kështu, në këtë mënyrë mund të kaloni në cikërrima. Mos futni në to gjëra të këqija, duke menduar se me to do t'i bëni xhamitë më të bukura.

Xhamia duhet të krijojë ndjenjën e hapësirës dhe të lirisë: mungesën e çfarëdo shtrëngimi e ngushtimi. Ajo duhet të jetë e ndritshme, pa kurrfarë dekorimesh të theksuara dhe pa kurrfarë hollësish specifike që bien në sy. Errësira dhe zymtësia janë të huaja për Islamin. As tepër shkëlqim drite që të lodhë, e as hije të errëta. Asgjë e jashtëzakonshme nuk duhet ta preokupojë faltarin, e as ta pengojë në namaz. Ky është thelbi i kërkuesës. Faltari duhet të jetë i preokupuar vetëm me namazin e vet, të jetë kthyer nga vetvetja, ndaj asaj që ka në zemër, që ka në shpirt. Të gjitha efektet (e këtu tregojmë për të jashtmet) që e pengojnë këtë, janë gabim.

Në xhami nuk duhet ta hetojmë as të ftoftët as të nxehjtët. Më e përshtatshme do të ishte temperatura rrëth  $20^{\circ}\text{C}$ . Xhamia duhet të jetë e ajrosur, pa erëra të forta dhe kundërmuese. Nuk duhet hetuar as fortësia e dyshemesë.

Kur të filloni të ankoheni për disa të meta dhe gjëra të pakëndshme në xhami, shpesh merrni përgjigjen se si aty, në ato kushte, është më sevap të faleni. Këto janë mendime xhahile, të atyre që nuk e kuptojnë thelbin e Islamit. Njeriu nuk duhet t'i trillojë vvetvetes hidhërimë dhe sprova. As nuk ka të drejtë në këtë.\* Ti lirisht rregulloje mënyrën më të rehatshme të jetës dhe vendin për namaz. Edhe vetes edhe tjetrit. Dhe falëndero Zotin xh.sh. për këtë. Ndërsa sa u përket vështirësive dhe sprovave, All-llahu nuk do të na lë pa to, të atilla dhe aq sa vendos se janë për ne. Sa është serioze kjo, shihet nga ajo se All-llahu na udhëzon në Kur'an, Ta lusim që të na dhurojë fuqi për sprovat e Tij, gjegjësisht Ta lusim të na kursejë nga sprovat që nuk mund t'i përballojmë.

Kështu pra, xhamia nuk duhet të na largojë me asgjë; kjo është kërkesa themelore e cila përputhet me mendjen njerëzore dhe me ndjenjat natyrore.

E tani një hap më tej, një hap i madh, që xhaminë në detaje dhe në tërësi ta bëjmë sa më tërheqëse, me faktin që tërësinë ta bëjmë të lehtë, elegante, të bukur. Fatkeqësisht, kjo është e rrallë, shumë e rrallë - shumë më e rrallë se sa që mendojmë - në kuptimin individual.

Përkundër rasteve të këtilla, kemi njerëz të shumtë, të cilët pa marrë parasysh qëllimin e mirë të tyre, shpesh bëjnë gjëra të privuara qoftë për çfarëdo nevoje reale dhe bashkë me të pothuaj rregu-

\* Shih Sahihul-Buhari, përkthimi i Hasan Shkapurit, botues OIZ, Prijedor, Sarajevo, 1974, lib. III, fq. 75.

llisht të degraduara nga çfarëdo mendimi estetik, ndërsa nganjëherë largohen dukshëm nga ndonjë qëndrim islam. Dhe kjo ka ndodhur në shumë xhami. Në të vërtetë, këto janë bukuroshe të cilat më vonë i kemi shëmtuar. Shembuj të tillë kemi në çdo hap.

Vërtet, shumica e xhamive nga largësia lënë përshtypje të mirë. Bardhësia në gjelbërim. Harmonia. Mbizotërojnë rrëth e përqark. Veçanërisht minaret shtathedhura, duken sikur heshtarët në rojë. Minaret janë traditë. Sot janë simbol. Sipas tyre edhe i njihni xhamitë.

Mirëpo, kur i afrohemë xhamisë, përshtypjet ndërrohen: gjeni gjithçka që ju pengon. E ngreni kokën nga sherifja e minares-dhe e para mbresë e pakëndshme: altoparlantet, prodhim i shekullit tonë të njëzetë, por që varen rrëth sherifeve të ndërtuara dhe të zbuluar në shekujt e kaluar. Disharmoni e plotë. Kjo shihet edhe në xhami. Nga çdo anë mikrofonët, telat, altoparlantët.

Të kuptohemi: sot askush nuk është kundër asaj që këto të arritura të teknikës të shfrytëzohen në xhami. Aq më tepër, këto janë të nevojshme. Vërejtja qëndron në këtë: të gjitha këto vendosen pa kurrfarë rendi dhe pa kurrfarë shije, ndërsa do të duhej të inkorporoheshin në mënyrë të pahetueshme.

Një e metë e këtillë jona për prirje të vlerës nuk është kurrfarë risie. Kjo e metë është vazhdim nga e kaluara. Shembull didaktik është xhamia e Ferhad-pashës në Banjallukë. Në luftën e kaluar një bombë aeroplani ra përskaj xhamisë dhe shkaktoi disa prishje. Kur u evituan prishjet dhe u pastruan rrënimet, për befasi të madhe, xhamia u shfaq me bukurinë e vet të plotë. Ç'ndodhi - dikush dikur moti, ndërtimit origjinal të xhamisë i shtoi dhe i plotësoi ndonjë përmirësim në ndërtim. A ishte vërtet kjo e nevojshme, kjo nuk është me rëndësi, por është me rëndësi se si ne e bëjmë këtë shtesë me shumë pak ndjenja estetike dhe me shumë pak përgjegjësi.

Ne e dimë se çdo xhami është ndërtuar si tërësi arkitektonike. Mirëpo, shumë xhami nuk janë më të këtilla.

Gjithçka ndodh me to. T'uua përkruaj një xhami. Është tipike. Ndodhet në qendër të Sarajevës së vjetër, në Bashçarshi. Sipas gjasave, pozita e saj e dikurshme nuk është dukur e këtillë, mirëpo me zhvillimin e qytetit u gjet në qendër të rrugëve qarkulluese. Nuk ka as oborr as harem. Në të janë mbathur dofarë dyqanesh dhe qepengash. Supozoj se këto dikur kanë qenë hajrate-vakëfe. Në xhami, nëpër korridor me gjatësi disa metra shi hyhet drejtpërdrejt nga rruga. Ju pret një gjysëmerrësire dhe një kundërmim i ajrit të amu-

lluar. Hetohet sheshazi se xhamia nuk ajroset fare. Mendohem, kur mund tē jetē bërë kjo herën e fundit. Nē rastin mē tē mirë nē fund tē shekullit tē kaluar. Jo, mos mendoni se po bēj shaka. Dritaret pērdhese nuk keni si t'i hapni. Ndërsa ato tē epërmët janë tē ngritura shumë lart, dhe pa marrë parasysh këtë, nuk mund tē hapen fare. Shikoj nēpér muret e xhamisë. Janë tē mbuluara me levha (pllaka tē shkruara) tē shumta. Krejt njëra pas tjetrës. Shikoj secilën veç e vec. Ka tē atilla që haxhilerët tanë i kanë sjellë që nga Mekka, edhe pse tē tilla mund tē blini menjëherë aty rrëth xhamisë. Nuk ndjehem mirë. Diç mē pengon. Ju ndoshta mē qortoni: “O njeri, a ke ardhur ti tē falesh nē xhami apo t'i shikosh levhat? Pikërisht këtë pyetje ia shtroj vetvetes dhe vetvetes i përgjigjem. “E pérse mos t'i shikoj? Pérse janë varur këtu?”

“O njeri, a je ti kundër levhave?”

“Nuk jam, por kjo që po bëjmë humb kuptimin e vet tē plotë. Kjo nuk është ekspozitë.”

Çdo teprim shpie pikërisht nē drejtim tē kundërt nga ai që dëshirohet. Kjo është ligjshmëri e jetës sonë. Nē Islam kjo është e njobur mirë. Islami është besim i matur, besim i harmonisë dhe i baraspeshës.

Në shumësinë e levhave tē vogla, çdonjëra veç e vec humb; nuk i vërejmë, ndaj edhe nuk na nxisin që tē dimë rëndësinë e tyre. Do tē ishte shumë më mençuri: nē një mur tē vihet një levhë e madhe, e cila flet p.sh. pér ata, që besojnë dhe pér ata që bëjnë vepra tē mira.

Në Kur'an ajetet e këtilla janë tē shumta. Pastaj sipas numrit vijnë ato ajete, tē cilat krahas namazit madhërojnë edhe zeqatin. Një ajet i këtillë do tē vihej nē murin tjetër. Edhe një ajet i përshtatshëm, i cili do tē binte nē sy nē dalje tē xhamisë. Këto do tē ishin tē mjaftueshme. Kështu, disa mendime kur'anore, që nuk kanë humbur nē dekorimet e xhamisë, e as nē shumësinë e tyre, do tē tertiqin nē vete kujdesin. Pikërisht nē këtë drejtim, do tē duhej synuar. Me këtë do tē karakterizonin vendin se ku gjenden, ndërsa vetveti do tē bëheshin nxitje pér besimtarin.

Hyj nē një xhami tjetër. Posa është meremetuar përbrenda.

Në shikim tē parë hetohet se meremetimi ka kushtuar shumë. Ndërsa nē mes tē xhamisë dominon një rrëth unazor i varur pér kùpën e xhamisë me tela tē shumtë. Kushedi se kur është vënë aty? Askush nuk vendos ta heqë. Mbështetje ka fituar statusin e antikitetit. Ndërsa, krejtësisht është i panevojshëm: nuk shërbën pér diçka. Së

paku sot. Ai rreth nuk është kurrfarë origjinaliteti. Për shembull, rreth të njëjtë, por vetëm më të madh mund ta shihni në qendër të Stambollit, në njérën nga xhamitë më të mëdha. Keni një ndjenje shumë të pakëndshme, sikur t'ju shtypë njëfarë rrjete. Nuk është çudi, në përmasa të xhamisë së madhe dhe kupës së saj të lartë, ajo qëndron menjëherë mbi kokën tuaj. Ta keni të qartë se kjo ndikon aq shëmtueshëm, sepse ky nuk është përfytyrim origjinal i ndërtuesit të xhamisë. Është në disharmoni të plotë me tërë godinën arkitektonike. Rrjeta është menduar më vonë si bartëse e kandilëve të shumtë për të shtuar ndriçimin në raste solemne, në mubarek-netët. Do të thotë se dritat ekzistuese, të vëna nga ndërtuesi, u janë dukur të pamjaftueshme.

Ktheni shikimin në xhamitë tona më të mëdha në drejtim të mihrabit (vend i veçantë). Ju bien në sy ata kandilë të lartë, forma e të cilëve duhet t'ua përkujtojë formën e qiririt, që përfundojnë në llamba elektrike të topave të qelqtë ngjyrë qumështi. Që të sigurohej stabiliteti i tyre, me shufra hekuri janë fiksuar për muri. Dhe... vetëm shikoni se sa pa shije duket kjo. A thua sot, në mundësitë e sotme të ndriçimit, mund të qëndrojnë zgjidhje kaq të këqija?

Ndoshta dikush do të thotë: "Ama, more burrë i dheut, mos shit mend! Ne nuk mund çdo xhami ta stolisim me kristal dhe ta shkrijmë në argjend dhe ar" - Jo, as këtë! Kush kritikon kështu, atëherë ne mund të themi se nuk jemi marrë vesh mirë. Një stolisje e këtillë e xhamisë është gabim. Nëse dëgjoni se si diku larg ndonjë sheik i pasur i ka dhuruar diku në botë ndonjë xhamie të ndërtuar rishtaz, llambadar të kristaltë të stolisur me ar, dijeni që më parë se ky është gabim. Ç'ju duhet juve: ndriçimi apo kristali i pasur, i cili ua josh shikimin? Së paku sot është e mundshme të ndriçohet xhamia, kurse burimet e ndriçimit as mos t'i vëreni. Dhe të veprohet kështu është shkëlqyeshëm. Ndërsa xhamitë tona ne i ngarkojmë me imtësira të cilat na e tërheqin vërejtjen. Pjesët duhet të jenë pjesë të tërësisë, ato duhet të humbin në tërësi, të shkrihen në të, e jo të thërrmohen dhe të ndahen nga ajo, qofshin edhe ato imtësi që çmohen si të bukura ose të çmueshme. Nuk janë të papërshtatshme vetëm ato gjëra, që janë të shëmtuara në kuptimin estetik.

Sot xhamitë janë të mbuluara me gjëra të shtrenjta, por bisedoni me faltarët dhe do të befasoheni se sa dhe në ç'masë i pengojnë ato në namaz, larmia e ngjyrave dhe e formave. Njëri më tregon: "Shikoj para dhe mundohem të thellohem në mësimin e imamit, por djalli nuk më lë të qetë. Nuk di ç'të bëj me sytë. Ngado që të shikoj,

shoh lara dhe figura që më imponohen me praninë e tyre. Nganjëherë shihen-thjesht m’i shpojnë sytë - simbolet e religjioneve tjera.”\*

Janë të pakta xhamitë, si për shembull ato të mëdhatë stambolliane, të cilat janë të shtruara me qilima njëngjyrësh, qëllimi sh të qethur në lartësi të njëjtë, pa rrudha dhe pa figura, me shirit të vencantë si shenjë ku do të formohen safat. Sa thjeshtësi ka këtu! Kjo të impresionon. Kjo është cikërrimë, por i jep fuqi një mendimi. Me pak mund kjo mund të realizohet në çdo xhami. Njerëzve, të cilët i dhurojnë xhamisë shtrojë, mund t’u shpjegohet se në çka duhet të mbështetet kjo kërkesë.

Edhe diçka: Qilimi nuk duhet të shtrohet në dyshemenë e thatë. Që t’i iket vrazhdësisë dhe fortësisë, dimrit edhe të ftohtit - kjo mund të realizohet sot me efikasitet dhe me çmim të lirë: sfungjer plastik me dendësi më të madhe, më i qëndrueshëm, por më i hollë. (Më i trashë e me dendësi më të vogël do të shkaktonte jostabilitet gjatë lëvizjes).

Edhe më mirë do të ishte sikur të përdoreshin rrogozët (hasrat) tradicionale të thurura trashë nga fletëzat e buta të misrit, të cilat mund të hasen edhe sot në shumë xhami të botës islame.

Shumë xhami kanë aq halia (qilima) saqë mund të shtrohen njëra mbi tjetrën. Kështu edhe duhet vepruar në vend se të mbahen të paluara nëpër qoshe, ose është mirë të dërgohen në xhamitë tjera, të cilat nuk janë të pasura me to.

## II

Jo fort moti jam njojur me një njeri dhe në bisedë me të për problemet tona kam mësuar se si, derisa ishte jashtë, ka marrë pjesë në një ligjératë të një misionari të krishterë. Misionari përkatës paraqiste rrëthanat në një shtet të madh musliman në të cilin ka vepruar. Vështirë është të lirohem nga përshtypja se misionari nuk ka qenë tendencioz? Ndër të tjera, tha se mihrabi, të cilit i luten muslimanët është idhull. Deklaratat e këtilla, pa marrë parasysh a janë fryt qëllimkeq apo mosnjohje e Islamit, mund vetëm ta fyejnë dhe ta hidhërojnë besimtarin. Mirëpo, mund të llogarisim në këtë: nuk duhet pritur gjithmonë objektivitetin, madje mund të jetë fryt i mosnjohjes dhe i shpjegimit personal të asaj që ka parë. Mirëpo, ne duhet të kemi qëndrim të drejtë. Edhe përgjigje të drejtë. Kjo është

\* Se vërejtjet e këtilla nuk janë pa bazë shih Sahilul Buhari, lib. I, f. 335-336.

rregull. Në çdo gjë. Nëse dikush flet keq për ju, duhet më parë ta analizoni veten: me çka i keni dhënë shkas për diçka të këtillë, e pastaj të shkoni më tej.

Merrni me mend nëse në xhami sillni një njeri plotësisht të painformuar. A nuk keni frikë se ai njeri mund të fitojë parafytyrim të gabuar për Islamin?! Kuptohet se këtë nuk e dëshironi. E përse atëherë i ngarkoni xhamitë tona në atë mënyrë që ta shpieni në përfundime të gabuara. Ma tregoni xhaminë, posaçërisht mihrabin e saj, që ndriçon me thjeshtësinë islame. Pak janë të tilla. Kryesisht shihni gjëra të ndërlikuara, ngjyra të forta, gjithmonë vetëm dekorime dhe trajta, e të gjitha së bashku janë të tepërtë. Në vend se ta ndjekim thjeshtësinë, ne bëjmë të kundërtën.\*

Një shok nga provinca më rrëfen: "Një të premte shkova në xhaminë time (në të cilën e fal xhumanë), por e gjeta të mbyllur. Thanë: "Gëlqeroiset!" U gëzova. Tanimë ishte koha për këtë, u gjetën të holla. Dhe nuk ishin ato pak para. Mendohem: "Falë Zotit, ka akoma hajr-sahibi." Të premten e dytë, xhamia përsëri e mbyllur. Ka këtu punë! Gëzohem që më parë. Të premten e tretë... Nga larg e shoh se është e hapur. Nxitoj me vrap. Pernjëherë, sikur më godet dikush në kokë. Nuk mundja të vijë në vete nga habia. Ngjyrat! Ngjyrat! Ngjyrat! Ishin ngjethëse. Përpinqem t'i mbledh mendtë: ndoshta kjo mua nuk më pëlqen, por marrë në tërësi, ndoshta nuk është keq. Ndoshta të tjereve u pëlqen. Vërtet mendoj, a thua ç'mendojnë të tjerët? Sillen sikur mos të kishte ndodhur asgjë. As bardhë, as zi! Ndoshta ata nuk duan ta tregojnë dëshpërimin e vet, nuk duan ta fyejnë askënd, nuk duan t'i nënçmojnë sakrificat dhe mundin e huaj. I kthehem në mendime vvetvetës. E pyes veten: a mos jam mashtruar në përshtypjen time të parë. Por megjithatë, unë nuk mashtrohem. Vërejtja e parë: Cilat kanë qenë ngjyrat origjinale të kësaj xhamie? Për të, sigurisht, askush më nuk ka haber. Pothuaj është e pabesueshme se kjo ka qenë diku e shënuar, por me siguri mund të pohoni se kështu e ngjyrosur nuk ka qenë. Dhe tash merrni me mend godinën disa qindra vjet të vjetër dhe kic ngjyrën moderniste, t'i vret sytë... Këto nuk shkojnë bashkë."

Shtroj pyetjet si ka mund të ndodhë kjo. Ndoshta edhe ata nuk i kanë punuar shkel e shko. Kanë pyetur për mendimin e ndonjë eksperti. E ky i ka këshilluar, ja pikërisht këtë. Si duket e ka ndier se propozimi është jo i rëndomtë - qoftë i atij vetë, qoftë i bashkëbi-

\* Shih Sahihul-Buhari-përkthim i Hasan Skapurit, lib. I fq. 385.

seduesve të tij - sepse ai ka dhënë, përafërsisht, arsyetim të këtillë. "Lutja qetëson, ndaj është e nevojshme si kundërpeshë të ofrohet ambienti që gjallëron."

Duket sheshazi se këtij eksperti - pa marrë parasysh tërë profesionalizmin e tij dhe sigurisht qëllimmirësinë e tij - fryma e besimit i ishte e huaj. Ai nuk kishte sens për mendimin islam. Xhamia nuk është kafene. Asaj nuk i nevojiten elementet që nxisin, që shqetësojnë, që zemërojnë. Është e vërtetë se lutja qetëson, por kjo nuk është vdekje e ndjenjave, siç thanë shumë të tjerë të sojit të tij.

Besimi do të thotë paqe, qetësi shpirtërore. Pikërisht në xhami nuk duhet të gjenden kurrfarë elementesh që e prishin këtë qetësi. Duke bërë ndarjen në vija të trasha pa stërhollime dhe pa cikërrima, shohim se Lindja religjioze kaherë e kuptoi fatin si arritje të kësaj qetësie për dallim nga Perëndimi i materializuar, i cili konsideronte se fati gjendet në plotësimin e stimulimit dhe të nevojave materiale. Kushtoni kujdes fjalës islame *selam*. Ajo ka kuptim karakteristik: paqe dhe shpëtim.

Shpeshherë nuk është i mjaftueshëm qëllimi i mirë dhe sakrifica. Është e nevojshme të kesh ndjenjën për një manifestim të mirëfilltë islam.

Në një qytet të krahinës sonë vërej një xhami. Tërheq vërejtjen në vete. Ajo është objekt i dashurisë, i përpjekjeve dhe sakrificave kryesisht të një njeriu të vetëm. Kjo duhet pranuar, kjo është aq e dukshme. Xhamia dallohet nga përsosuria e saj e jashtme, nga oborri, haremi dhe nga brendia e saj. Mirëpo, disa fjalë kur'anore të gdhendura në dru në gjuhën boshnjake, të shkruara me alfabet latin, ndikojnë ashtu që të shtangin. Merreni me mend, xhamia e ndërtuar para 400 vjetësh dhe - alfabeti latin! Mirëpo, pa marrë parasysh ç'mendojmë ne për këtë, së pari (ose, ndoshta së fundi), ç'do të thoshte për këtë vetë themeluesi i xhamisë?

Pa bërë hulumtime të mëdha mund të parandjeni se si ka ndodhur një veprim i këtillë i pashije: njeriu i impresionuar me ajetet e caktuara kur'anore ka dashur t'ia afrojë të pranishmit, ndaj e ka parafytyruar në këtë mënyrë. Megjithatë, këtë nuk është dashur ta bëjë këtu dhe në këtë mënyrë. Duhet pasur masë në gjithçka! Nuk duhet magjepsur, e pastaj të harrohet ajo për të cilën duhet të kemi kujdes të veçantë.

Kalimthi po shtojmë: Përvoja ka dëshmuar se levhat e rëndomta të shkruara me shkronja të mëdha arabe plotësisht e durojnë përkthimin në gjuhën tonë (boshnjake) si shtojcë të shkruar me shkron-

nja të imëta (të dukshme vetëm kur i afroheni), të alfabetit tanimë të zakonshëm për nevojat tona të përditshme. - Do të ishte e pranueshme (madje edhe më tepër se kjo!) sikur përkthimi të ishte i shkruar me arabikun (e Çausheviqit) mirëpo, fatkeqësisht me zhvillimin e ngjarjeve ky shkrim, në praktikën tonë krejtësisht është nxjerrë nga përdorimi, ashtu që popullit musliman sot i është krejtësisht i panjohur.

Duhet të ruhem i nga synimet që me çdo kusht të bëjmë diç të re, duke konsideruar që kjo njëkohësisht do të jetë edhe atraktive. Xhamia ka fizionominë e vet si rezultat i përvojës njëmijekatë-qindvjeçare. Të mos kemi kujdes për këtë, do të thotë t'i ekspozohemi rrezikut.

Shembull drastik është xhamia moderne në Visoko, ndërtimi i së cilës po zgjat me vite të tëra. Derisa jemi duke e shkruar këtë artikull, ajo ende është në ndërtim e sipër dhe fundi nuk mund t'i parashihet. Mirëpo, më e pakëndshme është ajo se gjithnjë e më tepër po lë përshtypje se ajo do të jetë një dështim.\* Shikoni vetëm se si do të duket minarja! Kujt duhet t'i shërbejë kjo godinë moderne? Shikoni përbrenda atë mur të pjerrët. Shumëkush ankohet për një ndjenjë të pakëndshme, sikur në atë moment do të rrënohet mbi ta. Funksionalist - e panevojshme edhe njëra edhe tjetra, në aspektin estetik me vlera të dyshimita, ndërsa në raport me traditën nuk përfaqëson asgjë.

Gjatë ndërtimit të xhamive shpesh lihen pasdore elementet tona tradicionale, ndërsa futen elemente të huaja. Se kujt i jepet plani ideor, kjo bëhet pa kurrfarë vlerësimi kritik. Njerëzit sillen sikur i vetmi problem janë mjetet financiare. Ata mendojnë: "Të hollat dhe ekspertët dhe çdo gjë do të jetë në rregull." Është e vërtetë se ndërtuesi duhet të jetë ekspert, por jo vetëm kaq, ai duhet t'i njo'hë pikëpamjet fetare dhe qëndrimet e bashkësisë për të cilën punon dhe t'i respektojë gjatë punës. Përndryshe, nuk është gjë e rrallë që të ndodhin befasit të pakëndshme. Është rast didaktik xhamia në Kllopcë te Zenica. Një ditë në maje të xhamisë në tërë gjatësinë e saj, si skaj stolisës u paraqitën elemente krejtësisht të huaja dhe të kundërtat me Islamin. Natyrisht, është dashur të ndërmerrin punë të reja që të evitohen këto.

\* Ky artikull u shkrua në muajt e parë të vitit '80. Parandjenjat e këqija të shumëkujt, më vonë u treguan plotësisht të arsyeshme.

Dritaret janë elemente të dukshme që nga largësia. Organizimi ndërmjet tyre, madhësia dhe trajta - këto nuk janë gjëra të dorës së dytë. Shpesh hetojmë se diç nuk është në rregull me to, por nuk dimë si ta shpjegojmë këtë. Ndërsa puna qëndron në pamjen e tyre estetike, që nuk është lehtë të definohet. Kjo është më tepër çështje e sensit. Mirëpo, shpesh bëjmë gabime të mëdha dhe të dukshme. Që t'ishmangemi këndit të tyre të thjeshtë në formë të drejtë, i ndajshohet harku. Na janë mirë të njohura disa prej atyre stileve, me të cilat na kanë njoftuar derisa kemi qenë në bankat shkollore, siç janë stili romak dhe stili gotik. Ndonëse, në mesin e botës sonë të arsimuar, e veçanërisht në mesin e shtresave të gjera, është e panjohur (me këtë nuk na kanë njoftuar në shkollë), se ekziston i astuquajturi hark islamik. Kjo është figura e prerjes së qepujkës! Përafërsisht gjysmërrethore, e cila në fund kthehet në maje të mprehtë. E tërë arkitektura islame e së kaluarës është e pasur me këtë element stilistik, dhe kjo edhe sot mund të shihet te bujtinat e vjetra e të ruajtura, te qoshet, shtëpitë e bejlerëve, e jo vetëm te xhamitë. Harku islamik ka vlerë të pranuar të përgjithshme estetike. Megjithatë populli ynë nuk di për këtë, e meqenëse pjesa dërrmuese nuk di fare për të, ndaj kjo as nuk kërkohet që të zbatohet në xhamitë e ndërtuara rishtaz.

Të themi kalimthi, për një rast interesant, për të cilin para disa vjetësh është shkruar në shtyp, kur një arkitekt në Novi-Pazar me sukses harmonizoi pamjen arkitektonike të shumë ndërtimeve të reja me ndërtesat tradicionale të atij vendi. Kjo nuk kushtoi aq sa u fitua. E gjithë kjo joshi syrin e njeriut dhe "qetësoi" shpirtin. Komëtimi i përgjithshëm ishte i shkurtër dhe i qartë: "Bukur!" Si e këtillë nuk ka mundur të mos bie në sy. Lidhur me këtë do të duhej të mendonin. Ky arkitekt nuk ishte musliman, megjithëse i ka munguar një komponentë - ai prapëseprapë i ka kuptuar cilësitë e artit islamik dhe e ndjeu esencën e tij. Përveç faktit se kishte prirje ndaj tij, ai duket qartë se edhe vetë ishte artist. E kjo flet shumë. Ne do të duhej të lejonim që xhamitë të na i ndërtojnë njerëz të sprovuar dhe të dëshmuar në këtë punë, e jo vetëm t'i plotësojnë kushtet nga aspekti teorik. Është lehtë të thuhet: "Duam që xhamia t'u përgjigjet kërkuesave të këtilla e të këtilla!" Por, për ta bërë të bukur është i nevojshëm jo vetëm njeriu ekspert, por diç edhe më tepër, njeriu artist. E të këtillët gjithmonë kanë qenë të paktë. Në kohën e sotme të ndërtimit masiv të pakta janë objektet që do të mund t'i quanim të bukura. Të gjithë ne e ndjejmë se sa na lordin ndërtimet bashkë-

kohore. Janë tē paqarta dhe vuajnë nga pamje tē njëjta. Fizionominë e tyre nganjëherë e kanë edhe xhamitë e reja.

E shikojmë një tē tillë, brendinë e saj. Krejtësisht e thjeshtë, pa dekorime, mirëpo vijat e saj janë pa kurrfarë elegance dhe pa kurrfarë hijeshie, ndaj ndikojnë rëndë. Për ndërtim, si edhe në rastet e shumta, sot përdoret çimentoja dhe elementet betonike. Për këtë ka diktuar fizionomia e saj si zgjedhje më e lehtë. Duhet tē lirohem i nga kjo. Dritaret - me hapje katrore. Mihrabi - i futur në kornizë tē këndit brimprehtë.

Është e vërtetë se duhet shmangur kësaj. Nuk është as kjo për xhami. Xhamia nuk është magazinë. Njeriun e habisin trajtat e vrazhda tē betonit pa jetë.

### III

Derisa kërkosat funksionale dhe estetike u nënshtrohen analizave, deri atëherë morali ideor do tē jetë jashtë diskutimit. Këtu nuk duhet tē ketë divergjenca. Ato janë tē qarta. Megjithatë paraqiten gabime. Ato janë evidente. Shumëkush i tregon ato.

Sikur kjo tē ishte ndonjë rregull, përballë emrit të All-llahut, në njérën anë tē mihrabit, në tē njëjtën lartësi, në anën tjeter shohim emrin Muhammed. Mund tē shihen edhe *levha* tē këtilla. Ç'mund tē përfundojë një njeri i paudhëzuar nga kjo? Mos thuani se: "Po ne këtë do t'ia shpjegonim!" Nuk kemi tē bëjmë këtu me shpjegim, por si t'ishmangemi dykuptimësisë dhe përfundimit tē gabuar. Mendojmë se gjykatës është personalisht Resulull-lahu a.s. Ç'mendoni, a do tē pajtohej ai që emri i tij tē përmendej krahas me atë tē Zotit? A thua thelbi i pejgamberllékut tē tij nuk ishte dhe nuk mbeti: Me All-llahun asgjë s'është krahasuar, e kjo as që mund tē bëhet. Sikur Resulull-lahu tē ishte në mesin tonë, ai do tē bënte sexhde me ne dhe do tē na udhëhiqte me fjalët: "All-lahu ekber!."

T'i mbetemi besnikë mendimit islam! Do tē ishte e preferueshme që në vetë hyrjen mbi derë, mbi tarihun e rëndomtë tē xhamisë, tē qëndrojë dukshëm e shkruar "*Esh-hedu en la-ilahe il-la-llah ve esh-hedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu*" (natyrisht, e shkruar me alfabet arab). Do tē ishte efikase dhe kuptimplotë, si përvizitorin e dëshmuar po ashtu edhe përvizitorin kureshtar. I gjithë mendimi islam është përbledhur në tē. Ai na prezanton edhe qëndrimin tonë edhe tē Resulull-lahut ndaj All-llahut. Në vetë xhaminë do tē mjaftonin disa prej ajeteve kur'anore (siç kemi zënë

ngojë edhe më parë) dhe levha e rëndomtë “*La ilah il-lallah Muhammedur-resulull-llah.*”

Jo fort larg nga Sarajevo, në qytezën e vogël hyj në xhami. Është ndërtuar jo fort moti. Shikoj brendinë e saj. Ngre shikimin në drejtim të kopolës së lartë. Kalimi ndërmjet mureve të xhamisë dhe bazës së kopolës është bërë në trajtë të shumëkëndëshit, kurse në të (do të thotë në tërë gjatësinë e këtij shumëkëndëshi) e shkruar Ajetul-kursija. E shkruar me harfe të bukura e të lehta për lexim, në organizim të bukur të dimensioneve të xhamisë. Më la përshtypje të thellë. Pa kurrfarë vërejtjeje! Mjeshtërisht e realizuar!

Nëse ekspozoni ndonjë porosi kur'anore të papenguar nga as gjë në pastërtinë dhe në qartësinë e vet, në mënyrë të bukur - do të thotë në atë mënyrë që tek të pranishmit të zgjoni ndjenjat, pikërisht që janë edhe qëllim i porosisë - atëherë dijeni se keni arritur sukses. Fatkeqësisht, nuk mund të krenohemi se me një sukses të këtillë ndeshemi në çdo hap.

Përgjithësisht njerëzit janë të prirur ta taprojnë. Edhe ne nuk bëjmë përjashtim. Pak nga pak, e kalojmë kufirin e përcaktueshmërisë islam. Ngreni kokën nga plafoni. Në shumë xhami mund të vërehet se krahas emrit të All-llahu nuk qëndron vetëm emri ‘Muhammed’, por të radhitur në rrëth edhe shumë emra: ‘Ebu Bekr’, ‘Umer’, ‘Osman’, ‘Ali’. Këtyre u ndajshohen edhe, si me ndonjë obligim, emrat ‘Hasan’ dhe ‘Husein’. Ç’synohej në fakt me këtë? Dhe pa ndonjë hulumtim të veçantë, ne nuk mund ta pjekim mendimin për këtë dhe si është arritur kjo, por është krejtësisht e sigurt se kjo nuk është kurrfarë tradite që heq zanafillën nga periudha e Resulull-llahut a.s. A thua mendimin tuaj nuk e shqetëson pyetja a është në rregull kjo? Sikur ky veprim të ishte i drejtë, atëherë do të duhej që në vend të këtyre emrave të vihen emrat e pejgamberëve të Zotit p.sh. Ademit, Nuhit, Ibrahimit, Musasë, Daudit, Isasë. Megjithatë, këtë nuk e bëjmë, ndaj thënë haptaz, nuk është dashur ta bëjmë as këtë.

Nëse ju pëlqen një mënyrë e këtillë, atëherë nga 99 emrat e Zotit (që përmenden në Kur'an), sipas zgjedhjes tuaj të lirë, merrni disa prej tyre dhe vendosni në vend të emrave të njerëzve. Kjo nga aspekti islam do të ishte pa kurrfarë vërejtjeje. Zoti ynë me këtë sigurisht do të ishte i kënaqur. Korrektësia e një veprimi të këtillë është e qartë. Apo jo? Xhamia është tempull i Zotit, e jo i njeriut. I takon vetëm All-llahut dhe Ai nuk e ndan me askënd. Ai nuk do ta bëjë këtë dhe ne duhet ta respektojmë.

Shikoj harkun e një xhamie: i ngjyrosur në ngjyrë të kaltërt me shumë yje të arta dhe disa gjysmëhëna. Fillova t'i numëroj gjysmëhënrat: pranë mihrabit dy flamuj të gjelbër me gjysmëhënë, e në vetë mihrabin dhe përreth, i numërova në kapje të syrit rreth njëzet. Ç'duhen këto? A thua është fare e nevojshme gjysmëhëna?

Ajo është regjistruar si simbol tradicional musliman. Kur dhe si u bë kjo - nuk është krejtësisht e qartë. Përndryshe, muslimanët nuk ushqejnë kurrfarë kulti ndaj gjysmëhënës, e as që ka nevojë për këtë. Ajo nuk është për muslimanët siç është p.sh. kryqi për të krishterët. Lirisht hiqeni nga xhamia, xhamia nuk humb asgjë me të.

Mirëpo, ne nuk synojmë këtë, por vazhdojmë me grumbullimin e gjërave të panevojshme, që kufizohen me gabime. Në ndonjë mihrab mund të shihet fotografia e vogël e Qabesë. A thua është e nevojshme kjo? Ne nuk i lutemi Qabesë, por drejtohem i ajo. Mjafton mihrabi të na tregojë drejtimin në namaz. Ç'mandoni ju? Nëse kjo kështu ka qenë e mjaftueshme për Pejgamberin e Zotit dhe as'habët e tij, përse të mos jetë edhe për ne? Mos e teproni në besim! Mos u heponi në dykuptimësi!

Në të gjitha anët mund të shihen hali, qilima të vegjël dhe levha, që kanë fotografinë e Qabesë dhe Haremi-sherifit. Madje ka edhe të atilla në të cilat vërehen qenie njerëzore. Është rrugë e rrëshqitshme kjo! A thua ne harrojmë se si kanë devijuar disa Katabije?! Ndër të tjera, tempujt e Zotit i kanë zbuluar me figura njerëzish dhe shtatore. A thua kemi harruar fjalët e Resulull-llahut: “*Engjëjt nuk hyjnë në dhomat ku gjenden fotografi njerëzish.*”

Ka mjaft mihrabe në të cilat gjenden nga sureja kur'anore El-Bekare pjesë nga ajeti 144, ose nga sureja Ali-Imran pjesë nga ajeti 37. Derisa pjesa e ajetit nga sureja El-Bekare (në përkthim thuhet: “*prandaj ktheje fytyrën tënë nga Tempulli i shenjtë*”) është e kuptueshme dhe e pranueshme, pjesa nga sureja Ali-Imran, e cila (në përkthim) thotë: “*Sa herë që hynte Zekerijau tek ajo në mihrab*” e sjell njeriun në dilemë të madhe. Kuptimi i këtij veprimi mbetet i panjohur. Do të ishte mirë që ata, të cilët e bëjnë këtë, ose lejojnë apo kërkojnë të bëhet, ta sqarojnë këtë zakon. Vërtet do të ishte shumë mirë!

#### IV

Të gjitha këto dhe shumë gjëra të tjera, njeriu mund t'i shohë. Dhe vërtet të gjithë ne i shohim këto. Mirëpo, mos t'i myllim sytë para tyre! Njëmend, njerëzit janë ngopur me grindje dhe me kon-

flikte, ndaj me ëndje heshtin. Bëhen sikur asgjë nuk po ndodh. Mirëpo mendoni se ç' thotë All-lahu pér këtë. Mendoni ç' është obligimi ynë. Obligimi Islam është që ta thoni atë që duhet bërë, dhe të sinjalizoni pér atë që nuk është dashur të bëhet. Nuk duhet pajtuar me gabimet, duke u mbrojtur e arsyetuar se i kemi trashëguar ato. Ato nuk janë as farz as sunnet! Të gjitha këto në të kaluarën u shfaqën si risi, risi sipas kuptimit të tyre në krahasim me pastërtinë e mendimeve islame. Mirëpo, disa, edhe kur i parandjejnë, nuk vendosin që gjërat e tilla t'i evitojnë ose ta ngrenë zërin kundër tyre, vetë atyre një veprim i këtillë do t'u dukej si përdhosje e faltores. Njerëzit nganjëherë sillen si xhahilë (injorantë), të cilët arsyetohen se besimin dhe sjelljen e tyre e kanë trashëguar nga të parët e tyre. Por të përkujtohemi se si Kur'ani me qortim pyet: "*A thua edhe atëherë kur ata ishin të hutuar?*"

Pér të tjerët kjo do të jetë njëfarë purizmi që do të rrezikojë vlerat kulturore të thesarit tonë. Ata do të pyesin: "Ç'do të mbetet nga xhamitë tona? Ndoshta druajnë se turistët më nuk do të kenë se ç'të shohin në xhami, se do ta gjejnë të zhveshur. E pér kë është xhamia, pér besimtarët apo pér turistët? Dhe, nëse turisti nuk ka se ç'të "shohë" në xhami, atëherë edhe më mirë! Vrojtimet e tij mos të jenë të preokupuara me asgjë tjeter përveç asaj "La ilah ilall-lah Muhammedun resulull-lah" dhe me disa ajete kur'anore. Njoftoni me idenë islame. Kjo pér All-llahun do të jetë më e dashur sesa të flisni pér ndonjë shandan, i cili sot nuk ka kurrfarë funksioni. Turistët në të, mbase do të shohin vetëm njëfarë vlere të lashtësisë. E ta formojnë qëndrimin e tyre ndaj Islamit në këtë mënyrë, nuk është asgjë tjeter por xhahilijet i rëndomtë. Prandaj, ju lirisht hiqni gjërat e këtilla nga xhamia.

E di, e di, ju do të bëni vërejtje se kjo është çështje e pronës, e hajratit, ndaj askush nuk merr guxim ta thyejë vasijjetin e bamirësit. Vërtet këtë nuk duhet bërë, por gjithashtu as xhaminë nuk duhet bërë muze. Ju skajoni këto si antikitete diku në një vend të veçantë, dhe le t'i shikojë kush të dojë.

Të tretët do të shkojnë aq larg dhe do të jenë në gjendje të bëjnë këtë vërejtje. "Duke iu përbajtur rregullave të tilla, bota islame kurrë nuk do të kishte një Alhambër dhe Taxh-mahal." Vërtet, këto janë realizime kulminante të kulturës islame, janë krenaria e saj. Mirëpo të gjitha këto mund t'i sodisim me ndenja të ndara. Ato përfaqësonin zenitin e një periudhe, kur rënia veçmë parashihej. Fryma

islame e këtyre shoqërive muslimane në një masë të mirë veçmë ishte prekë dhe dëmtuar.

Xhamia nuk është qëllim për vete. Ç'duhet xhamia madhësh-tore me plot zburime e vlera, ndërsa brenda e zbrazët? All-llahu dëshiron që ato të jenë plot! Nuk ndihmon gjë bukuria e tyre.

Kjo nuk është ajo që i tubon njerëzit. Nxitja për t'u tubuar ësh-të diç krejtësisht tjetër. Xhamia duhet të përfaqësojë fillimin e jetës shoqërore të besimtarit, e jo fundin e kësaj jete. Kur kjo të kuptohet dhe të pranohet kështu, atëherë xhamitë do të jenë plot me besimtarë. Në të kundërtën, ato do të jenë të boshatisura.

Të përkujtohem se çfarë ka qenë xhamia e parë, atë të cilën e ngriti Resulull-llahu a.s.: krejtësisht e thjeshtë. Nga besimtarët nuk është kërkuar ta stolisin xhaminë, por ta pasurojnë shpirtin e tyre. Për fenë nuk është qenësore kurrfarë forme, as nuk ka qenë, as nuk do të jetë, por thelbësore është pastërtia e zemrës, zjarri dhe dashuria e saj, përcaktimi i saj. Sepse pa të, çdo formë bëhet e detyruesh-me, agresive dhe e pasinqertë. E Zoti më se tepërm i urren josin-qeritetin.

Islamit nuk i nevojiten elementet artificiale, të cilat kinse nxisin në religjiozitet. Në Islam këto nuk ekzistojnë. Ai i mohon ato, i hedh poshtë. Ajo është kurth i djallit në të cilin ka rënë shumëkush. Rezultati definitiv është idhujtaria. Islami i drejtohet njëkohësisht intelektit të njeriut dhe ndjenjës së mbjellë thellë në shpirtin njerëzor për të vërtetët dhe gënjeshtren, për të drejtën dhe të padrejtën, për të bukurën dhe të shëmtuarën, për të mirën dhe të keqen.

Dhe, vërtet, nxitja e gjeneratës së parë të besimtarëve ka qenë e madhe. Ndërtuan dhe punuan atë që u nevojitej. Kjo ishte ajo nxitje dhe ai hov, i cili krijoi një botë të mëvetësishme, plotësisht të ndryshme nga çfarëdo botë tjetër që kishte njojur deri atëherë historia.

# BISEDË GJATË RRUGËS\*

---

## Taksi-biseda nga shiriti i magnetofonit

Në atë shoqëri isha i katërti. Por unë nuk jam përzier në bisedën e tyre. Këtë e bëra nga mirësjellja. Vjetët e mia mezi arrinin gjysmën e vjetëve të cilitdo prej tyre. E tërë kjo bisedë ishte e parëndësishme. Edhe ata flisnin ndonjë fjalë nga një monotonë e mirëfilltë. Kush do të ishte i disponuar për bisedë, i shtrënguar në makinë në atë vapë hercegovase. Nuk është kjo Bosnja, gjelbërimi i së cilës të përkëdhel. Deti është ende larg, mirëpo kemi shpresuar se vapën e mesditës do ta kalonim në Vitinë e freskët. Makina nxitonte në pushimin e premtuar edhe të saj edhe tonin.

Ata njerëz nuk ishin të jashtëzakonshëm. I ndeshni në jetë dhe nuk preokupojnë interesimin tuaj. Mirëpo, interesante ishte filozofia e tyre jetësore me të cilën udhëhiqeshin - siç e shpjegonin ata këtë - apo ndoshta me të cilën i arsyetonin veprimet e sjelljet e tyre të theksuara nga njojja e thellë e tipareve individuale. Te njëri ky ishte *realizmi*, te i dyti *altruizmi*, ndërsa i treti ishte *besimtar*.

BESIMTARI:

“Kopshtet nën të cilat rrjedhin lumenjtë!” Sa bukur është! Nuk është çudi pra që përkundër ferrit dhe zjarrit të tij, Zoti prenton një parajsë të këtillë.

REALISTI:

---

\* Është publikuar në Takvimin e BI Sarajevë 1975, me pseudonimin Ekrem Hajriq.

Nuk është çudi! Fantazia njerëzore është dashur patjetër të tri-lojë diç të tillë përkundër shkretëtirës së nxeh të.

**BESIMTARI:**

Përse fantazia njerëzore? Përse kjo tē mos jetë premtim i vërtetë? Nëse këto janë kontraste aq efektive pér imaginatën njerëzore, nuk ke tē drejtë të shikosh në to si frys i asaj imaginatë.

**REALISTI:**

E gjithë kjo është relative. Pér eskimezin frika është errësira dhe tē ftohtët. Xhenneti pér ta do tē ishte dhoma e ndritshme dhe zjarri në oxhak.

**BESIMTARI:**

Krejtësisht në rregull! E pérse jo edhe vendbanimi ku nuk ka as vapë as tē ftohtë, siç e premton këtë Kur'ani.

**ALTRUISTI:**

Indianët e kanë pasur zakon tē flasin pér tē vdekurit e tyre se kanë shkuar në gjueti tē amshueshme.

**BESIMTARI:**

Ndoshta kjo pér ju është tepër naive, kurse mua kjo gjithmonë më prek thellë. Nëse lëmë mënjanë idhujt dhe maskat e tyre, nëse heqim shtresat e idhujtarisë, atëherë ndeshim në mendimin e stërlashtë pér Zotin dhe parajsën në respektimin e tyre tē Shpirtit të Madh dhe shpërnguljen në vendet e amshueshme të gjuetisë.

**REALISTI:**

E tërë kjo është e kaluar dhe tregim nga e kaluara, pér jetën bashkëkohore ngarkesë e panevojshme dhe mjegullim i realitetit. Duhet tē jemi realë. Me punë është arritur çdo gjë që kemi, e jo me lutje. Kjo është aq e qartë saqë fantazia njerëzore i ka lënë rezultatet e lutjeve atje diku pas vdekjes. E ç'është vdekja? Vetëm eshtra tē kalbur!

**BESIMTARI:**

Pérse ti i ke përbledhur njëren mbi tjetrën? Hajde ta zbër-thejmë çështjen në hollësi: Pérse duhet zgjedhur: ose punë ose lutje? Pérse jo: edhe puna edhe lutja?

**REALISTI:**

(Duke qeshur): Aaa... ti tani je pér koekzistencë! Ju, besimtarët, nuk keni folur kështu në Mesjetë.

**BESIMTARI:**

Ti po i identifikon konceptet, fetarët dhe besimtarët. Bëhu korrëkt! A thua ti do t'i lejoje dikujt që pseudomjekët sharlatanë t'i radhisë në mesin e mjekëve? Atje ku ti sot hedh shikimin tënd plot respekt, atje ishte Mesjeta jote, koha e errësirës dhe e paditurisë, ndërsa në anën tjetër, nga e cila ti e kthen shikimin tënd, atje ka qenë...

**REALISTI:**

E di... e di përse do të flasësh. Kordova, Bagdadi, Alhambra - kjo është tema juaj e përhershme. Megjithatë, mirë, e respektoj atë të kaluar dhe kërkoj falje! Mirëpo kuptimin e jetës e gjej në *krijimtari*, kjo më bën të lumtur. Njeriu me punë është ngritur mbi të gjitha në natyrë dhe përfundimisht po ngadhënjen mbi të...

**ALTRUISTI:**

... me dituri.

**REALISTI:**

Edhe dituria është fryt i punës.

**ALTRUISTI:**

Edhe e kundërta.

**BESIMTARI:**

Më lejoni t'ju ndërpres. Puna nuk është cilësi vetëm e njerëzve, por e çdo gjëje të gjallë në natyrë.

**ALTRUISTI:**

Aty kemi të bëjmë vetëm me instinktet, ndërsa te njeriu kemi vetëdijen.

**BESIMTARI:**

Mos je aq i sigurt në këtë! A ke lexuar Meterlinkun, bletët e tij, thneglat dhe termitet? Do të sjellin në dyshim të madh se ç'duhet të jetë instinkti. Ndërsa njeriu gjithnjë mendon: "Është punë e kuptueshme vetveti!"

Po ju rrëfej: Para disa vjetësh dallëndyshet donin të ndërtonin folenë në një vend të kacavarur, përmua të çuditshëm.

Shoh se çdo gjë do të më ndyejnë. Për t'i penguar vara disa arna. Reaguan ashpër. Bënë alarm të vërtetë. U mblohdhën edhe të tjera dhe përpinqeshin që bashkërisht t'i mënjanojnë këto pengesa. Meqë nuk patën sukses në këtë, filluan të shqyrtojnë se ç'të bëjnë. Në të njëjtën kohë ua ndreqa një dërrasëz në një vend tjetër si platformë për fole. Sikur e kuptuan. Shtatë-tetë sosh u vendosën në dërrasë. E provonin a do ta mbajë peshën. E pastaj aty ndërtuan çerdhen. Njëfarë shkalle e intelektit gjatë punës, duhet t'u pranohet.

Ndërsa - ajo që njeriu realizoi me progres dhe me të u ngrit mbi të gjitha në natyrë - duhet t'i falënderohet - *shkrimit!* Përvoja e fituar, dija, me shkrim u janë përcjellë në trashëgim breznive. Popujt që nuk kanë pasur shkrim kanë mbetur në shkallë të egërsisë; madje në ta shikoni si në shtazë. Kurrfarë përparimi në mënyrën e jetesës dhe në format e saj të ndryshme nuk ka pasur mundësi të realizohet. Njeriu pushoi të jetë kafshë, jo kur filloi të punojë, por kur u paraqit shkrimi.

ALTRUISTI:

E kujt është kjo teori?

BESIMTARI;

Çfarë teorie? Kjo nuk është kurrfarë teorie. Kjo është aq e qartë! Rregulla e Pitagorës është frysht i një dijeje dhe një të menduari të logjikshëm, të njërit nga dijetarët më të mëdhenj të njerëzimit, ndërsa sot, kjo rregull falë shkrimit bën pjesë në fondin e dijes së miliona njerëzve që nga arsimimi fillor. Në një libër mund të punohet me vite të tëra, ndërsa ne mund të njihemi brenda disa ditësh me atë që na ofron ai libër. Shkrimi e ka shumëfishuar jetën tonë. Edhe sot e kësaj dite për ne janë të panjohura disa të arritura në teknologjinë e materialit, përvoja nga medicina ose nga fusha të ndryshme të shkencës, vetëm për shkak se me xhelazi janë fshehur - janë konsideruar monopol - ndaj me traditë gojore u janë lënë në trashëgim më të zgjedhurve. Me zhdukjen e tyre, për njerëzimin kanë mbetur fshehtësi e përhershme. Prandaj nuk është çudi që shkatteredimi i fjalës së shkruar përfaqëson krimin barbar kundër përparrimit dhe kulturës në përgjithësi. Fjala e shkruar është pasuri e vërtetë për gjininë njerëzore.

ALTRUISTI:

Shih, shih? Kush e kishte pritur këtë prej teje?

Të lutem, më fal... tani unë duhet të kërkoj falje... Asgjë keq nuk kam menduar, por vërtet po më befason se me çfarë patosi po flet për këtë çështje. Prej nga të erdhi kjo ide? Unë këtë për herë të parë po e dëgjoj ... së paku të interpretohet në këtë mënyrë.

BESIMTARI:

Cudi si nuk di ti për këtë, kur ti ke lexuar aq shumë. Sigurisht do të habitesh se kjo është e vjetër më tepër se një mijë vjet. Këto janë fjalitë e para në shpalljen kur'anore. Muhammedi ftoshet të lexojë dhe të mësojë në emër të Krijuesit dhe Zotërueshit, i cili krijoj njeriun. Prandaj thuhet se Ai është Zotëruesi më fisnik: ia mësoi shkrimin, ia mësoi njeriut atë që njeriu nuk e dinte.

(Këta dy vetëm shikoheshin ndërmjet vete).

BESIMTARI:

Përse ashtu e mprehni fytyrën? Sikur të kisha thënë se kjo ishte teoria e Shtajnit, Bergerit ose e Tropit, ju këtë me respekt do ta pranonit, e kështu... Ju keni disa paragjykime dhe nuk jeni në gjendje t'i përbaheni parimit: mos shiko se kush flet, por dëgjo se për çka flet.

REALISTI:

Sa më kujtohet, ti përpara ke pasur tjeter mendim: ke pushuar të luftosh kundër Teorisë së Darvinit, nuk ke mundur me kufi të bësh prerjen e kontinuitetit fiziologjik-biologjik ndërmjet kafshëve dhe njeriut, kështu që ke filluar të pohosh se *religjioziteti* është kufiri që ndan *homo sapiensin*. Për këtë ke ligjëruar gjerë e gjatë. E tanisht... shkrimi.

BESIMTARI:

Këtu nuk ka asnjë tjeter. A thua për ty nuk është e çuditshme se pikërisht priftërinjtë te të gjithë popujt ishin të parët zotërues të shkrimit? Për mua jo.

Kur'ani i ndan njerëzit në dy grupe: në ata që dinë dhe në ata që s'dinë. Zoti kërkoi nga engjelli që t'i falet njeriut, përkundër të gjitha të metave të tij, pikërisht për arsyen e diturisë me të cilën e dekoroi mbi engjëllin.

ALTRUISTI (duke qeshur):

E prej nga e di ti këtë?

BESIMTARI:

Unë këtë nuk po e trilloj, këtë e thotë Kur'ani.

ALTRUISTI:

Ah, e gjithë kjo është legjendë!

BESIMTARI:

Kjo do të ishte legjendë sikur të ishte prodhim i kohës së sotme, kur shkencës pas të gjitha atyre sukseseve nuk mund t'i mohohen vlerat. Mirëpo - përpinquni ta paramandoni mjedisin në të cilin u paraqit Kur'ani - mjedisin në të cilin është çmuar tradita gojore, ndërsa arsimimi ka qenë raritet i vërtetë, kështu që nuk ka pasur kurrfarë baze për disiplinat shkencore dhe atëherë përnjëherë, si rrufeja papritmas - një qëndrim i këtillë. Edhe unë nuk befasohem që në fushën shkencore aq shumë kanë arritur pikërisht ata, të cilët seriozisht e kanë përvetësuar atë qëndrim.

REALISTI:

Kur marrim parasysh se Muhammedi ka qenë tregtar, edhe atë siç pohohet - vetë ishte analfabet, ndaj shi për këtë e kuptoi rëndësinë e shkrimit. Rreth e përqark Arabisë ishin shtete relativisht të përparuara; kjo sigurisht e ka impresionuar. Siç duket, ka qenë ambicioz dhe praktik dhe u përhoq që të bëjë diç në këtë drejtim. Po mirë, diçka edhe bëri, mirëpo e gjithë kjo nuk meriton një rëndësi aq të madhe. Të këtillë ka edhe te popujt tjerë, të cilët në një mënyrë i dolën borxhit mjedisit të vet. Një glorifikim aq i madh i Muhammedit është fryt i një njëanshmërie të kulluar, e jo i ndonjë vlerësimi objektiv.

**BESIMTARI:**

Ti je i njëanshëm, viktimë e njëanshmërisë së atyre të anës tjetër. Me ton të tillë the “tregtar...” ashtu disi, sikur kjo e zhvlerëson karakterin ose veprën e tij. Talesi nga Mileti ishte gjithashtu tregtar, me gjithatë kjo aspak nuk ia zvogëlon vlerën në mesin e plejadës së shtatë filozofëve grekë. Ti do vlerësim objektiv e kriteri yt për njerëz është suksesi, pra urdhëro vlerësoje Muhammedin sipas rezultateve të punës së tij.

Para disa vjetësh bisedoja me një hoxhë të vjetër fshati. E pyetë çfarë argumente ka se Muhammedi ka qenë pejgamber i Zotit, ndërsa ai tha: “E more biri im, sikur Muhammedi të ishte paraqitur në mesin e gjermanëve, kjo nuk do të ishte kurrfarë çudie, atyre plotësisht do t'u përgjigjej.

Tek ata çdo gjë shkon si sahat. Ata e dinë se ç'është rendi dhe rregulli. Mirëpo, ai u paraqit në mesin e arabëve... e ja, e sheh se çfarë janë... dhe ai prej tyre bëri njerëz. Kur’ani - ai është pushtet i Zotit!”

**REALISTI (me një përqeshje të hapur):**

A e ke pyetur përsë ai pushtet nuk vepron tanë ndërmjet tyre?

**BESIMTARI:**

Pikërisht këtë ma more nga goja. Hoxha më tha: “Po punojnë mbrapsht. Imani i dobët!” E pastaj filloi t'i përshkruajë njerëzit: disa janë të këtillë, disa të atillë. Me disa fjalë të thjeshta i karakterizoi, por kjo doli aq mjeshtërisht - ky ishte hapi i vërtetë - që në këtë rrjedhë ju kam njojur edhe ju të dyve. Njeriu gati bindet se personalisht ju njeh. (Realisti skuqet, ndërsa te altruisti vërehet shqetësim).

**REALISTI (pothuaj me zemërim):**

Çfarë të keqe i kam bërë dikujt? Unë shikoj punën time, e kush do ndryshtë - e ka rrugën hapur!

### ALTRUISTI:

Nëse dikujt nuk i kam bërë mirë, nuk i kam bërë sigurisht as keq.

### BESIMTARI:

Nuk duhet të hidhëroheni. Ju e konsideroni atë si të prapambetur, ndërsa ai juve se jeni të humbur, dhe hesapi është barazuar.

T'i kthehem Muhammedit. Gjithmonë e kam respektuar dhe e kam dashur ashtu siç është rendi. Mirëpo që tani fillova ta çmoj me të vërtetë, tani kur fillova të mendoj pak.

Sikur Muhammedi ta shpiente dikë në pije, në bixhoz ose në shtëpitë e natës, ose ta nxiste dikë që ta shtonte pasurinë e vet me anë të kamatës - a thua këtë do të duhej ta konsideronim sukses, a do të ishte kjo vështirë? Mirëpo, more burrë, ai veproi krejtësisht të kundërtën dhe këtë e bëri me një gjeneratë të tërë. I detyroi të marrin mësim ngajeta dhe vdekja, që e kishte edhe vetë. A e di ç'do të thotë kjo? Ja (dhe ia vuri gishtin në gjoks realistik), ti nuk je në gjendje ta bindësh djalin tënd, sipas bindjeve tua, për ato gjëra që për ty janë të qarta. Ti vetë mu ankove një ditë: Më the: "Ai imi ka filluar t'i ndjekë Kafkën dhe Kamynë. Është dëshpëruar në çdo gjë. Çdo gjë i duket e pakuptimit. Madje njeriu do të thoshte se po flet me vend sikur mos të ishte puna për gjëra të marra. Unë i flas - thua ti, "bota është e këtillë çfarë është. Ti nuk mund ta ndërrosh. Pranoje ashtu siç është dhe shiko punën tënde, e të tjerat le t'i marrë djalli, ç'dertohesh ti." Mirëpo, ai gjithmonë të njëjtin mendim. "E gjithë kjo është absurd."

Ndërkaq Muhammedi me idetë e veta po ndikon me shekuj në miliona njerëz, dhe kjo është ajo që the ti se "diçka edhe bëri." Natiqisht ty të impresionojnë kalibra të tjerë. Hanibili, Qesari, Odiseu, Perikleu, Leka i Madh - ata të kanë fascinuar menjëherë në takimin e parë në shkollë. T'i krahasojmë këta shembuj tuaj me Muhammedin! Objektivisht, kush është më i madh?

Çka do të ishte Qesari sikur mos t'i kishte në disponim ato legjione. Ai pati kujt t'i thoshte: "Fati është caktuar." Po ashtu edhe Hanibili te Kani, me thënien e vet: "... nuk ju kanë dhuruar armë më të fuqishme sesa përbuzja ndaj vdekjes që të triumfoli." Zgjidhja e Nyjës së Gordit nga ana e Lekës me vringëllimin e shpatës për ty gjithmonë ka qenë gjest madhështor, mirëpo shumë shigjeta të fallangës së tij që ia kishe lënë i ati ia mundësuan që të dalë në shesh aftësia e tij.

Të gjithë këta me radhë i shfrytëzuan rrethanat, të tilla çfarë ishin, me mjetet që kishin në disponim - pajtohem, në mënyrë gjeniale! Mirëpo, e gjithë kjo shpejt u bë gërmadhë historike. Madje disa si Hanibali dhe Napoleoni, e panë këtë me sytë e vet. Ndërsa vepra e Muhammedit edhe sot e gjithë ditën vazhdon. Sikur Muhammedi të ishte ambicioz dhe praktik, siç thua ti, ai do t'i përshtatë situatës, duke i shfrytëzuar të metat dhe virtytet e bashkëfistarëve dhe aftësitë e veta - së shpejti do të dilte në plan të parë. Meqenëse Mekka ishte qendër shpirterore e arabëve, ai me logjikën e Perikleut do të imponohej edhe si autoritet politik, e pastaj do t'i nxiste në pushtimin e botës. Mirëpo, ai vepron disi krejtësisht ndryshe - dhe ky, duke vlerësuar nga aspekti politiko-shkencor dhe ushtarak, veprim shumë i rrezikshëm, tëhuajësimi dhe largimi nga bashkëfistarët e vet të cilët e respektonin dhe i ofronin pushtetin, i bëri armiq të tij të përbetuar rrëth çështjeve religjioze. Kjo do të mund ta shkatërronte plotësisht, por përfundoi me faktin se ai historikisht u vonua dy dekada. Po ta krahasonim me Lekën e Madh dhe me Napoleonin, vonohet madje dyzet vjet. Kështu trashëgimtarët e tij për gjysmë shekulli pushtuan vetëm gjysmën e botës, e sikur të vepronte si model-trimat tuaj; arabët nën udhëheqjen e tij atëherë do ta pushtonin tërë botën e njohur. Mua më intereson se për cilën do të përcaktohesh ti. Jam i bindur se për këtë të dytën. E çka pastaj? "Pas meje kijameti"! Saktësisht kjo edhe do të ndodhë: një perandori e këtillë e Muhammedit, në mungesë të kohezionit shpirteror, do të shkatërrrohej si ajo e Xhingis-Kanit, pas vdekjes së tij. Pushtuesit do të shkriheshin në kulturën mbizotëruese të popujve të pushtuar.

Ndërkaq, Muhammedi-edhe pse ishte i shkathët edhe në politikë edhe në fushën e betejës, siç u dëshmua më vonë - në të vërtetë nuk ishte politikan që synonte pushtetin, e as udhëheqës ushtarak që u nis ta pushtojë botën... ai u nis *ta ndërrojë atë*.

Sikur Hanibali për çdo rast të arrinte ta shkatërronte Romën, ose Pompeu ta mposhte Qesarin, trojanët t'i mundnin grekët, apo Napoleoni t'i ikte disfatës në Uaterlo, në çka do të ndryshohej me këtë bota!. Në asgjë! E shiko betejën në Bedër! Ti për të do të thuash: "Pih, e di unë mendimin tënd." Megjithatë, pa marrë parasysh përmasat e saj, ajo u bë vendimtare për një pjesë të mirë të njerëzimit, e jo si për shembull, ajo kasaphanja prej milion njerëzish që quhet "Beteja e Marnës."

Po tē mos ngadhënente Muhammedi dhe nēse nē njëfarë mënyre deri te ti arrinte lajmi pér tē, ti do tē thoshe: "Ndonjë i marrë." Ndërsa kështu: "tregtar që e kanë impresionuar..." Ti nuk e vëren izolimin e atij mjedisi. Ai vend kurrë nuk ka qenë nē përbërje tē Perandorisë romake. Me muaj është dashur tē udhëtosh deri tek ato shtete tuaja tē përparuara. Megjithatë, kjo do tē duhej tē ishte aq vendimtare - sipas mendimit tēnd - pér veprimin e tij. E kujto vetëm para tridhjetë vjetësh izolimin e atyre fshatrave rrëth qytetit tonë! Ti atëherë tmerroheshe, kjo pér ty ishte kontrast ndërmjet civilizimit dhe prapambeturisë që ishin larg njëri-tjetrit vetëm disa orë udhëtimi nē këmbë. Ti nuk po e merr parasysh proporcionin e largësisë dhe mundësitë e dikurshme tē komunikacionit. Ajo kohë nuk është kjo e sotmja, kur bariu duke i ruajtur delet nē mal dëgjon tranzistorin. Atëherë ke thënë: "Sa shumë talente kanë dështuar nē këto fshatra tē pashkollë." Dhe tani mos i nënçmo mundësitë se sa përparësi patën para Muhammedit trimat tuaj që i more si shembuj. Tē gjithë ata qenë tē shkolluar nē mënyrën e vet, dhe patën mundësi tē mëdha pér arsimim tē pavarur. Pér shembull, Leka i Madh e pati mësues Aristotelin... Ndërsa pér Napoleonin thuhet se kohën e lirë e kalonte duke lexuar libra, tē cilat më vonë ia mundësuan gjindshmërine e jashtëzakonshme nē problemet e nduarduarta nē marshimin e tij historik, kështu që kjo la përshtypje tē thellë nē rrëthinë. Ndërsa Muhammedi nuk pati nē disponim as mësues e as biblioteka. Dhe tani vlerësoje fuqinë dhe origjinalitetin e paraqitjes së tij!

#### ALTRUISTI:

Do tē ishte qesharake që disa mendime tē dikurshme tē përhapura pér Muhammedin si pér ndonjë mashtrues tē merren seriozisht. Unë plotësisht pajtohem me Karlajlin (Carhyle) se Muhammedi ishte deri nē fund i singertë nē paraqitjen e vet dhe besoi singjerisht nē atë që fliste. Nëse Muhammedi madje edhe iu nënshtua sprovave tē pushtetit dhe pranoi marrëveshjet me mekkasit që tē mos e gjykojë idhujtarinë e tyre, dhe se duke e shfrytëzuar pushtetin vetëm i bashkoi arabët, kjo do tē ishte e mjaftueshme që ai tē arsyetohet para historisë. Në çdo aspekt, vepra e tij ka qenë progressive dhe ka pasur rëndësi tē madhe pér përparimin e njerëzimit pér nja dhjetë shekuj, por gjithashtu më duket qesharake që nga idetë e tij tē krijohet aktualiteti i sotëm. Ato i takojnë së kaluarës.

#### BESIMTARI:

Pér shembull: Thekso çfarëdo ideje tē tij, e cila parimisht do tē ishte e papranueshme sot.

**ALTRUISTI:**

Nuk është kjo papranueshmëri, por pikësëpari do të ishte e tephert. Ngarkesë e panevojshme pa të cilën mund të jetohet mjaft mirë.

**BESIMTARI:**

Mundet... por megjithatë, ja, njerëzit nuk po jetojnë. Qe djalit të tij, të gjitha këto i duken absurd. Edhe për mua do të ishte ashtu sikur mos të besoja në Zot. Sepse ç'më intereson mua atje njëfarë natyre, e cila s'është e vetëdijshme as për vetë ekzistencën e vet e lëre më për ekzistencën time, kurse unë duhet t'u nënshtrohem ligjeve të saj. Njeriut i është dashur të jetojë si shtazë aq mileniume në emër të njëfarë progresi, e çfarë ngushëllimi është për të që ne sot po jetojmë si shoqëri e qytetëruar: ai për të as që di fare. S'më përket mua kinse njëfarë fati i gjeneratave të ardhme, kur unë këtu vuaj në mjerim dhe kur për mua me vdekjen çdo gjë merr fund.

**ALTRUISTI:**

Po, ti gjen kuptimin e jetës në vullnetin e Zotit, ndërsa unë në *humanitet*.

**BESIMTARI;**

Ç'i pengon humanitetit nëse unë besoj në Zot?

**ALTRUISTI:**

Unë mund të jem human edhe pa besim.

**BESIMTARI:**

Ndërsa besimi nuk mundet pa humanitet. E çka do të pengonte edhe sikur të besosh?

**ALTRUISTI:**

Ja, ti beson por unë jam i bindur se jam më human se ti.

**BESIMTARI:**

Ti nuk e ke kuptuar besimin. Ndoshta ti nga natyra je më i mirë se unë, pranoj, mirëpo nuk qëndron çështja në atë që të krahasohemi ne të dy. As unë nuk jam i keq, por unë jam plotësisht i vetëdijshëm se falë besimit shumëçka në mua është pozitive. Ajo më nxit të bëj të *mira*. Edhe humaniteti yt ka disa kufij; por këta kufij ti do t'i kaloje sikur të gjeje nxitje në besim. Në mua ka diç të keqe, por besimi e refuzon këtë të keqe pikërisht aq sa është i fortë.

**ALTRUISTI:**

Një qëndrim i këtillë është një gjykim mjaft i keq për ju besimtarët. Prandaj ka pak besimtarë, ndërsa ata janë shumë larg nga ajo që kërkon feja prej tyre.

**BESIMTARI:**

E përse ti të mos jesh i drejtë pa marrë parasysh të tjerët? Më në fund nuk është fjala për këtë, por për vetë idenë e fesë.

ALTRUISTI:

Unë, deri diku e kuptoj Muhammedin, i cili nga arabët e vet kérkoi, për shembull, të mbahet pastërtia. Ai nuk ka mundur t'i bindë për këtë, por vetëm i ka shtyrë me frikë para ndonjë fuqie. Sot ajo frikë më nuk është e nevojshme, është e pranishme shkenca dhe mundësitë e sotme të edukimit. Vetëm duhet luftuar për një sistem të përshtatshëm. Këtë edhe Muhammedi e kishte të qartë, ndaj krijoj sistemin e vet. Edhe neve na nevojitet pastërtia, ushtrimet trupore, agjërimi dhe të ngjashme, mirëpo përse kjo duhet të jetë rituale. Nëse ekziston ndonjëfarë disponimi dhe përjetimi shpirtëror, përse janë të nevojshme aq shumë manifestime materiale? Kjo më duket tepër formaliste, tepër e vrazhdë. Për mua sikur të isha fetar, kjo do të ishte mjaft e mundimshme.

BESIMTARI:

Ndoshta pikërisht për këtë edhe nuk je besimtar. Mirëpo ki kujdes! Gjithkund në natyrë vërehet multifunksionaliteti i disa dukurve dhe komplementariteti i tyre. Mirëpo, shpirti analistik njerëzor në gjithë këtë më parë do të vërejë, nëse shikohet ngusht, kundërthënien. Shqyrtuar nga këndvështrimi tjetër, duket ndryshe. Për shembull, bimët mund të "mendojnë" se kafshët ekzistojnë për shkak të tyre - që t'u japin dioksidin e karbonit, ndërsa se bimët janë për atë që t'u japin oksigjenin. Ose për shembull, funksionet e mëlçisë. Ju mund të përcaktoheni për njërin ose ndonjërin si më kryesor, ndërsa për të tjerët si të dorës së dytë, por nuk guxoni të mos merrni parasysh multifunksionalitetin e saj.

Edhe diçka: këto funksione edhe pse janë të ndryshme, nuk janë kontradiktore, por nuk janë as në kundërshtim me organet tjera. E gjithë kjo është një tërësi.

Në të njëjtën mënyrë, i gjithë ky zërthim i njeriut në komponente shpirtërore dhe materiale është i panevojshëm, sepse shpie në përjashtim të hidhët ndërmjet tyre, në vend që të shihet se tërë kjo përbën një tërësi. Besimi kërkon nënshtrim të vetëdijshëm dhe me gjithë zemër ndaj Krijuesit, dhe ky nënshtrim shprehet në trajta të ndryshme. Për mua asgjë nuk është e çuditshme që kjo shtrihet në fushën nga e cila ti do të doje ta evitosh besimin arbitrarisht. Kuptimi i të gjitha normave fetare është njëkuptimësh: *të kryhen në emër të Zotit*, edhe pse ato janë krejtësisht të ndryshme, por edhe çdonjëra për vete është shumëfunksionale në kuptimin e asaj që ne

e quajmë jetë në kuptimin e asaj e natyrshme, normale dhe e arsyeshme. Këto norma nuk janë, as nuk mund të jenë në kundërshtim me ndjenjat tona të rrënjosura thellë për drejtësi, moral dhe logjikë.

Paramendoni një situatë kësisoj: në tren rrëmujë. Një udhëtar ngrihet dhe ia lëshon vendin një gruaje. Si të shpjegohet një veprim i këtillë? Ja në sytë e tij (tregon kah realisti) hetoj pyetje ironike: a ishte e re apo plakë. Këtë me qëllim do ta hesht... Jo, jo edhe më mirë... ishte e re dhe e shëmtuar, kështu që t'i ikim konstatimit: "Vardisës!"

**REALISTI:**

Megjithatë nuk i ke ikur tjetrës: "I marrë, don të bëhet i mirë."

**BESIMTARI:**

T'i lëmë ata që janë për: "Unë nuk ia lëshoj vendin tim."

**ALTRUISTI (duke qeshur):**

Ose ndoshta: "Burri zbret në stacionin e ardhshëm!"

**BESIMTARI:**

Nuk është kjo. Ai shtoi diç të tillë si "zbres shpejt", kur pa se gruaja ishte plotësisht e befasuar dhe e shqetësuar për vendin e ofruar. Mirëpo, ajo "shpejt" e tij kurrsesi nuk vinte, ndërsa stacionet kalonin...

**ALTRUISTI:**

E po, mirë, e di çfarë përgjigje do, nuk na ke lënë bash shumë zgjidhje. Në rregull; bukur.

**BESIMTARI:**

Vazhdojmë për gruan: Ulet në ndejëse dhe me një zë që mezi dëgjohet, ashtu nga zemra thotë: "Të falem Ty o Zot!" Të tjerët, duke mos ju hetuar shenja në fytyrë, qëllimi shtiren kinse nuk kishin dëgjuar.

Parafytyrimi për këtë njeri të bëhet edhe më i bukur. E tani paramendo kthimin befasues. Ai u kthye e tha: "Vërtet, falënderoj Zotin! Unë këtë e kam bërë vetëm nga dashuria ndaj Zotit."

E përse ti e zhvlerëson këtë njeri ose veprën e tij, nëse mëson se motivi i tij i vërtetë është urdhri kur'anor, besnikërisht, 'bëni vend'. - etj.

**ALTRUISTI:**

Kush po të thotë se unë po e zhvlerësoj...

**BESIMTARI:**

Ti! Të kam dëgjuar se si po e citon Shopenhauerin "...dhe kështu virtyti i Kantit mban duart prapa të pranojë shpërblimin."

**ALTRUISTI:**

Në një masë: po! Ky nuk është humanitet i mirëfilltë, ai është për ndonjë shpërblim.

BESIMTARI:

E përse të mos jetë për shpërblim? A thua do të ishte e drejtë që ai mos të fitojë asgjë njësoj si ata, që i kanë ruajtur vendet e veta?

ALTRUISTI:

E po mirë, a do të fitoj unë shpërblim për altruizmin tim?

BESIMTARI:

Nuk do të fitosh!

ALTRUISTI:

Çfarë drejtësie është kjo?

BESIMTARI:

Po ti e ke fituar: Ke kënaqësinë të sillesh në mënyrë humane, të sillesh sipas bindjes tënde. Mirëpo, t'i lëmë analizat akademike se çka duhet të quajmë humanitet. Atij që ka nevojë për ndihmë, për të është krejt njësoj se kush është urdhërdhënësi yt dhe ç'pret ti nga urdhërdhënësi; për të është humane nëse ti prej tij nuk pret kundërshërbim. Vetëm se ti keq mashtrohesh nëse mendon se me humanitetin tënd i ke zgjidhur të gjitha; dhe jo vetëm kaq, ti nuk je korrekt. Ja, së pari ndaj vetvetes: po helmohesh ngapak me alkool, vetëm në shoqëri, që të mos ua prishësh harmoninë.

ALTRUISTI:

Çka u intereson të tjerëve se çka i bëj unë vetvetes, me rëndësi është që të jem i drejtë ndaj të tjerëve.

BESIMTARI:

Nuk je as ndaj të tjerëve!!! Jo fort moti, duhej të të vinte në-punësi i ri; vajza, më parë çupëza, e përbajtur dhe e rezervuar pa një fije sjelljeje bashkëkohore. Aty ka edhe meshkuj. Ti qeras cigarette. Ajo e refuzon... e hutuar. Qeras me gotë, e kur të vish tek ajo, thua ashtu me elegancë, për ty në mënyrë të veçantë: "Për zonja kam diç të veçantë!" Vajza diç pëshpëritë, por ti nuk ia vë veshin. Gota e saj qëndron pranë saj, vërtet disi e pakëndshme - marri. Vajza mbyll sytë... Merre me mend, pas disa vitesh dëgjon se është bërë alkooliste, kjo i është reflektuar edhe në bashkëshortësi, edhe te fëmijët, dhe të gjitha ato tmerre që i lexon nëpër gazeta dhe në statistika. Lexon diagozën e medicinës zyrtare, ashtu kuturu, duke kërkuar vetëm shprehjet karakteristike, dhe përsërit: "Kush do ta priste këtë prej saj!" E nuk mendon asnjë moment se ti ia ke ofruar gotën e parë.

**ALTRUISTI** (Ka hapur sytë dhe s'di se ç'të thotë)

**REALISTI:**

Ç'je lidhur sot për pije?

**BESIMTARI:**

Nuk jam lidhur unë, por ju. Tekefundit, ju do të braktisni pijen kur të fitoni infarkt, atëherë do ta kuptioni seriozisht. Islami kërkon që qysh tani ta kuptioni seriozisht ndalimin e saj, dhe kjo nuk është diçka jonormale.

Feja kërkon që mos të teprohet në ushqim, dhe kjo është plotësisht në pajtim me rregullat medicinale.

Feja kërkon shkuarjen në Haxhxh një herë në jetë. Asgjë e pazakonshme as e çuditshme. Njerëzit gjithsesi vrapojnë në të gjitha anët e botës të shohin e të përjetojnë diçka jo të rëndomtë.

Namazi! Përse të pengon ty se ky na qenka një ritual. Ty as nuk të shqetëson përbajtja e tij shpirtërore. Ty të çudit që ajo e dyta përputhet me rregullën e cila të shtyn të vravosh shtigjeve. Namazi nuk është ushtrim trupor, siç mendon ti, ai është njëkuptimësh, edhe pse është shumëfunksional. Dhe ai nuk është në kundërshtim me rregullat medicinale, është i dobishëm. Mirëpo, kuptimi i tij qëndron në tregimin e disponimit shpirtëror në një mënyrë të veçantë: njerëzit gjithmonë i janë lutur diçkasë, dikujt, ndërsa feja thotë se për këtë është i denjë vetëm Zoti.

**ALTRUISTI:**

Këtë e kanë bërë dikur njerëzit kur kanë qenë të egër... të egër në shpirt.

**BESIMTARI:**

Mashtröhesh! Të shikoj se si i përshëndet disa. Nuk është ajo "Tungjatjeta!" dhe lëviz kokën. Ajo është përulje. Madje kur ka të bëjë edhe me zonjë, këtë e dëshmon me fjalët: "Përkulja ime!"

**ALTRUISTI:**

Kurrsesi s'është ashtu, kjo është diç krejt tjetër.

**BESIMTARI:**

Nuk është, kjo është njësoj. Vetëm nëse ti në përkuljen tënde nuk sjell ndonjë element ironik. Në çdo rast, pusho t'u falesh një-rëzve dhe fillo t'i falesh Zotit, natyrisht me seriozitetin e duhur. Ai këtë e kërkon. (Altruisti mbeti pa fjalë. Shihej se është tepër i befasuar. Kuptohej se njiheshin mirë, por kurrë nuk kishin zhvilluar biseda të këtilla. Edhe realisti heshti e pastaj...)

**REALISTI:**

Unë këtë e kisha bërë, por përse kur Ai nuk ekziston!

BESIMTARI:

E çka do të bëhej nëse Ai ekziston!?

REALISTI:

Asgjë, unë do të them: “O Zot, ti më ke krijuar të këtillë, a thua për këtë do të më bësh përgjegjës!?”

BESIMTARI:

Edhe ti mendon që Atij t'i thuash kështu, duke qeshur. Unë dyshoj në këtë. Moti të shikoj, kur kishe atë komplikimin në punë. Ishe nervoz dhe i brengosur se si do të reagojë eprori yt. E shikoje në sy dhe përpiqeshe t'i lexosh mendimet, ndërsa ishe plotësisht i pastër në atë çështje. E tani paramendoje Atë, i cili të ka krijuar, nëse të pyet:” Përse nuk iu përgjigje thirrjes Sime?...”

REALISTI:

Ç'farë thirrjeje?

BESIMTARI:

Në Kur'an.

ALTRUISTI:

Unë jam përpjekur ta lexoj Kur'anin, por ore vëlla, disi më është i çuditshëm, disi i pér...pér...

BESIMTARI:

... thuaj lirisht, lirisht ... i ngatërruar.

Atëherë diç nuk është në rregull me ty!

REALISTI:

Si bëhet ashtu? Çfarë logjike është ajo? Ja shiko: Më preferuan një ditë një libër rreptësisht profesional nga fusha ime, “shumë interesant”, thonin, është nga eksperti i njohur. E marr dhe e lexoj dhe... fjeta! E këndej ekspert i njohur... ai është fajtor!

BESIMTARI:

Nëse ti nuk ke gjetur asgjë në Kur'an për vete, atëherë ti je fajtor. Ta sqaroj: Ti e di se unë që nga bankat shkollore nuk kam pasur kurrfarë prirjeje ndaj muzikës. Te ti ka qenë ndryshe. Singerisht ta pranoj, pérherë kam menduar se aty ekziston njëfarë snobizmi, unë kurrë nuk kam besuar në vlerën e mirëfilltë të muzikës. Mirëpo, njëherë dëgjoj radion kur e paralajmëronte valsin e Shtrausit: “Në Danubin e bukur kaltërosh...” dhe pér herë të parë taktet muzikore më parafytyruan pamjen e valëzimeve që lagin breglumin dhe më dukej sikur i shikoj në realitet.

Sikur të isha piktor do të mund ta pikturoja këtë bukuri magjepsëse. Fatkeqësisht, kjo zgjati vetëm një moment-dy, pastaj çdo gjë u zhdavarit dhe unë e humba fillin. Megjithatë kjo për mua qe

një befasi dhe një zbulim. Më vonë jam përpjekur ta kuptoj muzikën, por nuk shkon. Kështu pres Smetanën dhe veprën muzikore të tij “Atheu im.” Spikeri shpjegon: “Vëltava, e cila depërton nëpër viset malore, nëpër pyje, dëgjohen sharrat, cicërrima e zogjve, pastaj Vëltava derdhet rrafshinës.” Spikeri më zgjoi aq shumë interesim, saqë më parë fillova t’i përjetoj ato piktura muzikore. Kur atje... sinqerisht kam qenë i dëshpëruar. Jo në Smetanën, por në vetvete. Betoveni, Vagneri, Listi e të tjerët përmua do të mbeten emra të rëndomtë. Dyert e mbretërisë së tyre kanë qenë vetëm përmjës të hapura, e pastaj përsëri u mbyllën fort para meje. Unë jam i shurdhër përmja. Ndoshata edhe ju jeni të shurdhër ndaj Kur'anit. Kur'anit nuk i qasemi sikur librave të tjerë të cilët i lexojnë një herë ose ndoshata edhe disa herë. Kur'ani lexohet pandërprejtë. Vlera e tij është se në të çdo njeri, i çfarëdo kohe qoftë, mund të gjejë porosinë përvete. Kuptimi i fjalive të tij është aq i ngjeshur, saqë prej një faqeje mund të shkruani një roman të tërë. Një fjali mund ta lexoni me qindra herë, e të mos e hetoni, atëherë përnjëherë fillon të jehojë në shpirt si ushëtimi në mal. Lëkura ju ngjethet, e nga sytë rrjedhin lotët.

**ALTRUISTI:**

A thua ti vërtet beson se Kur'ani është nga Zoti?

**BESIMTARI** (pas një mendimi të shkurtër, filloi ngadalë, duke pshërejtitur pothuaj çdo fjale):

Në të më shtyu shumëçka. Unë e kam plotësisht të qartë, se unë dhe çdo gjë që gjendet përreth meje është fryt i ndonjë fuqie, fuqi me të gjitha ato veçori dhe atributë që përcaktohen me konceptin Zot. Dhe plotësisht më duket e arsyeshme se neve, njerëzve, të këtillë çfarë jemi, ajo fuqi na dërgon porosinë e Vet. Nëse ky nuk është Kur'ani, kush do të jetë atëherë? Mua më impresionon që ai fton në përhershëmërinë e një parimi në këtë botë të ndryshueshme. Sikur unë të besoja se Kur'ani është vepër e Muhammedit, atëherë Muhammedin do ta konsideroja psikologun më të madh që ka pasur bota ndonjëherë: i shtyu miliona njerëz të jetojnë dhe të punojnë në një mënyrë, ku është e nevojshme një punë e vështirë, por kjo s'është vështirësi me të cilën ne në aspektin fiziologjiko-biologjik shkelim jetën normale, por është vështirësi psikologjike e cila pushon të jetë e tillë kur buron nga besimi. Muhammedi nuk i ka entuziazmuar besimtarët, por i ka bindur. E si të arrihet ky sukses? Mbetem i shtangur prej nga i erdhë atij njohja e psikologjisë njerë-

zore. Kur e lexoj Kur'anin, shoh se Muhammedi nuk e ka njojur edhe aq shumë. Kur'ani është vepër e Zotit.

Ti vetë thua se Muhammedi është i sinqertë në sjelljen e tij. Pra ja: ai asgjë tjetër as nuk ka pohuar, por se është njeri i rëndomtë dhe transmetues i porosisë së Zotit.

(Pasoi heshtja. Gjatë nuk foli askush. Në atë moment hetuam se diku larg vetëtinte. Retë ishin grumbulluar. U nisëm. Rigat e shiut ftohën ajrin e zjarrtë. Në makinë filloi bisedë e re, për gjëra të rëndomta, të përditshme. Këtë bisedë as s'e dëgjoja. Mendoja për atë të përparmen, vlen të mbahet mend).



## LETËR E HAPUR\*

### Sinodit të Kishës Ortodokse Serbe, Beograd

Me respekt të veçantë i drejtohem tubimit të nderuar të popullit serb. Jam besimtar dhe i përkas popullit musliman. Ky pohim është i mjaftueshëm që letra ime të kuptohet në tërësi. Emri dhe mbiemri im, mosha, profesioni dhe vendbanimi janë pa rëndësi.

Shkas i kësaj letre ishte romani i Vojislav Lubardës “Metamorfoza”\*\* i publikuar vitin e kaluar në edicionin “Naprijed” në Zagreb. Thënë shkurt: shkas i saj është mënyra se si është kuptuar ky roman në popullin Tuaj, ku dëgjohen vetëm zëra lavdate, gjë që krijon përshtypjen e një qëndrimi të përgjithshëm unik. Heshtja e përfaqësuesve të Kishës mund të shpjegohet vetëm si pajtim i plotë me këta zëra. Ndërsa është pritur se nëse - askush tjetër - së paku klerikët do ta ngrenin zërin kundër këtij rrëbeshi të urrejtjes. Ja përse:

“Metamorfoza” e Lubardës vlon nga urrejtja ndaj turqve, turkoshakëve, muslimanëve dhe fesë së tyre. Kjo është një përpjekje letrare e një dredhie dhe bishtnimi shekullor të ushqyer artificialisht nga instinktet e errëta njerëzore duke i shkulur nga thellësia e ndërdijes e ngritur në gjendje të vetëdijshme, së cilës do të duhej t’i takonin pasojet historike. Kjo në të njëjtën kohë është cytje dhe

\* U publikua në *Islam und der Westen*, Jahrgang 1, Heft 4. Wien, dhjetor 1981 (safer 1402).

\*\* Romani i Vojislav Lubardës në original titullohet “Preobrazhenje” që do të thotë transformim ose metamorfoza.

arsyetim për shfarosjen e një populli të tërë. Në një zinxhir të kobshëm, që shtrihet nga e kaluara e largët: në një varg këngësh popullore, te “Kurora e maleve” e Njegoshit, në veprat e nobelistit Ivo Andriq dhe të paraardhësve të tij, “Metamorfoza” e Lubardës përfaqëson kulmin e llojit të vet. Ajo që është shkruar në atë roman dhe dukuritë që ndodhin, qëndrojnë aq larg nga mësimet ungjillore përdashurinë dhe faljen, kthimin e së keqes me të mirë, saqë është vështirë të vihen në lidhje me çfarëdo forme të humanizmit. Qëllimi i kësaj letre nuk është vërejtja përkëtë. Autorit të kësaj reviste gjithashtu nuk i flen në intencë, që klerikëve t'u bëjë vërejtje përgatishmërinë e pamjaftueshme që të gjykojnë dhe të kundërshtojnë vërvshime të këtilla të mosdurimit. Në dukuri të këtilla ai është mësuar. Kështu ka qenë te ne që nga kohët e lashta.

Po ashtu, qëllimi i kësaj letre nuk është që të kthejë vëmendjen në të, se gjithë ky shkarkim letrar nuk ka kurrfarë lidhjeje as me objektivitetin e as me drejtësinë. Ngacmimi jongjillor i klerikëve me parullën: “Të hakmerresh - të shenjtërohesh” nuk është respektimi i Dhjatës së Vjetër “Sy për sy...” sepse turqve vazhdimisht u ngarkohet një gjë që s’ë kanë bërë: *gjenocidi*. Sikur vërtet ata ta kishin bërë këtë, sot nuk do të kishte kush t'u kërcënohej me hakmarrje. Pushteti i tyre nuk ka zgjatur pesë vjet, por pesëqind vjet!

Nëse ajo literaturë predikon ndjekjen e turkoshakëve, sepse kinse e kanë tradhtuar fenë e baballarëve të tyre, të polemizosh rreth kësaj “se kush kë e tradhtoi”, kjo nuk do të ishte asgjë e re. Vetëm Kur’ani polemizon me kundërshtarë të tillë, të cilët e arsyetojnë armiqësinë e tyre me faktin se nuk duan ta braktisin fenë e baballarëve të vet, dhe i pyet ata: “A thua edhe atëherë kur ata janë të humbur!?” Personazhet e Lubardës nuk e kuptojnë sa e pakuptimitë është t’i akuzosh të tjerët për tradhtinë e besimit të stërgjyshërve. (Edhe stërgjyshërit e tyre kur e pranuan Krishterimin e tradhtuan fenë e etërve të tyre.) Kjo nuk shpie në marrëdhënie të arsyeshme ndaj të tjerëve. Tradhtitë nuk ekzistojnë. Tradhtia është vetëm një. Tradhtarë është vetëm ai i cili tradhton Zotin dhe ligjet e Tij, dhe në pajtim me këtë, ai i cili shkel fjalën e dhënë, të dhënë në emër të Tij, për veprën me të cilën Ai është i kënaqur. Muslimanibesimtar nuk është tradhtar. Ai është i cili i pranon të gjithë librat autentikë të Zotit dhe pranon të fundit - Kur’anin, kurse ju këtë e mohoni. Mirëpo, ta lëmë këtë për Ditën e gjykimit - sepse edhe ashtu ajo ditë nuk është aq larg! - atëherë do të mësojmë, kush është besimtar e kush është tradhtar.

Natyrisht, lubardasit qortojnë: "Ndërsa dyzetenjëshi,... dyzetenjëshi! Ata sillen në atë mënyrë sikur të ishte e mirëseardhur përt, që të mund të ushqenin urrejtjen e vet me të. Për dyzetenjëshin do të duhej të merreshin gjerë e gjatë në një rast tjetër. Por, personazhet e Lubardos bëjnë gabimin themelor që gjithmonë nisen prej vetes, kurse kurrë nuk e shohin mëkatin e tyre. Për çdo fatkeqësi që i godet gjithmonë është fajtor "dikush tjetër atje." Kurrë nuk duan ta shohin, qoftë edhe si dënim i Zotit për veprat e tyre mëkatore, qoftë edhe si sprovim i Zotit për qëndrimin e tyre moral dhe bindjet e tyre morale, ose si pasojë edhe të njërsë edhe të tjetrës.

Nuk ishte qëllimi që të thuhet e tërë kjo (e gjithë kjo është thënë në të kaluarën dhe është dokumentuar edhe më mirë), mirëpo ka qenë e pashmangshme që të preket kjo çështje.

"Metamorfoza" e Lubardës vazhdon pothuaj një traditë të vetëdijësimit, por shkoi edhe një hap më tej, një tmerr në përmasa kozmike në mënyrën në të cilën deri më tanë, sa i është e njojur publikut të gjerë, askush nuk guxoi. "Metamorfoza" e Lubardës i ofroi botës sharjen në Zotin - ndoshta për herë të parë të shkruar në historinë e gjinisë njerëzore!

Edhe diçka - (sa kohë e errët!) - askush as nuk ia vë veshin asaj. Madje as ju klerikët. Ju silleni sikur për këtë ose nuk dini ose nuk çani kokën. Lini përshtypjen se nuk jeni as të vetëdijshëm se Lubarda dhe personazhet e tij letrare me aktin e tyre ju bëjnë përgjegjës para Zotit. A thua Ju kuptioni - edhe tash derisa jeni duke e lexuar këtë - përse është fjala? Ndoshta nuk është e nevojshme t'ju thuhet se All-lahu - në emrin e të cilit Lubarda hedh ofendime në-përmjet gojës së personazheve të veta - nuk është askush tjetër, por Zoti i tij dhe Zoti juaj?! All-lahu - Ai nuk është Zot i turqve, Ai është Zot sa i turqve aq edhe i popullit serb si edhe i të gjithë popujve të botës. All-lahu - është Ai, emrin e të cilit e himnizuan Ademi, Nuhi, Jehova, Ibrahimi, Jakupi, Musai, Dauti, Sulejmani, Isai, Muhammedi... Se si do ta quajmë Atë - a thua Jahve, Jehova, Andonaj, All-lah, Zot, Krijues, I Madhërueshmi... kjo për besimtarët nuk është kontestuese, sepse emri i Tij nuk është vetëm një, por Ai për ta është i vetmi Sundues i gjallë dhe i amshueshëm. Në shpalljen e Vet të fundit, në Vërejtjen e shenjtë, Ai i është paraqitur gjinisë njerëzore me 99 emra të ndryshëm.

Ndërsa tanë - shih! - një Lubardë, - pothuaj një popull i tërë, i tërë kleri i tij... E pastaj Ju, priftërinjtë, i jeni përgjëruar Atij, se do ta himnizoni emrin e Tij dhe do ta imroni nga të poshrit! A thua

nuk e ndjeni për detyrë t'ia têrhiqni vërejtjen Lubardës dhe lubardasve për mëkatin e tmerrshëm që del nga goja e tyre?

Ndoshta nuk do të filloni edhe Ju tanë: "Letërsia... literatura bashkëkohore... një vështrim artistik... pasqyra e jetës nga ana e pandriçuar"?! Të gjitha këto janë dokrra! E ashtuquajtura shprehje artistike nuk është ajo që i entuziazmon lubardasit. (Kur'ani ka realizim artistik të pakrahasueshëm, ndërsa ata sillen në mënyrë refuzuese ndaj tij: nuk u përgjigjet shpirtit të tyre, dhe ja!). "Metamorfoza" e Lubardës përfaqëson bastardimin më të mjerë. Nëse letërsia e kulturës bashkëkohore ka rënë në nivelin e synimeve të pafisnikëruara dhe në shprehje të pakulturuara - madje edhe të këtilla, - si pasqyrim më i fuqishëm i realitetit... asgjë, aq më keq edhe për kulturën, edhe për realitetin, edhe për vetë ne... atëherë paskemi arritur deri në fund edhe të realitetit edhe të kulturës sonë.

Këtu është e palejueshme që të lahen duart sipas recetës: "Këtë nuk e kanë shkruar duart tonë. Kjo neve nuk na intereson!" Kjo pikërisht ju përket Juve. Ju e dini fare mirë, se në Gjykatën e tmerrshme do t'ju pyesin për veprimet e grigjës suaj. Nëse nuk e çani kokën për Kur'anin, e as nuk ju intereson se ç'thotë për dyfytyrëshat dhe shkrimtarët, ja ku e keni shembullin në qëndrimin e Krishtit ndaj shkrimtarëve dhe farisejve. Përse Ju do të silleni ndryshe? A thua Ju nuk frikësoheni nga hidhërimi i Krijuesit tuaj? A thua në atë popull nuk ka njerëz të drejtë, veprat e të cilëve Zoti do t'i përfillë, do të mëshirohej dhe do të përmbahej nga dënimimi?

Të shohim se ç' i ndodhi njërsës nga kishat më autoritare: Kishës Ortodokse Ruse! Ku janë autoriteti dhe fuqia e saj e dikurshme? Ç'u bë me lojalitetin e grigjës së famullive të saj të shumta? Kush është fajtor për këtë?

Secili prej nesh mund të ketë shpjegimin e vet, por çfarë do të ishte kundërshtimi Juaj në këtë qëndrim:

Rrënimi pasoi kur s'mbetën njerëz në zë, siç ishin Tolstoi i Dostojevski, të cilët sinqerisht u mbështetën në virtytet unggjillore. Kleri ortodoks rus ua predikonte të tjereve mohimin e pasurisë dhe të pushtetit, ndërsa për vete nuk pati as forcë e as vullnet që të veprojë në këtë mënyrë. Kisha u ngrit ndër feudalët më të mëdhenj dhe përmbante një gjendje të padurueshme. Klerikët silleshin në atë mënyrë sikur të thonin: "Të jesh besnik në kohën e Krishtit, disi ka qenë e mundshme, por sot (në kohën moderne) - kjo është e pamundshme!" A thua vepër e regjimit bolshevik nuk është përgjnjeshtrimi i të menduarit të këtillë? Ai i çpushtetizo i varfëroi

edhe ata edhe këta, që i përkrahën. A s'është kjo shenjë e madhe nga Zoti? A thua Zoti me këtë nuk ua mori fjalën, me të cilën në Ditën e gjykimit të tmerrshëm, do të arsyetonin jobesnikërinë e tyre? Dashuria e tyre ndaj Zotit nuk qe aq e madhe, saqë ta bënин nga dashuria atë që bolshevizmi e bëri nga urrejtja. Këtë Zoti ua dëshmoi dhe ua argumentoi para gjithë botës.

Ose diç e këtillë, për ne më e afërt: Kam njohur një person, i cili vetvetes ia kishte zbuluar të vërtetën për shkatërrimin e Jugosllavisë së vjetër: për shkak të sharjeve! Pushteti më i lartë i Jugosllavisë monarkiste përsaqësohej sipas mëshirës së Zotit! Megjithatë në atë shtet, në çdo vend dhe në çdo situatë vetëm shahej. Asgjë këtu nuk kursehej, madje as emri i Tij; ndërsa këtij pushteti dhe të gjithë atyre, të cilët e pranuan, e përkrahnin dhe e shfrytëzonin, as që u shkonte ndër mend të kishin kujdes për këtë. Në kohë të mirë - të lazduar dhe jomirënjos. Në kohë të liga edhe më të këqij, ndërsa shumë syresh edhe E mohonin.

Ashtu siç janë sjellë ndaj Zotit, ashtu edhe Ai i ka shpërblyer!

Ja diç edhe më konkrete:

Të gjithë ne, serbët, kroatët, sllovenët, muslimanët dhe të tjerët - i pranuam parimet e vëllazërim-bashkimit të Jugosllavisë së re. Këtë e përforcojnë edhe deklaratat dhe veprimet përkatëse në çdo situatë. A është pranuar kjo shpirtërisht apo si opurtunitet politik, nuk do të ishte e udhës ta shqyrtojmë, por thelbësore është kjo: kjo nuk ishte e pranuar nga motive ungjillore. Ishte e imponuar nga ana e ateistëve si e vëtmja zgjidhje e arsyeshme. A thua nuk e shihni në këtë vërejtjen e Zotit? Këtë ende nuk e kishin kuptuar njerëzit besimtarë. Ato akuzoheshin nga ateistët se kishin qenë të verbuar nga feja, kurse ne të gjithë po shohim se aty ka pasur shumë pak besim, pak ose aspak.

*E si atëherë, ashtu edhe tash.*

Nëse poshtërsia e Lubardës nuk e ka shqetësuar ndërgjegjen Tuaj, aty më kurrfarë të mire s'ka. Nuk mund ta bind veten, se te Ju feja është shuar. A thua nuk shihni Ju, se "Metamorfoza" e Lubardës është sprovë e madhe e Zotit për të gjithë? Mos të magjepsemi me entuziazmin e lubardasve, e as me mirënjosjet vezulluese dhe dhuratat për trimat e tij! Ç'mandoni, a do të lejojë Zoti, që një sharje e këtillë në madhështinë e Tij, t'u ofrohet fëmijëve shpirt-dëlirë si shembull i krijimtarisë letrare? A llogaritni në atë se Zoti mund t'ua marrë, t'ua shpëtojë shpirrat e tyre ende të panjollësur, kurse Juve - si dënim! - t'u lërë topitjes dhe brengave prindore? Ose

ndoshta është afruar momenti i tmerrit të paralajmëruar, momenti në të cilin - ja! - pikërisht grigja Juaj ia ka sigruar vetes përparësinë në mëkatin e tmerrshëm?

Askënd mos ta mashtrojë mëngjesi i mirë e me diell i ditës së sotme! Nëse do Zoti, kështu do të jetë edhe nesër, pastaj edhe ditëve të ardhme, por askush mos të ngutet të thotë: "Asgjë nuk do të ndodhë!" Dënim i tmerrshëm i Zotit papritmas mund të lëshohet mbi të gjithë ne.

Kjo nuk është kurrfarë profecie, por përfundim logjik i nxjerrë nga mësimi themelor i të gjitha librave të Zotit: ato që i pranoni Ju dhe ato, të cilat i pranojmë ne.

Është vështirë të parashihet se a thua për hir të vullnetit të Zotit do të ndërmirni diç në këtë punë. Çështja qendrore është - çfarë jehone do të ketë kjo letër. Megjithatë shpresoj se kjo, krahas tronditjes e cila për arsyen tē qarta shpërthen nga ajo - në fund do të jetë shkas për dashamirësinë Tuaj, të dëshmuar me gjykim tē theksuar tē së keqes në shoqërinë tonë, qoftë edhe tē reduktohet kjo vetëm në ligjërimin letrar tē individit tē huaj. Me përshëndetje miqësore dhe lutje Të Plotfuqishmit t'u dhurojë maturi të gjithë njerëzve vullnetmirë!

## NDJENJA JONË E INFERIORITETIT

---

Në një rast qëllova në një shoqëri me njerëz pak më seriozë, njerëz me përvojë jetësore. U shtrua pyetja: *Përse Islami sot në botë nuk përfaqëson atë që duhet të jetë sipas vetë mësimit të tij?*

Aty është shpallja e fundit e All-llahut - Kur'ani. Numri i pjesëtarëve të tij sillet ndërmjet një të pestës apo një të katërtës së njerëzimit. Ndërsa, në botën e sotme - në mundësitetë bashkëkohore të komunikimit dhe informimit - Islami është gati i panjohur. Ndërsa vetë Kur'ani për vetveten thotë “*Është vërejtje për gjithë botën!*” Mirëpo, edhe atje ku është i njohur, dispozitat e tij respektohen pak. Përse?

A thua këto dispozita janë të vështira?

A thua obligimet e tij janë të padurueshme?

A thua ndalesat e tij janë të pazbatueshme në praktikë?

A thua kërkesat kur'anore janë të panatyrshme?

U bënë shumë vërejtje, por u reduktuan në një: faji qëndron te vetë ne. Fatkeqësisht, nuk është një gabim, por një varg gabimesh. Por, mua më ra në sy njëri prej tyre; ne muslimanët, në çdo hapndeshim një ndjenjë të pazakonshme dhe të paarsyeshme - ndjenjën e inferioritetit!

Kjo ndjenjë na përcjell gjithkund, në çdo hap, si hije. Ne tur-përohemë të pranojmë se jemi muslimanë. Shpeshherë nga goja e të huajve mund të dëgjojmë shumë gjëra të bukura për Islamin, megjithatë ne i ikim deklarimit se i takojmë atij. Prej nga kjo ndjenjë? Prej nga kjo dukuri kur do të duhej të ishim të lumtur për bindjetonë. Ai, besimi islam, do të duhej të na frymëzonte me qëndrueshmëri dhe fuqi. Kurse ne jemi larg nga ajo. Ne ndjehemi si fajtorë,

ndaj edhe si të tillë sillemi. Ne nuk kemi vetëbesim: e dëshmojmë qartë se nuk kemi besim në atë, të cilës i përkasim.

Pamja e përditshme me të cilën ndeshemi është e këtillë. Djaloshi ose vajza nga familja muslimane; edukata; aq sa është - është islame. Mirëpo, sjellja e tij ose e saj në kontakt me ata që nuk i takojnë Islamit - qofshin ata pjesëtarë të konfesioneve ose ateistë, madje edhe ata që janë indiferentë ndaj fesë - është krejtësisht nën nivelin që do të prisnim. Janë të shqetësuar, nuk ndjehen mirë, sepse çdo gjë për ta është ndryshe. Asgjë për ta nuk është si në mjedisin e tyre! As ushqimi! As pija! As biseda! As bashkëbisedimi! Ata zbulojnë se krejtësisht kanë qëndrime të ndryshme edhe ndaj jetës edhe ndaj vdekjes. Zbulojnë se u takojnë botëve të ndryshme. E po mirë! Le të jetë ashtu! Mirëpo, përse tek ata shfaqet kompleksi i inferioritetit? Kjo s'është normale. T'i takosh Islamit dhe të jesh i ndrydhur nga disa komplekse, e madje edhe t'u nënshtrohesh - kjo është e palogjikshme. Ja përse. Të nisemi nga baza!

Në kohët e sotme nuk është moderne të jesh religjioz. Ky është fakt. Ta pranosh tekstualisht dhe besnikërisht religzionin - këtë mund ta bëjnë vetëm individë të veçantë. Si duhet t'i trajtojmë këta individë: si të shenjtë apo si të marrë? - kjo është e dorës së dytë. Por me rëndësi është të pandehet se religioni nuk është për masa të gjera popullore.

Kjo është dukuria që ende gjallëron në botën moderne si frysht i përvojës së Perëndimit dhe i dominimit të tij në kulturë dhe në shkencë gjatë këtyre shekujve të fundit.

Mirëpo, Islami nuk mund të reduktohet në konceptin e religionit ashtu siç definohet ai në përgjithësi. Koncepti *religion* për Islamin është tepër i ngushtë dhe i njëanshëm. Islami me pikëpamjet e veta ndaj botës dhe jetës së njerëzve është shumë më i gjerë se çdo religion ose çdo ideologji tjeter. Islami në mësimin e vet është gjithëpërfshirës dhe i plotë. Për të në këtë kuptim nuk ekzistonë përkufizime sakrale dhe laike. Për të, tërëjeta njerëzore, gjithë veprimtaria njerëzore dhe përfundimisht vdekja e njeriut, është një tërësi kuptimplotë. Ai është këtu për vlerësimin e çfarëdo veprimtari njerëzore.

Islami është krejtësisht i natyrshëm dhe i pranueshëm si përlaikët ashtu edhe përtë diturit, përtë pasurin dhe përtë varfërin, përtë fortin dhe përtë dobëtin. Islami nuk është religion i njerëzve të veçantë, i filozofëve dhe i të diturve: Islami s'është përjetim i një

numri tē vogël njerëzish tē zgjedhur. Ai nuk është religjon figurash, statujash, amuletesh, i magjive, i horoskopeve, i kamuflimeve.

Islami është ajo, e cila nē mënyrë tē domosdoshme i imponohet njeriut tē rëndomtë dhe normal edhe nga arsyaja edhe nga ndjenja nē shpirtin e tij. Sepse, Kur'ani thotë:

*"Nuk është e gjithë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytarat tuaja nga Lindja ose Perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, Ditës së Gjykit, engjëjve, librit, lajmëtarëve, dhe pasurinë që e do, ua ndanë tē afërmve, jetimave, tē varfërve, udhëtarëve, lysorëve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë edhe e zbatojnë, dhe tē durueshmit nē skamje, nē sëmundje dhe nē flakën e luftës. Të tillët janë ata tē singertit dhe tē tillët janë ata tē devotshmit. (El-Bekare, 17)*

Islami nuk njeh as idhuj, as kulte, as tē shenjtë. Vetëm All-llahu është i madhëruar, i shenjtë dhe i pastër: All-llahu është i vetmi që është i denjë për adhurim. Vetëm All-llahu është Zot. Të dërguarit e Zotit kanë qenë njerëz tē rëndomtë. Kur'ani bën fjalë edhe për gabimet e tyre: rasti i Ademit a.s., rasti i Junusit a.s., nē surenë "Abese" qortohet Muhammedi a.s. E atëherë, pse tē turpë-rohemi tē pranojmë se Kur'ani është përcaktim yni? Ne na mundon kompleksi i inferioritetit! Vetëm nuk e kemi tē qartë nē krahasim me çka! Ç'mund tē na ofrojnë tē tjerët nē vend tē Kur'anit?

Islami është shumë më i natyrshëm se sa mendimi i klishtizuar për fenë që e marrim nga Perëndimi. Sipas mendimit të Perëndimit, religjioni kërkon *mohim* dhe *refuzim*, ndërsa Islami kërkon tē përbajturit dhe maturinë. Kur'ani shpesh thekson: "*Këto janë dispozita tē All-llahut, pra mos i kundërshton!* (El-Bekare, 229) *Këto janë dispozitat e All-llahut, pra mos i kundërshton!* (El-Bekare, 186); *Kush e kundërshton All-llahun dhe Të dërguarin e Tij* dhe i shkel *dispozitat e Tij, atë e fut nē zjarr tē përjetshëm. E për tē* është një dënim i rëndë." (El-Nisa, 14).

Rregull e madhe e mjekësisë bashkëkohore është që tē mos teprohet nē ushqim. Ndërsa Kur'ani thotë: "...*Hani dhe pini e mos tepronit, pasi Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapérderdhin).*" (El-A'raf, 31).

Mjekësia bashkëkohore nuk flet aspak me admirim për mishin e derrit, megjithatë tē gjithë ne jemi dëshmitarë edhe qesharakë edhe tē mjerë - tē sjelljeve tonë kur kemi ardhur nē aso situate dhe e

kemi konsumuar gjënë të cilën nuk e preferon shkenca moderne, kurse All-lahu që nga kohët e lashta na ka ndaluar përdorimin e mishit të derrit. Kjo nuk ndihmon asgjë, madje as ajo se mishi i derrit na gërditë; shumë muslimanë janë mësuar me të. Përse? Për shkak të ndjenjës së inferioritetit!

Xhahilët mendojnë se të jeshë besimtar do të thotë të jesh i privuar nga shumë kënaqësi të jetës. Ata nuk janë të vetëdijshëm se ajo që ata e quajnë kënaqësi e jetës, përfaqëson shkatërrim për individin, për familjen, për bashkësinë.

Shikoni vetëm alkoolin! Sa kontradiktor është njeriu bashkë-kohor! Ai i vëren vetë pasojat e tmerrshme të alkoolizmit, për to vazhdimesht shkruan dhe flet, ndërsa nga ana tjetër, nuk heq dorë nga kjo e keqe. A do të dijë kush ta tregojë kufirin që e ndan këtë të keqe nga “kënaqësia jetësore” dhe tmerret e jetës? Jo, këtë askush nuk di t’ua tregojë!

Ju mund të dëgjoni vetëm se çfarë marrish fliten. Shembulli i sparkanëve të vjetër është shembull didaktik: ata i dehnin skllevërit e vet - helotët për t’i treguar rinisë së vet se sa e neveritshme është sjellja e njerëzve të dehur.

Ne të gjithë po e shohim se shumë pak po ndihmon akuza e shkencës, ndërsa Kur’ani e ndalon alkoolin. Njerëzit pijnë! Përse! Përse kur as gota e parë e as e dyta - sipas vetë pohimit të tyre - nuk ishte kurrfarë kënaqësie. - Nga ndjenja e inferioritetit! Të gjithë ata thonë: “Le të jetë sa për shoqëri! Nuk dua të jem i veçuar nga të tjerët!” Së shpejti kjo bëhet shprehi jetësore. Ndërsa një ditë pasion pa të cilin nuk mundet. Kurrfarë kënaqësie e jetës. As bukuri e saj.

E njëjta dukuri ndodh edhe me duhanin. Për kë cigarja e parë ishte kënaqësi, dëfrim? Për kë? Për askënd! Ishte një kundërmim i erës së keqe, kundërmim i padurueshëm. Ngulfatje! Kollitje! Pësh-tyrje e shoqëruar me sharje intime. Megjithatë, njeriu vazhdon ta pijë. Përse? - nga ndjenja e inferioritetit. Dëshiron të bëhet burrë! Ta refuzosh cigaren do të thotë t’i ekpozohesh talljes dhe shpotisë: “Ti nuk je burrë!” Sa larg jemi nga kohët kur burrëria kishte kuptimin e besnikërisë, ndershëmërisë, sinqueritetit dhe trimërisë dhe përcaktimi i vendosur për to. Virtytet njerëzore përfaqësonin burrërinë. Ndërsa sot: kriter i burrërisë është vesi (e metë, shprehi e keqe).

Edhe tanë më tingëllojnë në veshë fjalët e një dashamiri:

“Kurrë nuk kam pirë duhan. Thjesht, kam menduar se nuk kam kohë për një gjë të tillë. Mirëpo, tanë pas aq viteve, e kuqtoj se ç’do

të thotë kjo. Kam filluar t'i analizoj ata që pijnë duhan dhe ata që s'pijnë në mesin e rinisë. Vërtet është vështirë ta definosh këtë, por e kam krejtësisht të qartë se bëhet fjalë për një të metë të madhe. Nuk di si ta quaj. Vini re gjestet e tyre. Vini re si e ndezin cigaren, si e shkundin shpuzën. Të gjitha këto janë poza, gjeste boshe. Në ndërdije luajnë njëfarë roli madhështor. Skena! Kurse në realitet perde tymi për të mbuluar zbrazëtirën e vet shpirtërore.”

Kalojmë nëpër park, kurse ai vazhdon: “Parandjej rrënjet se si meshkujt jepen pas pirjes së duhanit. Kjo është njëfarë nevoje për afirmimin e personalitetit. Ata mund të kenë vlera, madje edhe të janë të vetëdijshëm për to. Në jetën e përditshme mund të janë mjaft të vyer dhe të suksesshëm dhe të fitojnë afirmim në mjedisin e vet. Kjo i mbushë me vetëkënaqësi; në ndërdije dëshirojnë të dallohen në atë shoqëri, e kjo mund të ndodhë vetëm nëse shoqëria i pranon si “të vetët”, kështu që edhe pa vetëdije (shpesh edhe me vetëdije) përvetësojnë mjaft rregulla të sjelljes së asaj shoqërie. Atyre e mungon *njëfarë autonomie shpirtërore* dhe *njëfarë vetëkënaqësie*, njëfarë *stabiliteti shpirtëror* dhe *njëfarë bindjeje*, dhe një lojalitet ndaj asaj bindjeje.”

“Mirëpo, shihi këto nxënëse të shkollës së mesme! Ç'i shtyn ato që të pijnë duhan? Cigaret e tyre thjesht të shtangojnë. Ato nuk janë të vetëdijshme çka posedojnë: rininë dhe bukurinë - kjo duket, por duhet të kenë edhe mend: shkollohen - prandaj për të kanë vërtetim, dëftesa dhe diploma. A thua nuk është kjo e mjaftueshme t'i kundërvihen çfarëdo ndjenje të inferioritetit? Megjithatë, disi shumë lehtë i nënshtrohen. Ato as nuk janë të vetëdijshme, e as nuk ka kush t'u thotë se sa të pakëndshme dhe sa të marra duken me cigare në dorë. Madje edhe kriminele - sepse ato një ditë duhet të bëhen nëna!”

Në retë e tymit të duhanit lind gënjeshta e madhe e duhan-xhinjve. Ata flasin për kënaqësi të madhe... shkarkim. E në realitet, ata janë helmuar me duhan. E kanë mësuar organizmin me të. Ata më nuk mund të rrinë pa të. Ata janë robër të cigares.

Mbani mend: duhani është gjë e panatyrshme. Rregulla e madhe e natyrës është: ajo që nuk e ushqen organizmin-është helm. Të shuash urinë dhe etjen është një lehtësim dhe kënaqësi e vërtetë, natyrisht, me kusht që të mos teprohet. Edhe një gjë: mos harroni që për këtë dhuratë të falënderoni All-llahun! Në Kur'an thuhet: “*O ju që besuat, hani nga të mirat që ua kemi dhënë dhe falënderoni All-llahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuroni!*” (El-Bekare, 172).

Parimi themelor i Islamit është: Çdo gjë që i bën dëm njeriut-është e ndaluar! A ka gjë më të qartë që e ndan cigaren nga ushqimi i mirë dhe i lejuar?

Prandaj, nëse dikush ju ofron cigare, konsiderojeni armik. Ai është pa ndërgjegje, ai është pa përgjegjësi. E njeriut të tillë duhet thënë: "Në jetë mos iu nënshtoni duhanit! Nuk ka cigare të fundit, pas secilës vjen tjetra. Kjo është fatkeqësi e vërtetë! Vetvetes ia merr shëndetin dhe këtë budallallëk e bën me të holla personale." Mirëpo, duhanxhinjtë këtë nuk duan ta thonë, por përpiken që rrëthim e tyre ta zgjerojnë. Ata i janë nënshtuar këtij kompleksi, e tanë i udhëzojnë edhe të tjerët në të. Ata as nuk duan të mendojnë se ai është haram (i ndaluar). Ata nuk çajnë kokën për diç të tillë.

Ç'të themi për drogën! Është dëm i madh që droga ende është nën gjykimin shoqëror, sepse besimtarit do t'ia merrnin për të madhe nëse e refuzon prej vete këtë të ligë. Megjithatë, edhe pse e anatemuar nga shoqëria, droga po përhapet fshehurazi. Ajo po gjen viktimat e veta. Si mund t'i kundërvihet shoqëria kësaj? Praktikisht shumë pak. Çfarëdo masash që të ndërmerren, në fund tregohen si të pamjaftueshme.

Tmerri i drogës qëndron pikërisht në atë sepse çlirimi i vërtetë nga robëria e saj nuk ekziston.

Rrugë deri te droga është naiviteti dhe verbëria rimore, dëshira që të përjetohet "diç." Zbrazëti shpirterore që duhet mbushur me diçka. Individu dhe vëtmia e tij ndaj "shumicës." Kompleksi i inferioritetit! Dhe në fund...

Fundi nuk ekziston. Kënaqësia e fundit nuk ekziston – kënaqësia pas së cilës më nuk kërkohet asgjë. Ja, sot cigaret. Nesër këto nuk mjaftojnë. Ja edhe gota! Po, por edhe ajo nesër nuk mjafton. Sot marihuana. Nesër edhe kjo do të jetë e pamjaftueshme - duhet heroina! Fundi:... fundi është shkatërrim. A thua është e çuditshme që Islami e gjykon aq ashpër këtë rrugë të djallit?

Çështja e moralit është gjithashtu problem që e degjeron rininë tonë. Askund nuk konfrontohen aq shumë e mira dhe e keqja si në këtë çështje. Që nga kohët e stërlashta morali ka qenë i lidhur ngusht me fenë. Nuk ka fe pa moral, e as moral pa fe. Civilizimit bashkëkohor i kërcënöhët shkatërrimi pikërisht si shenjë vdekje-prurëse. Kriza e kulturës është shfaqur domosdo kur u nda kultura nga morali, kur në të nuk gjen shtytje as frymëzim. Dobësimi i vëtëdijes religioze e dobësoi disiplinën morale, si atë në kuptimin themelor të fjalës, ashtu edhe në kuptimin e gjerë të saj. Kufiri

ndërmjet moralit dhe jomoralit zhduket. E gjithë kjo filloi me parrullën: "Nuk duam moral të rrejshëm!", "Nuk duam kurrfarë ndalesash!" "Ndërpreni me tabutë!", "Duam marrëdhënie të lira seksuale!" etj.

Liria seksuale shumë e lëvduar, shpejt u dëshmua si egërsim seksual. I shkarkuar nga çfarëdo arsyе ose obligim, seksi merr forma të panatyrshme të llojit më të shëmtuar. Dimensioni i rrezikut të veçantë qëndron në atë se kjo dukuri fitoi mbrojtësin (patronin) në film, në letërsinë moderne dhe në përgjithësi në art. Tash këta mbrojtës në mënyrë të papengueshme, nëpërmjet televizorit, infiltrohen në shtëpitë familjare. Qëmoti kanë pushuar kundërshtimet ndaj tij për "hir" të lirisë krijuese. Madje nuk dëgjohen më zërat e protestës. U heshtën me klithmat: "Mjaft fariseizëm dhe moral të rrejshëm? Jujeni kundër artit, kundër lirisë artistike, ju fanatikë të pagdhendur...!" Rreth tyre, por edhe në vetë ata lind ndjenja e inferioritetit. Kjo në të vërtetë është njëra nga sprovat më të rënda për njeriun.

Dhe kështu derdhjet më të shëmtuara të veshura në petkun artistik shkatërrojnë shpirtin e njeriut bashkëkohor. Deri më tanë, morali ka qenë moral, jomoral-i-moral! E tash - ka arritur deri atje - saqë jomoral është bërë rregull e jetës. Për shembull, mashtrimi ndaj obligimeve dhe kujdesit bashkëkohor ka fituar mbrojtës të madh në art. Arsyetimi: "në emër të dashurisë... dashurisë së madhe." Morali i vjetër klasik thoshte se kjo është tradhti bashkëshortore. Mirëpo, kësaj gjithnjë e më pak i janë përbajturi. Sot ajo më nuk është as dashuri e madhe, as pasion të cilit nuk mund t'i përballohet, por thjesht tekanjozitet, argëtim. E gjithë kjo përmblidhet në përpjekjet që të dëshmohet shprehja artistike. Ky është koncepti i sotëm i librit "të mirë" dhe i filmit "të mirë."

Merreni si shembull filmin "Vdekja në Venecie"! Krejt goja është e mbushur me fjalën "art." Askush nuk gjykon me fjalët: "Jomoral!" Jomoral ka fituar mbrojtësin besnik në art. Askush nuk është më në gjendje që t'i vë pengesa imoralitetit.

Në shqyrtimet teorike vazhdimisht shtrohej pyetja: Ç'është arti dhe cili është misioni i tij? Në një tubim të shkrimitarëve dhe të teoricienëve të letërsisë u shpreh një mendim - vërtet i vetmuar, por mjaft interesant: letërsia do të duhej të predikonte moralin, atë që religjioni e bënte me sukses në të kaluarën. Mirëpo, mendimi mbetet mendim, ndërsa realiteti katandis në rrugë gjithnjë e më të keqe.

Se është kështu, do të analizojmë një vepër në mesin e shumë të tjerave të zhanrit të ngjashëm: "Farkuesit e monedhave të rrejshme." Shkrimtari: Andre Zhid, emër në zë i penës franceze. Shkalla më e lartë e stilit letrar. Shprehje e fuqishme stilistike, në të cilën vetëm mund t'ia kemi zili: disa personazhe përvetësojnë simpatinë tuaj, ndërsa të tjerët janë antipatikë për ju, pikërisht ashtu siç ka dëshiruar shkrimtari t'i prezentojë.

Ndërkaq, përse disa personazhe të romanit duhet të gjelqinë prirjen e lexuesit, t'i kuptojë ata, të "anojë" nga ata dhe në kundërshtim me ta, t'i urrejë personazhet tjera, t'i dënojë, t'i refuzojë - vërtet nuk është e kuptueshme.

Prej tre personazheve të romanit analizoni dy: shkrimtari i konfronton, pason ngatërrimi dhe konflikti. Shkrimtari përcaktohet për njërin e bashkë me të edhe lexuesi. Mirëpo, përse? Jo, mos mendoni se njëri është pozitiv, ndërsa tjetri negativ. Ajo që doni ta thoni: "Njëri është i mirë, kurse tjetri i keq", aspak s'është me vend.

Kriteret: i ndershëm, fisnik, i moralshëm, i fjalës, i singertë nuk kanë kurrfarë vlera reale për artin, që do të trajtohet si bashkë-kohor dhe që vërtet ashtu edhe trajtohet. Mbrojtësit e kritikave të këtilla, shkrimtari i quan farkues të monedhave të rrejshme, ata për të janë imoralë!

Po, t'u kthehem i atyre të dyve. Nuk është e qartë përse njërin duhet ta simpatizojmë, t'i dëshirojmë sukses, përfundim të mirë, ndërsa tjetrin ta urrejmë dhe t'i dëshirojmë dështim. Që të dy me profesion janë shkrimtarë. Që të dy janë të dashuruar në të njëjtin person.

E vërteta, ajo është fshehur, është mbuluar, konflikt i paspre-hur. Kjo është kohë moderne, e jo Mesjetë me qërim hesapesh kalorsiake. Mirëpo, e tërë kjo nuk ka rëndësi. E rëndësishme është edhe për shkrimtarin, edhe për artin edhe për historinë, edhe për lexuesin, edhe për të gjithë ne, kjo: që të dy janë të dashuruar në një djalosh, të bëhem i më të qartë - që të dy janë homoseksualë. Çfarë neverie! Të neveritshmit e këtillë luftojnë për vendin e vet nën diellin artistik.

Për këtë në roman nuk ka asnje fjalë dënuese. Përkundrazi, për këtë flitet me gjuhë lirike, me gjuhë kushtuar ndjenjave më të bukura të dy të dashuruarve siç janë Omeri dhe Merima ose një Hasanaginicë.

A duhet të ndihemi inferiorë e ta lëmë dhe ta harrojmë thesarin tonë të vërtetë kulturor me vlera etike?

A duhet tē sillemi si snobistë dhe ta pranojmë kulturën “moderne” çfarëdo qoftë ajo. Këtu nuk flitet pēr artin por pēr moralin, më saktë pēr jomoralin, tē cilin na e ofron jeta bashkëkohore nē formën e artit.

Vesi nuk është vet, nuk është vetëm një, një ves tērheq tjetrin. Dhe thjesht, është e pakuptueshme edhe kjo! - tē ndihemi inferiorë nēse jemi pa vese! Sikur duam tē dëshmohemi pikërisht nē veprimet më tē pakulturuara. Kur i dëgjojmë sot tē rinjtë dhe pleqtë, fitohet përshtypja se këtu më nuk ka kurrfarë bindjeje, as motive fisnike, as ndershmëri, as moral, as fjalë tē denja...

Megjithatë, ndoshta kjo është pamje e gabuar. Ndoshta pēr gjithë këtë fajtore është ndjenja e vtmisë dhe e izolimit tē atyre që besojnë. Ose janë tepër tē tērhequr?

Mirëpo, ku janë veprat e tyre?

Pērse tē ndjehen tē vtmuar, pērse janë pa vepra?

A thua nuk është ky kompleksi i inferioritetit?

Ose ai është iman i dobët?

C'mendoni ju?

\* \* \*

Kjo ka qenë e shkruar nē vitin 1979 dhe i është dorëzuar Hasan Çengiqit si ligjëratë pēr rinnë nē mesxhidin e Tabakut. Nē procesin e Sarajevës më 1983, nga përfaqësuesja e prokurorisë publike i është bërë pyetje pēr autorësinë e këtij artikulli. Mirëpo, ai e mori mbi vete tērë përgjegjësinë pēr tē.

Më vonë pas shumë vitesh - kur u gjend nē liri, H. Çengiqi tregonte: “...Përfaqësuesja e prokurorisë publike atëherë më shikoi duke u përqeshur, e pastaj edhe autorin e këtij artikulli, i cili rrinte menjëherë pas meje nē bankën e dytë pēr tē akuzuarit. E kisha tē qartë se ishin tē informuar mjaft mirë!”

Kurrfarë çudie: regjimi mendonte se ajo pēr ta ishte detyrë parësore.



# **PERSONALITETI DHE ISLAMI\***

## **(Ligjëratë e mbajtur në Tribunën e Rinisë në Xhaminë e Mbretit në Sarajevë)**

---

*“E kështu Ibrahimit ia mundësuam t’i shohë madhësitë e qiejve e të tokës për t’u bërë edhe më i bindur. E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: “Ky është Zoti im!” E kur u zhduk ai (perëndoi) tha: “Unë nuk i dua ata që humbin”. Kur e pa hënën e posalindur tha: “Ky është Zoti im!”, e kur perëndoi edhe ajo, tha: “Nëse Zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të humbur!” Kur e pa diellin të lindur, tha: “Ky është Zoti im, ky është i madh!”, e kur perëndoi edhe ai, tha: “O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni! Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok!”*

*En-nam (75-79)*

Ne, muslimanët e sotëm, jemi mësuar që të jemi “në frysë e kohës”, ndaj përpinqemi që mësimin islam ta përshtasim sipas gjendjes momentale. Ne nuk kemi guxim të banojmë në ndërtesën e mësimit islam, kaherë jemi larguar nga ajo. Ajo, megjithatë, ende mund të na jetë e dashur, mirëpo, është larg asaj që të jetë dëshmi e vërtetë dhe nuk kemi forcë që jetën tonë ta harmonizojmë me dok-

---

\* I publikuar në Takvimin e BI, Sarajevë 1971.

trinën islame. Ajo ndërtesë na duket e rrëzbitur dhe e papërshtatshme, jobashkëkohore, edhe pse nganjëherë jemi fatlumë nëse jemi në gjendje që nga ajo ndërtesë të përdorim diç në jetën bashkëkohore, dhe me krenari theksojmë:

“E sheh, sado që tē jetë e vjetër, i përgjigjet kohës së sotme!” Ndërsa kur nuk i përgjigjet, atëherë atë e meremetojmë vetëm që tē duket bashkëkohore. Por çka nëse ajo nesër nuk do tē jetë moderne? E pastaj... përsëri do ta rimeremetojmë...

Vërtet, ajo ndërtesë për ne është e dashur; ne nuk do tē dëshironim që ajo tē shkatérrohet. Rrëmbejmë çdo mendim tē mirë njërezor ta përkrahim dhe ta mbrojmë atë godinë, por për shkak tē pasigurisë sonë dhe bindjeve tē dobëta, ne nuk shohim shtyllat më tē sigurta dhe themelet në tē cilat qëndron ndërtesa - autoritetin e fjalës së Zotit. Dhe sa përpjekje investojmë që tē dëshmojmë se Kur’ani pajtohet me “mendimin e sotëm”, me “shkencën bashkëkohore”, kurse nuk jemi tē vetëdijshëm se si ne vetë, në jetën tonë tē shkurtër, bëhemë dëshmitarë tē ndryshimeve, ashtu që shumë tē vërteta shkencore, pas një periudhe tē shkurtër kohore shpallen si tē dështuara.

E kujt i shërbën kjo? Kur shohim se ajo është rrugë e pasigurt, përse nisemi në atë drejtim? Përse tē mos vepronim tē kundërtën? Përse nuk i drejtohami Kur’anit në tëresi, kur e dimë se ai është fjalë e dëshmuar e Zotit dhe ta marrim si themel tē pikëpamjeve tona në jetë? Por vërtet, përse?

I dashuri lexues, ti qeshesh me mosbesim! Apo jo? Thjesht tē duket e pabesueshme, madje edhe qesharake, sepse edhe sot e kësaj dite mund tē dëgjosh një propozim tē këtillë. Mendon: “Po kjo është e pamundshme!” Gjithsesi, do tē ishte vështirë për ne. I dobët është imani ynë, i dobët është besimi ynë...

Ne sot sillemi tepër tē shfrenuar e tē shkujdesur ndaj dispozitive dhe ndalesave kur'anore. Si duket, shumë pak mendojmë se kush është Ai që na predikon... Madje shpesh ndodh që parimet themelore islame tējenë tē panjohura.

E gjithë kjo na shpie në hutim tē rëndë, në mëkat tē rëndë. Ne sillemi si xhahilë tē vërtetë. Ç’do moment zëmë në thua, e për këtë nuk jemi tē vetëdijshëm. Ka shumë raste tē këtilla, por ne po sjellim vetëm një shembull:

Nëse shqyrtojmë me kujdes zhvillimin e religjioneve gjatë historisë, shihet qartë se idhujtaria është zhvilluar nga barbarizmi i rëndomtë dhe respekti ndaj disa individëve tē caktuar, tē cilët u

ngritën mbi mjedisin e vet. Pamaturia njerëzore, të cilën njeriu aq vështirë e frenon, e solli njeriun në besim të paarsyeshëm dhe të gjykuar, duke glorifikuar dhe madhëruar individin, deri në idhujtarinë më primitive. Historia është përplot me shembuj të këtillë, dhe nuk ka popull që nuk ka rënë në këtë huti. Edhe te politeizmi më i keq mund të shihen gjurmët e monoteizmit, por meqë koha i sprovon edhe individët edhe popujt, ndaj njeriu duke mos mundur që në shpirtin e vet dhe në mendimet e veta të sjellë konceptet e pamaterializuara për Qenien e Zotit, humbte parafytyrimin e qartë për Të.

Dhe - thjesht, sikur ka dashur ta zvogëlojë me diçka dallimin e pakrahasueshëm ndërmjet vetes dhe Krijuesit të vet: vetitë e Zotit ka filluar t'i krahasojë dhe t'i masë me aftësitë e veta të kufizuara.

Ndërsa, në anën tjetër, njerëzve të famshëm dhe të pasur u ka mveshur cilësi mbinjerëzore. Edhe këtu nuk ka pasur kurrfarë arsy. Ai ua atribuonte fuqinë dhe aftësinë të cilat i përkasin vetëm Zotit xh.sh. Mirëpo ajo që na habit më së tepërti, këtu kanë ndërhyrë edhe ata të cilët e kanë njohur shpalljen e Zotit.

Në Greqinë e vjetër shumë personalitete historike, të stolisura, pa kurrfarë kufizimesh, me legjenda dhe tregime, imaginata njerëzore i ka ngritur në Olimp dhe i ka shoqëruar me perëndi, ekzistencia e të cilëve humb në ngjarjet e lashta e të panjohura të parahistorisë. Në Romën e vjetër mbretërit i shpallnin për zotëra, u ngrenin tempuj, statuja dhe u flijonin viktima. Ne sot habitemi se si kanë mundur të bëjnë një gjë të këtillë dhe pyesim, a thua vërtet kanë besuar në fuqi zoti të mbretërve të vet, vetëm për arsy se ua kanë atribuar. Kur vetëm i kujtojmë ato koka të urta: filozofë, historianë, poetë dhe oratorë të mëdhenj të Greqisë së vjetër dhe të Romës, thjesht është vështirë të besojmë se ka mundur të ndodhë një gjë e këtillë. A thua vërtet kanë besuar në fuqi dhe në cilësi të Zotit për ta, për të cilët e kanë ditur se edhe ata janë njerëz sikur edhe ata vëtë, madje kanë njohur edhe shumë dobësi të tyre. Ajo që mund të vlerësohet sot: më e besueshme është se ata kanë dashur t'i nderojnë duke i ngritur dhe duke ua atribuar cilësitë e zotave, dhe këtë duhet kuptuar në aspektin figurativ e kurrsesi ndryshe. Dhe jo vetëm nga respekti, por shpesh edhe nga qyqarllëku dhe lajkatimi ndaj tiranëve...

Edhe njeriu i sotëm nuk është aspak më i mençur. Sa shpesh i dëgjojmë fjalët “i përjetshëm”, i “pavdekshëm”, që u atribuohen njerëzve me merita, njerëzve të shquar... Mirëpo, gjithsesi askush prej nesh këtë nuk e kuption tekstualisht, por në kuptimin figurativ.

Por duhet tē jemi tē kujdeshem. Tē pērkujojmē se bota romake i adhuronte mbretërit e vet dhe shpirtërisht jetonte nē idhujtari mē tē shëmtuar, dhe jo vetëm ajo, por edhe shumë popuj tjerë.

T'i kujtojmē tē krishterët e parë. Ata, Zotit xh.sh. iu drejtuani si atit tē tyre nē kuptimin figurativ, nē kuptimin se Ai është krijues dhe mbrojtës i tyre, që shihet edhe sot nga lutja e tyre “Ati ynë...”

- Kur sot nē Ungjill, që e kemi nē disponim, shohim se edhe Isa flet pēr Atin si Zot, pasardhësit e tij nē hutim tē tmerrshem e pandehin këtë pēr tē vërtetë tekstuale. Isanë a.s. nē aspektin njerëzor e pandehin si bir tē Zottit, prandaj edhe nxjerrin pērfundim se Zoti nē tē solli edhe cilësitë dhe fuqinë e Zottit.

Ndërsa Zoti xh.sh. nē Kur'an thotë:

*“Vërtet, çështja e Isait (tē lindur pa baba) te All-lahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi nga dheu, e pastaj atij i tha: “Bëhu!” dhe ai u bë.” (3:59)*

*“E Të Gjithëmëshirshmit nuk i takon tē ketë fëmijë.” (19:92)*

*“All-lahu nuk ka marrë pēr vete kurrfarë fëmijë (as nga engjëjt, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pasi (sikur tē kishte zot tjetër), atëherë secili zot do tē veçohej me atë që e ka krijuar, dhe do tē dominonin njëri mbi tjetrin! I lartë, i pastër është All-lahu nga ato që ia përshkruajnë.” (23:91)*

*“Vini re se si ata nga trillimet e tyre thonë: “All-lahu ka lindë!” S'ka dyshim se ata janë gënjeshtarë (kur thonë se engjëjt janë bijat e Zottit).” (37: 151, 152)*

Meqë edhe vetë Ungjilli mëson pēr monoteizmin, nē Krishterim u krijuua një nyje e pazgjidhur rrëth çështjes së trinisë dhe vëcanësisë së Zottit. Ndërkaq, kur kjo krahasohet me Kur'anin: shihet se sa pastërti dhe qartësi ndeshim nē mësimin islam pēr Zotin!

Mësimi i krishterë nuk ka mundur tē ruhet nga ndikimi pagan dhe idhujtaria.

Faltoret krishtere janë pērplot me figura dhe shtatore njerëzish, tē cilët kisha i ka shpallur pēr tē shenjtë dhe tē cilëve drejtpërdrejt u luten që tē ndërmjetësojnë te Zoti. Lutjet ia drejtojnë Isasë a.s., nënës së tij dhe ndërmjetësve tē shumtë tē vdekur e tē gjallë.

Kur'ani na mëson se mendimi njerëzor gjatë shekujve ka devijuar nē huti, se kanë ardhur udhëzues dhe përtërirës tē fesë nē ekzistencën dhe nē vëcanësinë e Zottit, dhe se I dërguari i fundit i Zottit

është Muhammedi a.s. Muhammedi është vetëm njeri i rëndomtë - njeri si edhe të gjithë pejgamberët tjerë të Zotit - pa kurrfarë shenjtërie. Vetëm Zoti është i shenjtë, i madh dhe i lartësuar. Vetëm Atë duhet lutar, falënderuar dhe lavdëruar.

Ndërkaq, te muslimanët aty-këtu ka pasur (ka mund të gjenden ndonjëherë) raste që disa njerëzve fetarë dhe të ditur t'u atribuohen cilësi mbinjerëzore, kurse sot njerëzve me autoritet dhe pasuri, - diçka që Islami nuk ka lejuar t'i përshkruhet madje as Muhammedit a.s. e as ndonjë pejgamberi tjetër të Zotit. Mirëpo ka edhe raste kur është tejkaluar çdo kufi i arsyes.

Njeriu i së sotmes, i mahnitur me të arriturat e veta shkencore dhe teknike, mburret se është shkarkuar nga paragjykimet, ndërsa ai në paragjykime e numëron edhe besimin në Zot.

Çfarë mashtimi! Duke e mohuar besimin, pikërisht ka rënë në paragjykime. Ai sot jeton në një errësirë të plotë shpirtërore. Ai kërkon realitetin, objektivitetin, në formë të vrazhdë materiale. Kjo është bindja e tij. Ndërsa gjërat tjera jashtë shqisave të të prekurit dhe të pamurit... për të është qesharak vetë mendimi për to, kurse vetë nuk sheh se sa qesharak bëhet.

“Të bëhem realë!” - kjo dëgjohet nga goja e tij. Ai nuk ka forcë, as nuk përpinqet, as nuk do e as nuk dëshiron, të ngrihet moralisht dhe shpirtërisht. Ai nuk sillet aspak më mirë se që silleshin dikur idhujtarët. Ai, i cili lavdërohet se është i përparuar, nuk e sheh vetveten se sa poshtë ka rënë.

Mendimet e mëdha të njerëzve të mëdhenj, fjalët e urta të të urtëve, veprat e famshme të njerëzve të famshëm - meritojnë mahnitjen e tij, ai i feston dhe i madhëron; ai i adhuron - ky është besimi i tij. E Zoti, madhështia e Zotit, dituria e Zotit, fuqia e Zotit? Ai i mohon me dorë. Kjo për të është fryt i frikës para vdekjes, para urisë dhe mynxyrave jetësore të njerëzve të shkallës së ulët të zhvillimit mendor, të njerëzve të cilët nuk kanë ditur shpjegimin shkencor të dukurive natyrore. Ai është armatosur me dije dhe shkencë. Këto i mjastojnë. Zoti është i panevojshëm për të.

Ai sjell mendime dhe fjalë të njerëzve “përparimtarë dhe bashkëkohorë” si fjalë përfundimtare e së vërtetës së argumentuar shkencore. E Libri i Zotit? Ai haptaz e nënçmon atë: ai për të është një grumbull tregimesh dhe përrallash të popujve të lashtë. Ai nuk çan kokën për të. Atë ndoshta ka mund ta çmojë edhe ndokush tjetër, por ai jo! Ai madje çuditet se si sot në kohën e një përparimi aq të madh të shkencës, mund të gjendet ndokush që i përbahet atij.

Kur'ani një pjese të jobesimtarëve u është kërcënuar me përbuzje edhe në këtë botë. Edhe sot për njerëzit e këtillë është vërtetuar fjala e Zotit. Bindja e tij tanimë është e vdekur: ajo të cilën e ka konsideruar për të vërtetë, shkencërisht fort të ndërlidhur, u tregua si gënjeshtër e cila shkatërrohet si rrjeta e merimangës. Vetë jeta, në të cilën ai kryesisht besoi, e përgënjeshtroi atë. Ata, të cilëve ai u mahnitej, u lutej dhe i adhuronte, u rrëzuan nga postet e tyre të lartësuara të nderit dhe të fuqisë, në baltën e jetës dhe të poshtërimit. Çdo fjalë nga goja e tyre, ai e pranonte i mahnitur, si urti dhe e vërtetë e mirëfilltë. E tani - të gjitha janë vetëm gënjeshtra. Ndryshe as që ka mundur të ndodhë. Ai e ka harruar urdhrin e Zotit. Ka harruar se vetëm Zoti xh.sh. është i denjë të adhurohet, se vetëm Zotit i takon fama dhe lavdërimi. Ai është krenuar me dijen dhe mundësitë e veta, duke harruar se ato janë dhuratë e Zotit. E ka konsideruar si nënçmim të besojë në Zot, kurse i ka lejuar vetes t'u përulet njerëzve të vdekshëm. Çfarë kundërthënie qesharake! Dhe sa e mjerë. Ai i ka madhëruar dhe lartësuar - edhe atë në çfarë mënyre! Kjo do të mund të krahasohej vetëm me apoteozën e mbretërve romakë.

Ai u harrua tepër, ndaj sot ndjehet i përbuzur bashkë me idhujt e tij të rënë. E është dashur ta dijë se askush nuk mund të krahasohet me Atë i cili është i amshueshëm dhe vërtet i fuqishëm, me Krijuesin tonë dhe Krijuesin e çdo gjëje rrëth nesh.

Harroi ajetin kur'anor "*A thua u frikësoheni?! Do të ishte më mirë që Zoti t'i frikësoheni...*"

Vërejtje plotësisht e arsyeshme: pushteti njerëzor është i kufizuar, kurse fuqia e tij kalimtare; Pushteti i Zotit është i amshueshëm, kurse fuqia e Tij e pakufishme.

Sa madhështi në mësimin islam: Të gjithë njerëzit para Zotit janë të njëjtë; ata duhet të kërkojnë mëshirë vetëm nga Ai, vetëm Atij t'i luten dhe vetëm Atij t'i frikësohen. E askujt tjetër. Kurrfarë lavdërimi njerëzve - kurrfarë lartësimi, kurrfarë madhërimi! Madje as të dërguarve të Zotit. Ademi dhe Nuhi, Ibrahimi e Musai, Isa e Muhammedi janë vetëm - si edhe të tjerët - robër të Zotit. Të shenjtët nuk ekzistojnë. Islami nuk njeh shenjtërinë njerëzore. I shenjtë është vetëm All-llahu, Zot e Krijues yni dhe sundues i pakontestueshëm i të gjitha botëve.

Kjo është e shpallur në të gjitha librat e Zotit; ato i kanë transmetuar të gjithë pejgamberët e Zotit.

Ky mendim është zbatuar besnikërisht në Islam: Dhe - sipas haditheve -jeta e Muhammedit a.s. ka qenë e harmonizuar në mënyrë rigoroze me urdhurat e Kur'anit. Muhammedi është përpjekur, posaçërisht, që pasardhësit e tij mos ta pandehin aspak më të madh se që është. Sipas dëshirës së tij u varros në Medine në mesin e atyre të cilët atij dhe muslimanëve mekkas u ofruan strehim në kohët më të vështira të mërgimit. Falë Zotit që është ashtu - sepse gojëkëqijtë do të thonin se me rastin e haxhit shkojmë që t'i përulemi atij e jo Zotit. Njëra nga porositë e tij të fundit ishte edhe vërejtja drejtuar muslimanëve që mos ta konsiderojnë varrin e tij si objekt adhurimi.

Dhe, një ditë erdhi çasti i vdekjes së tij. Të përpinqemi që shpirtërisht dhe psikikisht të hepo hemi në atë kohë. Çfarë rëndësie ka pasur Muhammedi për bashkëfistarët e vet? Ne sot shohim se paraqitura e tij në histori ka përfaqësuar një kthesë në jetën e fiseve arabe, dhe se historisë i ka hapur horizonte të reja, në të cilat janë zhvilluar ngjarje me rëndësi të madhe edhe për popujt tjerë, madje edhe përtërë gjininë njerëzore.

Këtë ne e shohim sot, por të përpinqemi të parafytyrojmë çfarë përshtypje la në mesin e atyre për 63 vjet. Shumë prej tyre e kanë njojur mirë. Ua predikoi 23 vjet mendimet, të cilat i kanë transformuar nga themeli. Ata e braktisën besimin e baballarëve të vet. Lufuan bashkë me të, vuajtën dhe pësuani, sakrifikuani dhe vdiqën për idealet që ua solli ai. Të durueshëm në bindjet e veta, triumfuan definitivisht. Bashkuani fiset arabe, për herë të parë në histori themeluan shtetin e vet dhe sunduesi i parë i tyre ishte Muhammedi a.s.

Të ishte ai vetëm themelues i shtetit të tyre të përbashkët dhe sundues i tyre i parë, do të mjaftonte të vlerësohet se çfarë rëndësie kishte ai për ta. Mirëpo ai ishte diç shumë më tepër. Atë e zgjodhi dikush, i Cili jep jetë dhe vdekje, Krijues i çdo gjëje që shihet dhe nuk shihet; Zoti i të gjitha gjithësive, e zgjodhi për pejgamber të Vetin, i cili atyre, në gjuhën e vet, do t'ua transmetojë shpalljen e fundit të Zotit përtërë njerëzimin. Vërtet shpalljen e cila i tronditi deri në thellësi të themelit të shpirtit të tyre.

Islami depërttoi në çdo pore të jetës së tyre të përbashkët dhe personale, ndërsa Bartësi i besimit ishte aty në gjirin e tyre. Dhe përnjëherë u largua nga ata, nuk gjendet më në mesin e të gjallëve. Grusht i tmerrshëm edhe përmendje edhe përzemër. Lajmi përvdekjen e tij ndër muslimanët shkaktoi një hutitë të përgjithshme, bota humbi çfarëdo gjykimi të arsyeshëm. Umeri, luftëtar i madh i

Islamit, më vonë halifi i dytë, i çmendur, me shpatën nxjerrë nga këllëfi, i kërcenohej çdokujt me vdekje, që kishte guxim të thoshte se Pejgamberi kishte vdekur.

E atëherë Ebu Bekri, njëri nga të parët që pranoi Islamin, që mori emrin Siddik për shkak të besimit të madh në Muhammedin dhe të cilit Muhammedi ia besonte ato punë që nuk mund t'i kryente vetë, e me këtë heshtazi e emëroi si trashëgimtar të vetin më të besueshëm, ja, ai plak, duke e parë gjithë këtë trazirë, iu drejtua turmës së shqetësuar. “O besimtarë të vërtetë, kush beson në Muhammedin le ta dijë se ai (Muhammedi është i vdekur), e kush e adhuron Zotin, le ta dijë se Ai (Zoti) është i amshueshëm!” E pastaj e recitoi ajetin kur'anor që u shpall me rastin e disfatës së muslimanëve në Uhud, ku Muhammedi qe plagosur, ndërsa ishte përhapur se kishte vdekur, ajet i cili thotë: “*Muhammedi është vetëm pejgamber. Para tij kanë ardhur dhe kanë shkuar pejgamberë. A thua edhe ju, nëse ai vdes ose vritet, do të ktheheni (në mosbesim)?*”

Çfarë befasie! Çfarë kthese! Apo jo, lexues? A mund të gjenet në histori diç e ngjashme? Jo, nuk mund! Ç'do të priste njeriu në një moment të këtillë?

Gjithsesi, sipas rastit, diç të këtillë: “Është ky moment i pikëlluar, është çast i rëndë për të gjithë ne. Vdekja ka rrëmbyer më të mirin dhe më të lartin, më të guximshmin dhe më të diturin në mesin tonë. Ju në këtë thjesht nuk besoni! A thua ndër ne nuk gjendet më ai i cili na udhëhoqi në momente të vështira dhe në sprova, por edhe në fitore, i cili na bashkoi, na bëri më njerëzorë, nga ngriti nga balta e paditurisë, i cili na siguroi famën dhe respektin e të gjithë popujve përreth...” Të gjitha në të njëjtin kuptim, të gjitha në të njëjtin drejtim. Kështu ose ngjashëm me këtë theksimi i veprave dhe meritave të tij, pohimi se do të ekzistojë përherë “sa të jetë bota dhejeta”, se ai do të jetojë gjithmonë në zemrat e tyre dhe në histori. Ose, ndoshta, në mënyrë edhe më groteske.

Mirëpo, nga e gjithë kjo asnjë gjurmë. Muhammedi është vetëm rob i Zotit dhe pejgamber i Zotit. Dhe asgjë tjetër. Në të vërtetë, i madh është vetëm All-llahu. Veprat e Tij janë të denja të lavdërohen dhe të falënderohen.

Askush nuk mund të jetë i barabartë me të.

Për Muhammedin a.s. është shkruar dhe është folur gjatë shekujve, e kjo do të ndodhë gjithsesi edhe në të ardhmen. Mirëpo, kur t'i kujtojmë mësimet e Kur'anit dhe jetën e Muhammedit, me ndërgjegje të pastër mund të themi se edhe vetë Muhammedi a.s. do të

ishte më i kënaqur me komentimin e parë për të, me fjalët e Ebu Bekrit se Muhammedi a.s. është i vdekur, kurse Zoti është i përjetshëm. Ato thelbësisht burojnë nga mësimi islam.

E meqë e dimë këtë, a s'është ky njëri nga argumentet më të mira të pejgamberllëkut të Muhammedit? Për shumicën! Kurse për ty lexues?

Dhe, ta përfundojmë!

Ka shumë momente në jetë që na sjellin shqetësim dhe frikë për jetën, mirëqenien dhe paqen për ne dhe për tanët. Si ndjehemi atëherë të pafuqishëm dhe të varur nga vullneti dhe mëshira e huaj! E duke ia shtuar kësaj edhe ndjenjën e poshtërimit jonjerëzor. Të meditojmë për këtë kur jemi edhe mirë edhe keq! Njeriu nuk mund të jetë pa ndihmëtar dhe pa mbrojtës. E nëse na është e nevojshme mbrojtja, ta kërkojmë te i Plotfuqishmi; nëse kemi nevojë për mëshirë, ta kërkojmë te i Gjithëmëshirshmi! Të nisemi shtegut të Ibrahimit që të mësojmë njojuritë e vërteta të Zotëruesh tonë - të fuqishëm dhe të ditur.

T'ia imponojmë vetes pendimin, t'i falemi Atij i cili është i vetmi i denjë për faljet tona. Të biem në sexhde para Atij i cili jeton gjithmonë dhe i Cili përjetë sundon me të gjitha krijesat!

## **Islami si fe**

Prej të gjitha krijesave të Zotit, i vetmi është njeriu që pranoi amanetin e besimit. Mirëpo, ai gjatë historisë së vet, nuk mundi gjithnjë ta bartë këtë barrë, ndaj dredhoi në hutim dhe në mëkate. Për këtë arsyе i erdhën pejgamberët e Zotit me porosi të Zotit, që ia tregoi rrugën e drejtë.

Të gjithë këta pejgamberë të Zotit kanë predikuar besimin në një Zot dhe ringjalljen e sërishme pas vdekjes. Predikuan mirësinë, jetën e virtytshme dhe ruajtjen nga veset, për të cilat njeriu një ditë doemos duhet të japë llogari para Krijuesit të vet.

Pejgamberë të Zotit ka pasur shumë, por në Kur'an me emër janë përmendur vetëm një numër syresh.

I fundit prej tyre që Muhammedi (a.s.) i cili solli librin e Zotit, Kur'anin. Besimi, të cilin e shpalli është Islami - që do të thotë nënshtrim Zotit, kurse pjesëtarët e tij thirren Muslimanë që do të thotë: ata të cilët i nënshtrohen Zotit.

Pas Muhammedit a.s. nuk do të vijë më kurrfarë pejgamberi i Zotit. Kur'ani mbeti i plotë dhe i pandryshuar në trajtën e tij buri-more në trashëgim të gjeneratave të ardhme të mbarë njerëzimit, si porosi dhe udhëzim i Zotit, që me të të qeverisin. Ky është vendim i Zotit, dhe ai është i shpallur në Kur'an.

Kur'ani në faqet e veta vë në spikamë përse u paraqit nevoja për Shpallje: Gjithkund zotëronte politeizmi (në shumë zotëra), ndërsa besimet monoteiste kanë qenë të shtrembëruara. Arabët, pas ardhësit e djalit të Ibrahimit, Ismailit, e braktisën besimin në një Zot dhe u dhanë pas idhujtarisë; Hebrenjtë ua ndërruan vendin disa fjalëve në Tevrat, dhe me këtë ia ndërruan edhe kuptimin e krye-hershëm, ndërsa pjesën më të madhe të Tevratit e fshehën - gjithë këtë e bënë për dobi të majme materiale. Të krishterët u zhytën në hutim të rëndë duke i atribuar Isait a.s., të dërguarit të Zotit (njeriut siç kanë qenë Ademi, Ibrahimi, Musa), cilësi të fuqisë së Zotit, të dijes dhe të famës. Nga veçanësia e Zotit, Kisha trilloi dogmën për trininë dhe pjesë e këtij triumvirati ishte Isa a.s. edhe pse ajo edhe më tutje pohonte se në parim mbetet se është vetëm një Zot.

Mësimi islam në të vërtetë është i njëjtë si të gjitha besimet e shpallura monoteiste. Kuptimi te Muhammedi është i njëjtë siç ka qenë edhe te Ademi, Nuhi, Ibrahimi, Musa, Isa dhe pejgamberët e tjere. Dallim ka vetëm në disa dispozita dhe në mënyrën e zbatimit të tyre, por thelbin e të gjitha këtyre besimeve - Shpallja nuk e ndryshon. Dallime të këtilla të ndërsjella ka edhe ndër besime të tjera. Kështu për Isanë në Kur'an thuhet se është dërguar t'i zbusë rregullat e rrepta të Tevratit.

Armiqtë e Islamit e shfrytëzojnë këtë argument që ta zvogëlojnë rëndësinë dhe madhështinë e Islamit, e mohojnë originalitetin e Kur'anit dhe përpiken që Muhammedin ta paraqesin si plagiator i cili nga çdo mësim mori nga diçka, diçka modifikoi dhe këtë ia ofroi njerëzimit si të re. Ata që në fillim e mohojnë Islamin, ndërsa nuk duan të shohin ku qëndron madhështia e tij, sepse në atë rast patjetër do ta pranonin edhe argumentin për prejardhjen e tij nga Zoti. Sikur ata të thoshin se Islami nuk predikon asgjë tjeter, por vetëm atë që mësojnë edhe religionet tjera monoteiste, atëherë ata parimisht do të ishin në prag të Islamit, por ata nuk e pranojnë këtë.

Kur'ani as që ka mund të sjellë ndonjë mësim të ri, sepse rrjedh nga i njëjtë burim si edhe librat tjere të Zotit, ndërsa misioni i tij ka qenë ta përtërijë besimin në një Zot në tërë pastërtinë e vet. Ai është dërguar t'i verifikojë shpalljet e mëparme: të dëshmojë për

Tevratin, jo për të sotmin, por për atë origjinalin, me të cilin ne sot nuk disponojmë; ta vërtetojë mësimin e Ingilit, jo këtë të sotmin, por atë origjinal, në të cilin nuk flitet fare për trininë, por për Isain flitet vetëm si njeri dhe si pejgamber. Mësimi i Kur'anit për Zotin është i lartësuar dhe jashtëzakonisht i qartë:

*“All-lahu - s’ka zot pos Tij. I Gjalli, Vigjëluesi. Nuk e zë të koturit, e as gjumi. E Tij është çka ka në qiej dhe çka ka në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, pos me lejën e Tij? Ai e di se ç’po u ndodhë dhe ç’do t’u ndodhë. Dhe asgjë nga dija e Tij nuk mund të përvetësojnë, pos sa të dojë Ai. Ndërsa pushteti i Tij përfshin qiejt dhe tokën. E nuk lodhet duke i ruajtur (mirëmbajtur), ngase Ai është i Larti, Madhështori!”*

(El-Bekare: 255)

*“Pos All-lahut mos adhuro ndonjë zot tjetër, s’ka të adhuruuar tjetër veç Tij. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe te Ai do të ktheheni!”* (El-Kasas, 88)

*“Ai është All-lahu, nuk ka zot tjetër pos Tij. Dijetari i të fshehtës dhe të dukshmes, Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërsi! Ai është All-lahu, pos të Cilit nuk ka zot tjetër, Sunduesi, i Shenjti, i Dëliri, Siguruesi, Mbikëqyrësi, i Plotfuqishmi, Mbizotëruesi, i Madhërishmi. I lartësuar është All-lahu nga ajo që ia sho-qërojnë! Ai është All-lahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të tij janë emrat më të bukur. Atë e lartëson çka ka në qiej e në tokë. Dhe Ai është i Fuqishmi, i Urti!”* (El-Hashr, 22-2)

*“Thuaj: Ai, All-lahu është Një! All-lahu është Ai që çdo krije i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.”* (El-Ihlas)

A thua armiqtë e Islamit - të cilët për vete pohojnë se besojnë në Zotin - kanë ndonjë vërejtje në një mësim të këtillë? Ky nuk është kurrfarë plagjiati, por një e vërtetë e lashtë dhe e amshueshme për veçanësinë e Zotit, e shpejguar qartë dhe e lartësuar me fuqinë origjinale, e cila është plotësisht e endur në tërë Kur'anin. E çka i largon atëherë nga Islami? Vërejtjet e tyre janë naive, sepse kanë të bëjnë me gjëra të parëndësishme.

Dikur pjesëtarët e librave tjerë bënин vërejtje për shkak të ndërrimit të Kibles, ndaj Kur’ani u përgjigjet:

*“Të All-lahut janë edhe (anët nga) Lindja edhe nga Perëndimi, dhe ngado që të ktheheni, aty është ana e All-lahut.”* (2:115)

*“Secili (popull) ka një anë të cilës i kthehet, ju shpejtoni kah punët e mbara.”* (2:148)

*“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah Lindja ose Perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-lahut, Ditës së gjykimit, engjëjve, librit, lajmëtarëve dhe pasurinë që e do, ua ndanë të afërmve, jetimave, të varfërve, udhëtarëve, lypstarëve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e mbajnë premtimin, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të singertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.”*

*(el-Bekare: 177)*

A thua njerëzit, të cilët thonë se kërkojnë të vërtetën, mund të bëhen të shurdhër ndaj një mësimi të këtillë? Me çka ata mund t’i kundërvihen këtij mësimi? Njeriu më tepër e sjell veten në huti kur i ngatërron përbajtjen me formën, kur zhvillon në hollësi gjërat e parëndësishme, ndërsa i ikin nga syri gjërat thelbësore.

Njeriun e sotëm e habitjeta modeste e Muhammedit. Ai refuzoi prej vete oreolin e çdo shenjtërie. Të gjithë njerëzit janë robër të Zotit, ndërsa edhe ai vetë është rob i Zotit dhe pejgamber i Zotit. Ai ka kundërshtuar që me asgjë të mos konsiderohet më i lartë. Ai i solli vetëm udhëzimet e Zotit e asgjë tjetër. Nga njerëzit nuk kërkoi asgjë përvete. Ua solli vetëm shpalljen, e cila do t’ua tregojë rrugën deri te mëshira e Zotit.

Ai vetë nuk qe i kursyer nga vështirësitë e përditshme të jetës dhe nga privimi, ndaj për këtë idhujtarët, kinse u çuditën - nëse ai është më i zgjedhuri i Zotit - Kur’ani u përgjigjet:

*Thuaj: “Unë nuk kam në dorë përveten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do All-lahu. Sikur ta dija të fshehtën, do t’i shumoj përvete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues përvjetor që besojnë.”* (Arafat, 188)

Më vonë, kur erdhën muslimanët në pushtet, në mirëqenie dhe autoritet, Muhammedi tregoi një cilësi të rrallë: ruajti tërë atë modësti të mëparme në çdo aspekt, nuk u mashtua nga sukseset, por

ua la amanet trashëgimtarëve të Islamit që mos të bëjnë gabime, duke e lartësuar atë dhe varrin e tij - si objekte adhurimi. Ai është vetëm rob i Zotit dhe transmetues i shpalljes së Zotit.

Vetëm Zoti është i denjë për adhurim. Vetëm Zotin duhet lavdëruar dhe falënderuar, dhe vetëm Zotit duhet t'i lutemi. E askujt tjeter.

Historia shumë rrallë ka njojur ftyra të këtilla modeste. Shumica mendojnë se ngjarjet historike janë fryt i veprimit të heronjve, të individeve, ose edhe të turmës, krejt njësoj. Disa historianë, të cilët nuk deshën të jenë objektivë, madje as dashamirë ndaj Muhammedit, e tregojnë si gjeni, i cili kuptoi "nevojën" e kohës së vet, i cili "spikati" rrugën e suksesit dhe me aftësi të jashtëzakonshme e realizoi qëllimin. Vetë Muhammedi do të refuzonte një mendim të këtillë, sepse ai e dinte se çdo sukses njerëzor si dhe rruga deri te suksesi: dituria, aftësia dhe vendosmëria - janë dhuratë e Zotit.

Ai i ka këshilluar edhe të tjerët që të jenë modestë dhe ua ka tërhequr vërejtjen që të mos mburren e krenohen me atë që kanë dhe e kanë arritur, sepse e tërë kjo është sipas paracaktimit të Zotit, prandaj për këtë nga zemra le Ti falënderojnë. Ndërsa, Zoti nëse do, mund edhe të na privojë nga kjo.

Ishte përplot me virtyte njerëzore, e jo me cilësi mbinjerëzore, që historia dëshiron t'ua atribuojë trimave të vet.

Virtyti ishte ai, i cili e stoliste Muhammedin; ky ishte edhe predikimi i tij. Obligimin ndaj Zotit tonë të vërtetë e kryente me shpirt - ky ishte mësimi i tij. Përulja ndaj urdhrale të Zotit, e cila manifestohej në vetëdisiplinë dhe në maturi - ja, kjo ishte përbajtja e jetës së tij.

Njeriu është i prirur ta teprojë; shumë lehtë e humbë ndjenjën e maturisë dhe të arsyes. Edhe njeriu bashkëkohor, i cili e konsideron veten të arsimuar, e me këtë të privuar nga paragjykimet (ku ai e inkuadron edhe religionin), vetë i shkelë parimet e veta individuale. E ka braktisur besimin në Zotin; ai tanë beson vetëm në "njeriun", në diçka më të arsyeshme në natyrë - dhe zë në thua. Njeriu i sotëm bën gabimin e njëjtë si edhe ai i mëparshmi. Të dalluarve u ngren statuja dhe përmendore madhështore. Fotografitë e tyre mund të gjenden në çdo hap. Glorifikimi i tyre humb çdo dimension njerëzor...

Ndërkaq, muslimanët nuk posedojnë kurrfarë fotografish as skulptura të Muhammedit, sepse ai vetë u ka thënë se Zoti ua nda-

lon këtë, që të mos bien në apoteozën e njerëzve - të hutuar, siç kanë bërë shumë popuj tjerë.

Atëherë nuk është për t'u çuditur se një evropian, kur u njoftua me jetën dhe punën e Muhammedit, deklaroi: "Unë më tepër e çmoj Muhammedin se sa Jezu Krishtin, sepse Jezusi në kulmin e famës së vet u shpall zot, kurse Muhammedi gjithmonë pohonte se është njeri i rëndomtë." Ndërsa muslimanët e çmojnë Isanë a.s. njësoj dhe aq siç e çmojnë edhe Muhammedin, sepse...

*"S'është e drejtë as nuk i takoi asnje njeriu që t'i ketë dhënë All-lahu librin, urtësinë dhe pejgamber-llëkun, e pastaj ai t'u thotë njerëzve: "Bëhuni rob të mi (adhuromëni mua) e jo të All-lahut!", por (ju thotë): "Bëhuni dijetarë të mësimeve të Zotit, ngase ua keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë."*

(Ali Imran : 79)

sepse...

*"I biri i Merjemes vetëm është rob, të cilin Ne e kemi dhuruar me bekim dhe e kemi bërë si shembull të bijve të Israilit." - thotë Kur'an.*

Islami nuk bën kurrfarë dallimesh ndërmjet pejgamberëve të Zotit. Për çdo musliman ata janë njësoj siç është edhe Muhammedi a.s. Me të njëjtin respekt ata sillen edhe ndaj Zeburit, Tevratit dhe Ingjillit si edhe ndaj Kur'anit. Prandaj, kur e mësojnë këtë ihtarët e Librave tjerë, përse ata eurrejnë Islamin dhe dishepujt e tij? Ne muslimanët nuk kërkojmë asgjë tjeter prej tyre, pos që për Muhammedin të gjykojnë ashtu siç gjykojnë muslimanët për të dërguarit e tyre, ndërsa ndaj Kur'anit të kenë pikërisht atë qëndrim çfarë kanë muslimanët ndaj librave të tyre të shenjtë.

Kjo nuk është kurrfarë shakaje, edhe pse tingëllon si shaka. Kjo ka kuptim, sepse në gjëra themelore pajtohem: se besojmë në veçanësinë e Zotit, në Ditën e gjykimit, në engjëjt, në pejgamberët e Zotit dhe në Librat, dhe se gjithçka që ndodh, bëhet me urdhër të Zotit.

Përse ata nuk e pranojnë Muhammedin a.s. si pejgamber, kur ardhja e tij është paralajmëruar në librat e tyre të shenjtë? Mirëpo, ata i kanë mashtrimet dhe hutimet e veta dhe s'duan të heqin dorë nga ato. Islami, i cili para hutimeve të idhujtarëve nuk lëshoi pe aspak, po ashtu i gjykoj rreptë edhe devijimet e hebrenjve dhe të krishterëve.

Ndryshe nuk ka mund as tē jetē sepse edhe ky ishte misioni i tij.

Kur hebrenjtë refuzuan ta pranojnë Islamin, me arsyetim se ata besojnë vetëm atë që u është shpallur atyre, Kur'ani i pyet, përse ata i mbytën pejgamberët e Zotit; ua tërroqi vërejtjen se në mungesën dyzetëditëshe të Musait, në shkretëtirë e ndërtuan viçin e artë tē cilit i faleshin; kur i ftoi Musa a.s. që në emër të Zotit tē luftojnë, ata nuk iu përgjigjën thirrjes.

Ndërkaq, sa u përket tē krishterëve, ata në besimin e tyre i tejkaluan tē gjithë kufijtë e lejuar tē arsyses.

Kur hebrenjtë dhe tē krishterët theksojnë gjoja njëfarë përparësie tē tyre se besimet e tyre janë më tē vjetra se Islami, Kur'ani i kundërshton qartë dhe thotë se Islami është besimi i Ibrahimit, dhe thekson se ai nuk ishte as hebrenj as i krishterë, ashtu siç nuk ishte as idhujtar, por i është nënshtuar vetëm Zotit (musliman).

Islami përsëri vuri bazat e pastërtisë së besimit, tē cilin e kishin predikuar tē gjithë pejgamberët e Zotit prej Ademit deri te Muhammedi, besimin në një Zot.

Pikërisht ky monoteizëm i pastër dhe ndërprerja e festimit të mosnjohjes së Zotit nga individët e caktuar, është veçoria më qenësore e Islamit, e cila i jep fuqi tē jashtëzakonshme tē arsyeshmërisë dhe bindshmërisë në krahasim me religionet tjera.

Kjo doktrinë islame, falë Zotit, na ka mbetur deri më sot e pacenueshme. Të tjerët nuk arriten ta ruajnë pastërtinë e mësimit tē mësuesve tē tyre. Buda dhe Isa predikuan modestinë, modestinë më tē madhe njerëzore, ata edhe ishin tē tillë, kurse dishepujt e tyre i devijuan, duke i shpallur ata hyjni, tē cilëve u luten edhe sot.

Dhe kur tē gjitha këto i prezentojmë, ata, tē cilët ia kthejnë shpinën Islamit, i pyesim a thua kanë ata ndonjë vërejtje në ajitet kur'anore: *E kam pranuar dhe jam i kënaqur që Islami tē jetë besimi juaj, dhe kush kërkon një besim tjetër, përvëç Islamit, ai nuk do t'i pranohet. Ai gjithmonë do tē jetë në mesin e atyre, që kanë humbur shumë.*

Vërtet, ata duhet tē mendojnë seriozisht për këto ajete...



## **JE I OBLIGUAR QË ATË QË E PRET PREJ TJETRIT, TA BËSH VETË\***

---

Agjencia APP më 17.2.1971 e transmetoi këtë lajm:

“Liga Islame Botërore ftoi qeveritë dhe popujt e shteteve muslimane që ta vazhdojnë “Luftën e shenjtë” për çlirimin e Palestinës dhe vendeve të cilat luftojnë për Fenë Islame t’u ofrojnë gjithë ndihmën e mundshme. Apeli u drejtua nga konferenca e përfaqësuesve të organizatave të anëtarësuara në Ligën Islame Botërore, që këto ditë u mbajt në Mekke.”

Ndonëse nuk jemi të njoftuar me përbajtjen e tërësishme të këtij apeli, e sidomos me hollësitë e kësaj konference, megjithatë do t’i qasemi asaj me disa fjalë.

Përshtypja e parë është se vërtet pjesëmarrësit e kësaj konference janë të preokupuar me dëshirën më të sinqertë që të bëjnë diç për çlirimin e Palestinës. Mirëpo, nëse ky apel është ndërmarrja më e madhe e tyre (dhe të ngjashme me të), atëherë ata vërtet nuk kanë bërë asgjë. Apeli vetveti është një ndërmarrje plotësisht joreale.

Nga përvoja e deritanishme shihet qartë se bota muslimane është e gatshme për çdo lloj ndihme, mirëpo inteligjencia e saj, shtetarët dhe politikanët nuk kanë për këtë mirëkuptim të plotë. Për ta një apel i këtillë është objekt i padiskutueshëm, madje për disa edhe qesharak.

Idetë dhe synimet e tyre sillen jashtë frymës së një thirrjeje të këtillë. Natyrisht, as ata nuk e lëshojnë rastin që në emër të Islamit

---

\* U publikua në Preporod nr. 13, të 15 marsit 1971, Sarajevë.

të ftojnë në ndihmë, kur fatkeqësi të ngjashme trokasin edhe në dyert e oborreve të tyre. Bindjet dhe morali i tyre, i lejojnë ata që t'i shfrytëzojnë ndjenjat fetare muslimane për qëllimet e veta, mirëpo kështu - që ata të angazhohen për diç që është çështje islame, e diç që shpie në komplikime dhe në rrezik - që besa, nuk ka autoritet të tillë që do t'i detyronte në këtë.

Ndër ta ka disa që falen dhe agjerojnë, që lënë përshtypje të mirë në çdo besimtar. Mirëpo, as në këta nuk duhet mbështetur. Sipas tyre, feja është çështje private e njeriut e jo çështje shoqërore; namazi dhe agjërimi janë arritje kulminante të besimit dhe të ngritjes shpirtërore.

Ata nuk kuptojnë se ato janë komponente (bashkë me disa që u mungojnë atyre) për jetë të vërtetë islame me të cilën sigurohet Ajo botë. Ata janë muslimanë sa i përket Ahiretit, kurse sa i përket kësaj bote, ata janë p.sh. sirianë, marokenë, persianë, turq, pjesëtarë të partive politike ose të lëvizjeve sociale.

E gjithë kjo mund të jetë rezultat i ndjenjave të nderit, obligimit, dëshirave dhe bindjeve që gjatë jetës të bëjnë diç të mirë dhe fisnike. Sipas tyre, e gjithë kjo as që mund të jetë në kundërshtim me Islamin. Madje në qëndrimet dhe programet e tyre mund të inkorporojnë edhe mjaft gjëra islame. Mirëpo, ajo që është islame, ata këtë në rrethe të gjera plotësisht e heshtin, siç është bashkëpunimi me popuj tjerë muslimanë në ndonjë program dhe qëllim të përbashkët. Zhvillohen në drejtime të ndryshme. Udhëheqin politikë të interesave të ngushta partiake dhe nationale, që shpeshherë ka përfunduar me masakra vëllavrasëse siç ishte ajo nën udhëheqjen e Lorensit para gjysmë shekullit, ose kjo e sotmja në Jordani.

Si rezultat i gjithë kësaj, në botën muslimane paraqitet një anemi e përgjithshme. Popujt muslimanë i mundojnë problemet të cilat nuk janë në gjendje t'i zgjidhin vetë, kurse ndihmë efikase nuk kanë prej askujt! Gjendja e muslimanëve në Etiopi, pozita e pakicës turke në Qipro, privimi i të drejtave të shumicës muslimane në Çad, çështja e Kashmirit - të gjitha këto në të njëjtën mënyrë janë probleme muslimane siç është edhe problemi i Palestinës. Bota muslimane nuk është indiferente ndaj tyre. Megjithatë, dëshirat e kësaj bote shumëmillionëshe janë paralizuar.

Dhe këtu shpesh dëgjojmë sqarimin: "Ajo botë është pa moral islam, ndaj nuk dëshiron të udhëheqë xhihadin." Kjo në thelb nuk është e vërtetë. Krahas gjithë këtij korrupzioni ndërmusliman, edhe pse Bota islame ka pësuar dekadencë në aspektin shpirtëror, me-

gjithatë në atë botë ka mjaft moral të shëndoshë për diç të këtillë. Në atë botë ekzistojnë fuqi potenciale të virthyteve dhe karakterit ashtu që mund të jetë e gatshme të sakrifikojë shumë, e që në të vërtetë nuk është kështu - gabimi qëndron krejtësisht diku tjetër.

Këtu - ndërmjet këtij morali dhe xihadit - ekziston një gremi-në, të cilën pakkush e sheh ose nuk do ta shohë, ndaj nuk do ose nuk dëshiron ta tejkalojë. Është e nevojshme një punë paraprake, gjatë viteve të tëra, një punë e ndërlikuar e njerëzve të arsimuar, të shkathët e të angazhuar me besnikëri në këtë punë. E kësaj bote kë-ta njerëz i mungojnë. Ajo nuk i ka liderët e vet të mirëfilltë. Ajo nuk ka inteligjencien e vet e cila planifikon, organizon dhe dëshirat e saj i zbaton në jetë.

Kjo e sotmja - çfarëdo dhe sidomë që të mendojë për vete - nuk është islame, ajo nuk është besnike ndaj Islamit, e as që punon për të. Kjo shihet nga rezultatet e punës së saj. Për të gjitha disfatat dhe fatkeqësitë, sajtore është ajo: qoftë që ajo vetë i ka krijuar, qoftë pse me kohë nuk ka patur kujdes për qëllimet e të tjerëve, që të angazhojë mund e punë adekuat për pengimin e gjithë kësaj.

Shihet sheshazi se mungon ajo që quhet "qëllim unik dhe ak-sion unik."

Pra, kjo mund të na shpie në shembullin didaktik të indianëve amerikanë. Indianët në kokat e ardhacakëve kanë qenë vetëm si koncept i një tërësie. Ndërsa ata vetë këtë ndjenjë nuk e kanë patur. Shfaroseshin ndërmjet vete me të njëjtën urrejtje armiqësore me të cilën vepronin të bardhët kundër të gjithë indianëve. Ata nuk kishin ide për të cilat do të lidheshin. Prandaj edhe u shkatërruan. U zhdu-kën nga një numër i vogël kolonizatorësh. Asgjë nuk bëri punë numri i madh i tyre. Gjithmonë u mundën si fise të vetmuara. Asgjë nuk u shërbue as guximi personal, madje ishin shumë më trima se të bardhët. Falë organizimit më të mirë, kolonistët ngadhënjen mbi individualitetin e tyre luftarak.

Kjo histori në mënyrë të çuditshme sot po përsëritet në Lindjen e Afërmë. Para shumë kohësh Napoleoni bëri vërejtje parafërsisht të këtillë: dy mamilukë janë pa dyshim në të fortë se tre francezë, por se njëqind francezë bëjnë sa 100 mamilukë, ndërsa një mijë francezë gjithmonë do t'i mundin 1.500 mamilukë.

Ndërkaq, organizimi krijohet nga fryma e idesë me të cilën janë të udhëhequr njerëzit. Nga historia kemi mësuar se muslimanët e parë paraqiteshin në fushën e betejës me forcë gjysmë më të vogël

se armiku, megjithatë për gjysmë shekulli e pushtuan gjysmën e botës.

Kur'ani në kohën e vet thekson se me pranimin e Islamit fiset arabe shpëtuan nga zhdukja e ndërsjellë. Dhe më vonë, në histori përfaqësohen në vetëm si pjesëtarë të Islamit, e jo si pjesëtarë të ndonjë fisi, populli ose race. Duke folur me gjuhën e sotme, ajo ishte *spiritus movens* i tyre, ajo ishte ideologjia e tyre.

E meta themelore e muslimanëve të sotëm me ndonjë rëndësi shoqërore (nëse e ndjejnë fare veten si të këtillë), qëndron në jobesnikërinë ndaj parimeve islame. (E pikërisht këta do të duhej t'u ishin besnikë). Ata nuk janë në gjendje që botën islame ta shikojë si një bashkësi integrale, e nga ky aspekt të veprojnë në fushën përkatëse, qoftë edhe të shohin nevojën e një qëndrimi të këtillë. Realiteti i ngjarjeve është ngarkuar me aq shumë vështirësi dhe kundërthënie saqë i huton, ndaj këtë tërësi të botës islame fillojnë ta shohin si utopi. Së shpejti bëhen viktima të rrethanave të ngushta lokale dhe nationale, të cilat i shtyjnë të bëjnë kompromis ndërmjet jetës dhe parimeve islame. Në katastrofat që i sjellin disfatat, ata ende nuk e akuzojnë veten e as veprimet e veta, por për shkak të mungesës së unititetit islam, në të cilin ata kurrë nuk qëndruan me vendosmëri, ankohen në të tjerët.

Në çdo hap ndeshim në krahasimet: muslimanët - hebrenjtë. Themeli i shtetit të Izraelit paraqet fenomen historik, ndërsa fitoret e tij mahnitën botën. Ne zakonisht ankohemi se si “ata kanë përkrahjen e këtyre ose të atyre.” Ky është një maskim më i rëndomtë i gabimeve vetjake dhe vetëmashtrim i marrë e i rrezikshëm. Analiza bëhet në drejtim të gabuar. Përgjigjja e vërtetë (dhe ajo që duhet të na mahnitë) është vendosmëria e cionistëve që gjatë aq dekadave ta ruajnë kuptimin dhe idenë për përkatesinë e përbashkët të të gjithë hebrenjve të shpërndarë nëpër botë, dhe t'i angazhojë në një program dhe qëllim të përbashkët. Sikur të ishte gjendur ndër muslimanët diç e ngjashme, në radhë të parë në gjirin e inteligjencies muslime (pa marrë parasysh se në krahasim me atë hebraike ishte e vogël, por kishte përparësi të tjera të cilat s'i patën hebrenjtë), dhe sikur të punohej paralel në të njëjtën periudhë historike besnikërisht ndaj ideve islame, fizionomia e botës sot do të dukej krejt ndryshe. Mirëpo, muslimanët punuan pikërisht në drejtim të kundërt - dhe ja tash kanë atë për të cilën punuan!

A thua janë të vetëdijshëm për këtë edhe pjesëmarrësit e konferencës së zënë ngojë? Ata në apelet e tyre gjithsesi ftojnë në

frymë të re të Bedrit, ashtu siç e kemi ne zakon në situata të ngjashme. Por mos të harrojnë se Bedri ishte frys i një pune shumëvjeçare e jo rezultat i ndonjë apeli. Ai kishte punën e vet përgatitore dhe logjikën e vet të parazhvillimit. U gjendën ata, të cilët me vetëdije krijuan rrëthanat dhe kushtet historike për të. Për një punë të këtillë në kushtet e sotme të ndërlikuara, nevojiten dekada.

Nëse pjesëmarrësit e konferencës mendojnë se kanë kryer obligimin e tyre ndaj Zotit, duke ua treguar të tjerëve obligimin e tyre, atëherë ata mashtrohen. Ky do të ishte iluzion më i rëndomtë i ndërgjegjes së “qetë” personale.

Pikërisht obligimi, për të cilën ata flasin, është obligim i tyre personal. Çdokush udhëheq betejën e vet. Askush nuk do ta zgjidhë çështjen e tyre.

Nëse janë muslimanë, le ta udhëheqin besnikërisht këtë mision deri në fund.

Ne e kemi të qartë se ata momentalisht nuk mund të bëjnë diç të madhe dhe efikase. Nuk kanë as kushte as mundësi. Nuk kanë as kuadër përkatës as mjete. Mirëpo, të gjitha këto duhet t'i krijojnë vetë, madje edhe nëse janë të vetëdijshëm se kjo do të sjellë frys për gjeneratat e ardhshme. Muslimani është i obliguar që në frymën e njohurive të bëjë çdo gjë në dobi të Islamit. Tekefundit, nuk ka nevojë që frysjet e kësaj bote - për të cilat jemi munduar - t'i vjelim personalisht ne.

Në pajtim me këtë, nuk do të jemi përgjegjës për situatën, në të cilën kemi ndeshur, por për atë, të cilën e kemi lënë... Në Ditën e gjykimit do të na pyesin (edhe për atë) se ç'kemi bërë për ata, të cilët kanë ardhur pas nesh.



## NË Ç'DREJTIM T'I ANGAZHOJMË MENDIMET TONA\*

*“Kush është që e shpreson takimin me Zotin e vet, letë bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askë.”* (18:110)

*“E kush ka fjalën më të mirë prej atij që thërrret te All-lahu, vepron (punë) të mira dhe thotë: “Unë jam prej muslimanëve?!”* (41:33)

Periudha e letargjisë së shoqërisë muslimane, falë Zotit, siç duket i takon së kaluarës. Gjithkund ndjehet dëshira për ngritje dhe përparim, dhe shumë njerëz u drejtohen mendimeve burimore të Islamit që në to të gjejnë nxitje për veprimtarinë e vet. Nga të gjitha anët dëgjohen mendime të zëshme për mjetet që do të na siguronin rrugën sa më të shpejtë dhe sa më efikase për realizimin e qëllimeve, si edhe në të kaluarën, që të mos humbim e të mos hutohem në vështirësi të shumta. Synimet dhe veprimet tona mos t'i drejtojmë shtigjeve që nuk na shpien në përparimin tonë të mirëfilltë dhe të domosdoshëm. Kur shfletojmë revistat tona, gazetat dhe librat, nga e kaluara e largët dhe e afërt, shpeshherë ndeshim në gjëra për të cilat nuk gjejmë asnje fjalë arsyetimi, ndërsa në to është investuar gjithë ai mund, gjithë ajo kohë dhe gjithë ajo sipërfaqe e shkruar.

Mirëpo, as ne sot nuk jemi plotësisht të kursyer nga kjo dukuri. Ne patjetër duhet të spikasim cilat janë argumentet qenësore, e cilat janë joqenësore për jetën tonë islame. Kjo është e nevojshme

\* U publikua në Takvimin e BI, Sarajevë 1969.

pikërisht për atë që përpjekja jonë të japë rezultate të dëshiruara e jo të humbim në analiza të mjegulluara, të cilat shkaktojnë mos-marrëveshje dhe grindje.

Shembuj të këtillë ka mjaft, dhe kohë pas kohe, ata paraqiten si për inat. Kështu, jo fort moti te ne u zhvillua diskutimi lidhur me ekzistencën e jetës pas vdekjes. Ajo është zhvilluar lidhur me atë se si duhet kuptuar çështjen e mësimit islam për të. Megjithatë, një shqyrtim i këtillë ka qenë i panevojshëm, i tepërt, madje edhe i dëmshëm, dhe në të nuk do të duhej të ndaleshim sikur të mos kercenohej rreziku se çështje të këtilla të ngashme me kohë do të paraqiten përsëri.

Është e pakuptueshme se si lëshohen njerëzit në polemika rreth çështjeve të këtilla (a është jeta përtej varrit shpirtërore apo materiale), kur e dinë dhe besojnë në ajetin kur'anor: “*Ne e kemi caktuar vdekjen për ju, por Ne nuk jemi të pasuqishëm t'i ndërrojmë vetitë dhe trajtat tuaja, dhe për të dytën herë t'ju krijojmë në një trajtë për ju të panjohur.*”

Kujt i duhen diskutimet e këtilla në mesin e atyre, të cilët qysh përpara e pranojnë Kur'anin si e vërtetë e Zotit, si fjalë e Zotit?

Ç'mund të dimë ne për jetën pas vdekjes?

Për ne është e njohur vetëm ajo që është dhënë në Shpallje, dhe prej nesh kërkohet të besojmë, e jo të diskutojmë se ç'kuptim ka ajo.

Tekefundit, polemikat e këtilla janë edhe të rrezikshme, sepse përnjëherë gjendemi në një situatë të pohojmë diç për çka nuk kemi kurrfarë argumentesh, por udhëhiqemi nga supozimet personale.

Të bëjmë një krahasim: çka mund të kenë ditur ose të supozjnë filozofët e mëdhenj të kohëve të lashta siç ishin për shembull Aristoteli, Platoni, Euklidi, Arkimedi, Sokrati, për të arriturat e sotme të teknikës dhe të shkencës? A thua nuk do të mahniteshin ata sikur t'i shihnin sot të gjitha këto? Ata kanë njohur disa të vërteta shkencore, por megjithatë jo të atilla që do t'i lejonin të jepin supozime për të arritura të këtilla të periudhës bashkëkohore. Ata as nuk kanë ditur, as nuk kanë besuar se diç e këtillë që kemi ne sot është e mundshme. Ata as nuk kanë supozuar, sepse nuk kanë pasur kurrfarë baze për të. Atëherë, ç'mund të themi ne për jetën përtej varrit? Të pohojmë se do të jetë kështu ose ashtu është plotësisht e pakuptimtë, sepse Kur'ani thotë qartë: “*Ne më së miri e dimë se ç'do të mbetet prej jush...*” si përgjigje jobesimtarëve, të cilët pohonin se me vdekjen njeriu shkatërritet dhe zhduket krejtësisht.

Sipas Kur'anit, ne e dimë se ajo jetë është e vërtetë dhe e mirëfilltë, në krahasim me këtë jetë kalimtare, ndaj nëse këtë e pranojmë si të vërtetë dhe *besojmë* në të, kjo nuk do të thotë se tani mund të zhvillojmë diskutime, të cilat kinse do të duhej të na shpienin në njohuri reale të thelbit të jetës tjetër. Duhet ta kemi të qartë se ne qëndrojmë shumë larg nga një mundësi e këtillë dhe çdo polemikë rrëth saj është e panevojshme dhe e dëmshme. Ajo është e panevojshme, sepse ne nuk mund të dimë asgjë më tepër se sa ajo që gjendet në Kur'an, ndërsa është e dëmshme sepse tërheq mendimet tona nga rruga në të cilën duhet orientuar veprimin tonë sipas mësimit islam.

Po sikur edhe kinse përfundimisht të zbulonim të vërtetën për ekzistencën e jetës pas vdekjes, ç'do të arrinim me këtë? A thua me këtë do të shtohej besimi ynë? A thua me këtë edhe për një qime floku do t'i afroheshim dhe do ta siguronim atë jetë përvete? Ajo që neve do të na siguronte atë jetë është besimi dhe puna në kuptimin e ajeteve kur'anore "*ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.*"

Është e nevojshme të spikatet se rëndësia e mësimit islam qëndron në këtë, ndërsa ajete të këtilla - të cilat bashkërisht kërkojnë *besimin dhe veprat e mira-ka* mbi 120! Vërtet numër impresiv!

Ne do të duhej t'i kushtonim kujdes kësaj, e jo t'i orientojmë mendimet tona në rrugë të tërthorta, të cilat nuk na shpien askund.

Kur e analizojmë shoqërinë islame, hasim në të dhëna të cilat këtij urdhri kur'anor i kushtojnë më pak kujdes sesa meriton ai. Kjo ndoshta për shkak se na është dhënë në mënyrë tepër të përgjithësuar krahas irregullave të tjera të caktuara kur'anore plotësisht të qarta dhe të kuptueshme. Në kuptimin dhe pranimin serioz të pamjaftueshëm të këtij parimi kur'anor, qëndron embrioni i prapambeturisë sonë.

Kjo dikuj mund t'i duket si gjë e pabesueshme. Por, megjithatë kjo është një e vërtetë, por të cilën ne nuk e hetojmë. Se ky konstatim është i saktë, do të bindemi pas shqyrtimit të disa gjérave.

Islami njeriun e konsideron si pjesëtar të shoqërisë dhe kërkon ndikimin e tij në këtë shoqëri, si dhe të shoqërisë ndaj individit, jetën shpirtërore të tij dhe manifestimin e kësaj jete, si jetë personale plotësisht e izoluar dhe e mjaftueshme përveten. Fatkeqësia qëndron vetëm në faktin se në këtë periudhë të madhe të prapambeturisë sonë është praktikuar një jetë e tillë. Nuk do të thotë se kanë qenë të panjohura parimet me të cilat muslimanët obligohen në aktivitetin shoqëror në fryshtë e irregullave islame - madje dëshira përvrim ishte e pranishme aty - por ndodhët diç e pakuptueshme:

ndërgjegjja e qetë mbretëronte në vetëdijen muslimane, ndonëse me kalimin e kohës bashkësia muslimane gjithnjë e më tepër shkatërrrohej.

Një sjellje e këtillë e muslimanëve, shikuar anash, madje edhe tek njerëzit e paanshëm, krijoj atë përshtypje, mbi të gjitha, krejtësisht të pasaktë, se Islami përmban fryshtë imanente fataliste, e cila pasardhësit e vet i shpie në mosaktivitet.

Jo, ata nuk kanë qenë indiferentë ndaj gjendjes shkatërruese të shoqërisë islame, siç nuk jemi edhe ne sot. Ata kanë dëshiruar diç më të mirë. Mirëpo, ata vetëm kanë dëshiruar...

Po ashtu edhe ne sot aq herë ndeshemi, duke filluar prej vetyves e më tutje, me të njëjtat fjalë: "Unë do ta bëja këtë e këtë...", ndërsa shumë rrallë ndeshemi: "Unë e bëra këtë e këtë..." Kështu ne në çdo hap ndeshim vetëm muslimanë të *dëshirave të mira*, ndërsa pak muslimanë *të veprave të mira*.

Të gjithë ne e vërejmë këtë. Prandaj jemi të gatshëm që edhe vetyeten ta përqeshim (e këtë edhe e bëjmë) dhe nervozohemi, kritikohemi dhe akuzohemi.

"Ne vetëm po diskutojmë, ndërsa asgjë s'po punojmë", është refreni i përditshëm i vajtimit tonë.

Megjithatë, ne këtë çështje duhet patjetër ta shqyrtojmë esëll. Këtë dukuri nuk duhet atribuar eventualisht përtacisë njerëzore ose josinjeritetit. Këtu qëndron një dobësi tjetër, për të cilën ne si muslimanë pak kujdesemi por e cila bart barrën kryesore të fajit të prapambeturisë sonë.

Çdo musliman qëllimmirë, i dëshmuar në besimin e vet islam, ka parë dikur edhe sot, nevojën e veprimit e jo të dorëzimit fatalist fatit, siç ia përshkruajnë të tjerët, vetëm se një musliman i këtillë e ka ndjerë veten të pafuqishëm, sepse nevojat e kanë tejkaluar fuqinë e tij. Ai e ka ditur se në kuptimin kur'anor të *veprave të mira* kërkohet punë. Ai madje shpeshherë saktësisht e ka ditur, praktikisht, qëllimin e duhur të cilin duhet synuar, por ai ka qenë i gozduar në mosaktivitet nga ndjenja e pafuqisë, sepse nuk ka ditur si ta realizojë atë.

Këtu ndeshim në dukurinë e pakëndshme historike të *individualizimit* të fryshtës islame, mendimeve dhe veprave. Muslimani ka bërë *vepra të mira*, mirëpo e gjithë veprimitaria e tij është reduktuar në punë të vëtmuar, personale, e cila shumë shpejt është shtrydhur në mundësitet e kufizuara të individit.

Atij i ka munguar prirja për punë të koordinuar. Prandaj ne nuk shohim ndonjë *vepër të mirë* të ndjeshme dhe të rëndësishme siç do të pritnim, sepse të gjithë e ndjejmë se puna islame në kuptimin e veprave të mira, ka fushë të madhe të pashfrytëzuar të veprimit. Muslimani i mirë e ka bërë atë që ka mund ta bëjë dhe ka pasur ndërgjegje të qetë, sepse e ka ditur se nuk është i obliguar për atë punë që është jashtë mundësive të tij. Ndërkaq ajo “që ka mund...”, është vetëmashtrim i madh. Në të vërtetë, ajo “që ka mund ta bëjë”, është shumë më tepër se sa ajo që ai e paramendon. Këtu qëndron thelbi i problemit tonë. Në kuptimin e veprimit të përbashkët dhe të koordinuar, qëndron mundësia e pakufizuar e punës dhe këtë çdo musliman duhet ta dijë nëse dëshiron ta zbatojë urdhrin e Zotit *për vepra të mira*.

Mirëpo, për fat të keq, ne nuk kemi prirje, e as vullnet për punë të kontraktuar me plan, të orientuar drejt një qëllimi, ku veprimi i individit do të përputhej me punën e të tjera ve në një tërësi të kuptimit. Ne asgjë nuk duam të punojmë nëse nuk jemi në gjendje që ta kryejmë vetë atë punë, sepse nuk dëshirojmë të lidhem “me atë” ose “me këtë” për një punë të caktuar, qoftë, sipas bindjes sonë, ajo punë edhe islame.

Ne nuk dëshirojmë me asgjë të pengohemi, të kufizohemi, të ngarkohemi ose të obligohemi. Ne duam të kemi komoditet. Neve na janë të mjaftueshme obligimet personale! Ne s’kemi ndjenjën e disiplinës, e as të vetëdisiplinës. Ne parashtrojmë kushte që na konvenojnë vetëm neve, qoftë edhe nëse i shmangemi urdhrit të Zotit të punojmë vetëm në emër të Tij dhe për Të në rrugën e Tij.

Prandaj nuk duhet qesendisur me fjalët: “Unë do ta bëj këtë e këtë”, sepse ato përbajnjë kushtin e pasprehur “sikur të mund”, por duhet gjykuar pse nuk duam ta disiplinojmë veten në mënyrë të zgjuar me punë metodike e me marrëveshje, dhe të themi: “Menëse një njeri nuk mund t’i kryejë të gjitha punët, atëherë le ta kryejë njérën pjesë; kurse pjesën tjetër do ta kryej unë.” Mirëpo, kjo është larg nesh. Këtu qëndron fatkeqësia jonë. Ne, sipas mentalitetit tonë, jemi tepër të individualizuar. Më me ëndje veprojmë (nëse punojmë diçka) individualisht. E ç’është ajo dhe sa është ajo që jemi në gjendje ta bëjmë vetë?

Vërtet, ka pasur edhe vepra të mira të individëve, edhe sot i shohim ato dhe shumë prej tyre i shfrytëzojmë si vepra të mira të individit që kanë vlerë të përhershme historike, si p.sh. xhamitë! Mirëpo çdo ditë e re parashtron kërkesa të reja, kurse përgjigje nuk

ka. Jeta është marshim i pandalshëm, kurse ne vetë të lodhur e të pakënaqur në trokun pas kohës, jemi të vetëdijshëm se mbesim prapa saj. Nëse duam të ecim në hap me kohën, duhet të zbatojmë metodë tjeter të punës; e deritashmja plotësisht dështoi.

Sa e dhembshme është e gjithë kjo kur përkujtohem se dikur muslimanët ecnin para kohës, se i imponoheshin kohës si fakt i rëndësishëm, duke ia dhënë tonin, fymën dhe orientimin me të cilin ajo lëvizte. Mirëpo, ta lëmë këtë! T'u kthehem i dhembjeve tona!

Ne jemi nën ndikimin e përhershëm të të arriturave të të tjerëve, ndaj ndjehemi tepër inferiorë. Ne mund të mahnitemi me këto ose ato rezultate të arritura, mirëpo mashtrohem i nëse mendojmë se “ata” kanë pasur njerëz më të mençur dhe më të zellshëm se ç’kemi pasur ne. Edhe ne kemi pasur punëtorë dhe të mençur, por atyre u mungonte prirja dhe disiplina në punën e përbashkët drejt një qëllimi të caktuar. Dikush mund të tregojë me gisht se edhe ne kemi pasur një punë të tillë. Kjo është e saktë, kemi pasur, por jo në masën e duhur dhe të mjaftueshme, në atë masë që e kanë kërkuar koha dhe vendi; kështu që nuk ka pasur atë ndikim frytdhënës, të cilin e kemi dëshiruar.

Shembuj që dëshmojnë se vetëm puna e përbashkët mund të japë rezultatin e dëshiruar ka me bollëk. Ja vetëm një prej tyre: Nevoja për përkthimin e Kur'anit gjithmonë është ndier në mjedisin tonë. Deri më tanë kemi pasur disa sosh, por asnjëri prej tyre nuk ka qenë plotësisht i qëlluar. Secili prej tyre ka pasur të meta. Kjo është kafshatë e madhe për individin! Vërejtjet vinin nga të gjitha anët. Edhe atë në çfarë mënyre! U hodh gur e dru.

Ky është stili ynë.

Mirëpo, gabimi i mirëfilltë ka qenë dhe ka mbetur: mungesa e punës së koordinuar e të gjithë atyre që konsiderohen se janë të aftë të jalin fjalën profesionale dhe e ndjejnë veten përgjegjës për një punë të tillë aq të ndjeshme. Nuk është me rëndësi që mendimet nuk akordohen. E rëndësishme është përpjekja e përbashkët në veprën e përbashkët. Ç’fiton bota nga zënkat e tyre që ata i quajnë polemika studimore, e të cilat në të vërtetë janë vetëm akuza dhe fyerje personale, kurse botës i mbetet vetëm të çuditet.

Ne patjetër duhet të kuptojmë se kurrë nuk ka pasur mendim të njëjtësuar, e as nuk do të ketë, por mund të ketë dhe duhet të ketë përpjekje të përbashkët drejt një qëllimi të përbashkët. Nëse bindja jonë është islam, e pastër islam dhe vetëm islam, atëherë lehtë mund të merremi vesh për qëllimin të cilin duhet ndjekur. Ai vet-

vetiu imponohet. Megjithatë, mendimi për rrugën dhe mënyrën deri te qëllimi i caktuar, gjithmonë do të jetë kontestues derisa të arrihet ndonjë rezultat. Mirëpo, kur të rëndoja ndonjë mendim, qenësore është që të veprohet bashkërisht, në harmoni, shpirtërisht, me plan, të gjithë pa përjashtim, e kjo vlen edhe për ata, të cilët janë të bindur se mendimi i tyre i pamiratuar do të jepte rezultate më efikase.

Kur të konstatohet se një rrugë nuk na shpie në qëllimin e caktuar, atëherë kërkohet rrugë tjetër, por përsëri bashkërisht, vetëm bashkërisht, pa përjashtim... Këtu duhet të jemi këmbëngulës. Përfundimisht do të gjendet rruga në të cilin do të arrihet qëllimi i dëshiruar.

Natyrisht, e gjithë kjo dikujt kështu mund t'i duket vështirë. Dhe vërtet është vështirë! Mirëpo bashkësitë, të cilat i kanë siguruar vetes në punë një këmbëngulësi dhe një harmoni të këtillë, kanë arritur diçka. E nëse dikujt i duket tepër vështirë, e madje edhe e parealizueshme, atëherë nuk duhet të qajë për fatin tonë të "mjerë." Edhe diçka: nuk duhet të mendojë se ka merituar ndonjë shpërblim të madh për atë se ka pasur plane madhështore, por, ja, nuk u gjend dikush që do t'i realizonte.

Ne shpesh i shohim nevojat tona reale dhe konstatojmë domosdoshmérinë e veprimit të përbashkët, por nuk bëjmë asgjë në këtë drejtim, sepse na mungon prirja praktike për punë me marrëveshje dhe nuk mund t'ia nënrrëndojmë tekët tona vullnetit për sukces të përbashkët. Ne jemi tepër vetjakë, kryelartë, ambiciozë, pa përgjegjësi të mjaftueshme për mirëqenie të bashkësisë sonë. Nga njëherë veprojmë në mënyrë aq të paarsyeshme saqë duhet pyetur: A mos jemi ne muslimanë të dobët, kur i lejojmë vetes që në një punë të dobishme të na pengojnë momentet personale. A thua vërtet është e mundur të gozhdo hemi në mosaktivitet edhe pse e dimë se Kur'ani prej nesh kërkon që në emër të Zotit të angazhohemi dhe për Zotin në rrugën e Tij? Si mund t'i lejojmë vetes që në punë të na udhëheq dëshira për njëfarë afirmimi njerëzor, kur nga Kur'ani mësojmë dhe e dimë se një punë e këtillë te Zoti është e pavlefshme?

Të këtillët për arsyetim shpesh përdorin fjalët: "Unë do të bëj aq sa mundem, por unë nuk dua me këtë dhe atë..." Ata vërtet bëjnë diç të dobishme, por tragjedia e bashkësisë islame është se të këtillët nuk mund të shohin se ajo që bëjnë është shumë pak, përballë asaj që i nevojitet bashkësisë. Ata mund të krenohen se kanë hequr prej vetes borxhin e obligueshëm, mirëpo, njëkohësisht duhet të di-

në se kurrfarë shoqërie nuk mund të përparojë me pikëpamje të këtilla të zbatuara në praktikë. E kur ta vërejnë këtë, le të mendojnë pak se kush do t'i gjykojë. Me siguri jo bashkëkohësit e tyre sot ose historia nesër, por vetë Zoti në Ditën e shpagimit të llogarive.

Megjithatë ne jemi njerëz me dobësi, kjo është e kuptueshme, por njëkohësisht edhe e mjerueshme se shumë lehtë po u nënshtrohem. Shumë pak po bëjmë në frenimin e ndjenjave dhe mendimeve që zotërojmë mbi ne, e të cilat Islami i dënon.

Ndërsa do të duhej që bindja islame të mbizotërojë në ne dhe nga ajo të burojë ndjenja e përgjegjësisë për atë që është e nevojshtme - për punën e paramenduar me përgjegjësi të përbashkët. Vëtëm një punë e këtillë mund të japë rezultatet e dëshiruara. Rrugë tjeter nuk ka! Shkatërrimi ynë qëndron në faktin se nuk kemi prirje për një punë të tillë. Kjo është tragjedia jonë!

Ne mirënjohim zellshmërinë e thneglave, termiteve dhe bletave, sepse puna e tyre na mahnit. Ndërkaq, ne këtu parashikojmë një dëshmi, për të cilën vërtet duhet të çuditemi, e kjo është prirja e tyre për organizimin e punës për çdo individ drejt një qëllimi plotësisht të caktuar dhe të përbashkët. Natyra ka edhe lloje të punëve e aktiviteteve të kafshëve të tjera, mirëpo ne shumë pak flasim përzellin e tyre, nuk e hetojmë, sepse u mungon fryma e thneglave, bletëve ose e termiteve.

“Kokrra, kokrra - haja (bukë nore), gur, gur - kalaja”

Të jemi të vetëdijshëm se një grumbull drith nuk paraqet bukën nore, e as grumbulli i gurëve nuk paraqet kalanë!

Çdo atom është i papërfillshëm, i parëndësishëm për vetveten, megjithatë e tërë gjithësia është e përbërë nga atomet e këtilla “të pavlefshme”, sepse janë harmonizuar në një tërësi të kuptimesuar.

Çdo musliman është misionar. Këtë e kërkon Islami nga ijtiharet e vet. Mirëpo, habit fakti se sa e huaj është fryma misionare përmusilimanët e sotëm. Ai është aq i tjetërsuar saqë as nuk e vëren faktin se Muhammedi a.s. dhe as’habët e tij, kanë qenë misionarë të mëdhenj.

Është e vërtetë se ne jemi shëmangur nga të gjitha fushat e veprimit islam, mirëpo ende mund të gjendet ndonjë musliman, i cili kryen së paku ndonjë obligim. Por, këtë obligim ama askush nuk e plotëson. Ndërsa Islami e obligon në këtë punë çdo ijtatar të vetin. Ndaj këtij obligimi ndeshim një indiferentizëm të plotë. Neglizhençë të vetëdijshme ndaj këtij obligimi hasim edhe atje ku nuk do të

guxonte të jetë. Nevojitet vetëm pak që këtë dukuri në një mënyrë t'ia atribuojmë vetes si ndonjë virtyt!\*\*

Puna misionare në kohën e sotme na imponohet si kërkesë imperative. Ajo ka qenë gjithmonë mënyrë më efektive e punës.

Nevoja për një veprim të këtillë ndihet në radhë të parë - kjo është një e vërtetë e mjerueshme! - në vetë mjedisin musliman. Ai vuan nga mosnjohja dhe moszbatimi i rregullave themelore të Islamit (p.sh. salatë, të mësuarit e Kur'anit etj.). Shkelja e ndalesave themelore është dukuri e përditshme ndër ne. Alkoolizmi, bixhozi, imoraliteti, vjedhja, gënjeshtra, fjalët dhe sjelljet vullgare, po e brejnë shoqërinë tonë.

Për hir të së vërtetës duhet pranuar se gjithmonë në mjedisin tonë ka pasur njerëz, të cilët e kanë ndier veten të obliguar që t'u përgjigjen urdhërave kur'anore! “*Predikoni të mirën, kurse largohuni nga e keqja...*”, mirëpo veprimi i tyre (nëse mund të pandehet si veprim ajo që bënë ata) ishte krejtësisht i paefektshëm, metodat e tyre plotësisht u heshtën. Ata nga vendthirrje të larta *thirrnin dhe têrhiqnin* vërejtjen dhe kanë menduar se me këtë e kanë larë borxhin e vet. Mirëpo, kush i ka dëgjuar?

Vetë predikimi është i pamjaftueshëm. Duhet zbritur në popull, nga njeriu në njeri, duke iu drejtar çdo individi vec e vec, duke mos pritur që të të kërkojë ai ty që të dëgjojë diç prej teje. Këtë e kérkon Islami. Në të vërtetë, kjo është punë e mundimshme, por e vëtmja punë e efektshme. Madje edhe nëse ndërmjet njëqind vetave

---

\*\* Shpjegimi i fjalisë: *Nevojitet vetëm pak që këtë dukuri në një mënyrë t'ia atribuojmë vetes si ndonjë virtyt!*

Aludim ironik për një dukuri të pazakonshme të një kohe të vështirë, kur në shtyp mund të lexonit deklarata të njerëzve të njojur, të cilët paraqiteshin si besimtarë, por besimi i tyre shprehej me pasivitet të plotë. Ata, sipas, siç pretendonin, parimeve liridashëse, për të cilat asokohe trumpetohet në të katër anët, nuk përpinqeshin fare të vepronin në frymën islame as mbi fëmijët e vet. Shpjegimi për këtë ishte i llojit: “Unë si musliman jam lindur dhe ashtu jam edukuar - atëherë ishin kohëra të tillë; ndërsa fëmijët le të rriten dhe edukohen në kohën e ‘tyre’, e nëse e duan fenë, ata vetë do ta gjejnë.” (Si vërtetim për këtë qëndrim ata ceknin fjalët e hazreti Aliut, qartë të interpretuara gabimisht, se fëmijët duhet të edukohen në kohën e ‘tyre’, në kohën në të cilën do të jetojnë.)

Prej nga deklaratat e këtilla? Ka pasur aty çdo gjë: frikë, turp dhe llogari. Ateizmi kulmonte, ishte në një sulm shkatërrimtar, ishte ideologji shtetërore dhe sjellje publike e individëve e pranueshme për shoqërinë; ishte edhe qëndrim “shkencor” në të gjitha institucionet edukative-arsimore, të cilat ishin nën mbi-këqyrje të drejtpërdrejtë të shtetit.

ndeshim një përgjigje të përshtatshme - e përgjigje e përshtatshme konsiderohet kur ky ihtar e përvetëson mendimin, dhe kështu fillon ta përhapë edhe vetë - ky është sukses. Nuk është sukses kur tubohen faltarët (e namazit) një orë - dy dhe bisedojnë për nevojën e salatit ose kur abstinentët binden në dëmshmérinë e pijeve dehëse. Të kuptohemi: në njëfarë dore edhe një punë e këtillë është e nevojshme, mirëpo duhet ditur se kjo është mënyra më e afërt e veprimit. Duhet gjetur alkoolistin dhe atë që nuk falet, duke ua shqetësuar ndërgjegjen, ndoshta kthehen në rrugë... Natyrisht se për punë të këtillë misionare nevojiten cilësi, të cilat mjerisht ne nuk i kemi. Ne s'kemi as traditë, as përvojë në këtë aspekt, por duhet të konstatojmë se kjo është e vëtmja rrugë që të dalim nga kjo amulli shpirtërore.

Në radhë të parë këtë duhet ta kuptojnë ata që e njohin fenë dhe të cilët e ndjejnë veten kompetentë ta predikojnë atë. Le ta dinë se vetëm puna misionare sjell rezultate, e jo puna siç është bërë deri më tani. Kur ta vërejnë këtë, do të jenë shumë më modestë në vlerësimin e vërvetes. Shpejt do t'u kalojë vetëkënaqësia me të cilën mashtrohen se ata janë shtyllat e vetme të pakontestueshme të besimit.

Islami nuk është ndonjë filozofi e pazotërueshme për individë të jashtëzakonshëm. Mësimi islam është i kuptueshëm dhe i dobi-shëm për gjithkënd, por është vështirë të zbatohen rregullat e tij. Për këtë nevojitet besimi i singertë, besimi në Zotin dhe takimi me Të në Ditën e gjykimit. Nuk është vështirë ta shpjegojmë Islamin, vështirë është t'i bindim njerëzit që t'u përbahen rregullave të tij. Këtu është e nevojshme puna - puna taktike, metodike dhe puna e mundimshme. Këtu nevojitet një tip krejtësisht i ri, me një mentalitet krejtësisht tjeter, me cilësi më të larta të predikuesit islam, tipin e misionarit të cilin ne deri më sot nuk e kemi pasur. Kjo definitivisht duhet të na bëhet e qartë nëse duam t'u përgjigjemi kërkesave të ndërlikuara të shoqërisë dhe kohës së sotme.

Do të ishte me interes të dimë se ç'mendojnë ata, të cilët Islamin e konsiderojnë monopol të tyre personal dhe se kryesisht janë të thirrur ta jasin fjalen përfundimtare. Nëse nuk na mashtron përvoja e deritanishme, atëherë një propozim i këtillë mund të shkaktojë tek ata vetëm fytyra të vrenjtura. Ata qëndrojnë shumë larg prej çfarëdo mendimi dhe vepre konstruktive.

Është mjerim i madh se si ne nuk kemi prirje dhe sens për nevojat e bashkësisë dhe të kohës. Kështu në mesin tonë mund të

gjenden edhe njerëz të tillë, që i kryejnë edhe lutjet e paobligueshme, zikër. Gjithsesi kjo është për lavdatë, por është dëm se ata nuk e ndjejnë se do të ishte shumë më mirë që këtë kohë t'ia kushtojnë p.sh. të mësuarit e rinisë sonë në kryerjen e salatit dhe të mësuarit e Kur'anit (për të cilin ndihet nevojë e madhe) dhe këtë *fi sebilil-lah*. Ata nuk duhet të presin që dikush t'i kërkojë dhe t'i lusë, por le të ngrihen dhe vetë le t'i gjejnë njerëzit e tillë e le t'i bindin për nevojën e njohjes dhe të kryerjes së salatit dhe të mësimit të Kur'anit.

\* \* \*

Në mesin e brezit të të rinjve tanë vërehet njëfarë synimi drejt mendimeve islame dhe përtëritjes së tyre në shoqërinë bashkëkohore. Nga kjo gjeneratë, e dëshpëruar thellë me gjendjen e bashkësisë sonë, dëgjohen kritika, protesta dhe kërkesa. Mirëpo, kësaj gjenerate duhet t'i thuhet e vërteta e hidhur: Ajo nuk duhet të kërkojë prej askujt asgjë sepse atë që kërkon ajo mund t'ia ofrojë askush, sepse thjesht atë nuk e posedon askush. Atë që e kërkon ajo duhet ta krijojë vetë. Një pjesë e mirë e bashkësisë sonë është gërmadhë morale, shpirtërore dhe materiale. Janë të pakta vlerat që mund të shfrytëzohen. Gjithçka duhet filluar nga themeli.

Nëse dëshirat e rinisë sonë vërtet janë dëshira të singerta islame - e ne besojmë, dëshirojmë dhe e lusim Zotin që të jetë ashtu, - atëherë nuk duhet dyshuar në të.

Vërejtja që përsëritet aty-këtu, se rinia jonë nuk di shumë, është e saktë, por kjo më së paku duhet të na dëshpërojë, sepse më qenësore është se tek ajo ekziston vullneti që të punohet diç. Elani dhe entuziazmi do t'i konpensojnë shumë të meta. Kjo është ajo forcë që krijon, e pikërisht kjo te ne deri më tanë ka munguar. Nevoja do ta shtyejë rininë të mësojë, kurse përvoja do t'i ofrojë dije. Me rëndësi është që kjo gjeneratë kupton nevojën për të punuar. Nuk është lehtë të gjendet rruga e suksesit, por ai që e kërkon, do ta gjejë! Vështirësitë janë të shumta dhe ekziston vetëm një bar: duri-mi dhe puna këmbëngulëse. Me maturi, me planifikim, me marrëveshje dhe me punë të përbashkët gjendet rruga me anë të së cilës arrihen rezultate, që individi vetë nuk do të mund t'i arrijë kurrë.

Problemet e bashkësisë sonë janë të mëdha. Qëllimi, të cilin duhet synuar, është që bashkësia të mësohet të jetojë dhe të mendojë në mënyrën islame. Ky është qëllim i lartë dhe i vështirë. Të realizosh këtë do të thotë të arrish sukses të madh. Në të vërtetë, ky

reduktohet në veprimin prej individi në individ. Suksesi është vetëm individual, mirëpo këtë duhet konsideruar sukses të plotë vetëm atëherë kur nga ky individ formohet personaliteti, i cili gjithashtu do të veprojë në kuptim të njëjtë dhe në drejtim të njëjtë.

Rinisë sonë duhet t'i jetë e qartë se do të fitojë pak ose aspak përkrahje dhe mirëkuptim. E kotë është nëse ajo konsideron se ka të drejtë në të. Ajo le të shpresojë vetëm në forcat e veta, madje le të jetë fatlume nëse nuk has në pengesa. Gjithashtu mos të llogarisë në lavdata dhe në mirënjoyje. Kjo është e mjerueshme! Mirëpo, ndoshta është më mirë që është kështu. Idealeve nuk u nevojiten kurrfarë dhuratash, e as mirënjoyjesh! Rinia duhet të gjejë shtytje, impuls e kënaqësi të vërtetë vetëm në satisfaksionin e vlefshëm të së vërtetës kur'anore "...Vërtet, mëshira e All-lahut është më afër atyre që bëjnë vepra të mira!"

## IMANI DHE DËSHMIA E TIJ\*

---

Në kohën tonë të dialogut ndërmjet pikëpamjeve religjioze ndaj botës dhe pikëpamjeve të botës ndaj religionit, kemi dëgjuar një mendim jo të rëndomtë, ku thuhet se ka njerëz të cilët për vete mendojnë se janë besimtarë, ndërsa në të vërtetë janë jobesimtarë, dhe për dallim nga këta, ka të tjerë, të cilët për vete mendojnë se janë jobesimtarë, kurse në realitet janë besimtarë.

A thua vërtet është e mundshme kjo? A është e mundshme që njeriu me bindjen e vet dhe me ndjenjat të mos jetë i pastër ndaj vetvetes?

Ne nuk mund të mashtrohem i njerëzve të tjerë, e veçanërisht kur ata me vetëdije ndjekin rrugën e vet. Ne atëherë themi se jemi mashtruar, se pas fjalëve është fshehur gënjeshtra, ndërsa pas sjelljeve është fshehur dyfytyrësia. Mirëpo, a është e mundshme ta gënjejmë vetveten? Njeriu mund ta bindë vetveten përdicëka në mënyrën e cila mund të shndërrohet në psikopate. Mirëpo, kjo nuk është dyfytyrësi. Njerëzit dyfytyrësh janë krejtësisht njerëz normalë dhe mjaft të qetë në punën e tyre. Ata që janë të shqetësuar janë njerëz me karakter të dobët: ata i shqetëson ndërgjegjja, por ata nuk kanë fuqi që ta dëgjojnë atë. Ndërkaq dyfytyrësit nuk e njohin fare ndërgjegjen. Dyfytyrësia për ta është kulmi i sjelljeve të urta. Ndërsa për atë që e mendojnë në fshehtësi dhe që e fshehin në zemër, ata janë plotësisht të vetëdijshëm.

---

\* Është publikuar në *Takvimin* e BI, Sarajevë 1977 me pseudonimin Ibrahim Sturba.

Ka njerëz që nuk janë të përcaktuar as me besim e as me pasbesim, dhe këtë mund ta fshehin para të tjerëve, por para vetit... jo! Ata janë të vetëdijshëm për dilemat e veta, ose eventualisht për gjakftohtësinë e vet.

Kur'ani premton se çdo njeri do të sillet në situatë që të mund ta shprehë atë që e ka në shpirt. Dhe vërtet, ne shohim se si jeta vazhdimesht na sjell në sprova të ndryshme. Të besosh ose të mos besosh, nuk është një gjë e thjeshtë. Këtu kemi të bëjmë me besnikërinë. Kur'ani në pasqyrimin e njerëzve na ofron fisionominë edhe të njerëzve të këtillë: këta janë jobesimtarë. Mirëpo, kur i godet ndonjë e keqe, me zemër të thyer dhe pendim i luten Zotit për ndihmë. A thua nuk janë këta njerëz, të cilët në vete mendojnë se "janë jobesimtarë, kurse në realitet janë besimtarë." Kush është kompetent të japë vlerësim të këtillë për ta? Ja se ç'thotë Kur'ani për ta: "*Kur All-llahu i shpëton ata nga fatkeqësia, ata përsëri shkojnë rrugës së shtrembër, duke harruar atë për të cilën i janë lutur Zotit.*"

Por mund të ndeshim edhe në njerëz të atillë, të cilët për vete pohojnë se janë besimtarë, por në të njëjtën kohë ekspozohen aq tepër saqë bien në kundërshtim me normat e fesë. A thua këta njerëz janë ata, të cilët për vete mendojnë se janë besimtarë, ndërsa në realitet janë jobesimtarë? Kush është kompetent të japë një vlerësim të këtillë? Sipas Islamit, e drejta për këtë i përket vetëm Zotit. Nëse supozojmë se njerëzit e këtillë janë të singertë në deklaratat e tyre, atëherë pason përfundimi se ata nuke e njohin fenë dhe parimet e saj. Islami ka ofruar normat e veta, të cilat njeriu i manifeston edhe ndaj vetit edhe ndaj Zotit. Secili njeri duhet t'i njohë ato. Detyra jonë profesionale dhe mbarislame është që t'i udhëzojmë në to.

Imani - besimi në Zotin dhe në Gjykimin e Tij të Tmerrshëm është boshti kurizor i besimit. Kjo është qendra në të cilin synojnë të gjitha manifestimet tona islame, kurse ajo është burim i tyre. Këto manifestime pa iman do të ishin të pakuptimta. Si kategori e këtillë, imani nuk është një deklaratë boshe, që do të mund të mbe-tej e tillë po qe se njeriu personalisht nuk është i qartë dhe i pastër me vetveten. Imani ka dëshminë e vet.

## *Falënderimi*

Kur'ani na mëson se All-llahu i ka dhuruar njeriut aq shumë të mira saqë njeriu nuk mund t'i numërojë ato, ndaj kërkon t'i shprehë falënderim për to. Iblisi, i zemëruar në njeriun sepse për shkak të tij humbi mëshirën e Zotit, kërkoi nga All-llahu lejen që të mund t'i mashtrojë dhe t'i largojë njerëzit nga rruga e drejtë, ndaj premton: "...dhe nuk do të gjeshë shumë që do të falënderohen." Kur'ani kur polemizon me jobesimtarët, vazhdimisht i korrigjon ata se nuk duhet të krenohen me sukseset e veta, por duhet t'i falënderohen Zotit. Ata lavdërohen me sukseset e veta si frysht i dijes, mençurisë dhe fatit të tyre, kurse Kur'ani ua tërheq vërejtjen se ato janë dhurata dhe sprova të Zotit në mënyrë që njeriu nëpërmjet falënderimit të deklarohet si besimtar ose me anë të mosmirënjojjes si mushrik (jobesimtar).

## *Sabri (Durimi)*

Durimi është normë e gjithëpranueshme hyjnore e të gjitha besimeve të shpallura, ndaj edhe e Islamit. Vuajtja është pjesë përbërëse e jetës, ndërsa nga aspekti i besimit kjo është shkalla e sproveve të mëdha. Ajo nuk i kurseu as pejgamberët e Zotit. Nga besimtarët kërkohet durim në fatkeqësi. "Shpresën në mëshirën e Zotit e humbin vetëm jobesimtarët" - thotë Kur'ani.

Kjo sprovë mund të shpie në mosbesim edhe në një mënyrë tjeter: mossuksesi personal te njeriu mund të shkaktojë xhelozin, shpirtligësi dhe urrejtje. Kundër këtyre veseve njeriu duhet të luftojë me të gjitha forcat e veta. Këto janë kurthe djajsh, në të cilat gulçitet imani. Këto të meta mund të janë aq të fuqishme saqë janë në gjendje ta deformojnë njeriun psikikisht me rreziqe të mëdha, sa për të tjerët aq më tepër personalisht për të. Mund ta shpie në pangopësi e në makutëri me të cilën njeriu i shkel të drejtat e huaja ose p.sh. kërkon vetëkënaqësi në pije.

Besimi kërkon shpirt esëll. Njeriu duhet ta kthejë shikimin e vet shpirtëror drejt Zotit. Kur'ani thotë: Mos e takoni njëri-tjetrin me smirë e zili. Gjithçka që dëshironi, kërkoni nga Zoti t'ju dhurojë nga begatitë dhe bollëku i vet.

Ruga për arritjen e durimit - janë virtytet. Duke iu përbajtur normave morale, njeriu mund të sigurohet që mos të shmanget nga kjo rrugë.

### *Veprat e mira*

Meqenëse imani është themel dhe çështje përbledhëse e Islamit, njëkohësisht është edhe preokupim kryesor i Kur'anit. Prandaj kur të lexoni Kur'anin, kushton kujdes në atë që është përcjellës i konceptit të besimit. Do të hetoni se kur flet për "ata që besojnë", flet sikur "për ata të cilët bëjnë vepra të mira." Përpinquni t'i numëroni vendet e këtilla. Kjo sigurisht do t'ju lodhë dhe do të hiqni dorë, mirëpo do t'ju dalë parasysh qëndrimi i Kur'anit: *Nuk ka iman pa vepra të mira.* Dhe anasjelltas. Këto janë dy koncepte, të cilat në mënyrë të ndërsjellë plotësohen dhe kushtëzohen. Zoti në Kur'an thotë:

*"E përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira, se ata do të janë në Xhennete në të cilat rrjedhin lumenj."* (2:25)

*"Thuaj: "Unë jam vetëm njeri, sikurse ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askë."* (18:110)

*"Kthimi i të gjithë juve është te Ai, premtimi i Allahut është i vërtetë. Ai e filloi krijimin e pastaj e përsërit atë për t'i shpërblyer me të drejtë ata që besuan dhe bënë vepra të mira. E për ata që mohuan, ka pije të valë dhe dënim të dhembshëm, për shkak se ata mohonin."* (10:4)

*"Ndërsa ai që i paraqitet Atij besimtar e që ka bërë vepra të mira, të tillët i presin merita të larta."* (20:75)

*"Të dërguarit që ua lexon ajetet e qarta të Allahut, për t'i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej errësirave në dritë. Kush i beson Allahut dhe bën vepra të mira, Ai e shpie atë në Xhennete nëpër të cilat rrjedhin lumenj; aty do të janë*

*përgjithmonë. All-lahu i ka dhënë atij furnizim të mirë.*" (65:11)

*"Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjeter) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre."* (16:97)

*"E kush bën ndonjë vepër të mirë dhe është besimtar, mundi i tij nuk i mohohet, pasi Ne i shënojmë ato."* (21:94)

*"Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon, se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh."* (17:9)

*"E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Zoti i tyre, për shkak të besimit të tyre i udhëzon në Xhennete të begatshme, në të cilat rrjedhin lumenj."* (10:9)

*"Kush ka fe më të mirë se ai që singarisht i është bindur All-lahut dhe, duke qenë bamirës, e ndjek fenë e drejtë të Ibrahimit? All-lahu e zgjodhi Ibrahimin të dashurin më të ngushtë."* (4:125)

*"Ata që besuan dhe bënë vepra të mira dhe u përuлen ndaj Zotit të tyre, ata janë banues të Xhennetit, në të janë përgjithmonë."* (11:23)

*"Dhe vetëm të All-lahut janë ç'ka në qiej dhe në tokë - për t'i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t'i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre."* (53:31)

*"Ai është që u përgjigjet (lutjeve të) atyre që besuan dhe bënë punë të mira dhe, nga mirësia e vet, ua shton atyre të mirat. Ndërsa, jobesimtarët kanë dënim të rreptë."* (42:26)

*"E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që e lëshova!"* (23:100)

*"E kush e ka për qëllim botën tjeter, duke qenë ai besimtar, përpiqet për të ashtu si i takon asaj, angazhimi i tyre do të jetë i pranishëm (te Zoti)."* (17:19)

“...Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira...” (nga sureja Asr)

“Me përjashtim të atij që pendohet dhe beson e bën vepra të mira, të tillët do të hyjnë në Xhennet dhe atyre nuk u bëhet padrejtë.” (19:60)

“Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqëndrohet për në rrugën e drejtë.” (20:82)

“Ndërsa ata që besuan dhe bënë vepra të mira, të tillët janë krijesa më e dobishme.” (98:7)

“E sikur t’i shihje mëkatarët se si i ulin kokat e veta pranë Zotit të tyre: “Zoti ynë, tash pamë dhe dëgjuam, na kthe pra edhe një herë e të bëjmë vepra të mira, se tash jemi të bindur.” (32:12)

“Kush bën ndonjë vepër të keqe, ndëshkohet vetëm për aq sa është ajo, e kush bën ndonjë vepër të mirë, qoftë mashkull apo femër, por duke qenë besimtar, të tillët hyjnë në Xhennet dhe aty shpérblehen pa masë.” (40:40)

“Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vësh-tirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjidhënia e tij zgjat tri-dhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa të arrijë pjekurinë e vet dhe kur t’i mbushë dyzet vjet, ai thotë: “Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën Tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m’i bën të mirë pasardhësit e mi. Unë pendohem te Ti dhe unë jam me muslimanët.” (46:15)

“Vërtet... nuk do të ndjejë frikë dhe nuk do të bie në dëshpërim ai që singerisht beson në Zotin dhe në Ditën e Gjykimit, dhe ai që bën vepra të mira”

“O besimtarë, bini në ruku, bini në sexhde, besojeni Zotin tuaj dhe që të shpëtoni bëni vepra të mira.”

Çdo vepër duhet të ketë një cilësi plotësisht të caktuar që të mund të karakterizohet nga aspekti islam, si vepër e mirë. Duhet të jetë bërë vetëm në emër të Zotit dhe për Zotin. Duhet të jetë jashtë çdo interesit tonë personal të kësaj bote: pa synime për famë, për

lavdatë, për autoritet, ose për dobi materiale. Për këtë më së miri është që dora e majtë mos ta dijë se ç'bën dora e djathtë.”

Për veprat e kryera në këtë mënyrë All-llahu ka premtuar dhuratë të veçantë. Muslimani do të synojë vepra të këtilla aq sa është i fortë imani i tij.

### *Ngecja e sotme shpirtërore*

Derisa falënderimi dhe durimi në kuadër të normave morale islame janë shprehje pasive e imanit, veprat e mira janë shprehje aktive e tij.

Sugjerimit në këtë komponent aktiv të imanit, e veçanërisht në *përpunimin* e tij, sot i kushtohet shumë më pak kujdes se sa pasqyrohet dhe kërkohet në Kur'an. Qëmoti ka rënë në sy mungesa e realizimit të kësaj shfaqjeje në krahasim me ato dy të parat. *Shkak i kësaj nuk është aspekti ideor i Islamit, por erozioni ynë shpirtëror:* Duke e lënë pas dore komponentin aktiv, fryma e besimit ka rënë në pozitë pasive. Kjo është plotësisht e arsyeshme kur kihet parasysh se shumë më lehtë është të mos bësh keq, se sa të *bësh mirë*.

Parimet e mëdha të besimit gjithmonë kanë qenë: *mos rrej, mos pi, mos vidh, mos vrit, mos bën kurvëri* dhe ndalesat e ngjashme të konkretizuara, të cilat si parime, nëse u përbahemi, bëhen shprehi, duke krijuar një mënyrë të jetës. Kësaj jete mund t'i përshtatemi plotësisht.

Mirëpo, kërkesat për *vepra të mira* paraqesin një virtyt, të cilin mjerisht, ne e kemi humbur. Kuptimi i *veprës* së mirë praktikisht është i pakufizuar, ndërsa ne jemi të hutuar sepse na duket diç i mjegulluar, i pakonkretizuar, aq më tepër na duket i varfër në aspektin ideor. Mirëpo në realitet kjo tregon varférinë e shpirtit tonë. Cilësia e imanit tonë është e dobët. Parimi i madh: “Më i mirë është ai që jep se sa ai që merr” ka vdekur në ne. Shpirti ynë nuk është preokupuar aspak nga porosia kur'anore: *kryeni obligimet ndaj Zotit (me vepra të mira) e pastaj edhe Zoti do t'i kryejë ndaj jush (me rrjedhoja të mira)!* Mendimi ynë është lypës, e jo krijues! Ne e kujtojmë Zotin kur jemi ngusht, kur kemi zor. E ç'bëjmë kur jemi mirë? Ku i shpenzojmë mundësitë tona, kohën dhe fuqinë tonë? Me ç'ka e dëshmojmë ne imanin tonë?

Preokupimi i besimtarit të sotëm është *salati, agjërimi, haxhi dhe zekati*. Ne i kushtojmë kujdes këtyre dhe kjo është krejtësisht

në rregull. Por nuk është në rregull se si i kuptojmë këto obligime. Ne i trajtojmë si kulm i shprehjes islame. Ndërsa ato janë vetëm shtyllat e saj. Sikur ato të ishin realizim i fundit, atëherë Islami do të ishte kallëp. Ndërsa ai (Islami) nuk është i tillë. Islami mbështetet në shpirtin e lirë njerëzor dhe në intelektin e tij. Ai mbështetet në kërkesën e Kur'anit për të bërë vepra të mira.

C'bën pjesë në grumbullin e veprave të mira, kjo është vështirë të kanonizohet. Ashtu siç nuk mund të kanonizohet as jeta. Ato nuk kanë kufi! Në Islam janë caktuar parimet, disa rregulla dhe ndalesat. Të tjerat i janë besuar arsyes njerëzore që t'i zgjidhë sipas nevojave të kohës dhe në pajtim me synimet ideore të Islamit.

Kur'ani mendimin e vet e sintetizon në këtë mënyrë: “*Besimtarë të singertë janë ata të cilët besojnë në Zotin dhe në Pejgamberin e Zotit dhe nuk dyshojnë, por me jetën dhe me pasurinë e tyre luftojnë në rrugën e Zotit. Këta janë besimtarë të singertë!*”

Ky qëndrim është veti e Islamit. Ndërmjet atij fillestarit, “të cilët besojnë”, deri tek ai i fundit “të cilët luftojnë” është përfshirë tërë jeta e individit dhe e grupit. Jeta dhe puna e pejgamberëve të Zotit, e veçanërisht të pejgamberit tonë, janë shembuj për çdonjërin i cili dëshiron të bëhet besimtar i mirëfilltë.

Të shohim se si flet Kur'ani në një moment historik për kërkosat e atij momenti:

“*O ju që besuat! Ta keni kujdes All-lahun dhe të jeni me ata të drejtit. Nuk ishte me vend për banorët e Medines e as për ata që ishin rreth tyre nga beduinët, të mbeten (pa shkuar) pas Të dërguarit të All-lahut e as ta kursejnë veten e tyre ndaj vetes së tij (Pejgamberit). Nuk ishte me vend, ngase ata nuk i godet as etja, as lodhja, as uria kur janë në rrugën e All-lahut, dhe nuk shkelin ndonjë vend që i hidhëron mosbesimtarët, dhe nuk arrijnë kundër armikut çkado qoftë (vrasje, robërim të tyre ose ngadhënjim mbi ta), vetëm se të gjitha ato do t'u evidentohen atyre si vepra të mira (shpërblyese). All-lahu nuk ua humb shpërbimin veprimmirëve. Dhe nuk japid kontribut, të vogël ose të madh, nuk kapërcejnë ndonjë lugine, e që të mos u shënohet (për shpërblim) atyre, për t'i shpërblyer All-lahu më së miri për atë që vepruan.*”

(9:119,121)

Ndérkaq, pér muslimanët e sotëm një ajet i këtillë paraqet vetëm rrëfim nga e kaluara e largët, e jo edhe porosi. Rënia e tyre shpirtërore është çështje që duket dhe është e qartë. Ata nuk e kërkojnë më në Kur'an as ligjin e as inspirimin.

Ata kanë humbur kuptimin dhe shtytjen e shëndoshë pér aksion autentik islam. Mirëpo, këtë ata as nuk e shohin as nuk e ndjejnë. Ata nuk i shqetëson ndërgjegjja e tyre, sepse në ndërdijen e tyre Islami nga aspekti ideor është rrënuar. Prandaj prania e tij në ecuritë bashkëkohore nuk hetohet.

Muslimanët marrin pjesë në to, por vetëm si objekte, e jo si subjekte nga aspekti ideor islam. Pér këtë shkak, puna e tyre qëndron larg asaj që të karakterizohet si vepër e mirë... Kjo është aq e qartë saqë definitivisht zë rrënje kuptimi i besimtarit të mirë si njeri i ndershëm, fetar dhe i cili nuk punon asgjë. Madje edhe besimin e tij ia dhurojnë, ia lejojnë, kurse atë e tolerojnë. Aq është "i mirë" saqë nuk lufton as kundër të keqes. Ai vetëm largohet nga ajo.

Marrë në përgjithësi, kjo ikje nga e keqja nuk do të ishte pér ndonjë kundërshtim të veçantë, kur ajo do ta shpëtonte nga sprova. Mirëpo, këtu kemi të bëjmë me diç edhe më të keqe. Ndeshemë me rrezikun e shtrembërimit tragjik të kuptimeve: *besimi në Zotin kërkon të pranojmë situatën të qetësuar, e jo të pajtohemi me të*.

Në vend që të jetë luftëtar pér atë që ekziston në të, besimtari i sotëm është rob i rrëthanave, që janë jashtë tij. U nënshtrohet atyre. Dhe gati se krenohet me këtë! Tekefundit, shumica ia fusin në kokë atë mendim si virtyt.

Në të vërtetë, ai e di se e keqja do të dënohet, kurse shpërblehet e mira, e këtë edhe ai e pret në mënyrë të çuditshme. Ai nuk e kupton se hipja e Nuhit në anije, largimi i Lutit natën, deportimi i izraelitëve në Egjipt nga ana e Musait, hixhreti i Pejgamberit të fundit dhe as'habëve (shokëve) të tij, nuk ishte ikje. - Kjo do të ishte disfatë.

Kjo pér mushrikët (jobesimtarët) ishte disfatë, ishte fillimi i disfatës së tyre. Fundi i popullit të Lutit ndodhi pas një nate, i Salihut pas tri ditësh, ndërsa i idhujtarëve mekkas pas dhjetë vjetësh.

Ndérkaq, pér besimtarët ky ishte një mësim dhe shkuarje në ndonjë luftë në një formë të re. Junusi në një moment ishte i ikur. E çka arriti me këtë? A thua kjo pér ne s'është vërejtje? A thua muslimanët e sotëm në tregimet kur'anore lidhur me Junusin nuk shohin fatin e tyre: se me ikjen nga ngarkesa e disa detyrave e sjellin veten në fatkeqësi të vërtetë. I humbin nga kjo botë gjërat më të dashura,

e me humbjen e tyre nuk kanë fituar as botën tjetër. Kjo është pasqyrë reale e pafuqisë! E nga pafuqia, krahas paditurisë, nuk ka rrugë më të sigurt në mosbesim. Atëherë e vetmja rrugë e drejtë që u mbetet është rruga e Junusit, rruga e pendimit për shkak të tradhtimit të obligimeve dhe lutjeve drejtuar të Gjithëfuqishmit për falje dhe mëshirë.

E kjo nuk është njësoj si pritja e qetë e shpërblimit të Zotit për vepra të mira!

Është plotësisht e qartë ana e vështirë dhe e mundimshme e veprave të mirë, mirëpo ato janë krejtësisht të logjikshme, e madje edhe të bucura. Krijuesi ynë nuk kërkon prej nesh të pamundshmen. As atë që është e marrë! E as e shëmtuar!

Ai prej nesh kërkon që në kohë të caktuar ta bëjmë atë që është e *nevojshme*. Ç'është ajo dhe si duhet të punojmë - ne kemi arsyë ta vlerësojmë dhe kemi zemër që ta ndjejmë. Rrezik nuk ka: *Rruga e drejtë dallohet qartë nga e shtrembëta*. Nuk do të gabojmë nëse sinqerisht besojmë në Zotin. Zotin e kemi të vetmin dorëzan. Në tërë Kur'anin, surenë “Ankebut” e përfundon me premtimin e vet:

“*Ata që luftojnë në rrugën tonë, me siguri Ne do t'i udhëzojmë shtigjeve tona. Vërtet All-lahu është me ata që bëjnë vepra të mira!*”

# ILMIJA SOT DHE ROLI I SAJ NESËR\*

(Një vërejtje dhe një apel brezit të ri të Ilmisë)

## I

Në botën e sotme islame po zhvillohet një debat i llojit të vet pér rolin e ulemasë së saj, si pasojë e njohjes se bota islame nuk e ka atë fuqi shpirtërore të cilën do ta prisnim nga ata që veten e konsiderojnë muslimanë. Niveli i ulët kulturor i shtresave të gjera muslimane, kushtet dhe rrethanat sociale të çrregulluara të tyre, madje edhe varfëria materiale i mvishen rënies shpirtërore - e me këtë edhe një numër i mirë i konstatimeve dërgohen si vërejtje në llogari të ulemasë së saj, sepse, detyra e ulemasë është që të kujdeset pér jetën shpirtërore të grigjës së vet.

Ç'përgjigje kërkojnë këto akuza?

A thua duhet përgjigjur përsëri në mënyrë patetike: "Inteligjencien tonë të caktuar duhet gjuquar!" ose ndoshta me një ton, më pajtues:

"Edhe të tjerët janë fajtorë!" -?

Të lëshohemi në polemika të këtilla do të ishte punë shterpe.

Qysh herët është imponuar çështja e gjendjes së përgjithshme muslimane. Pjetja se në "Cilën rrugë?", ishte e pranishme gjithkund dhe përshkohet nëpër një pjesë të mirë të historisë islame. Dëshirat dhe kundërdëshirat, akuzat dhe kundërakuzat, ngatërrresat e ashpra dhe ofendimet personale, madje edhe luftërat e përgjakshme

\* Është publikuar në *Takvimin* e BI, Sarajevë 1972.

me përmasa historike-shoqërore - të gjitha këto variante konfliktuze ishin të pranishme në mjedisin musliman.

Prandaj të përgjigjemi në këto akuza, do të ishte vetëm një grindje më tepër e cila nuk shpie askund, por edhe moskujdesi ndaj të gjitha këtyre vërejtjeve (çfarëdo qofshin ato), do të ishte punë edhe më e keqe. Në të vërtetë, pikërisht nga këto akuza mund të mësojmë se çka duhet të punojmë dhe si duhet të punojmë për të mirën e idealit tonë të pranuar. Me këtë imponohet domosdoja e analizës dhe shqyrtimit të përgjithshëm të detyrave të Ilmisë dhe të pozitës së saj specifike në shoqërinë bashkëkohore. Pra, do të merrimi me këtë çështje jo për shkak të polemikës, por për arsyen mësimit.

## II

Sot Ilmija është reduktuar në kastë, e cila kujdeset profesionalisht rrëth nevojave të ashtuquajtura themelore fetare të bashkësisë së vet. Ky nuk është kurrfarë parimi por gjendje reale, sepse në kushte të caktuara këtë obligim mund ta kryejë çdo besimtar, por jo edhe në disa kushte të veçanta. Por kjo mund të na shpie në një përfundim të gabuar: se ky është kleri i një religjioni. Themi të gabuar, sepse një institucion i tillë është i papranueshëm për Islamin.

Kjo buron nga parimet islame se nuk ka ndërmjetës ndërmjet njeriut dhe Krijuesit të tij. Njeriu i drejtohet dhe i lutet në mendimet e veta, me fjalë dhe me vepër - drejtpëdrejt. Kur'an e ka vlerësuar si mëkat të pafalshëm, si kufër, drejtimin me lutje dhe falënderim kujtdo qoftë tjetër përvèç Zotit xh.sh. qoftë edhe në kuptimin si rrugë, si ndërmjetës deri te Zoti. Për shembull lutjet drejtuar engjëeve, të shenjtëve, të mirëve - të cilët do të duhej të angazhohen te i Plotfuqishmi, Mirëbërësi për lutësin - e gjithë kjo në Islam është gjykuar në të njëjtën mënyrë si idhujt dhe viktimat e tyre. Islami nuk i njeh dhe nuk i pranon të shenjtit dhe të lartësuarit, të cilët si pas disa rregullave do të duhej të emërohen si të afërmit e Zotit, ndaj edhe më me ndikim sa njerëzit e rëndomtë.

Për këtë arsyen termi “kleri musliman” që dëgjohej dikur - edhe në kuptim edhe në parim, është term i gabuar.

Thirrja e Ilmisë është themeluar me kërkesat e Kur'anit që ndërmjet besimtarëve të gjenden edhe ata njerëz, të cilët do t'uamësojnë të tjerëve mësim-besimin. Kuptohet se kusht për të këtillët është se duhet të jenë të njojur me mësimin islam. *Ky është grup i*

*të diturve, e jo i klerikëve.* Nuk ekzistojnë kurrfarë kushtesh të vëçanta morale jashtë normave që vlejnë edhe për besimtarët tjerë.

Është plotësisht i logjikshëm zhvillimi se nga mësues të këtillë të Islamit lindin interpretues dhe mbrojtës të parimeve të tij dhe predikues të moralit të tij. Veprimi i Ilmisë është diferencuar në: shërbimet fetare (të imamit, të hatibit), të arsimimit (të mualimit, muderrizit), të gjyqit (të kadisë, muftiut) dhe shërbimit të mirëfilltë shkencor (të alimit), por pa përjashtime të rrepta profesionale. Fizionomia e gjithë kësaj është roli i xhamisë: ajo nuk ka qenë vetëm faltore e Zotit, por edhe shkollë dhe gjykatë. Jeta shoqërore dhe shpirtërore ka qenë një tërësi e pandashme. Prijatar i kësaj jete ka qenë alimi, njeri i mësuar, dijetar.

### III

Derisa në të kaluarën pikëpamjet e veprimit të Ilmisë kanë qenë me rëndësi vendimtare në jetën e shoqërisë muslimane, sot roli i saj është ndërruar që nga themeli. Ajo nuk është më kreatore e ngjarjeve shoqërore; në njëfarë mënyre, ajo vetëm shtohet që ta bëkojë mundin dhe veprën e të tjerëve. Nga dita në ditë bie edhe autoriteti shoqëror i saj.

Profesioni i alimit e ka humbur popullaritetin dhe têrheqjen e vet të dikurshme.

Si ndodhi kjo?

Para së gjithash, duhet konstatuar pse në të kaluarën Ilmija kryente një rol vendimtar. Ne shpesh dëgjojmë se si na lavdërojnë moralin, besnikërinë islame dhe diturinë e Ilmisë së dikurshme, Ilmisë në periudhën e përparimit islam. Për këtë nganjëherë têrthorazi e nganjëherë edhe haptazi na e hedhin se kjo periudhë perëndoi. Ne kurrsesi nuk mund të pajtohem me një formulim të këtillë të thjeshtë. Jo vetëm se një pohim i këtillë do të ishte ofendues për ne, por thjesht se është edhe i pasaktë. Edhe sot ka dhe mund të ketë njerëz të ditur dhe të karaktershëm.

Ajo që dikur e ka vënë Ilminë në plan të parë, para së gjithash ishte fakti se ajo ka qenë e vëmja shtresë “masive” intelektuale. Kur kësaj i shtohet se kjo shtresë ka pasur qëndrime të njësuara e të mbështetura në moralin islam, atëherë është plotësisht i kuptueshëm edhe roli i saj vendimtar në ato kohë.

Ndërsa Ilmija sot nuk është e vëmja shtresë intelektuale. Kjo është ajo që duhet kuptuar. Fakti tjetër që ka ndikim të caktuar,

është mundësia e madhe e fitimit të arsimimit të përgjithshëm të pasembullt në historinë e hershme. Mirëpo, pikërisht ky fakt nuk do të duhej të ishte ndonjë rrethanë e pavolitshme për Ilminë dhe veprimtarinë e saj. Islami në shkencën dhe arsimin sheh aleatin gjithnjë e më të mirë dhe më të sigurt. Kushti për besim është informimi dhe dituria. Ky është qëndrimi me të cilin është i përshkruar i tërë Kur'ani. Ajeti i parë i shpallur kur'anor e fton Muhammedin a.s. të lexojë dhe të mësojë, që menjëherë pastaj - pas konstatimit se Zoti është Zotëruar që e krijoj njeriun - theksoi se Zoti është më i dituri, sepse e mësoi njeriun të shkruajë me penë dhe ia mësoi njeriut atë që ai nuk e ka ditur. Në këtë kontekst na bëhet edhe më e paspjegueshme rënia jonë shpirtërore, pikërisht në këtë kohë të shkencës. Si u shkaktua kjo situatë paradoksale?

S'do mend, dikush është fajtor për këtë gjendje. Gjithkush le t'i kërkojë gabimet e veta! Çdo musliman le ta analizojë vetveten: "Çka kam bërë, çka nuk kam bërë (e është dashur ta bëj dhe kam mundur ta bëj) dhe më në fund: çka kam punuar mbrapsht?" Hendedku është tepër i thellë që për këtë të mund të jetë përgjegjës vetëm dikush ose vetëm disa.

Sa i përket Ilmisë, faji i saj i mirëfilltë historik qëndron në faktin se ajo nuk e kupto se çfarë ndryshimesh po ndodhnin rreth saj në lëvizjet shoqërore dhe ç'ndryshime po bëheshin në shkencë. Ajo thjesht nuk i pranonte ato ndryshime dhe u mbyll në botën e vet. Asaj i mungonte fryma dhe vrulli i Islamit të hershëm. Ajo nuk dha më asgjë të re, asgjë origjinale. Ajo vetëm përsërise, citonte paraardhësit e lashtë. Gjithçka ishte e shabllonizuar në format që ia impononin shembujt e vjetër. Normal e arsimit islam nuk ndryshonin dukshëm. Arsimi në atë mënyrë siç trashëgohej, i tillë në amanet u dorëzohej, dhe si i këtillë në rrethanat e reja u bë i ngushtë, i kufizuar dhe i papërshtatshëm për nevojat e shoqërisë islamë.

Ishin të paktë ata, të cilët mund ta kuptionin ose ta ndjenin ardhjen e kohëve të reja me pikëpamje të reja dhe me struktura të veçanta shoqërore.

Është i jashtëzakonshëm, dhe sipas gjasave i vetëm, rasti i Gazi Husrevbeut tonë, i cili në testamentin e vet shtroi kërkesën që në medresenë e tij "të mësohen shkencat që i kërkonte koha." Mjerisht, muslimanët nuk patën numër të mjaftueshëm të njerëzve të këtillë largpamës e mendjehollë që ta kuptionin thelbin e ngjarjeve. Ata të paktët, të cilët me kohë e kuptionin thelbin e zhvillimit dhe kërkoni

qasje të re ndaj Islamit, nuk u kuptuan; madje qenë të gjykuar si shkelës të traditave. Rasti i Afganiut është shembull konkret.

Pasojat kanë qenë dukshëm negative si në jetën shpirtërore të muslimanëve, po ashtu edhe në pozitën e vetë Ilmisë në shoqëri. Ngjarjet shoqërore filluan të zhvillohen larg Ilmisë, ndërsa më vonë edhe kundër saj. Rrymat laike u shfaqën edhe ndër muslimanë, kështu që u shkaktua një konflikt i ashpër ndërmjet tyre dhe Ilmisë. Ilmija rezistoi me këmbëngulje, por gjithkund ishte e shtrënguar të tertiqet. Shikuar historikisht, kjo ishte një disfatë e vërtetë. Nuk mund të ishte ndryshe. Fitoren mund ta arrijnë vetëm ata që dëshirojnë të krijojnë diçka të re, kurse Ilmija nuk e ofroi këtë, ajo u përpooq vetëm ta ruajë pronën e saj të trashëguar.

Se sa ishin të pakuptueshme për të koha dhe rrethanat e krijuara, shihet nga fakti se ulemaja bjerrte fuqitë e veta në mbrojtjen e formave të zbrazëta dhe të parëndësishme për vetëdijësimin islam. Muslimanët harruan se format janë çështje e fundit në Islam. Me kurrfarë formash të imponuara artificiale nuk mund të shpëtohet besimi në zemrën njerëzore.

Formalizimi është xhahiljeti më i rëndomtë. Kur shfletojmë revistat tonë të vjetra, njeriu mbetet i shtangur dhe i hutuar me përbajtjen e tyre;

Zhvilloheshin diskutime, madje diskutime të “urta” për veshjen muslimane, ndërsa shoqëria muslimane notonte në imoralitet nga të gjitha anët. Jo vetëm që gjithnjë e më pak respektoheshin rregullat themelore kur'anore të njohura mirë (siç janë për shembull namazi dhe agjërimi) dhe ndalesat (siç janë alkooli dhe kamata), por gjithnjë e më pak respektoheshin kërkesat e rëndësishme dhe të gjithëpranishme morale, ndërsa, nga ana tjeter, askush nuk dinte të tregojë mënyrën se si të pengohen ato. Dëshira ishte e pranishme, zërat alarmues dëgjoheshin nga të gjitha anët, por mungonte veprimi. Puna e mirëfilltë - ajo punë që sjell fryt, mungonte.

Nëse edhe është investuar ndonjë përpjekje, investohej plotësisht gabimisht. Për shembull: përpinqeshin që muslimaneve t'u ndalojet dalja nga shtëpia. Ndërsa duhej të kuptohet se ajo është një domosdoshmëri, që është dashur ta presim të përgatitur, në mënyrë që muslimanes, në rrethana e kushte të reja, t'i ofrohet mundësia për jetë islame. Ilmija këtë dalje në shoqëri të hapur e kundërshtonte definitivisht si katastrofë morale. Në të vërtetë Ilmija, ashtu çfarë ishte, ishte e paformuar dhe e papjekur që të luftonte në një shoqëri të tillë për parime islame, ndaj gjeti shtegdalje në injorimin e

ndryshimeve të krijuara. Asaj as nuk i shkonte ndërmend se pikërisht vetë ajo duhej domosdo të ndërrohej për një veprimitari më të suksesshme. Lufta për *status quo* - ishte e vëtmja gjë që ajo dinte ta bënte, mirëpo, kjo ishte luftë iluzore. Sot për të gjithë ne është e qartë se ndalja e muslimanes në shtëpi - ashtu siç nuk ishte e mundshme - as vetvetiu nuk paraqiste zgjidhje të suksesshme. Ajo, nga e cila aq shumë tmerrohej ulemaja, i gjeti vetes rrugë dhe mënyrë të hyjë edhe në dyert fort të mbyllura të shtëpisë muslimane.

Madje mund të haset edhe në diskutimet se a është makina punë shejtani. Njerëzit kishin harruar se shejtani gjendet në njerëz, e jo në gjësende.

Ata nuk e kishin të qartë se shfrytëzimi i makinave nuk është kurrfarë mëkat, por mëkat është të harruarit e Zotit, mungesa e mirënjosjes për dhuratat e Tij, të cilat i shfrytëzon njeriu.

Gjykohej shkolla “qafire”, - ndërsa muslimanëve nuk u ofrohej shkolla gjegjëse - e tillë, e cila do t'i aftëson te përrthanat e reja kohore. Ajo që u ofrohej, as për së afërm nuk i përbushte nevojat jetësore. Njeriun pothuajse nuk e lënë mendtë, si u bë që muslimanët nuk u alarmuan me kohë për nevojën e arsimit të përgjithshëm. Të kuptohej kjo domosdoshmëri përfaqësonte *farz kifaje*. Mos-vërejtja e këtyre nevojave është xhahiljet i vërtetë. Pasojat qenë rrënuese: me një qëndrim të këtillë iu la në duar të tjerëve njëra nga armët më të fuqishme në formimin e frymës dhe shpirtit njerëzor - shkollimi. Aktorëve të shkollimit modern u takoi autoriteti i njerëzve të mësuar dhe të ditur. Fryma islame, me fajin e bartësve të saj, u gjend jashtë këtij arsimimi dhe jashtë edukimit bashkëkohor.

Si të ruhet karakteri islam i bashkësisë muslimane - kjo qëndronte jashtë percepcionit të Ilmisë se ç'është vërtet e nevojshme të punohet që të realizohej kjo, e me këtë pothuaj jashtë synimit të saj të caktuar me të cilin do të sigurohej ajo dëshirë.

Dhe pasoi disfata! Disfata e pashmangshme! Islami, si ide e njeriut nismëtar dhe si ide për shoqërinë krijuese, u zhduk! Ende mund të shërbejë si inspirim për jetën morale të individit, por jo edhe si parim i rregullimit të bashkësive njerëzore. (“Kjo është çështje private e individit” - se me mirësjellje këtë na e prezantonj-në). U reduktua në ngushëllim dhe rezignim, kurse protagonistët e tij në rangun e njerëzve që kujdesen për pleqtë dhe për pajisjet për të vdekurit.

Përkundër kësaj, ka edhe asish që nuk pajtohen me gjendjen shpirtërore të muslimanëve dhe me pozitën e Islamit në botë. Për

shembull, Ahmedijtë! Na janë të njohura rastet se si ata përpiken të veprojnë edhe në trojet tona. Kështu na rrëfejnë, se si në një rast shpërtheu një grindje e madhe ndërmjet njerëzve tanë dhe një misionari të tyre. Ai në të gjitha vërejtjet e njerëzve tanë përgjigjej me një fjalë të vetme!

“Ne po punojmë, ndërsa ju s’po punoni asgjë!”

Për këtë do të duhej të mendojmë mirë e gjatë. A thua ky po him është i saktë? Për turp të madh tonin, po! Ata kanë rezultate që nuk mund të nënçmohen. Njohja e Perëndimit me Islamin është kryesisht vepër e tyre. Është e njohur se atje ekzistojnë qendrat islamë dhe një pjesë e mirë e tyre është pikërisht vepër e punës misionare të tyre. Para gjysmë shekulli, madje diç edhe më tepër, ata i shtruan vetes obligim ta njoftojnë botën me pikëpamjet e tyre. Krijuan kuadrin intelektual me të cilin veprojnë me maturi dhe në mënyrë të planifikuar e të organizuar.

Në krahasim me ta, prania jonë islamë, si ihtarë të medh’hebit sunnit, nuk ndjehet fare. Kjo për dikë që shikon anash është e pakuptueshme nëse nuk merret parasysh asgjë tjetër, së paku numri i madh i sunnitëve. Dhe kjo nuk arsyetohet me asgjë. Ne për shkak të këtyre argumenteve rrënuese, do të duhej ta thirrni vveten në përgjegjësi. Mirëpo, ne jemi qetësuar me bindjen se e vërteta është në anën tonë, edhe pse nuk bëjmë kurrfarë mundi përkatës që kjo e vërtetë të ndriçohet dhe të njihet. Ne jemi aq pasivë saqë shumë kritikë të Islamit, pikërisht sipas sjelljeve tona, e vlerësuan Islamin si fe e pasivitetit.

Rezultat i një qëndrimi të këtillë janë edhe bashkësitë tona fetare në një pjesë të botës. Këto janë organizata më primitive të cilat mund të njihen në tërësi. Ndërmjet analizuesve të lëvizjeve shoqërore ndeshim (edhe) në mendimin se si në këtë botë nuk ka aftësi organizuese. Një vlerësim i këtillë është i paarsyeshëm, e përveç kësaj e shmang kujdesin nga e meta reale. Në të vërtetë, këto bashkësi nuk kanë frymë, atë frymë të muslimanëve të parë, të cilët u nisën që tërë botën ta njohin me Kur'anin. Prandaj këto janë ministruktura, programet, qëllimet dhe puna e të cilave nuk mund t’i kënaqin nevojat qenësore të misionit islam as përbrenda bashkësive muslimane. Njëfarë veprimtarie në kuadër të botës islamë si një tërësi është plotësisht e papranishme, e të mos përmendet ajo në përmasa të gjera botërore.

## IV

Pjesëtarët e Ilmisë formalisht mund t'i ndajmë në dy grupe: në ata që jetojnë në fshat dhe ata në qytet. Meqenëse fshati është më religjioz, përfundojmë se veprimi i Ilmisë në fshat është i kënaqshëm, së paku deri më tani. Sa i përket qytetit, gjendja është krejt ndryshe.

Largimi i qytetit nga feja mund të pranohet si argument, por absolutisht është e pasaktë të merret parasysh bindja se urbanizimi domosdo e shpie shoqërinë në joreligjiozitet. Të theksohet kjo si ndonjë ligjshmëri - është e palogjikshme. Shkaku i mirëfilltë që feja nuk ka atë ndikim në popullsinë e qytetit si në atë të fshatit – qëndron në mungesën e eksperiencës së përfaqësuesve dhe të predikuesve fetarë, që të veprojnë në frymën e thirrjes së tyre, në kushtet e jetës, të punës dhe të synimeve të popullatës qytetare.

Edhe në fshat edhe në qytet, Ilmija mesatarisht është prodhim i së njëjtës shkollë. Mirëpo, niveli i saj kulturor qëndron mbi atë në fshat, ndërsa nën atë në qytet. Ky është një përkufizim relevior i një gjendjeje dhe i një lidhjeje shkakore, qoftë se me këtë nuk është thënë krejt ajo që duhet thënë.

Të konstatosh se edhe konfesionet tjera, të cilat kanë kuadër “profesional” shumë më të mirë, po ashtu e humbin terrenin në qytet dhe të mbrohesh me këtë - është një konstatim i pavend. Arsyet reale që edhe të këtillët nuk kanë sukses qëndrojnë në atë se ata nuk mund t'i kënaqin pikëpamjet (urinë intelektuale), dëshirat dhe synimet e asaj bote. E kjo nuk mund të thuhet për Islamin. Mësimi i tij për monoteizmin është kategorik dhe ekskluziv, dhe si i këtillë është i pranueshëm pikërisht për njeriun e arsimuar. Pastaj, marrë në tërësi, Islami qëndron mbi kuptimin e konceptit *religion*, ai është diç më tepër.

Përndryshe, do të ishte gabim të pohojmë se në përmasa absolute religjioni po humb në qytet. Jo fort moti shtypi veçoi veprimin e rëndësishëm dhe suksesin e adventistëve të Nishit. Përderisa bashkësitë e mëdha me klerikë profesionistë ose nëpunës (si te ne) nuk shënojnë çfarëdo suksesi të vlefshëm që do të meritonte të shënohet, edhe një bashkësi e vogël do ta arrijë këtë sukses. “Lisat rrëzohen, ndërsa kallami mbetet.” Si ta shpjegojmë këtë? Nga ana jonë, si shpjegim, tërheqim vërejtjen në disa vrojtime.

Njeriu s'ka dëshirë t'i dorëzohet administrimit (të kujtojmë shprehjen popullore “priftërimi”, në kuptimin dhe përdorimin e tij!)

Bashkësitë, në të cilat nuk ndjehet patronati kujdestar por bashkëveprimi, nëse vazhdimisht dhe me nder punojnë - arrijnë sukses edhe në qytet! Tek ato nuk kërkohet që të jenë dele të gjigjës, por të jenë përfaqësues të barabartë të një ideje dhe propagandues aktivë të saj, realizues besnikë të një programi. Nga çdo anëtar njëkohësisht kërkohet të jetë edhe misionar. E çka do të thotë kjo, kur në një mjedis ndjehet veprimi, jo më i njerëzve të paguar por i entuziastëve, të painteresuar materialisht, nismëtarë dhe besnikë të një mendimi, puna e menduar dhe e organizuar e njerëzve të arsimuar, mjekëve, inxhinierëve, profesorëve, këtë e kemi parë në shembullin e adventistëve të zënë ngojë.

Nëse Islami nuk ka sukses në mjedisin urban, atëherë ky është lëshim i atyre të cilat e kanë obliguar veten para Zotit dhe para njerëzve se do ta predikojnë Islamin. *E meta themelore e Ilmisë sonë është mungesa e frysës misionare*. Kjo thelbësisht dallohet nga ata, të cilët arrijnë sukses në përhapjen e bindjeve të tyre fetare.

Brez pas brezi janë edukur gjeneratat e Ilmisë me pikëpamje krejtësisht të kundërtta. Për shembull si shembull autoritativ është marrë (edhe sot merret) se si Imam Maliku refuzoi thirrjen e Harunur Rashidit që ta vizitojë në pallat dhe t'i japë përgjigje në disa pyetje të ndërlikuara, por e porosit atë se nëse dëshiron ta dëgjojë le të vijë në xhami.

Sa i përket këtij rasti, vetveti del se Imam Maliku, fatkeqësisht, nuk kishte pasur të drejtë! Ne e çmojmë Imam Malikun, urtinë dhe diturinë e tij, guximin dhe pakorruptueshmërinë, mirëpo ai është dashur t'i përgjigjet një thirrjeje të tillë, qoftë ajo edhe e sundimtarit, të cilit ai nuk deshi t'i nënshtrohej...

Përfundimi i këtij rrëfimi shkon më tepër në favor të Harunur Rashidit. Ai doli më i madh, sepse ishte fisnik dhe me qëllimin e porositur islam - që të fitojë dituri - shkeli mbi dinjitetin e vet mbretëror dhe shkoi në mesin e popullit që si qytetar i rëndomtë ta dëgjojë alimin e madh.

Do të ishte shumë më mirë që fatmirësisht të mund të na rrëfenin se si Imam Malikun shkoi te ndonjë, qoftë ai edhe i një rangu më të ulët shoqëror se vetë ai dhe t'ia shpjegojë Islamin e të veçohej si shembull për mirësjellje. Mbi të gjitha, t'i kujtojmë pejgamberin tonë dhe as 'habët e tij: *ata nuk prisnin që t'u vinin njerëzit por vetë shkonin në mesin e tyre*. Nuk ishte ky ndonjë rast i veçantë dhe i vëtmuar; ose ndonjë gjest propagandistik, por praktikë e përditshme në jetën e një mendimi. Të kujtojmë se sa e rrezikshme ishte ajo!

Pos rezistencës dhe sakrifikimit, dikur edhe “koka futej në trastë”! Këto misione disa prej tyre vërtet i paguan me jetë. Kur flet Kur’ani për ata të cilët në rrugën e Zotit luftojnë me jetë dhe me pasuri dhe të cilët ranë viktimë në rrugën e Zotit, kjo pikërisht ka të bëjë me alimët e parë - misionarë (da’itë) të Islamit.

Ilmija - e vetëdijshme se çfarë parime përfaqëson - diti të mur-murojë nga minaret e larta. Tërhiqte vërejtjen dhe kërkonte. Dhe ishte krejt në rregull - së paku deri diku - derisa xhamitë qenë plot. Mirëpo, me ndërrimin e rrëthanave duhej të ndërrohen edhe metodat, kurse Ilmija këtë nuk e bëri. Nëse njeriu nuk ka ardhur më, është dashur ta kërkojmë. Mirëpo, medet, këtë askush nuk e bëri. Edhe sot e kësaj dite ky mentalitet jeton në ne, sepse ne presim që njeriu të na kërkojë dhe të na pyesë për të vërtetën. Këtu është filli i gabit fatal të ulemasë sonë muslimane.

Sikur të veprohej sipas rregullit “T'u ofrohem i njerëzve!” me dëshirë të singertë të ngjitemi përpjetë, shumëçka do të ishte më ndryshe.

Së pari, në ndeshjen me mendimet e huaja, njeriu shpejt do të zbulonte dijen e vet të kufizuar. Kjo do ta shtynte ta zgjerojë horizontin e arsimimit të vet. (Është e ditur se në strukturën kualifikuese, në krahasim me konfesionet tjera, Ilmija qëndron mjaft dobët. Për atë shërbim për të cilin është dedikuar ose me të cilin ajo vetylën e obligon, ky profesion do të ishte edhe i mjaftueshëm!!!)

Së dyti, së shpejti do të shihte se vetë nuk mund të bëjë shumë, ndaj do të kërkonte bashkëpunëtorë. (A thua është çudi se alimët tanë të respektuar tregojnë aq pak prirje për bashkëpunim të ndërsjellë? Ata për anash u bëjnë vërejtje se nuk janë në gjendje të bëjnë asnjë përkthim të përbashkët të Kur’anit, që do të ishte i liruar nga të metat që edhe ashtu njëri-tjetrit janë të gatshëm t’ia ngjeshin te hunda!!!)

Së treti, dëshira për sukses do ta shtynte të kërkonte rrugë dhe mënyra që ta realizonte atë. Do të shihte se si duhet shumëfishuar punën, e cila siguron sukses.

Nuk është vetëm kjo punë që të mbajmë ligjëratë, e pastaj secili të shkojë “pas punës së vet”! Duhet bashkëjetuar me njerëz, duhet punuar me ta dhe duhet ofruar ndihmë të çfarëdo llojshme në vështirësitë dhe në hidhërimet e jetës. Duhet bërë pjesë e pandashme e tyre, e shoqërisë së tyre dhe atëherë kur ata e pranojnë një gjë të tillë - vetëm atëherë mund të presim sukses nga misioni ynë.

T'i kushtojmë kujdes veprimit sistematik dhe të shkathët të bashkësive krishtere: ato krijuan institucionet themelore me rëndësi shoqërore në përmasa botërore, të cilat duhet në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë të udhëheqin drejt qëllimeve të kishave të tyre; prania e tyre në shumë shtete nuk mund të injorohet. Kohë pas kohe revistat tonë shënojnë se si ata veprojnë edhe në mjediset muslimane. Si t'u shmangemi? Nuk mjafton të thuhet: "Ruajuni nga mashtrimet, mos i shëmbëlle Zotit se ka djalë", por është e nevojshme punë voluminoze dhe luftë e përditshme në jetën njerëzore. Nuk duhet arsyetuar me atë se ato kanë kuadër të arsimuar, organizata të mëdha me mjete financiare të shumta. Jo! Ata kanë njerëz që sakrifikohen, kurse ne nuk i kemi. Ata e vazhduan traditën e havariunëve të vet, kurse ne jo.

Jo fort moti kam dëgjuar nga një mik imi se si e kanë vizituar dy misionarë të një sekti të krishterë, të vogël për nga numri dhe ia kanë ofruar diskutimin dhe literaturën e tyre. Ai rrëfen: "Rastësisht, duke kërkuar tjetër të përfshirë për të cilin e dinin se interesohet për problemet religjioze, më takuan mua; nuk kishin ankuar mundin të kalonin 500 km, e të vinin tek ai në provincë."

E ja ç'bëjmë ne: Vitin e kaluar para Ramazanit më luti një plakë t'ia blej Takvimin. Ajo tha: "E pashë hoxhën dhe e pyeta a ka dalë Takvimi, e ai m'u përgjigj: "Po, janë tek unë në shtëpi. Eja pasdite, do të gjesh ndonjë anëtar të familjes." Që të jetë pasqyra më e plotë, po përmend se ai hoxhë, djalë i ri, gati do të mund të ishte nip i saj. A duhet komentim për këtë?

Njëherë, në një shoqëri, dëgjoj se si një intelektual yni ankohej në 'tanët':

"Feja më intereson shumë, por bashkëbiseduesit e mi më tepër janë priftërinj sesa hoxhallarë. Priftërinjtë nuk ngurrojnë të më kërkojnë ose të më vizitojnë edhe atëherë kur janë shumë më pleq se unë. Janë të gatshëm të ofrojnë, përveç literaturës religjioze edhe çdo ndihmë tjetër. E sa u përket tanëve, ata më parë të dekurajojnë sesa të ndihmojnë. Kohë pas kohe e vizitoja njërin nga alimët tanë shumë të respektuar për nga karakteri dhe dituria. Nuk po hasi në atë takim të cilin e pres, madje me një rast më tha: "Shih, shumë njerëz u hyjnë punëve që nuk i kanë profesion. Shiko (dhe më tregoi një revistë tonën), ja kjo vajza po shkruan për Islamin... Ç'i duhet kjo asaj? Ajo është nëpunëse, le të merret me punën e vet, le të regjistrojë në ndërmarrjen e vet... etj..."

“Nuk ndjehem mirë” - vazhdon ky intelektual - “a nuk është ky qortim edhe ndaj meje sipas asaj shprehjes popullore: ‘I flet të bijës - që të dëgjojë reja’!” A t’i them: “Ata atje, laikët përhapjen e idesë për Zotin dhe moralin e fesë i presin duarhapur.” Ose: “Ju gjithsesi dini më tepër. Ndihmoni me dijen Tuaj atë qëllim fisnik, udhëzojeni!”-? Vendosa definitivisht dhe ia ktheva me zë: “Ç’të bëni profesor, kur të tjerët që janë më kompetentë dhe më të përgatitur nuk tregohen në vepër... Ra libri në dy shkronja!”

Në një rast tjeter dëgjoj një intelektual tonin se si kritikon Ilminë, ndaj qëllimi i thashë: “E po mirë, ku jeni ju kritikë në vepër? Gjithçka pritni nga hoxhallarët! Pse ju nuk punoni?” Ndërsa ai m'u përgjigj! “Pengesa e parë dhe më e madhe pikërisht janë hoxhallarët. Ata menjëherë do të më diskualifikonin. Ata nuk analizojnë veprën, por njeriun. Kunj murizi i tyre është: “Ai nuk është hoxhë, çka di ai!” Kështu dikur ishin në shënjestë dr. Metiljeviqi për shkak të librit të vet “Islami” dhe Bashagiqi për komentet e veta të haditheve”, - dhe vazhdon gjithnjë e më ashpër: “Ata këtë edhe nuk e duan. Atyre nuk u vjen mirë që aq shumë merrem me Islamin, më shikojnë vëngër. Dashamirësinë e tyre do ta fitoja sikur të vija në xhami nga Bajrami në Bajram dhe nëse do t’i angazhoja që të m’i këndojnë hatme babait. Atëherë do ta fitoja prej tyre karakteristikën “Muja është musliman i mirë.”

E kundërshtova. I thashë se po e tepron dhe se nuk ka të drejtë t’i fusë në një thes të gjithë.

Ai heshti. U mendua pak, dhe disi më i qetë filloi: “Ekziston anekdota (që i dedikohet herë njërit, herë tjetrit, në të cilën - në pyetjen: “Përse hoxhallarët kanë shkruar aq pak?” - përgjigjet: “... Që të mos ndriçohet se sa pak dinë.” Ndërsa unë do të shtoja: që edhe prej vetes të mos krijonin cakun e gjuatjeve të ulëta. Ja, Çausheviqi ka qenë alim, ne deri më sot nuk kemi pas alim më të madh, e çka përjetoi ai për shkak të përkthimit të vet të Kur'anit?! Unë po flas vetëm për mënyrën se si shqyrtohen: me këtë ata nuk i lejojnë askujt - as atyre në mesin e tyre, as atyre për anash - që me çkado qoftë të dallohen. Si mund të marrë njeriu guxim për çkado qoftë të rëndësishme, kur që më parë e di se nuk do të hasë në mirëkuptim, e as që do të fitojë çfarëdo qoftë përkrahjeje prej atyre, të cilët pikërisht janë kompetentë për këtë?”

Gjithsesi e gjithë kjo nuk mund të jetë arsyetim për papunësinë e kujtdo qoftë: Përveç kësaj, mendimi i shprehur më lart vlen të kihet parasysh: ai tregon gjendjen shpirtërore të bashkësisë sonë. Du-

het tē pyesim pēr tē dy anët: Ku qëndron puna me moralin tonë islam? Ç'po ndodh me ne? Është krijuar atmosfera e një kënete amull, në tē cilën shpirtërisht po shkatërrrohem.

Që ta plotësojmë mendimin e kësaj analize, ja edhe një shembull konkret:

Kur i ndjeri Çausheviq në kohën e vet skicoi arabikën ('matufën!) dhe kur njëherë ia tregoi një miku tē vet, ky-siq thuhet - iu përgjigj:" Kjo është punë shumë e mençur, mirëpo ç'do tē bëjmë ne alimët, kur çdokush mund ta mësojë Islamin pa ne?"

Ne sot jemi dëshmitarë tē gjallë se si këto farë rezonimesh tē marra e tē shëmtuara po na hakmerren rëndë.

Kjo është periudhë e masivitetit në çdo lëmë, pra edhe në kuadrot e kualifikuara edhe në literaturën cilësore. Ai, i cili nuk është në gjendje ta sigurojë këtë masivitet, automatikisht është i gjykuar në izolim dhe shkatërrim. Konkurenca e vrapimeve në krasim me përvojën e deritanishme ka marrë përmasa tē papara në fushën religjioze.

## V

Qëllimi i këtij artikulli - e përsëris rishtazi, - nuk qëndron në atë që ky ose ai tē nxihet. Jo se dikush nuk e ka merituar, por për arsy se kjo është një punë e padobishme.

Tekefundit, tē gjithë ne dëgjojmë rrëfime edhe më tē shëmtuara, tē cilat me pëshpëritje përhapen anembanë Bosnjës... Kush do t'i drejtojë lakadredhat e Drinës? Ta lëmë kritikën për shkak tē kritikës! Për këtë mund tē shkruhen romane.

Këtë e zumë ngojë që tē rintjtë tanë, inteligjencia jonë e nesërme, ulemaja jonë e ardhme, ta kenë parasysh gjendjen e vërtetë tē gjërave, shkaqet e mirëfillta tē tyre dhe rrugën e zgjidhjes.

Ata duhet tē jenë tē vetëdijshëm se në shoqëri do tē inkuadron pa orealin e autoritetit tē dikurshëm. Ata duhet patjetër ta braktisin iluzionin se gjenden në froni e autoritetit para tē cilit është i obligueshëm tē dorëzohet edhe Harunur Rashidi i fuqishëm. Të shpresosh në diç tē tillë është iluzion i kulluar.

Krahas asaj, ata tē cilët mendojnë për çfarëdo interes personal, le ta dinë se këtu nuk kanë shumë dobi. Tërë trashëgimia, tē cilën mendojnë ta pranojnë, përbëhet nga borxhet ndaj Zotit, bashkësisë dhe historisë. Kapitali shpirtëror dhe material islam kaherë është shkapërderdhur. Ndërtesa e vjetër e shoqërisë islame është një gërmadhë historike.

Ajo nuk mundi t'i bëjë ballë një javashllëku aq të madh dhe mentalitetit profitues e plaçkitës.

(Tekefundit, është çudi e vërtetë se si mundi të qëndrojë edhe aq gjatë!) Të vazhdohej në rrugën e deritanishme do të thotë vetëm të pranosh edhe rolin e varrmihësit të Islamit. A thua dëshiron ndokush prej jush një famë të tillë?

Në kushtet e reja të botës bashkëkohore është e nevojshme të ngrihet ndërtesa e re islame. Është kjo një detyrë e mundimshme. *Këtë mund ta realizojnë entuziastët dhe të dëshmuarit, e jo interes-xhinjtë*. Islamit i nevojitet një tip i ri i alimit.

Pengesat janë të mëdha, por ata që ushqejnë dashuri ndaj Islamit, nuk duhet të ligështohen shpirtërisht, nuk duhet të thonë: "Të gjitha lëvizjet historike - shoqërore janë kundër fesë, veçanërisht kundër mendimit islam", dhe kështu të pajtohen me zhvillimin e ngjarjeve dhe t'i nënshtrohen rrymës së tij. Edhe këto ngjarje janë fryt i veprimtarisë njerëzore. Trimat dhe të ndershmit le të fillojnë të punojnë! Shanset për fe janë më të mëdha se sa duken në vlug të parë. Keni shembuj të shumtë dhe të afërt.

Tribuna e rinisë në Xhaminë e Mbretit, *Takvimi, Preporodi* dhe definitivisht *Zemzemi* juaj, e gjithë kjo mund të shërbuje si shembull evident. Mundi i dhënë tregoi rezultat më të madh sesa ishte parashikuar.

Përfundimi është i padyshimtë: në grigjë ka më tepër shëndet (forcë) moral, sesa aktivitet te barinjtë. E grigja është e madhe, kurse barinj ka pak.

Për përparimin e Islamit janë të mundshme planet më ambicioze. Bota islame shpirtërisht është lënë pas dore, por e madhe dhe me dëshirë që të ngrihet. Këtë mision të zgjimit shpirtëror mund ta kryejë kuadri i njerëzve të profesionit tuaj, atëherë përse pikërisht të mos jeni ju?

Edhe në planin botëror mundësítë janë të mëdha. P.sh. bota bashkëkohore gjendet në zgrip të krizës morale, që i kërcënöh me asgjësim. I vetmi ilaç efektiv mund të jetë morali i një besimi.

*Përse të mos jetë morali i besimit tonë?*

Edhe njeriu i qytetërimit të sotëm po përpinqet ta kuptimësojë jetën dhe vdekjen. Kërkon shkakun dhe kuptimin e ekzistimit të vet. Islami i ofron përgjigjen e vet me autoritetin e pejgamberisë nga Qenia më e Lartë. Mirëpo, kush do t'ia përcjell këtë? A thua nuk është kjo pikërisht detyrë e jona ... e juaj?

E gjithë kjo nuk është e pamundshme. Vërtet, jeta njerëzore është shumë e shkurtër që njeriu të mund të përjetojë suksesin e plotë të një ideje, mirëpo kjo nuk duhet ta dekurajojë: vijnë të tjerët dhe e vazhdojnë punën e filluar. Kur Alejhiselami u paraqit me misionin e vet gjithënjerëzor, mushrikët (të pafetë), xhahilët, të dyshimtët dhe munafikët, e konsideronin si njeri të dalë mendsh. Ndërsa, ata te të cilët jehoi *besimi*, për një gjysmë shekulli, pushtuan gjysmën e botës së atëherershme.

Për njerëzimin nuk ekzistojnë ide të parerealizueshme. Njerëzit arriten në Hënë, sepse këtë e dëshiruan (dhe sinqerisht punuan në këtë drejtim). Ky është ligj i Zotit. Kur’ani thotë: “*E Zoti i tij ia pranoi lutjen atij dhe e largoi nga ai dredhinë e tyre. Vërtet, Ai është që dëgjon (lutjet) dhe di (gjendjen).*” (14:34)

Islamit i nevojiten njerëz të gatshëm për punë, edhe atë për punë të organizuar. Ne doemos duhet ta braktisim fryshtën “individualiste” të muslimanëve nga periudha e dekadencës, që u tregua si shkaktare kryesore e pafuqisë së mëvonshme historike të Islamit.

Zhvillimi i shoqërisë dhe i të gjitha manifestimeve të saj shpie nga ndërlikueshmëria. Është evidente tendenca drejt formave më të përsosura të organizimit dhe të veprimtarisë së individëve të specialisuar. Individët humbin në tërësi; ata me aftësinë e tyre të specialisimit të lartë i kontribuojnë cilësisë së tërësisë, mirëpo aftësia e tyre për veprimtari të pavarur është tepër e kufizuar. Veprimtaria e individëve të izoluar nuk garanton rezultate të dëshiruara. Ajo mund ta kënaqë kryelartësinë, madje edhe ambicjet personale të individit, mirëpo në synimet më të gjera të një ideje dhe të një bashkësie, ajo tregohet si veprimtari e pamjaftueshme, e paplanifikuar, e paorganizuar dhe si veprimtari që s’ka perspektivë.

Ne duhet patjetër të heqim dorë nga shpresa në “gjeni” dhe “mehdi” prej të cilëve presim shpëtim. Shpëtimi qëndron në ne, *në besimin*, nëse e kemi. Në fantazinë tonë ne presim nga dofarë shpëtimtarësh se do ta punojnë atë, me të cilën Zoti në të vërtetë na ka *obliguar* ne!

Madje edhe suksesi i Pejgamberit tonë, shikuar nga aspekti historik - mbështetej në aftësinë e tij që t’i organizojë muslimanët në punën drejt një qëllimi. Nga aspekti i besimit, besimtarët kanë arritur sukses, sepse në zemër kanë pranuar udhëzimet e Kur’anicit që të lidhen fuqishëm si një godinë. (Sureja Saff; ajeti 4).

Fitojnë vetëm ato ide, ku ithtarët e tyre ambicjet e veta personale njerëzore ia nënshtrojnë përbashkësisë ku ngulfaten dobësitë

tona njerëzore me të cilat ne dëshirojmë të shpërblehem materialisht ose të afirmohemi personalisht: këtu qëndron edhe kuptimi i thirrjes së përhershme kur'anore që shpërblimin e vërtetë, nëse vërtet jemi besimtarë, ta presim nga Zoti. Atëherë shpërblimet tonë njerëzore na duken të pavlefshme...

Ilmija, definitivisht, duhet të heqë dorë nga ndarja e muslimanëve të arsimuar në të ashtuquajturën inteligjenci fetare dhe në atë diç tjetër. Ky formalizëm i ndarjes është barrë e rëndë nga koha e parapambeturisë së Islamit.

Ndërkaq, po qe se dikush përpinqet ta mbrojë këtë me pohimin se ai është fakt që ekziston, dhe të cilin si të këtillë duhet edhe akceptuar (na pëlqen ose jo), atëherë aq më keq për ne! Nga jeta e përditshme e dimë se kjo ndarje bëhet gjithnjë e më tepër një formalitet i rëndomtë: t'i takosh Ilmisë nuk do të thotë të jeshë i ditur dhe besnik ndaj Islamit, e po ashtu të jeshë jashtë kësaj shtrese, nuk do të thotë të jesh i paditur në çështjet e Islamit dhe i painteresuar ndaj interesave të tij. Këtu nuk kemi të bëjmë me ndonjë ndarje të mirëfilltë shoqërore, por më tepër me momentin psikologjik, i cili mbahet falë inercionit të një shoqërie që gjallon në zgrip të jetës. Ekziston tendencia që ky dallim të shlyhet, vetëm duhet - në interes të përparimit tonë shpirtëror - sa më shpejt të evitohet.

*E vetmja ndarje, që ka mbështetje në parimet e Kur'anit, është: në ata që punojnë për Islam dhe në ata që nuk punojnë. Këtë duhet përforcuar në vetëdijen tonë. Atëherë secili le të vendosë për atë mbretëri që i bindet...*

Ilmija e re duhet të heqë dorë nga qëndrimi i përjetuar karakteristik i përvetësimit dhe monopolizimit të të drejtave në Islam. Duhet ngulfatur në vete atë synimin qesarian "Më mirë të jesh i pari në katund se sa i dyti në Romë!" Më tepër do të fitonim edhe si anëtarë anonimë të një bashkësie të fuqishme, se sa që fitojmë si barinj të vetmuar të një grigje të shpérndarë e të dobësuar.

Ilmija e re duhet ta kuptojë veten si *shërbëtore e Islamit*. Pikërisht për këtë, ajo le t'i qaset asaj të dytës, të ashtuquajturës inteligjenci laike, dhe me këmbëngulje le t'i kërkojë në radhët e tyre ata që duan të punojnë *në fushën e veprimitarisë islamë*. Me rëndësi është të krijohen mundësi për punë të organizuar me qëllim të qartë dhe me plan të caktuar të veprimit.

Të zbatosh besnikërisht këtë, do të thotë të arrish sukses – gjithsesi, sukses për Islamin. Kjo është e vetmja mënyrë që të krijo-

het *inteligjencia islame* e mirëfilltë - grapi që do të jetë në gjendje t'i realizojë me sukses kërkesat e Kur'anit (3:104).

## VI

E gjithë kjo që u parashtrua dhe u komentua do të jetë vështirë të kuptohet dhe të pranohet nga gjeneratatona të vjetra.

Njëra palë këtë do ta injorojë, ndërsa tjetra do ta përbuzë dhe do ta nënçmojë. Ndërsa kur është fjala për çfarëdo përpjekje për ndërrimin e rendit të rëndomtë të gjërave, bashkërisht dhe me kryneçesi e refuzojnë. Nuk është me rëndësi se sa vërtet, personalisht janë të bindur se bëhet fjalë për diç të re. Ata, thjesht, nuk janë në gjendje të zbresin nga binarët e deritanishëm. Me mënyrën e pikëpamjeve të tyre ata intelektualisht janë pjekur dhe psikikisht janë mësuar, saqë është e pamundshme të mendojnë dhe të punojnë jashtë këtyre kornizave.

Prandaj prej tyre as nuk duhet pritur udhëheqje dhe mbështetje, por as “uratë” në këto synime të reja. Tekefundit, nuk do të vlente të brengosemi për shkak të mungesës së përkrahjes, sikur të mos duhej të llogarisim në kokëçarje të pakëndshme nga ana e tyre. Ata janë në gjendje të shkaktojnë telashe të mëdha. Për diç të tillë, ata janë të zotët.

Mirëpo, gjeneratat e reja duhet ta kuptojnë nevojën e këndeljes sonë e ta shohin realitetin në sy, dhe kushtet e tij të vështira përpërtitjen e mendimit islam, e kjo për dikë (ndoshta) mund të thotë ndarje nga diçka, e cila ndoshta i është bërë.

Më në fund, ky është interes i vetë Ilmisë si kastë, nëse ajo mendon të ekzistojë dhe ta arsyetojë ekzistencën e vet shoqërore. Pikërisht, duke mos bërë përpjekje për ekzistencën dhe përparimin e Islamit, Ilmija e ka sjellë veten në situatë që e shpie drejt likuidimit të qetë të saj.

Nëse ky vështrim bëhet vetëm rrëfim për të shurdhërit, atëherë le ta dinë se së shpejti nuk do të kenë mundësi as për rolin e vet të sotëm përfaljen e xhenazeve dhe leximin e hatmeve.

A thua nuk e shohin ata se po vijnë gjenerata të reja, të cilat as që dinë për këtë ngushëllim? Për çdo ditë të re në “kështjellën” e tyre, besimi dhe xhamia po humbin rëndësinë e tyre: nëpër fshatrata tonë si vërvshima po përhapen kafenetë, bixhozi, revistarë pornografike, do të thotë diç më argëtuese, se sa janë në gjendje t'u ofrojnë ata me autoritetin e tyre. A thua kjo nuk shihet qartë? Ose ndoshta

mendojnë ta arsyetojnë neglizhencën e vet me fjalët: “Ç’ti bësh, të këtilla janë rrethanat dhe kohët!” dhe me përkulje të krahëve.

Ata, që mbesin të shurdhër për nevojat e Islamit, së shpejti do të mbesin edhe memecë në shoqërinë e vet. Do ta humbin atë (shoqërinë), por do të humbin edhe vetë. Zoti në Kur'an thotë:

*“O ju që besuat! Mos i merrnipër miq ata të cilëve u  
është dhënë libri para jush, e as jobesimtarët që me  
fenë tuaj tallen dhe luajnë. Keni dro All-lahun po qe  
se jeni besimtarë.”* (5:57)

Të mendojmë për ajetet:

*“O besimtarë, përsë flitni atë që nuk e bëni! - Zoti  
është shumë i zemëruar kur flitni atë që nuk e bëni.”*

Ose ky ajet:

*“O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni?  
Te All-lahu është shumë e urejtur ta thoni atë që nuk  
e punoni!”* (61:2-3)

në të cilin besnikërisht pasqyrohet tipi ynë! Ne shumë mirë e dimë kujt i është drejtar ky ajet dhe si është zemëruar Zoti në ta. A duam edhe ne Ta dëshpërojmë? Edhe ne e njohim besimin ashtu siç e kanë njohur edhe ata. A thua kjo është e mjafshme?”

Kur'ani është krejtësisht i qartë kur thotë:

*“O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti të  
bujshme që ju shpëton prej një dënimisë të dhembshëm:*

*“T'i besoni All-lahut dhe Të dërguarit të Tij, të luf-  
toni në rrugën e All-lahut me pasurinë tuaj dhe veten  
tuaj, e kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse  
jeni që e dini!”* (61:10-11)

Ndërsa ne sot në çdo hap ndeshim njerëz të cilët prej vetes kanë bërë tregtarë të besimit... A thua duhet kjo ta sigurojë përparrimin e Islamit?

Ne thjesht jemi anestetizuar nga prapambeturia e gjatë e besimit tonë. Në të vërtetë prapambeturi e ngadalshme, por e përherëshme. Më as nuk reagojmë. Këtë e pranojmë si domosdoshmëri, e nuk duam të shohim se pikërisht ne jemi mëkatarë. Kur'ani këtë haptaz na e bën me dije:

*“O ju që besuat, ç'është me ju, që kur ju thuhet:*

*“Dilni në rrugën e All-lahut!”, ju rëndoheni përtokë?*

*A jeni më të kënaqur me jetën e dunjasë, se sa me ahi-  
retin? Kënaqësia e jetës së dunjasë në krahasim me  
ahiretin, është e vogël!”* (9: 38)

Dhe menjëherë pastaj vazhdon me kërcënëm të tmerrshëm:

*“Nëse nuk punoni, Ai (Zoti) do t’ju dënojë me dënim  
të dhembshëm dhe do t’ju zëvendësojë me një popull  
tjetër...”*

A thua kësaj duhet shtuar edhe diçka?



# PËR NJË INTERPRETIM BASHKËKOHOR TË ISLAMIT\*

I dashuri mik!

Ka kohë që mendoj të të shkruaj për veprimin e atyre misjonarëve tanë nga Pakistani i largët. Edhe pse kam ndjerë nevojë për këtë, megjithatë jam hamendur, dhe për një kohë të gjatë as vetë nuk e kam ditur përsë ngurroja. Diçka më pengonte, e këtë diçka - tash po e kuptoj - ishte pamundësia që të thirrem në autoritetin, i cili do ta arsyetonte vlerësimin tim. Ndërkaq, ti e di se për mua i vetmi autoritet është fjala e Zotit.

Përnjëherë m'u kujtua një ajet kur'anor, i cili në kohën e vet më është dukur shumë relativ, dhe i cili pikërisht për këtë arsyе edhe më ka shqetësuar. Përndryshe, po të ishte i kujdo qoftë tjetër, as që do të merreja me të. Mirëpo, tani kur e zbatoj si masë në veprimtarinë misionare të atyre pakistanezëve, më del si pohim krejtësisht i qartë i vlerësimit logjik, e me këtë edhe mua më është bërë i qartë, e kam kuptuar se ç'është dëshiruar të thuhet me të.

Në përgjithësi është e njojur se këto misione në viset tona kanë dështuar plotësisht në qëllimin e vet. Pa marrë parasysh se ç'mendojmë dhe ç'ndjejmë me këtë rast - është i mundshëm dëshpërimi, që neve vijimisht na përcjell dhe që konstatohet në ne me fjalët e njoitura mirë "Te ne gjithçka është kështu" ose edhe më hidhur në paaftësinë tonë me fjalët e pashmangshme "Punët tona!"

\* U publikua në *Takvimin e BI* në Sarajevë, 1975, me pseudonimin Amir Shehiq.

që ne i dëgjojmë në çdo hap, ose më së paku nuk e ndjejmë veten mirë kur shohim të tjerët se si me ndërgjegje përpiken tepër në punën e pafrytshme dhe sado e pakëndshme qoftë kjo, gjithë ajo ndërmarrje meriton interesim dhe komentim. Çdo dashamir i Islamit, nga mossuksesi i tyre, mund të mësojë shumë gjëra. Ata që nga hapat e parë ndikojnë në mënyrë shumë të pakëndshme. Mendoj në veshjen e tyre. Për ambientin dhe shprehitë tona është veshje provokative dhe e çrregulluar. Vërtet kam qenë i befasuar me konstatimin se sa ndikon kjo edhe tek unë vetë. Kërkesa “Mos shiko se ç’vesh njeriu, por shiko se çka në njeriun!”, që ne shpesh e dëgjojmë, ndërsa edhe më shpesh e përsërisim - qëndron shumë larg nga e vërteta e parimeve tona, të cilave ne u përbahemi. Megjithatë, njeriu do të mund disi t’i arsyetojë (Ata janë njerëz nga një nënqiell tjeter i zakoneve e pastaj: një kohë të gjatë gjenden në rrugë dhe kanë mjete materiale modeste), ose kjo përshtypje do të zbehej vetyri, po qe se metoda e tyre e shqyrtimit të mendimeve islame u përgjigjet standardeve të arsimit, kulturës dhe interesimit të njeriut tonë. Këtu qëndron epiqendra e dështimit të tyre.

Njohja e tyre me mjedisin tonë është e qartë se ka qenë baraz me zero. Mirëpo, ende këtu nuk është tragjedia. Çdo gjë ka fillin e vet. Mirëpo - nëse ata momentalisht nuk posedojnë njohuri specifike pér mjedisin në të cilin mendojnë të veprojnë - ata do të duhej të posedojnë deri diku një arsimim të përgjithshëm, që bën të mundshëm kuptimin më të shpejtë të ndonjë mjedisit të huaj, siç është ky yni pér ta. E pikërisht një arsimim i këtillë i përgjithshëm tek ata nuk ekziston. Kjo është e metë kryesore e tyre. Është e pamundur të veprosh (me sukses!) në një mjedis derisa nuk arrin ta njohësh. Duhet të kesh parasysh mënyrën e rezonimit dhe vrojtimit të tij, e pastaj të japësh pér të *përgjigje islame*.

Mos të harrojmë se sa kujdes ka Kur’ani pér këtë! Ai besnikërisht e përfaqësonte mendimin e vet, ndërsa ne, duke e ndjekur këtë mendim, pothuaj rregullisht humbim nga vrojtimi të dhëna dramaticitetin e predikimit kur'anor. Në Kur'an janë shënuar të vërtetat e amshueshme, të cilat janë predikuar prej të gjithë pejgamberëve të Zotit, dhe ne sot i kemi të sistematizuara (si p.sh. shartet e imanit dhe shartet e Islamit e të ngjashme.) Mirëpo, ato nuk janë dhënë larg aktualitetit të një kulture të atij mjedisit, të cilit i janë drejtuar. Kjo ishte përgjigjja në praktikën e një bashkësie krejtësisht të caktuar. Ai pakursyeshëm iu vërsul gjithë asaj që i përket asaj shoqërie, duke filluar nga idhujt e tyre, duke u kundërvënë me devizën e vet

“Hyjnia e vetme është All-lahu!” deri në imtësitë të atilla të befasishme për ne, të cilat ne i radhisim në rregullat e mirësjelljes. (Në të gjeti dy virthje interesante, mikpritjen dhe fjalën e dhënë të heroit kalorsiar, të cilat - natyrisht, në frymën e qëndrimit të vet parimor - edhe i rekomandoi si vlera, vetëm nëse zbatohen në emër të Zotit dhe për Zotin). Faqet e Kur'anit janë shprehje impresive të kësaj bashkësie, sepse ai me fanatizëm i ofrohej - siç thekson - si vërejtje, si bar, si udhëzim. Dhe - që paraqet befasë - kjo nuk ka mbetur as nga aspekti sipërsaqësor e as nga ai kohor në periferinë e historisë. Vrulli ideor ka qenë aq i madh saqë Islami si aktor u gjet në qendër të ngjarjeve botërore në një kohëzgjatje prej mbi një mijë vjet. Shikuar historikisht, shfaqjen e Islamit mund ta theksojmë si gërcë të historisë, i cili e ktheu plotësisht në rrjedha tjera.

Pikërisht për këtë arsy, në ne lë përshtypje të mundimshme anemia e mendimit të sotëm islam, të cilin na e ofrojnë edhe këta pak misionarë tanë. Prej tyre vazhdimisht dëgjojmë rrësimin e lodhshëm për madhësinë e Islamit, porse nga ky tregim asgjë nuk del. Përse? Përgjigjja e mirëfilltë është: Ajo që na ofrohet është jo aktualë, ndërsa ata të cilët na ofrojnë këtë, nuk janë në gjendje t'i aktualizojnë parimet islame. Ky koncept për ta është i panjohur. Nuk ia dinë as kuptimin as rëndësinë. Ata janë të paarsimuar për diç që përfaqëson pikën gravituese të Islamit.

Suksesi historik i pejgamberit tonë, përmua personalisht paraqet një mrekulli të vërtetë historike... Pa precedent! Ai si bartës i një ideje arriti edhe ta realizojë në një tërësi, duke filluar që nga përvetësimi i individit për Islam, e deri te ngritja definitive e bashkësisë muslimane në shtet. Kur e krahasoj këtë sukses me mossuksesin e propaganduesve të sotëm të Islamit, kërkoj shkakun edhe të njërit edhe të tjetrit. Dhe atëherë më bie ndërmend ajeti kur'anor, në të cilin theksohet se si Zoti xh.sh. i dha Muhammedit a.s. Shpalljen, urtinë dhe diturinë. Ne e posedojmë këtë Shpallje, mirëpo ne kemi mbetur pa urti e pa dituri.

Kur'ani thekson se u është dërguar të diturve, ndërsa shikoni! - sot atë ua ofrojnë vërtet njerëz të paditur.

Po t'i marrim gjërat nga aspekti formal, këtë nuk do ta prisnim. Përkundër kësaj, kjo është dhembja jonë e përgjithshme, e cila nuk i bishtnon as këta misionarë. Përbërja e një grupei ka qenë e këtillë: i diplomuari i El-Ez'herit, djalë i ri; të tjerët janë nëpunës të institucioneve të ndryshme, madje njëri kinse mjek (por - unë mendoj se këtu kemi të bëjmë me ‘mjek popullor’). Disa dinin arabisht, ndërsa

të tjerët edhe anglisht. Mirëpo, shkalla e temës së tyre dhe interpretimit të saj ishte në nivelin e ulemave tanë (të viseve tona) të para shtatë-tetë dekadave. Ja si dukej kjo:

Ai nga El-Ez'heri ishte i thelluar mirë në temën e vet, e gjithsesi edhe pse e ka përsëritur kushedi sa herë. Ndërkaq, arabisht fliste mjaft rrjedhshëm.

Pa obligim që besnikërisht ta theksoj rendin e deklarimit të tyre, si bosht sipas kuptimit, do ta shënoja përpjekjen e shpjegimit të madhështisë së konceptit "*La ilah il-lall-lah!*" Kjo është shprehur nëpërmjet rrëfimit se si Musa a.s. i është lutur Zotit që t'i mësojë ndonjë zeje, ndërsa Ai i përgjigjet se do ta mësojë diç shumë të vlefshme, e kjo është *La ilah il-lall-lah!* dhe se kjo peshon (sikur ta peshonte) më tepër sesa e tërë gjithësia.

Ky është një mendim suptil, që kërkon nuancim shprehjesh, sepse i shtruar ashtu thjesht mund të shkaktojë parafytyrim të gabuar për kérkesat islame: thuajse njerëzit nuk kanë nevojë të kujdesen për jetën, por vetëm për besimin. Ndërsa, ne e dimë se si përkufizimi i mendimit religioz në një kuptim të këtillë i ka hapur rrugë disfatës ideore të fesë në botën e sotme. Dhe, në vend të pritjes së njëfarë argumentimi të fuqishëm kundër mendimeve të materializuar të njeriut të sotëm, ai vazhdon kështu: "Se sa e madhe është kjo, shihet nga fakti se kur të thuash '*La ilah il-lall-lah*', në Xhennet rritet një lis aq i madh saqë hijen e tij kali nuk mund ta kalojë me vrapim qarkor as për 500 vjet."

A është ky hadith apo është tregim i thjeshtë i lashtësisë, nuk e di. As nuk e hulumtoj këtë. Për mua kjo nuk paraqet çështje për diskutim: aq sa ka mbështetje në Islam e pranoj këtë pa vërejtje. Madje as nuk shtroj pyetje se si ta kuptoj, tekstualisht apo në alegori. Por vetveten e pyes: Ç'mund të përfaqësojë kjo për një frymë polemizuese dhe armiqësore ose definitivisht për një frymë neutrale dhe indiferente?

Paramendo një situatë të këtillë: bie shi i ftohtë dimëror me ditë të tëra, kurse xhamitë janë pa ngrohje. Kujt mund t'i bëjë përshtypje tregimi për hijen e madhe? E kuptoj se çfarë përshtypjeje mund të ketë për njerëzit, të cilët rrëth e përqark vetes shohin tokën e zhveshur përcëlluese. Mirëpo, ky tregim është pa efekt të dëshiruar për njerëzit të cilët prej jush presin diçka tjetër, diçka që është preokupim i tyre.

Në momente, sikur të thirresha në ndonjë ajet kur'anor ose hadith (si p.sh. ai për gjashtë obligimet ndaj të tjerëve: të japish selam,

të ofrosh ndihmën e kërkuar, të ofrosh këshillën e kërkuar, ta përvendosesh kur të teshqijë, ta vizitosh të sëmurin dhe t'ia falish xhenazen të vdekurit), kjo edhe mund të dëgjohej ende, po që se edhe nuk përfaqëson diç të jashtëzakonshme.

“E gjithë kjo qëndron në nivelin e medhhebit” - dëgjoj se si e komenton njëri. Dhe vërtet, sikur kjo t'u jetë drejtuar fëmijëve të mitur ose njerëzve të paditur. E pastaj do të pasonin rënie të palejueshme.

Përvkrimi i Pejgamberit të All-llahut ishte kësijoj: djersës së tij i vinte era, mbi të gjithnjë qëndronte një re që i bënte hije të vërtetë. Përvkrimi i xhennetit: në të gjendet pema, pas së cilës mbetet era 40 vjet me radhë, ndërsa njerëzit fatbardhë (xhennetlinj) mbajnë nga 120 palë rroba të tejdukshme nga mëndafshi më i mirë.

Ky tregim për rrobat veçanërisht më ka tërhequr vëmendjen dhe më ka shtyrë të meditoj.

Sa ka mbështetje ky tregim në hadith, nuk më është e njojur, por më është e njojur se në një fis të Saharasë Qendrore autoriteti shoqëror matet sipas veshimbathjes, në të vërtetë, të gjitha rrobat që i ka njeriu të gjitha i veshë mbi vete. Gjithsesi se këtu bëhet fjalë vetëm për disa palë rroba, sepse ata janë njerëz të varfër, dhe për shkak të kushteve klimatike, kanë nevojë për rroba shumë të lehta. Është e mundshme pra që ky mos të jetë rast i vëtmuar. Më lejoni të pohoj se dikur moti njëfarë fisi në Arabi kishte të njëtin koncept për autoritetin shoqëror. Mendoj se këtyre ndonjë misionar musliman ua ka përvkruar xhennetin si vend ku do të kenë mundësi të mbajnë 120 palë rroba. Mund ta parashoh se çfarë përshtypje ka lënë në ta ky njoftim.

Ndërkaq, neve që sot përdorim të gjitha këto të arritura teknike, të na servohet një tregim i këtillë... e po, vërtet, kjo nuk ka kurfarë kuptimi.

Po theksoj, ashtu siç besoj në Ahiret, po ashtu jam i bindur se shqisat e tij e tejkalojnë jo vetëm atë që e kanë arritur njerëzit dhe që do ta arrijnë, por edhe tërë këtë fantazi tonën botërore.

Prandaj edhe nuk e analizoj besnikërinë e këtij tregimi. Thjesht u përbahem ajeteve kur'anore ku besimtarëve dhe mirëbërësve u premtohet plotësimi i të gjitha dëshirave në Ahiret. Pra, edhe të këtillave!

Diç tjetër nuk më le të qetë: mungesa e prirjes që të nxehet dëgjesi për idenë dhe mendimin islam.

Personalisht për mua është karakteristik komentimi im spontan kur përmend hadithin në të cilin flitet si duhet pirë ujë: të bëhet Bismilah dhe duke ndenjur të pihet gërçamë pas gërçame. E ka theksuar pra se feja këtë e lavdëron, ndërsa njëkohësisht edhe për shëndetin është e dobishme. Mirëpo, ja se ç'kam menduar në atë moment në vete: "Pashë Zotin or vëlla, a thua është dashur të kaloj disa mijëra kilometra që të na thuash këtë?! Këtë mund ta dimë edhe ne këtu. Sepse këtë e kam dëgjuar nga nëna ime."

Gabimi metodik në shpjegim më ka rënë në sy veçanërisht në rrëfimin *për katër të mirat*. Përmend se si njeriu kur të vdes, mandej e varrosin, dhe kur të vijë koha e namazit - nëse është faltar - bëhet gati të çohet, e atëherë nga ana e djathtë një djalosh e ndalon dhe i thotë "Bjer! Ti je i vdekur, unë jam namazi yt që e ke falur gjatë tërë jetës dhe tani unë të ruaj." Kur shikon në anë të majtë, djaloshi tjeter, e ky është agjërimi i tij... etj. Pastaj shfaqet një gjarpër i madh, i cili don ta përbijë ndërsa këta katër djelmosha e mbrojnë...

\*  
\* \*

Jam tmerruar. Kjo i përmgjet një primitivizmi aq të madh intelektual saqë tingëllon si një komprometim i rëndë i mendimit islam. Në të njëjtën kohë, më mundon mendimi se ndoshta jam tepër i një-anshëm, dhe se gjykoj me njëfarë paragjykimi të gabuar. Përpinqem që me gjakftohtësi ta shqyrtoj çështjen. Mundohem që t'i krijoj vetes pasqyrën e ambientit, ku, megjithatë mund të ketë njëfarë efekti më të volitshëm: vend i prapambetur dhe i përthyer, me popullatë analfabete, ku u mungon çdo gjë, përveç kohës, dhe të këtillëve t'u ofrosh një tregim të zgjatur e të bymyer, ku përveç mësimit të gjejnë edhe argëtim.

Për çudi, më shkon mendja te Tolstoi! Diçka më bezdis mendimi se ai do të ishte i entuziazmuar me këtë tregim, megjithëse shpirti musliman për të ka qenë i huaj. Më duket se ai në këtë kallëzim do të gjente një alegori të thellë dhe mençurinë e njerëzve të rëndomtë. Mirëpo, për njerëzit të cilët në fe kërkojnë qartësi dhe besnikëri, kjo është e papranueshme.

Do të mundej vetëm - po qe se ky tregim ka fare mbështetje në hadithe, sepse në Kur'an nuk ka - të shprehet me një fjali të vetme, për shembull: "Edhe në varr njeriun e ruajnë këto *katër të mira* deri në Ditën e gjykit." Dhe asgjë tjeter! Mirëpo, kështu vetëm me kusht që kjo të jetë futur me mjeshtri në ligjëratë, e cila sipas vlera-

ve do të qëndrojë dukshëm mbi atë me të cilën ndeshemi për çdo ditë. Ligjëruesi duhet të jetë artist i përkryer në punën e vet. Në të kundërtën, e gjithë kjo merr karakter diletantizmi.

Përkthyesi ka qenë cilësor. Mirëpo në përkthimin e ligjëruesit qartësia nuk është manifestuar, ndaj nuk ka pasur aspak mundësi të fshihen të metat thelbësore të vaizit, por ato kanë dalë në shesh me tërë lakuriqësinë e tyre.

Vaizi ka dështuar para se të fillojë. Në të vërtetë, përfundim as që ka pasur. Ligjérata është ndërprerë në atë çast kur filloi të ngrihet masa. Qe i mjaftueshëm të dalë vetëm një si nxitje për të dalë të tjerët. Mund të paramendosh se sa situatë e mundimshme ishte ajo. Aq më tepër, disa u përpinqën thjesht të ikin edhe para fillimit. Kur vetëm e kujtoj këtë - disa vraponin drejt dyerve, kurse të tjerët i pengonin - do të qeshesha sikur kjo mos të ishte pjesë e realitetit tonë të hidhur. Veçanërisht më ka rënë në sy sjellja e një fetari, njeri plak, i ndershëm dhe i çmuar. I pari arriti në derë dhe vrazhdë e shtyu me dorë - gjest i cili flet shumë.

Kur bisedova më vonë me një mik, i thashë se sa e pahijshme ishte kjo, ky ma ktheu:

“Duhet ta kuptosh! Krejt kjo, që po e tregojnë këta, ai e ka dëgjuar që në fëmijëri, e përveç kësaj, ai është dëshmitar i aq shumë gjeneratave, të cilat e kanë braktisur Islamin. Ato nuk kanë mundur të mbahen me kësofarë përrallash. Ato kanë qenë humbje të mëdha, të cilat ai si të tilla i ka përjetuar. Të kërkosh prej tij që përsëri t’i dëgjojë këto, për të është njësoj sikur ta dëbosh nga feja. Ndërsa ai këtë nuk e dëshiron.

Ai dëshiron t’i mbetet besnik Islamit, dhe gjithsesi ka gjetur arsyetimin e vet intelektual për këtë besnikëri të vetën. Ai dëshiron që atë qetësi të fituar shpirtërore ta ruaj.”

U dëgjua edhe kjo vërejtje: “Çuditem sa të paturp janë. Nuk e njojin as gjuhën, ndërsa i hynë punës së këtillë. Krejt çka kam vërejtur ishte një fjalor anglisht me fjalë tona i formatit pak më të madh se kutia e shkrepëses. Si marrin guxim... si, kur shohin se jemi të veshur më mirë dhe se jemi më të mençur se ata.”

Në këtë nuk u përgjigja fare, edhe pse në thellësinë e shpirtit u pezmatova rreptë kundër fjalës ‘pa turp’! Kjo tanë ishte një ofendim i padrejtë për një qëllim të mirë.

\* \* \*

I dashuri mik, kur vendosa që të të shkruaj, mendoja të paraqes vetëm fakte të ftohta e përfundime edhe më të ftohta. Mirëpo e pashtë se kjo nuk është e mundshme, sepse nuk kam qenë vëzhgues i ftohtë. Sikur të kisha qenë i tillë, atëherë për krejt këtë, sigurisht, as nuk do të të shkruaja. Drejt po të tregoj se kundër vullnetit edhe kam vendosur të marr pjesë në vaiz, pikërisht kam rënë në situatë e cila më ka obliguar për këtë. Domethënë kurrfarë kureshtje - edhe më parë kam dëgjuar vaize. As nuk kisha dëshirë që diç të mësoj - e kam ditur përafërsisht çka më pret. Mirëpo kësaj here e tejkaluan edhe parandjenjën më ndjellazezë.

Me mund të madh jam përbajtur që thjesht mos të largohem.

Më duket sikur të dëgjoj: "Ani, se ke duruar deri në fund." Mirëpo, aty ende nuk ishte fundi. Rendi ishte që dikush t'i përcillte deri te vendstrehimi i tyre. Kaluam rrugës së ngarkuar. Nuk guxoja t'i ngrë sytë. Isha i sigurt se kalimtarët po na shikojnë. Më kapluan djersët dhe njëfarë mundimi. Më vinte turp... e atëherë u turpërova nga turpi i vetvetes. M'u kujtua ajeti kur'anor "Abese..."

Duke pritur jacinë, formuam një ndejë të vogël. Aty disi më lehtë merrja frymë. Ajo që ishte emotive ngapak u qetësua dhe përshtypjet e sistematizuan. Paramendoja vetë konturat e përfundimit definitiv. Kam gjetur diç edhe të mirë, për lavdatë.

Ata ndjejnë obligim që t'i përgjigjen Kur'anit dhe të veprojnë në rrugën e Zotit. Dhe ata këtë e bëjnë *fi sebilil-lah*. Krejt me shpenzime të veta. U ikin çfarëdo pritjeve dhe darkave, pikërisht ikin nga ajo prej së cilës vuajmë ne. E pashë se kjo është punë shumë e mençur. Kjo është shkollë e madhe që personalisht çdokush ta pastrojë zemrën e vet nga munafikllëku, ta ruajë veten nga sprovat, që krejt kjo mos të kthehet në një turne të lirë turistike në llogari të fesë.

Norma për këtë obligim është 40 ditë në vit. Më së paku është tri ditë, dhe atëherë shkojnë në fshatrat më të afërtë rrëth e qark vendbaneve të veta. Ndërsa maksimumi është katër muaj; si te këta, dhe të tillët drejtohen në vendet e largëta. Fitova bindjen se ajo është punë shumë më e menduar dhe më e organizuar sesa mund vërehet në shikim të parë. Atyre u lindi ideja të veprojnë sipas sistemit të Rotary - klubit, në grupe të përbëra nga njerëz të profesioneve të ndryshme. E kjo dëshmon diçka: dëshirën jovetjake për sukses. Dhe kjo prirje dhe ky vullnet - që të punohet bashkërisht

- nxitën te unë respekt. (Kjo ndër ne është e panjohur, nuk mund të gjesh dy veta që të punojnë diçka bashkë, me përjashtim kur kemi të bëjmë me diç qelepir!)

Kushtet për një veprimitari të tillë janë të vështira. Ato kërkojnë kursim, vetëmohim dhe përpjekje të mëdha. Këtu është e nevojshme shtytje e fortë - bindja, besimi.

I kam vërejtur me kujdes ata njerëz. Prej tyre shndriste flaka e njerëzve që stojnë në të vërtetën dhe freskia e dëshmisë se janë në rrugë të drejtë. M'u kujtua ajeti: “*Janë të ndritshme fytyrat e atyre të cilët bëjnë sexhde...*”

Dhe njëri nga kritikët e rreptë të përmendur, dukshëm e ndërroi qëndrimin e vlerësimit të vet. “Sikur ne ta kishim besimin e fortë të tyre, kurse ata dijen tonë!”, ishte saldoja e vëzhgimit të tij.

Vërtet, çelësi i problemeve të tyre është dija. Ata vetë thonë: “Ne nuk dimë shumë, edhe ne mësojmë dhe këtë e transmetojmë më tej.” Ndërkaq, e meta kryesore nuk qëndron në atë se ata nuk dinë ‘shumë’, por ata nuk dinë se çka duhet ditur për suksesin e misionit të tyre në kohën moderne.

Së pari, duhet të kesh kujdes për synimet e kohës së re, të cilat përgjithësisht janë pranuar si vlera. Krijimtaria e disa popujve i ka nxitur ambiciet edhe të popujve tjerë në të njëtin drejtim. Vizioni shkencor i një supercivilizimi në të ardhmen e drejtpërdrejtë u bë pikë orientuese dhe tërheqëse për të gjithë. Ndërsa predikuesit e Islamit nuk e shohin rëndësinë e këtij realiteti. Më parë këtë do ta nënçmojnë sesa ta vlerësojnë. Kjo është e pakuptueshme. Gjithë këtë duhet ta pranojnë në mënyrë që edhe ata të bëhen pjesëtarë të njerëzimit të nesërm dhe në të të luftojnë për vlerat etike. Por edhe pa këtë, ata gjithë këtë duhet ta pranojnë si shërbim njerëzor, të cilin e bëjnë nga dashuria ndaj Zotit.

Së dyti, civilizimi i sotëm ka edhe anën tjetër, ka pasojat e veta. Shfrytëzimi i të arriturave të tij ka krijuar probleme specifike të drejtësisë shoqërore. Kur kërkon prej tanëve zgjidhje për to, ata nuk të ofrojnë kurrfarë çanësimi real. Unë nuk dyshoj se kjo përgjigje është për vetë ata, e jo edhe për të tjerët. T’i ofrosh dikuj këshillë të dobishme mundesh vetëm nëse vihesht ‘në lëkurë të tij’. Mirëpo, ata janë shumë larg nga kjo. Ata intelektualisht janë të robëruar me të kaluarën. Prandaj, Islami në duart e tyre përfaqëson diçka të vjetër, të përjetuar, pa dinamikë të brendshme e cila krijon dhe formëson.

Ndërkaq, shikojeni Kur'anin! Edhe ai vazhdimisht merret me të kaluarën, por jo për shkak të faktografisë historike. Për fat të keq

të dashamirëve të historisë, ai nuk u kushton kurrfarë kujdesi numrave, emrave dhe kohës së ngjarjeve. Atij i interesojnë ato fakte nga të cilat mund të nxirren përfundime *morale* të nevojshme për krijimin e historisë së vet.

Protagonistët e sotëm të Islamit janë predikues të rëndomtë të së kaluarës, të mahnitur nga drejtësia e Umerit, heroizmi i Tarikut, Kordova, Alhambra... Por ata asgjë nuk krijojnë të veten. Janë në gjendje të shkruajnë një mal librash se si ka përparuar Islami, por nuk punojnë me sukses edhe në përhapjen e tij sot. Ata nuk janë pjekur e as nuk janë astësuar për një detyrë të këtillë. Ata nuk janë të aftë të nxjerrin mësim nga ajo që e kanë parasysh. Ata nuk janë pjekur t'ia ofrojnë njeriut bashkëkohor Islamin krijues si shtegdalje nga vështirësitë që e mundojnë. Vizioni i tyre nuk është ardhmëria islame e njerëzimit, të cilën do ta synonte fryma e tyre. Shpirtërisht jetojnë në të kaluarën e Islamit, mirëpo ky nuk është frysëzim. Ata dëshirojnë të jenë besimtarë sipas sjelljes. Mirëpo, kopjet shkatërrohen, ndërsa origjinalet mbasin. Muslimanët e sotëm dobët e vërejnë thelbin e Kur'anit. Kur'ani është përplot kallëzime për Nuhin, Ibrahimin, Musanë, Isanë, por këta nuk janë plagjiatë. Sikur Muhammedi a.s. të kishte qenë plagjiator, ai kurrë nuk do të arrinte sukses. Ai ishte diç tjetër. Ai ishte luftëtar origjinal për parimet e paraprijësve të vet, e jo imitues i jetës. Shumëkush këtë nuk e kupton. Imitimi nuk është njësoj me të qenurit konsekuent. Ajo është forma në të cilën shpesh mbytet shpirti.

Dhe jo vetëm se nuk janë në gjendje që të ‘kaben në vallen’ e ngjarjes, por edhe bëjnë gabime sheshazi. Nga goja e tanëve mund të dëgjosh edhe zgjidhje të tilla, që në mosdijen e tyre e komprometojnë rëndë mendimin islam. Ata këtë e bëjnë përafërsisht kështu: sikur të kërkohej prej dikujt mendimi se si të pengohen grabitësit ajrorë në aksionet e tyre kërcënuese, kurse ai të përgjigjet:

“Ja, ky është civilizimi juaj! Asgjësoni aeroplanët!”

Shqyrtimi për këtë propozim është i padobishëm - jo pse këtë askush nuk do ta bëjë, dhe se gjithmonë do të gjenden njerëz, qoftë edhe me rrezik, që do të fluturojnë, por - se t'i zhdukësh aeroplanët nuk do të thotë se do të zhduken edhe grabitësit. Këta tipa të njëjtë deri dje i kanë ndeshur udhëtarët si cuba deti ose si hajdutë rrugësh, ndërsa nesër - kur të përparojë kozmonautika dhe kur të niseni p.sh. për uikend në Hënë - do të keni rast të ballafaqoheni me ta edhe në hapësirat e gjithësisë.

Rezonimi i mbrapshtë, në të vërtetë nuk është monopol i vencantë i tanëve. Nga të gjitha anët dëgjohet alarmi përmjedise të këqija urbane dhe pothuajse duhet zhdukur qytetet. Tanët me dëshirë i citojnë mendimet e këtilla dhe - në mungesë të pikëpamjeve të veta të qarta - del se edhe pajtohen me to. E ky është moskujdes i madh: Meqenëse njerëzve u është mjegulluar rruga drejt zgjidhjes dhe i kaplon frika nga e ardhmja, ata kërkojnë ngushëllim në të kaluarën e idealizuar dhe merren me ide joreale, ‘kthimin nga natyra’ dhe mashtrime të ngjashme.

Paramendoni sikur vërtet të ekzistonte mundësia që p.sh. me ndonjëfarë temponaut (kohëfluturues) të Uellsit të transferoheni në ‘kohët e vjetra të mira’, a do ta pranonit këtë me të dy duart? Do të ishte mirë që të mendoni mirë përmirat, të cilat kinse ju presin. Do të mund të gjendeshit si ndërtues i dhunshëm i piramideve ose si galeot<sup>\*\*</sup> i gozhduar përmbrëtë lundrës, derisa kërbaçi vazhdimisht ju qëndron mbi kokë; ose të gjendeni në mesin e kanibalëve, apo të qëlloni në kohën kur murtaja bënte kërdi. Në këtë rast ju do të ishit të sigurt, sepse para këtij zgjimi ju do të injektoheshi... por si do ta ndjenit veten duke shikuar gjithkah mjerim: vetëm çdo i katërti mbetet të jetojë dhe këtë në mjerim të tmerrshëm?

Është e vërtetë se me bollëkun e të mirave materiale, nuk është përbushur ëndrra njerëzore, të cilën e quajmë lumturi, mirëpo, po ashtu edhe ikja nga civilizimi nuk është ikje e domosdoshme në ndonjëfarë shoqërie më humane, e as nuk është garanci përmiratësia të vërtetë të individit. Ju lutem në emër të Zotit, mos e udhëzoni mendimin njerëzor në rrugën e gabuar të mendimit. Feja nuk e gjykon përparimin material. Kuptojeni se mundësitë e sotme të civilizimit janë bekime të mëdha të Zotit, përmiratësia e cilat nga zemra duhet T'i falënderohemi - ky është parim i fesë.

\*  
\* \*

Rënia e moralit sot është dukuri drastike në të gjitha strukturat shoqërore. Rezistenca kundër imoralitetit gjithnjë e më tepër po dobësohet. Disa forma të imoralitetit, madje edhe ligjshmërisht janë pranuar si fakte në shumë shtete të civilizuara me arsyetim se ato janë sëmundje e jo ves. Kështu imoraliteti po bëhet veçori e civili-

---

<sup>\*\*</sup> Galeot-i m. galerian m. detar në galë. Ndërsa galë-ja ishte një anije lufte ose tregtare, që përdorej në kohët e lashta, duke lundruar me pëlhurë e lopata; (Sh.p.)

zimit bashkëkohor. Mirëpo, kjo nuk është asgjë e re në histori. Shoqëri të këtilla ka pasur edhe në të kaluarën, të cilat janë zhdukur.

Kur'ani ia parafytyron në figura të gjalla civilizimit mekkas, i krahason njërin me tjetrin, sjell shkaqet e katastrofës së tyre, ndaj e nxit shoqërinë mekkase të zgjedhë: besimin dhe moralin ose shkatërrimin.

Edhe rënia e moralit të sotëm është pasojë e mohimit të besimit në Autoritetin absolut, mohimin e Zotit. Çdo besimtar e ndjen se Islami do të duhej të ishte intervenues. Kur'ani është Shpallja e fundit për të gjithë popujt dhe për të gjitha kohët. Mirëpo, ku janë mbrojtësit e tij?

Dhe tani, me keqardhje duhet të konstatosh se edhe këta, të cilët janë të paktë në numër dhe iu përgjigjën Zërit të ndërgjegjes, veprojnë pa sukses. Ata gabimisht i qasen njeriut të së sotmes, sepse nuk e njojin mënyrën e të menduarit të tij. Ata dëshirojnë ta tërheqin në besim me çështje që nuk kanë kurrfarë lidhje logjike me të, në vend se t'ia ofronin Islamin si udhëzim, si bar, si vërejtje në jetën e tij të përditshme.

Nëse dëshiron sukses, duhet t'i qasesh njeriut në mënyrë të pranueshme, sipas kritereve të tij, pa marrë parasysh se çfarë mendimesh të çuditshme shpreh. Ne nga Shpallja e dimë se çfarë qëndrimi mund të ketë njeriu ndaj besimit (duke filluar ta trajtojë si marri e thjeshtë njerëzore e deri te armiqësia e rrezikshme), mirëpo, ti nuk guxon të ftosh në mënyrë të marrë dhe dëbuese! Në suren "Nahl" të Kur'anit, ekziston ajeti - e ky është ajeti në të cilin aludova në fillim të kësaj letre! - dhe ai thotë: "*Thirri (njerëzit) në rrugën e Zotit të tyre me urti dhe me këshilla të mira.*" Ai ua ka sqaruar të gjitha. Mënyra e veprimit të këtyre, për të cilët po të flas, vërtet është larg nga ajo që të jetë e mençur.

Ky është rezultat i një shkolle, kallëpet e së cilës janë bërë të shenjta për ne. Atë e kanë programuar alimët tanë të mëdhenj nga e kaluara e largët, ndaj edhe pse horizonti i dijes dhe metodave të tyre nuk u përgjigjet nevojave të sotme të Islamit, ne me këmbëngulje u përbahemi atyre. Neve nuk na është aspak e qartë se këta njerëz të mëdhenj, të së kaluarës sonë dhe të së kaluarës së huaj - Farabiu, Sina, Gazaliu, Aristoteli, Platon, Arkimedi - të gjithë me radhë do të kishin rënë në një provim të sotëm të rëndësishëm të pjekurisë. E tërë fusha e tyre intelektuale dhe e diturisë (për ç'arsye me të drejtë u bënë dhe mbetën të famshëm), nuk do të mund t'u ndihmonte të hyjnë në garë me nxënësin e sotëm mesatar të shkollës së mesme.

Sot një fillorist mund të japë sqarime për shumë nocione, për të cilat ata nuk kanë ditur asgjë. T'i numërojmë të gjitha këto gjëra do të ishte shumë didaktike, por këtu nuk do të ketë mundësi - ky numërim do të ishte një studim i tërë. Ata shumë gjëra nuk i kanë ditur.

Sokrati këtë në diturinë e vet e ka paraparë dhe sinqerisht e ka pranuar.

Kushtet dhe kriteret që njeriu të arrijë atributin *i ditur, i arsimuar, i shkolluar*, nga dita në ditë po ndërrohen. Përderisa arsimimi bashkëkohor i Perëndimit është në hulumtim të vazhdueshëm përsisteme sa më efektive, duke i braktisur metodat e veta të deridjeshme, shkolla jonë islame të njëjtat metoda ende nuk i ka përvetësuar. Kjo shkollë është anakronizëm i pashebullt. Dhe kështu feja jonë po fundoset bashkë me të. Ajo (shkolla) akoma mund të japë karaktere të mrekullueshme, si këta misionarë, por ata dështojnë në veprimin praktik. Ata nuk arrijnë rezultate pozitive. Dëm i madh! *Ata do të dëshironin, por nuk dinë!*

Dhe fundi i fundit - është tragjike! Sepse, përballë tyre janë të tjerët që dinë, por nuk duan. Me këtë rrumbullakohet pasqyra e gjendjes sonë të pakëndshme. Rrethi i mallkuar nga i cili nuk po mund të dalim kurrë.

\*  
\* \*

E di mik, e di se ç'do të thuash. Të njoh mirë... - më duket sikur po të dëgjoj: "E ata, të cilët dëshirojnë dhe të cilët dinë - nuk munden!"

E përse nuk munden?

Kjo ndjenjë e pamundësisë a mos është ndjenjë e rrejshme, në të cilën fshihet ndonjë dobësi personale!

Të bëhem i të sinqertë! Ndoshta kjo është e metë e përgjegjësisë që të bëhem i të ndershëm e besnikë në bindjet tona.



## ÇËSHTJA E HILAFETIT SOT

---

Në Takvimin e vitit 1969, nga autori i panënshkruar është publikuar artikulli me titull “*A mund të shihet definitivisht fundi i fasilei-hilafetit?*”

Në këtë artikull në mënyrë interesante është theksuar mendimi se si duhet zgjidhur çështjen e pakëndshme, pothuaj çështjen e dhembshme që “gati plot dyzet e pesë vjet Bashkësia Gjithislame jeton pa krye, nuk e ka imamin e vet suprem, nuk ka në ballë përsaqësuesin e autorizuar të Pejgamberit për dhënien e menshurës për xhuma, për kadei-sher’ij, për sqarimin komplet, për ruajtjen e amanitetit etj.”

Autori përpinqet të hapë çështjen sikur të ketë pushuar t’i shqetësojë muslimanët e botës. Vlen t’i përmendim vërejtjet e këtij autori të panjohur. Edhe pse nuk janë origjinalë (se disa sosh i kemi dëgjuar deri tash), megjithatë janë shtruar në mënyrë provokative. Nga pena e shkrimit tarit shpërthen i gjithë mllefi dhe zemërimi për shkak të gjendjes poshtëruese të muslimanëve të botës, ndërsa me dëshirë të flaktë që të dilet nga kjo gjendje, ofrohet zgjidhje, zgjidhje e *realizueshme*, siç mendon personalisht shkrimitari.

Nëse për asnjë tjetër, këtë qëndrim të autorit vlen ta shqyrtojmë. Ky pikërisht edhe është qëllimi ynë. Të mos e përfillim dhe ta lëmë *pasdore*, do të ishte e paarsyeshme. Sa na është neve e njohur, në mundësitë e kufizuara të informimit ky qëndrim është origjinal. Që ta kuqtojmë këtë sa më mirë, po sjellim shqyrtimet e shkrimit tarit në një ekspoze të zgjeruar.

Në ballë të artikullit verifikohet argumenti historik se *fasilei-hilafeti* vazhdon prej 3 marsit të vitit 1924 dhe se Bashkësia ende

nuk është në gjendje të gjejë në gjirin e vet njeriun e talentuar me veti *hilafetike*, dhe - ndër të tjera - me këtë dëshmohet se (sipas disave) Bashkësia jeton në *kufr*...

Më tutje vazhdon në të njëjtin rrafsh:

“Pasojat e rënda të një gjendjeje të këtillë janë të papara. Vetëdija e masave islame i sheh drejt shkaqet e saj dhe ndërgjegjja kolektive e duron këtë *fasilei-hilafet* të gjatë si mëkat i rëndë shoqëror. Mirëpo, që të çlirohet nga ky mëkat, para pengesave të paevitueshme, Ummeti i sotëm është i pafuqishëm! Ai vetëm pyet: kush është ai që po e shkatërron unitetin shpirtëror musliman? A është ky xhahilijeti i masave të paudhëhequra, apo është mosmarrëveshje në rivalitetin egoist sedërmadh të qeveritarëve të sotëm islamë, ose këto janë forca të errëta të armiqve islamë? Apo ndoshta janë bashkuar të tria në një qëllim: që me shkatërrimin e unitetit shpirtëror të shkatërrojnë edhe paqen dhe lumturinë e muslimanëve, dhe kështu edhe më tutje t'i nënshtrojnë politikisht dhe t'i mbajnë të varur!”

Shkrimtari tregon se përpjekja e mbretit hixhaz, Huseinit që të shpallet halif dështoi, e po ashtu edhe Kongresi gjithislam i mbajtur në Kajro më 13 maj 1962 nuk mundi ta zgjidh çështjen e halifatit. Autori thotë:

“Pas Luftës së Parë Botëroreasnë qeveritar islam nuk ka qenë i pajisur me atrabile që do ta personifikon halifin.”

Pastaj vazhdon:

“Pasojat e rënda të *fasilei hilafetit* veçanërisht u reflektuan në krizën e sotme të Lindjes së Afërt. Humbja poshtëruese e tërë Islamit para agresionit izraelit, e ngarkoi rëndë ndërgjegjen e të gjithë muslimanëve...”

Shkrimtari paraqet përçarjet edhe më të mëdha ndërmjet muslimanëve pas këtyre disfatave, kurse që ta fitojnë halifin, muslimanët gjenden ende larg mundësisë reale, ndaj propozon që ky problem të vendoset në baza krejtësisht tjera, në bazë apolitike, siç e ka emërtuar. Që ta mbështesë dhe ta sqarojë këtë mendim, autorri ofron pasqyrën e zhvillimit të institucionit të halifatit që nga fillimet e tij e këndej.

Në kaptinën *Gjeneza dhe karakteri imamik i institucionit të halifatit* thuhet:

“Halifati në botë dhe në histori është unikat i pashembullt i mënyrës së qeverisjes. Sa ka karakter të përgjithshëm si jurisdiksion shpirtëror në të gjithë trashëgimtarët e Islamit, njëkohësisht aq është edhe sistem specifik i rregullimit shtetëror tipik për periudhën e Hulefair - Rashidinëve... Institucioni i halifatit, ndërkaq, gjatë historisë nuk qëndroi pranë prototipit të vet. Përhapja e Islamit, ardhja në Bashkësi e popujve dhe kulturave joarabe, ia ndërruan karakterin, ashtu siç ndodhi edhe me vetë Islamin, i cili në tri periudha zhvillimore prezentoj tri afirmime historike:

Islami - besim

Islami - shtet dhe

Islami - kulturë.

Forma e kryehershme e bashkësisë shoqërore islame është ‘ummeti’, që do të thotë, organizim primitiv i trashëgimtarëve në vëllazëri shpirtërore. Kjo formë e kryehershme, pa klerikë, pa hierarki, pa pushtet qendror, është ruajtur gjatë kohës së Muhammedit a.s. Në atë periudhë xhamia ka qenë forum, oborri i xhamisë ka qenë ushtrimore ushtarake, ndërsa imami njëkohësisht ishte edhe kryekomandant ushtarak. Në krye të vëllazërisë ka qenë vetë Pejgamberi, duke e udhëhequr Bashkësinë në marrëveshje me as’habët. Kur u shtua numri i muslimanëve, marrëveshja ishte e mundur vetëm nëpërmjet përfaqësuesve më autoritatitivë të Bashkësisë.

Këta përfaqësues ishin trup këshilldhënës “Shûrâ!...” Autori pastaj me emër i përmend anëtarët e “Shûrâsë”, 11 sish, emrat e dy ‘sekretarëve’ të Pejgamberit, siç i emérton, që administronin me punët e “Shûrâsë.” Thekson se për financimin (mjete për jetë) e Bashkësisë së parë, mjetet vinin nga zekati (të mbledhur nga muslimanët) dhe xhizja (ë mbledhur nga jomuslimanët).

Në një fragment të shkurtër pasqyron se si në krye të Bashkësisë erdhi Ebu Bekri dhe ai i pari mbajti titullin e “Halifetur-Resulull-llah”, dhe vazhdon:

“Karakteri i Ebu Bekrit përputhej me karakterin e Halifit, i atillë çfarë buron nga konцепциони i Islamit. Mirëpo, në karakterin e trashëgimtarit të tij Umerit r.a., krahas zgjerimit të dukshëm territorial dhe rritjes së numrit të anëtarëve të Bashkësisë, problemeve që pasu-

an nga aspekti i jetës së tij dhe ekzistimit si dhe formimit të shtetit, tipi i halifit mori karakterin emirul-mu'mininit. Në karakterin e Umerit u formua personaliteti i personifikimit të veçantë të pushtetit shpirtëror dhe profan, kushtëzimi dhe përkrahja reciproke. Ndërkaq, në tipin e halifit të tretë, Osmanit r.a. mbizotëroi tanimë krahu botëror i pushtetit dhe institucioni i hilafetit në mënyrë rapide filloi të largohet nga shembujt e shariatit dhe gjithnjë e më tepër të identifikohet me shembullin e mbretit laik. Hyrja e nepotizmit dhe prirja kah luksi, shmangjet gjithnjë e më të mëdha nga rregullat dhe dispozitat përkatëse, si dhe largimi nga koncepti themelor i Islamit, shkaktuan në shoqërinë islame, madje edhe në unitetin shpirtëror, farën e parë të ndarjes dhe të përçarjes politike..."

Kjo përçarje shpërtheu me vrullin më të madh në kohën e halifit të katërt, Aliut r.a. Në fund, Muaviu arriti ta grabisë pushtetin dhe të shpallet emirul-mu'minin, ndërsa pasardhësve të vet t'u sigurojë të drejtën e trashëgimisë hilafetike.

Në kaptionën *Emirul - mu'minin - natyra profane e hilafetit*, ndër të tjera thuhet:

"Gjatë Hulefair-Rashidinëve, do të thotë gjatë sundimit të katër halifëve të parë të zgjedhur ligjshmërisht, bashkësia islame përputhej me nocionin e besimit. Nga koha e Muavijes, Islami nuk përputhej me konceptin e shtetit. Pas lëvizjes fetare pasuan problemet ekonomike dhe politike. Me zgjerimin jashtë Arabisë, Islami nën mbrojtjen dhe patronazhin e vet pranoi shumë fise joarabe, popuj dhe raca... Në këtë integrim me veçori të ndryshme, krahas gjithë bashkimit shpirtëror (fatar), nuk mundi të realizohet Panislamizmi '*pax islamica*' ideal, por në kundërshtim me koncepcionin e mirëfilltë islam, u themelua imperializmi. Këtë imperializëm të vrullshëm, ndërkaq, nuk duhet identifikuar me kuptimin e përhapjes së shpejtë të Islamit. Islami u përhap me një shpejtësi të çuditshme, por me fuqinë lëvizëse të Kur'anit e jo me forcën e shpatës. Mirëpo tek pasi zgjerimi u bë dhe u vendos, fuqia lëvizëse e nomaditetit arab, pas dëshirës për bukë dhe hurme, për toka më pjetiore dhe më të pasura, ndërttoi imperializmin. Për atë se

a ka pushuar pas kësaj të ekzistojë halifati si institucion fetar, nuk janë dhënë shpjegime juridike për arsyet e oportunitetit politik. Te sunnitët halifi i fundit është hazreti Aliu, te shiitët imami i dymbëdhjetë, ndërsa te harixhitët halifati i parë u mbyll me vetë hazreti Umerin. Interesat shtetërore ia vazhdonin misionin dhe qëndrimin në këto prerogativa formale:

1. Imamati (eprori suprem fetar)
2. Kadiu (gjykatësi suprem)
3. Ifta (shpjeguesi suprem)
4. Xhihadi (komandanti suprem)
5. Hisba (drejtori suprem).

Në një hapësirë të madhe heterogjene... imamatin halifët më parë e bartnin në zëvendësit, ndërsa kur detyra e halifit u lokalizua plotësisht, imamati u bart në ulimanë, e cila me këtë filloj të shndërrohet në kuptimin e klerit. (Sufitët më vonë patën ndikim vendimtar politik). Megjithatë, prerogativat e pushtetit shtetëror (profan) halifët në mënyrë autokrate i mbanin për vete, edhe pse nuk hiqnin dorë as nga titulli i halifit.

Në karakterin e vet qeveritar Muaviu ishte i pari që i dha përparësi karakterit *të emirul-mu'mininit*. Fasada fetare e thirrjes së halifit filloj gjithnjë e më tepër të zbehet dhe të zhduket. Emirul-muminini gjatë kohës së trashëgimtarëve të Muavisë, më vonë të abasidëve, e tek së fundi edhe të osmanlinjve, krejtësisht e nënshtroi halifatin. Ajo që i kishte hije sundimtarit, nuk i kishte hije halifit, mirëpo nga inferioriteti ndaj fuqisë pushtetmbajtëse, halifi gjatë historisë barti përgjegjësinë për të gjitha devijimet e sundimtarëve profanë. Me Kur'an dhe Sheriat halifi nuk ka mundur ta kundërshtojë këtë, sepse në personalitetin e halifit ishte inkorporuar edhe eprori fetar edhe pushtetmbajtësi (Halifetur-Resul dhe Emirul-mu'minin).

Me kthimin e plotë të jetës në rrjedha të përbotshme, profane, luksi i oborrit të halifit krejtësisht e rrëzoi rëndësinë e halifit, ndërsa ngriti rëndësinë e monarkut. Ashtu sikur fuqia e shtetit islam të çmohej sipas pasurisë dhe luksit. Ndërsa, e gjithë fuqia e shtetit islam, përkundrazi, mbështetet kryesisht në fuqinë shpirtërore të

Islamit. Me atë që abasidët rrëzuan rëndësinë e halifit kurse ngriten rëndësinë e emirul-mu'mininit, vërvetes ia prenë qarkullimin e gjakut i cili ua ushqente fuqinë. Më në fund në një mirëqenie e bollëk të tepruar të shtresave të larta shoqërore, e tërë bota islame ra në një gaflet të tillë saqë nuk mundi t'u kundërvihet as kryqëzatave, e as invadimit të mongolëve. Vetëm një anëtar i dinastisë, pas shkatërrimit të Bagdadit dhe zhdukjes totale të kulturës islame, arriti të ikë me amanetet e halifit në Egjipt, dhe pasi nuk pati kurrfarë fuqie tjetër, që së paku në arrati të bartë prerogativat e rojtarit të amanetit.”

Në kartinë *Ndërprerja e traditës Kurejshe*, udhëzohet në të dhëna historike:

“Duke zgjeruar pushtetin mbi Hixhazin dhe duke pushtuar Egjiptin, sulltan Selimi I turk, i vetmi prej të gjithë sundimtarëve islamë të asaj kohe, dispononte me veti të nevojshme për halif. Duke marrë halifatin, Selimi i barti edhe amanetet në Stamboll. Me këtë akt u ndërpri tradita e Kurejshëve dhe halifati u zhvendos në trashëgiminë juridike të dinastisë së Ali-Osmanit.”

Pastaj theksohen arsyetimet e Sheriatit dhe arsyetimet e Selimit I për marrjen e halifatit dhe thuhet se si një herë në vit (ditën e 15-të të Ramazanit) bëhej prezentimi solemn i amanetit në praninë e halifit dhe të të ftuarve. Shkrimtari vazhdon:

“Deri në disfatën nën Vjenën, sulltanët turq e bartën me dinjitet thirrjen e halifatit, duke ia besuar kryerjen e punëve fetare Shejh-ul-Islamit. Pas disfatës nga Vjena dhe shtuarjes së “çështjes së Lindjes” edhe vetë fuqia e Perandorisë turke filloi të bie, ndaj edhe sulltanët humbën kushtet e hilafetit të sheriatit dhe kuvvetit, derisa definitivisht, me përcaktimin e gabuar në Luftën e Parë Botërore, nuk humbën edhe të drejtën formale që ta përfaqësojnë tërë Islamin... Mehmed Reshadi shpalli ‘xhihadin’, të cilin popujt islamë nuk iu përgjigjën, me çka e dezavuan atë prerogativ të sulltanit si halif?”

Në kartinë *A thua halifati në kohën e sotme mund të ketë arsyen e ekzistimit të vet? - thuhet:*

“Halifi si emirul-mu'minin ka humbur çdo kuptim të ekzistimit. Restaurimit të halifatit, i tillë çfarë ka qenë, i

kundërvihen si faktorët politikë ashtu edhe faktorët e shariatit. Atyre sot nuk mund t'u shmangemi.

S'do mend se: në heqjen e halifatit kanë qenë të përziera edhe interesat e Fuqive të Mëdha kolonizatore të Evropës, sepse me heqjen e tij u shkatërrua uniteti islam dhe u bë i mundshëm vazhdimi i kolonizimit të popujve dhe shteteve islame për një kohë të gjatë.”

Shkrimtari pandeh se lozha masone ka pasur rol aktiv në shkatërrimin e halifatit, të “teokracisë islame.” Mandej tregon për disa përpjekje të zvetënuara se halifati mund të qëndrojë edhe pa fuqi shpirtërore. Këto përpjekje si të këtilla ishin të zbehta dhe përfunduan para se të fillojnë, dhe vazhdon:

“Ndonëse sot nuk ekziston ajo pengesa më e fortë për restaurim: interesat e Fuqive të Mëdha evropiane, sepse evolucioni dhe progresi e ndërprenë kolonizimin dhe pothuaj të gjithë popujt islamë janë të lirë dhe të pavarur, mund të thuhet se sot si pengesa të vetme parqiten: disharmonia, mospajtimi dhe rivaliteti i qeveritarëve islamë. Është e padrejtë që faji të hedhet në përçarjen ideologjike-politike, ndërmjet medhhebeve dhe sekteve, sepse këtë përçarje, e cila sot ka humbur çdo shkas të vetin, e ringjallin vetëm interesat e dinastive intransigjente. Në të vërtetë, qysh nga Muaviu shiitët nuk e njobën halifin dhe deri në kohën e Kemalit ia penguan veprimtarinë mirëbërëse. Madje edhe kur me imamin e dymbëdhjetë u shua gjenealogjia e drejtpërdrejtë e hazreti Aliut dhe Fatimesë, shiitët gjithnjë deri në heqjen e halifatit zgjedhnin, në kuptimin autoqefal, imamët e vet. Mirëpo duke pasur parasysh rrethanat e sotme, kjo do të thotë se halifati sot nuk ekziston fare, ndaj në të gjitha shtetet islame ligjshmëria e laicizuar dhe pengesa medhhebike në restaurimin e halifatit dhe gjetja e platformave të kuptueshme për zgjedhje, tanimë nuk kanë kurrfarë funksioni.”

Në fillim të shekullit XX, kur ishte e pranishme dhe gjithnjë hetohej dobësia e halifatit nga pafuqia e sulltanëve turq, u ndërmorën aksione për eliminimin e të gjitha përçarjeve ideologjike në Islam. Qysh më 1906 muslimanët rusë ndërmorën aksionin me qëllim të inicimit të çështjes së bashkimit të medhhebeve, e shkrimtari shpjegon:

“...mirëpo, kësaj iniciative nuk iu përgjigjën popujt tjerë islamë. Mbi humnerë nuk qe e mundur të vihet ura e marrëveshjes dhe unifikimi i interesave. Tekefundit, shtetit të shekullarizuar islam nuk i interesonte uniteti shpirtëror... Në shkëmb të njëjtë u thyen edhe valët e aksionit të rektorit të Universitetit të El-Ez'herit dhe e gjithë kjo dëshmon: se hilafeti në atë kuptim çfarë ishte deri në heqje, nuk mund të restaurohet më.”

Dhe shton:

“Esh-Shahrestani, historian i njohur i religjioneve (vdiq më 1153), ka thënë: Asnjë çështje në Islam nuk ka shkaktuar më tepër gjakderdhje sesa halifati! Kjo fymë ndër përfaqësuesit politikë të Islamit ekziston edhe sot...

Përveç këtij mospajtimi, halifati i deritashëm nuk mund të restaurohet, sepse është komprometuar.”

Mirëpo, shkrimitari thekson se si muftitë e mëdhenj dhe reis-ul-ulematë nuk mund të kompensojnë rolin e halifatit, ndaj gati me ton vajtues vazhdon:

“Për këtë arsy, nëse sot nuk mund të ekzistojë emirul-muminini, ekzistimi i halifatit të çpolitizuar dhe të çshekullarizuar është arsyetuar me domosdoshmëri bashkëkohore. Gjysmë miliard e më tepër njerëz, pasardhës të një religjioni, të paorganizuar shpirtërisht, nuk mund t'i kontribuojnë kulturës së përgjithshme njerëzore, mirëqenies dhe paqes në atë mënyrë siç kontribuojnë bashkësitë e tjera fetare të organizuara dhe të rregulluara, në radhë të parë ato monoteiste. Nga vetë fakti i drejtësisë, edhe muslimanët e botës duhet të kenë eprorin e tyre suprem shpirtëror, siç e kanë katolikët papën, të krishterët ortodoksë patrikun, hebrenjtë rabinin suprem etj. Riorganizimi i Islamit është në interes të të gjithë njerëzimit, ndaj këtij sot nuk do të duhej t'i kundërvihen fuqitë shekullare të botës, as nga aspekti i solidaritetit njerëzor, as nga interesi i ruajtjes së moralit shoqëror.

Sot, nëse fuqitë kolonizatore të Evropës, sipas imprerativit të kohës, i kanë humbur kolonitë e veta në vendet islame, do të duhej të angazhohen që të rregullohen rrethanat në Islam, sepse me vënien e bashkëpunimit kul-

turor dhe ekonomik me popujt islamë, të lidhur me një kulturë unike, do ta regresonin atë dëm ekonomik.

Ballë për ballë fuqive të brendshme, të cilat e shkatterojnë unitetin shpirtëror, muslimanët me prapambe-turinë e vet do të paralajmërohen në obligimin fetar për të jetuar në solidaritet dhe harmoni vëllazërore. Për këtë nuk nevojitet të kërkojnë dogmë të prerë kategorike, është e mjaftueshme analogja e farzit të xhumasë dhe e imamit, dhe të vetëdijësohen se edhe vendosja e udhë-heqjes shpirtërore supreme për muslimanët është farz!"

Në kaptinën: *A ekziston atëherë mundësia e restaurimit të halifatit dhe çfarë janë ato mundësi?* - shkrimtari menjëherë fillon me fjalët:

"Mundësia për restaurimin e halifatit ekziston, vetëm nëse institucioni i halifatit çshekullarizohet, çpoliti-zohet dhe vihet në kufijtë e vet më parësore, thjeshtë në trashëgiminë imamnore të Muhammedit alejhisselam. Sot nuk ekziston më asnjë shtet teokratik, ndaj një shtet i këtillë nuk ekziston as në botën islame. Prandaj, asnjë sundimtar bashkëkohor islam, si laik i vërtetë, nuk do të mund e as nuk do të pranonte të mbajë titullin e halifit... përveç nëse nëpërmjet kësaj thirrjeje do të shikonte me egoizëm në interesat e vendit të vet, por në dëm të bashkësisë mbarislame! Sepse halifi i ardhshëm nuk duhet të jetë përfaqësues i asnjë populli islam, por përfaqësues dhe udhëheqës i gjithë besimtarëve islamë në botë.

Për plotësimin e fronit të zbrzetë të halifit, muslimanët, sipas ixhmai-ummetit, i lidhë obligimi fetar (zejdije dhe mutezilje). Për këtë obligim muslimanët janë të lidhur edhe me arsyen e shëndoshë (Xhahizi, Basriu, Kabiu)."

Mendimet e atyre, të cilët i ka dëshpëruar reduktimi i nocionit të halifit, ndaj flasin në favor të respektimit të riteve fetare individuale si të mjaftueshme, shkrimtari i refuzon dhe i quan anarkike e të pazbatueshme. Dhe shkrimtari - në një moment të hutimit personal, bërtet:

"Në krye të Bashkësisë gjithislame duhet të qëndrojë halifi dhe ai do të zgjedhet pavarësisht nga pëlqimi i kujdo qoftë. Atë do ta zgjedhë dhe do ta caktojë koha!"

Shkrimtari vazhdon të argumentojë dhe të propozojë:

“Të gjitha dallimet në qëndrime i bashkoi anulimi i halifatit... Në fizionominë e re të halifit do të mund të kënaqet tradita legjitime e Kurejshitëve dhe parimi hanefit i zgjedhjes. Në karakterin e apolitizuar të halifit mund të pajtohen pikëpamjet e shiitëve dhe të sunitëve... Hilafeti duhet të jetë qendër shpirtërore dhe ndërlidhës i unititetit shpirtëror të besimtarëve... e jo sikurse deri më sot, pronë private e sundimtarit më të fortë! Paramendohet si Kombet e Bashkuara Islame... jashtë çdo politike në qëllimet fetare. Në këtë asamble gjithislame çdo popull do ta dërgonte përfaqësuesin e vet të zgjedhur. Si të tillë ata në radhë të parë do të duhej të gëzonin autoritet dhe të kenë merita e respekt të gjithanshëm, e nëpërmjet këtij respekti të gëzojnë autoritet edhe në tërë botën islame. Ata duhet të kenë pas veti veprimtarinë e vet jetësore, që pranohet si kontribut i përgjithshëm reprezentativ, e veçanërisht në kulturën islame.

Asambleja gjithislame nuk duhet të qëndrojë nën protektoratin e askujt, e aq më pak nën tutelën e cilitdo shtet islam... Asambleja gjithislame duhet të jetojë vetëm përvete, kështu që ta ruajë lirinë e plotë të veprimit, në mënyrë të barabartë në tërë hapësirën e botës islame, si edhe në vendet, ku muslimanët jetojnë të nënshtruar nga pushteti joislam. Atë nuk duhet ta ndihmojë me ndihma asnje shtet islam. Ashtu siç ka jetuar nga zekati bashkësia e parë islame, ashtu do të mund të jetonte edhe Bashkësia e sotme gjithislame.”

Shkrimtari propozon që për kryetar të Asamblesë Islame të zgjedhet dikush nga pasardhësit e fisit Kurejsh në mënyrë që të kënaqej parimi ligjor, dhe ky do të ishte i vendosur gjithmonë në Mekke. Prerogativat e tij, përveç udhëheqjes së Asamblesë, do të ishin edhe ruajtja e Haremejnët dhe amanetit.

*Halifi* do të ishte sekretar i përgjithshëm i Asamblesë Islame, do të zgjedhej në një periudhë të caktuar kohore dhe prerogativat e tij do të kishin të bëjnë edhe me: *imamatin*, *kada*, *ifta* dhe *hisba*, dhe shton:

“Prerogativat e veta *halifi* do t’i kryente me anë të të autorizuarve të vet në tërë hapësirën e botës islame,

ndërsa interesat e përfaqësisë supreme si dhe të Islamit, do t'i përfaqësonë si në vendet islame, po ashtu edhe në ato joislame, nëpërmjet emisarëve të vet të akredituar në bazë të marrëveshjeve të ndërsjella. Bashkësia gjithislame e organizuar në këtë mënyrë, kaherë do të kishte modelin e vet në praktikë, tanimë një organizim të sprovuar në tarikate sufiste dhe në vëllazëri, sepse do të kishin kutubin (halifin) e vet, gavset (asamblenë) e vet dhe delegacionet e veta.”

Në fund të shqyrtimit të vet shkrimtari sjell shkaqet se ide të këtilla shfaqen në bashkësi të vogla islame, ndaj fton pleqësinë tonë kombëtare fetare që të angazhohet për heqjen e *fasile-i hilafetit* në kuptimin e ideve të zëna ngojë.

## Vërejtjet tona

Ç'të themi për mendimet e zëna ngojë? - Shkrimtari qartë është krejtësisht i singertë në propozimin e vet dhe në pasionin e vet prekës për të zgjon simpati. Mirëpo, sipas mendimit tonë, një propozim i këtillë për “hilafetin apolitik” është i parealizueshëm, dhe këtë arsyе do ta sqarojmë. Mirëpo, të theksojmë menjëherë se diskutimi për të është më se i dobishëm: ai na obligon të hulumtojmë shtegun që na shpie në zgjidhje, kështu që mundi i shkrimtarit, sipas kësaj, nuk është i kotë.

Së pari, kalimthi t'i qasemi një çështjeje të tërthortë: Shpjegimi i autorit se prej nga një propozim i këtillë nga një bashkësi e vogël, është dhënë në mënyrë të ngrohtë, të singertë dhe bindshëm. Ndërkaq, kur apelon në “pleqësinë tonë kombëtare fetare”, që këtë apo ndonjë propozim tjetër të plotësuar lidhur me krizën islame, ta autorizojë dhe ta përkrahë para ndonjë forumi gjithislam, ose në shtypin islam, tingëllon më tepër si kurtuazi sesa si realitet për çdokënd i cili sadopak është i njohur me gjendjen momentale (ndërsa kjo “gjendje momentale” po zgjat tepër) në pleqësinë tonë fetare. Ajo ka shumë pak pavarësi, dhe këtë po e shohim të gjithë, me këtë realitet po ndeshemi në çdo hap. Këtu mund të mbahen njerëzit, të cilët me vetëdije ose pa vetëdije, me vullnet ose pa vullnet, u nënshtronhen kërkesave të bashkësisë, por edhe përfaqësítë e tyre nuk janë në pozitë më të mirë.

Sa u përket shteteve të pavarura muslimane, edhe vetë shkrimitari nuk ka për to ndonjë mendim veçanërisht të mirë. Përvoja historike dhe ajo e përditshme shkakton pezm kundër udhëheqjeve të tyre politike. As ato nuk u lejojnë asgjë institucioneve të veta fetare nëse nuk shohin në to interesin e vet të drejtpërdrejtë politik.

Mirëpo, të supozojmë se një ide e këtillë, megjithatë depërtion p.sh. (ja, të jemi në pajtim me shkrimitarin - përpjekjet e bashkësive të vogla islame, të cilat jetojnë të shpërndara në Perëndim. Kë do ta degradonin bashkësitë e shumta islame, të vogla ose të mëdha anëmbanë botës? Të pakta janë ato bashkësi të mirëfillta dhe të pavarura. Të gjitha këto pak a shumë janë të varura nga vullneti politik i regjimit të shteteve të tyre përkatëse. Do t'i dërgonin - që të shprehemi me mirësjellje - vetëm ato, prej të cilave ato regjime nuk do të kishin çrregullime ose thënë haptas - ato regjime do t'i delegonin agjentët e vet! (Apo jo?! - kështu veprojnë të gjithë pa kurrsfarë ngurrimi në çdo vend dhe në çdo kohë!) Sa u përket ish-fuqive kolonialiste, pastaj Bashkimit Sovjetik, madje edhe Amerikës, përse ato të kenë qëndrim miradie ndaj një ideje të këtillë për hilafetin?

Të gjithë në këtë botë udhëhiqen nga interesat politike, që përfshijnë sferën ekonomike si dhe atë kulturore e ideologjike. Kur të kihet kjo parasysh, prej tyre nuk mund të pritet as gjakftohtësia, shprehur politikisht - as neutraliteti.

Ne jemi dëshmitarë të përditshëm dhe të drejtpërdrejtë se sa të paskrupullt mund të jenë në sjelljet dhe në veprimet e veta, të cilat jorrallë thjesht janë fryt i kulturës ose ideologjisë ekskluzive, pavarësisht nga interesat ekonomike ose obligimet politike. Dhe këto veprime janë të mbushura me aq shumë cinizëm, saqë as nuk përpilen ta fshehin antipatinë ndaj muslimanëve dhe besimit të tyre. Kjo është puna që e bëjnë publikisht! E çka bëjnë fshehurazi?! Mirëpo, pa marrë parasysh gjithë këtë, çka do të mund të bënин ata, nëse muslimanët e botës do të dëshironin seriozisht të angazhohen rrëth punës së vendosjes së halifatit? Fatkeqësia më e madhe është në vetë ne dhe vetëm me anë të mospajtimeve, grindjeve dhe konflikteve tonë, të tjerëve u ofrohet mundësia që edhe më tepër të nxisin mospajtimin ndërmjet nesh. Tekefundit, edhe vetë shkrimitari nxjerr të njëtin përfundim dhe në në një vend tekstualisht thotë:

“... mund të thuhet se sot përfaqësojnë të vetmen pengesë: dis-harmonia, mospajtimi dhe rivaliteti ndërmjet qeveritarëve islamë.” Mirëpo, përse edhe ta përkrahin hilafetin? Cilët janë ata muslimanë-besimtarë kaq të mëdhej që diç të këtillë ta vënë si qëllim parësor?

Nëse ndërmjet tyre gjenden vërtet besnikë të Islamit dhe që në aspektin ideor pajtohen në raport me interesat e përgjithshme muslimane, çdo të ndodhte atëherë? Cila do të ishte arsyja që të pranohej qëndrimi i atij tjetrit? Askush nuk do të lëshojë pe! Secili punon sipas mendjes së vet. E kësaj shtoni edhe interesat e shumta, dhe ja, do të ballafaqoheni me botën e sotme muslimane! (Prandaj edhe të mos u japim dorë atyre, të cilët janë shumë larg nga ajo që Islami për ta të përfaqësojë përcaktim të mirëfilltë).

Për të gjithë ata, njëfarë hilafeti (qoftë edhe i këtillë çfarë na e ofron shkrimtari), në njëfarë dore do të përaqiste ngarkesë me vlerë të dyshimtë, që kalon në rrezik të panevojshëm. Deri ku ai do të ishte ‘apolistik’ në veprimtarinë e vet? Më në fund, ku qëndron kufiri ndërmjet politikës dhe ‘jopolitikës’? Ndonjë kriter dhe masë të pavarur nuk ka: nuk ekziston qëndrim i pranueshëm për të gjithë, i pranuar nga të gjithë si qëndrim objektiv, e lëre më gjykatës i pranuar nga të gjithë si i paanshëm dhe me autoritet.

Shkrimtari përpinqet, dhe vërtet në këtë drejtim arrin të jetë i quartë dhe i thellë në shpjegimin e problemeve dhe ofrimin e zgjidhjeve. Por megjithatë, në atë vend ku propozon që “prerogativat e veta halifi do t’i kryente nëpërmjet të autorizuarve të vet... ndërsa interesat e përfaqësisë në bazë të marrëveshjeve të ndërsjella,...” mbetet e paqartë si mendon ta harmonizojë me propozimin se “hilafeti bashkëkohor, mendohet... si Kombe të Bashkuara Islame”, dhe “Në atë asamble gjithislame çdo popull islam do të dërgonte të zgjedhurin e vet!” Në kompetenca juridike të kujt do të ishte ulëmaja e një shteti? Kush do të ishte kompetent në emërimin e imamëve, hatibëve, hoxhallarëve - mësues të mësim-besimit (të të gjitha shkallëve të mundshme), gjegjësisht në shkarkimin nga këto detyra? Prej kujt do të vareshin financiarisht? Tekstualisht financiarisht! Kjo çështje është lehtë të zgjidhet në teori (p.sh. nga vakëfet, nga zekati, nga hajrati etj), por pyesim: nga dora e kujt? Kush do të ishte punëdhënës i tyre? Institucionet fetare të shteteve përkatëse apo hilafeti mbinacional? E të gjithë e dimë se çdo të thotë varshmëria financiare! Cili shtet pa hidhërim të madh do të pranon te që kjo të zhvillohet jasht kompetencave të tij dhe pa kontrollin e tij?

Meqenëse shkrimtari nuk merret me shqyrtimin e hollësive të këtilla, por që të jemi në njëfarë pajtueshmërie me propozimet e tij, supozojmë: të autorizuarit, emisarët e halifit, do të ishin muftitë, ndërsa të gjithë të tjera, në kompetencën e bashkësisë islame të

shteteve përkatëse. Mirëpo, çdo të ndodhë tanë me hatibët? Ata drejtpëdrejt do të ballafaqoheshin me problemet e përditshme të shoqërisë. Meqë hutba, sipas shkrimtarit, bën pjesë në kompetencën e halifit, atëherë si do të sillet një hatib ndaj ndonjë dukurie joislame në shoqëri, ndërsa ligjet e atij shteti këtë krejtësisht në mënyrë të qetë e indiferente e tolerojnë? Për shembull, në një shtet musliman, ku muslimanët përbëjnë pjesën absolute, shiten pijet në mënyrë të pakontrolluar, sepse këtë e lejojnë ligjet e atij shteti. Si të sillen ndaj fyterjeve të përditshme të besimit dhe shenjtërise më të mëdha të tij në vendin ku All-llahu ofendohet me sharjet më të rënda, dhe askush as nuk përpinqet t'i mbrojë bindjet dhe ndjenjat e besimtarëve sepse në pushtet gjenden armiqëtë e përbetuar të fesë. Si të sillen e të mos u ekspozohen akuzave se po përzihen në mënyrë të palejueshme në politikën dhe në ligjet e vendit?

Ndoshta shkrimtari ka parasysh përvojën dhe sjelljen e Kishës katolike, e cila gjithsesi ofron shembull të organizatës më të suksesshme fetare, duke pasur parasysh organizimin e saj, besnikërinë dhe numrin e madh të klerit të saj, dhe mbartjen e saj me shtetet.

Ajo që sot e përfaqëson Kisha katolike, është fryt i përvojës dhe i traditës së pandërprerë pothuajse dymijëvjeçare dhe përleshjes së saj me problemet e kësaj bote me të cilat ndeshej vazhdimi. As sot Kisha nuk është krejtësisht apolitike. Ajo ka politikën e vet. Ajo përpinqet të zhvillojë një politikë ‘të mençur’ në kuptimin e mundit që të mos ndërthuret në rrymat politike, të cilat nesër mund të tregohen të gabueshme, ndërsa Kisha do të pësonte dëm të madh.

Kurse shkrimtari na propozon diç që duhet ndërtuar nga fillimi, nga themeli. Dhe me kë duhet ndërtuar këtë? Për ulemanë halifi nuk e ka përfaqësuar kurrë atë që e ka përfaqësuar papa për priftërinjtë e vet. Ai tek ata gjëzon njëfarë shkalle të shenjtërisë.

Pastaj, celibati (beqaria) e tyre dhe kurorëzimi me Kishën! E kjo s'është rruga e Islamit. Atëherë si të vendoset autoriteti i atij hilafeti të ri dhe i halifit te ulemaja e sotme? Dhe te bota tjetër? Me se do të arrihej kjo? Pranim me vullnet. Dhe atë sheshazi e përlëndinë!

Shkrimtari na propozon që në këtë detyrë të tubohen të gjithë ata që kanë autoritet dhe respekt te muslimanët. E gjithë kjo është thënë bukur, por: a janë të gjithë ‘të pushtuar’ nga një ide e këtillë siç është shkrimtari ynë? Shkrimtari harron faktin se të gjithë ata që dëshirojnë të krijojnë diç të re, duhet t'i jenë kushtuar plotësisht këtij mendimi të entuziazmuar dhe të bindur. Dhe ja se si Kur'an i

paraqet “të vetët”: “*Besimtarë të vërtetë janë ata që besojnë në Zotin dhe në Pejgamberin e Tij e nuk dyshojnë, por luftojnë me pasurinë dhe me jetën e tyre në rrugën e Zotit.*”

Shkrimtari mendon se është e mjaftueshme të theksojë apolitikën e halifatit të ri dhe me këtë shpreson edhe të drejtën e pranimit nga të tjerët. Mendojmë se shkrimtari është plotësisht i singertë në propozimin e vet, por gjithashtu ne jemi fort të bindur se ky halifat së shpejti do të gjendej në vorbullin politik: politika do ta shtynte që të merrej me të! Të kujtojmë Resulull-llahun dhe paraqitjen e tij! Gjithë kjo ishte larg nga politika! Megjithatë, një ditë e gjithë kjo u shndërrua në politikë. Këtë e bënë pikërisht kundërshtarët e tij. Resulull-llahut nuk i mbeti gjë tjetër, përveç: ose ta ulë kokën para kërkesave të tyre ose ta pranojë Islamin edhe si politikë edhe... edhe... edhe... Të gjithë neve nga historia na është e njojur se si me zhvillimin e ngjarjeve atij dhe as’habëve të tij u është imponuar kjo.

Që e tërë kjo mos të jetë vetëm një supozim i thjeshtë, të ndalemi te vetë shkrimtari.

Ai propozon:

“Hilafeti sot duhet të jetë vetëm qendër shpirtërore dhe të shërbejë vetëm si ndërlidhës i unitetit shpirtëror të besimtarëve; vetëm si moralizues dhe arsimues islam; vetëm rojtar i të arriturave të kulturës shpirtërore islame, i traditave islame dhe monumenteve islame...”

Sipas një shikimi normal të kuptimit të qëndrimeve të përgjithshme të kulturës së botës së sotme të civilizuar, e gjithë kjo është e kuptueshme dhe e pranueshme. Mirëpo, ç’të themi ne, ose më saktësisht, ç’do të thonë ‘të tjerët’ për këtë:

“...Vetëm mbrojtësi i lirive të të gjithë popujve islame, pa marrë parasysh se në çfarë statuti shoqëror jetojnë, mbrojtësi i lirisë së predikimit fetar, kryerjes së normave fetare dhe mbrojtësi i të drejtave për barazi në bashkësitet heterogjene etj.”

Mbrojtësi i lirive?! Mbrojtësi i lirisë së predikimit fetar?! Mbrojtësi i të drejtave për barazi!

Muslimanët në shumë shtete do të ishin tepër të kënaqur me një mbrojtës të këtillë. Por shikoni në ata ‘të tjerët’, shikoni se me çfarë dyfyrësie i rrudhin fytyrat, sikur vera që pijnë t’u është ngorpur me thartinë uthulle. Ata të gjitha këto liri i kanë garantuar me kushtetutë, shtypi dhe radioja e tyre janë përplot me vetëlavdata për këto liri por ato janë vetëm në letër dhe në eter. Të shpresohet se të

këtillët mund të klasifikohen në ‘botën qëllimire’ me të cilën mund të bashkëpunohet ndërgjegjshëm, është absurde. Mirëpo fatkeqësia e vërtetë qëndron në atë se të këtillë ka shumë, dhe se janë tepër të fuqishëm ndaj botës së përçarë islame - politikisht të përçarë.

Bota islame është përplot me konflikte politike, edhe në marrëdhëni e ndërmjetvetshme edhe me të tjerët. Këto konflikte shndërrrohen edhe në konflikte ushtarake, duke filluar që nga Magrebi në-përmjet Lindjes së Afërt, Kashmirit, Indisë e deri në Filipine. Pozita më e vështirë e muslimanëve është në vendet komuniste. Ç’duhet pritur nga tutela e tyre politike?

Duke vlerësuar nga këndvështrime të ndryshme, por edhe sipas pasojave të këqija dhe të shumta, çështja e Palestinës është ndër çështjet më të rënda për botën islame. Askush nga muslimanët nuk është indiferent ndaj saj, dhe të gjithë ata, që janë të sinqertë e përjetojnë si poshtërim personal, ndaj edhe vetë shkrimtari. Mirëpo, si do të sillej *hilafeti apolitik* i shkrimtarit, në këtë rast poshtërues? Ta ngre zërin kundër agresionit izraelit? Ta ftojë Perëndimin e fuqishëm që t’ia ndërprenë Izraelit dhënen e ndihmës ekonomike, politike dhe ushtarake? Ose të ftojë në humanitet, në arsyë dhe në dialog? Kë ta ftojë? Ose të katandiset në sprova dhe të shpallë ‘xihadin’, siç veproi sulltan Mehmet Reshati V, të cilit popujt islamë nuk iu përgjigjën, siç thekson vetë shkrimtari. Ç’do të thoshte bota për një hap të këtillë *politik* të *hilafetit apolitik*? Kur është fjala vendimtare, nuk është më i rëndësishëm mendimi i atyre të tjerëve (jomuslimanë), dhe vetë muslimanët nuk do ta qortonin për asgjë, por gjithashtu praktikisht askush prej tyre nuk do t’i përgjigjej ashtu siç nuk iu përgjigjën as Mehmet Reshatit V!

Shkrimtari nuk ka parasysh se me çfarë ka të bëjë, ku qëndron gabimi. Nuk është gabimi i Mehmet Reshatit V pse shpalli ‘xihadin’ (ky ishte hap normal), por gabimi është që as ata, e as paraardhësit e tyre nuk kishin supozuar se do të vinin në një situatë të tillë saqë të kujdeseshin seriozisht për të. Pikërisht ata kanë qenë të detyruar të bëjnë përgatitje për një gjë të tillë, e kjo përgatitje bëhet vite më parë: në arsimimin e kuadrove, besnikë dhe të verifikuar, të cilët do të ishin të gatshëm dhe të aftë për këtë detyrë. Pastaj kujdesi për burimet materiale dhe financiare? Dhe e gjithë kjo në përmasa të gjera të botës islame. Në këtë mënyrë e gjithë kjo do të binte mbi supe të hilafetit, të cilin na e propozon shkrimtari. Edhe diçka: E gjithë kjo punë do të kërkonte *organizim konspirativ!* Sa fjalë e tmerrshme për shumë veshë: *Organizata konspirative islame!* Çfarë

zemërimi dhe çfarë urrejtje do të zgjonte tek ata të tjerët. Këta ‘të tjerët’ i lejojnë vetes shumëçka, por t’ua lejojnë muslimanëve këtë, - kjo s’bëhet kurrsesi!

Presioni i gjithanshëm në shtetet muslimane do të ishte unanim. Edhe pa këtë presion, regjimet në shtetet muslimane këtë nuk do ta lejonin, sepse ato (kryesisht) janë regjime autokratike me shpirtnushtësi të horizontit politik në raport me kërkeshat ideore muslimane, pa marrë parasysh sa e konsiderojnë veten bartësit e pushtetit të tyre publikisht përfaqësues besnikë të Islamit. Ata këtë nuk e bëjnë vetë, kurse të tjerëve nuk ua *lejojnë!* Ata notojnë në përfitime të imta plaçkitëse të ndërmjetësimeve politike.

Nuk duam të jemi të padrejtë ndaj shkrimitarit: të përpinqemi ta kuptojmë seriozisht parimin e tij: deri këtu - po, por më tutje - jo! Sikur të kishim pasur vetëm halifat të këtillë, i cili do të luante një rol pajtues ndërmjet muslimanëve të përçarë, edhe ky do të ishte një përfitim i madh. Por medet! Ne nuk e kemi, e kur mendojmë se duhet vendosur nga themeli, na kaplon ndjenja se duhet të ndërtojmë diç me mund të madh, që edhe sikur të ishte nuk do të jepte fryte, dhe atë fryte që do të ishin tepër të vogla për nevojat *reale* të botës islame. Kërkeshat reale të kohës janë shumë më të mëdha dhe më të rënda për të gjithë ne muslimanët, se sa përgjigjet tona në to. Bashkësitë muslimane nga të gjitha anët përjetojnë dhunë: edhe moralisht - shpirtërisht, edhe materialisht, edhe politikisht. Secila prej tyre veç e veç është e vogël që të mund me sukses t’u kundërvihet agresorëve të fuqishëm. E nëse ka përgjigje pozitive nga shtetet dhe bashkësitë tjera muslimane, në formë ndihme të të rrezikuarve, në rastet më të mira janë këto deklarata të solidaritetit, apele dhe protesta në shtyp. Më në fund, të gjitha këto janë të pakta ndaj asaj që kërkon Kur’ani. Të përkujtojmë se ai kërkon: edhe ‘jetëra edhe pasuri’. Dhe i bindur i pyet besimtarët muslimanë, përsë nuk do të luftonin për të shtypurit dhe të pafuqishmit, të cilët nga All-llahu kërkojnë që t’u dërgojë ndihmës dhe shpëtimtar. Ndërsa këta të thirrur nga Kur’ani, të pafuqishëm i hapin duart dhe thonë: “Edhe vetë jemi të pafuqishëm!” Arsyetohen se nuk janë përgjegjës para All-llahut për atë që nuk kanë forcë. Por gënjejnë! Ata kanë rrugën e tyre dhe e njohin këtë rrugë, dinë të arrijnë fuqinë e ky është: *Bashkimi politik!* Po ata këtë nuk e duan!

Në vend të kësaj, ata zëshëm flasin për unitetin shpirtëror të muslimanëve, takohen nëpër kongrese dhe gjatë takimeve përqafohen, formojnë aleanca dhe liga, shkruajnë rezoluta të cilat askë për

asgjë nuk e obligojnë. E meqë problemet edhe më tej grumbullohen, ata të poshtëruar dhe të hidhëruar vazhdojnë me akuzat e ndërsjella për shkak të tradhtisë dhe kështu deri në pafund.

Shkrimtari thekson vendosmërisht gjykimin e vet: "Koha e sotme nuk lejon që halifi të jetë sundimtari më i fortë, por kërkon që ai të jetë shpirti më i fortë, mendja më e lartë, shembulli më i ndritshëm i moralit islam." Ta zbërthejmë këtë porosi dhe t'i shqyrtojmë mendimet e saj (ashtu siç e kemi kuptuar ne)."

Mendimi që ai të jetë shpirti më i fortë, mendja më e lartë, shembulli më i ndritshëm i moralit islam, është i kuptueshëm. Ky është kusht i nevojshëm edhe për halifin e sotëm nëse dëshirojmë që me dinjitet ta zëvendësojë Resulull-llahun, mirëpo siç duket, ky kusht nuk mjafton. Sikur të mjaftonte, ne kaherë do ta kishim halifin! Sa i përket pohimit: "Koha e sotme nuk lejon që halifi të jetë sundimtari më i fortë..." pyesim: përse dhe me se nuk lejon?

Në jetën e individit dhe të bashkësisë fuqia ka qenë vendimtare edhe deri më tash, e po ashtu edhe sot. Ndërkaq, të flasësh sot për sundimtarin më të fortë ndër muslimanë, vërtet nuk ka kurrfarë kuptimi. Ai nuk ekziston. Do të ishte me vend të flasim sikur të ekzistonte një shtet absolutisht më i fortë nga të gjitha vendet muslimane të marrura bashkërisht. Nëse një shtet i tillë do të deklarohej ideologjikisht si shtet islam, kush do të mund t'ia kontestonte që të parin e vet më përgjegjës ta emëronte edhe si halif? Kush do të mund ta pengonte që interesat e Bashkësisë Gjithislame t'i shndërrojë në vullnet politik edhe të shteteve tjera muslimane?

Që të vendoset halifati është i nevojshëm jo vetëm vullneti, por edhe pasuria, fuqia. E kjo mund të jetë fuqi apolitike, e me këtë as hilafeti i tillë nuk mund të jetë apolitik. Vetë shkrimtari na udhëzon në faktin: "Deri në disfatën e Vjenës, sulltanët turq me dinjitet e mbanin thirrjen e halifit. Më vonë vetë fuqia e Perandorisë turke filloj të bie, ndaj edhe sulltanët humbën kushtet e hilafetit të shefketit dhe kuvvetit."

Me këtë edhe padashtas shprehu një rregull për muslimanët.

Bazat ideore të jetës së bashkësisë gjithislame janë unikate në botë. Për të nuk vlejnë rregullat e disa bashkësive të tjera: t'i zba-

\* Fjalia është e paqartë dhe mund të shpjegohet në dy mënyra, mirëpo ne, sipas aspekteve të shkrimtarit, këtë problem e kemi kuptuar kështu: "Koha e sotme nuk lejon që për halif të emërohet sundimtari më i fortë, por kërkon që për halif të jetë emëruar shpirti më i fortë....." etj.

tosh në të, thjeshtë është e pamundshme. Muslimanët e botës kanë nevojë edhe për fuqi politike. E këtillë ka qenë edhe bashkësia e parë islame në kohën e Resulull-llahut kur ua la në trashëgim as'habëve.

Sot ajo mund të arrihet vetëm me bashkimin politik të vendeve muslimane.

Në këtë edhe qëndron thelbi i problemeve të muslimanëve të sotëm. Ata duhet të synojnë drejt kësaj dhe për këtë të angazhohen me gjithë zemër dhe gjithanshëm, ‘me jetëra dhe me pasuri’. E si do të quhej prijësi më i fuqishëm politik i një bashkësie të këtillë, ‘Halifetur-Resulil-lah’ ose ‘Emirul-mu’minin’ apo ‘sekretar i përgjithshëm i asamblesë islame’, kjo është çështje e dorës së dytë; me rëndësi është të jetë përfaqësues i denjë dhe prijës i muslimanëve; t’ua udhëheqë shtetin në shërbim të gjithë Islamit.

## Vërejtje plotësuese

Këtu do të sinjalizojmë për një qëndrim plotësisht të gabuar, të cilin të gjithë ne disi e kemi përvetësuar, madje edhe autori ynë. Vazhdimisht flasim për popujt muslimanë ose për popujt islamë, ndërsa nga aspekti islam - fjala është *për një popull të vetëm*. Prej nga ky qëndrim i gabuar kur është plotësisht në kundërshtim me qëndrimin kur'anor (p.sh. “*Vërtet besimtarët janë vëllezër*” etj.)? Pa menduar shumë shohim se kjo është pasojë e presionit të fakteve politike të kohës së sotme: bota islame është shpërndarë në shumë shtete sovrane dhe josovrane, pastaj në vende të shtypura. Kur kësaj i shtohet fakti se muslimanët e botës flasin në shumë gjuhë të nduarduarta, e që atëherë fitoni pamjen e një bote plotësisht të pa-sistemuar. Ndërsa humbni nga vrojtimi atë që e bën unike.

Për themelimin e çfarëdo bashkësie qoftë, me rëndësi është *qëllimi!* Mirëpo, për çudi - për themelimin e konceptit *popull*, dhe për këtë arsyë edhe për formësimin e tij në termin juridik *shtet*, konsiderohet se qenësore është gjuha. Ky mendim ka depërtuar thellë në vetëdijen njerëzore në dy shekujt e kaluar në lëvizjet ideore të Perëndimit. Edukimi dhe arsimimi bashkëkohor në Perëndim ishin nën dominimin e kësaj ideje. Ndërkaq, të konsiderohet kjo si e vëtmja ose rrëgulla vendimtare politike, thjesht është mashtrim. Ne e dimë se e tërë historia e përgënjeshtron këtë pikëpamje. Një ide të

këtillë nuk e solli në këtë mënyrë as zhvillimi bashkëkohor i shoqërisë se duhet të pranohet si rregull e shenjtë për shtetësi. E tashmja si edhe e kaluara është e atillë që fare nuk mund të flitet për ndonjë rregull. *Ju mund të formoni bashkësinë - shtetin në çfarëdo parimi që dëshironi.* Kështu ka qenë në të kaluarën, kështu është edhe sot. Nuk po shohim asgjë që do të tregojë se kështu nuk do të jetë edhe në të ardhmen.

Shikojeni Indinë e sotme! Në çfarë parime është themeluar ajo?! Sipas numrit të gjuhëve që fliten në truallin e saj, e tejkalon çfarëdo shteti të njohur ndonjëherë deri më sot, ndërsa përkatësia çfarëdo grupei gjuhësor, sipas kushtetutës së saj, nuk do të thotë as përkatësi politike e lënie pasdore për këdo qoftë. Kur kërkuan Sikët të ndahen nga tërësia e saj, këtë nuk e kërkuan në mbështetje të gjuhës së vet (sepse ka edhe popuj të tjerë që flasin të njëjtën gjuhë), por në mbështetje të religionit të vet!

Ç’do të thoni për Bashkimin Sovjetik? Parimi i kësaj bashkësie është ideja për pushtet të proletariatit.

Ç’do të thoni për Zvicrën, për idenë e saj dhe për themelin dhe ekzistimin e saj edhe sot e kësaj dite?!

Evropa Perëndimore bashkëkohore synon që të bashkohet dhe politikisht të krijohet si shtet mbinacional!

Të mos numërojmë më tutje. Mirëpo autori ynë, i shtrënguar ndërmjet kërkesave ideore të Islamit dhe ashpërsisë së kundërthënieve të realitetit politik të botës së sotme islame, është shqetësuar plotësisht. I dekurajuar nga dështimi i aq shumë përpjekjeve për themelin e hilafetit, i lëshohet inercionit të gjendjes ekzistuese dhe ofron zgjidhjen e vet si kompromis - “hilafetin apolitik.” Është e vërtetë se historia është përplot kompromise, por kompromiset janë të mundshme vetëm ndërmjet gjërave ekzistuese, ndërsa ai na ofron ndërmjet një gjëje ekzistuese (përçarjes politike të botës islame) dhe gjësë tjetër joekzistuese - mosekzistencës se çfarëdo hilafeti qoftë.

Nëse autori ofron hilafetin e vet ‘apolitik’ si diçka të re (por megjithatë të themeluar aq sa është e mundshme në dëshirat dhe në bindjet e muslimanëve, të cilat nuk u kundërvihen as kërkesave ideore islame, pa marrë parasysh që në tërësi nuk i kënaqin nevojat e botës islame), pyesim si ta inicojmë dhe me se? Ku është ai autoritet? - Po kjo botë nuk lëviz vendit as nga rrrafshi i urdhërave të Kur'anit! Përse?

Gjendja e botës së sotme islame është larg nga kërkesat ideore islame edhe pse këto kërkesa paraqesin edhe bindjet edhe ndjenjat dhe dëshirat e kësaj bote. Arsyja përse nuk manifestohet kjo, faji qëndron në faktin se ky nuk është vullneti *politik*, qëllimi dhe lufta. Derisa kjo mos të jetë e vështruar dhe e kuptuar qartë, Islami nuk do të përfaqësojë në botë atë që duhet të jetë sipas njoftimeve të veta, ndërsa muslimanët do të janë këta që janë edhe sot: objekt loje nga ana e të fuqishmëve dhe objekt i përqeshjeve dhe talljeve të tërë kësaj bote.

Veçanërisht është i dukshëm çrregullimi i botës arabe. Ajo është nën çfarëdo pritje reale. Sjellja e liderëve të tyre politikë është jashtë çfarëdo gjykimi normal.

Është e pakuptueshme - madje edhe për armiqitë - se nuk janë në gjendje të gjejnë bazën e veprimit të tyre të përbashkët. Ekziston tregimi si gjykojnë izraelitët për ta: Në kohën e formimit të Izraelit të tyre ata flisnin ndërmjet vete: "Për fat që armiq nuk i kemi arabët (por vetëm palestinezët)!" E sot: "Fati që për armiq i kemi arabët!" Ne këtu do të shtonim ndoshta në mënyrë të vrazhdë ose fyese për veshët e dikuj: "por jo muslimanët." Në konkurrencën e përgjithshme arabët gjithnjë ngecin pas Izraelit.

Vetëdija dhe ndërdija izraelite sillet ndaj tyre me përbuzje, sepse vendet e tyre i shikon si vende të reja diktoriale ose rigorozisht feudale, kurse të gjitha bashkërisht si vende të korruptuara me masa të gjera të analfabetëve dhe ekonomikisht me popullsi të prapambetur, të cilën politikisht e udhëheqin njerëz pa kurrfarë parime, të uritur dhe të etshëm vetëm për pushtet.

Hebrenjtë janë përpjekur që me anë të kanaleve të *shumta* t'i sigurojnë Izraelit ndihmën e gjithanshme nga ana e Perëndimit. Propaganda e Izraelit është në nivel të lakmueshëm. Ajo arriti që të rë Perëndimin ta kthejë si publik simpatizues për Izraelin. Izraeli për Perëndimin është i vetmi shtet demokratik i qytetëruar dhe me prosperitet në Lindjen e Afërt, i vetmi vend i atij rajoni i denjë për respekt.

Si i kundërvihen arabët kësaj? Deri më tanë në horizont nuk ka asgjë të vlefshme. Politikisht u treguan plotësisht të papjekur. Mundësitet e veta: hapësirën e madhe territoriale, numrin e madh të popullsisë, pasurinë tokësore, ata nuk janë në gjendje t'i shndërrojnë në përparësi politike. Madje as Islamin! Kjo është përgjigjja e vërtetë. Mendojmë në mbështetje të singertë në Islamin, e jo në ato që kanë mbështetje dyfyrësinë.

Arabët dhe politikanët e tyre duhet përfundimisht të mendojnë, të sillen dhe të punojnë si njerëz të sinqertë dhe si njerëz besnikë të Islamit, përndryshe do të dështojnë plotësisht. Për këtë vetë All-llahu xh.sh. ua tërheq vërejtjen! A thua nuk e shohin ata se atë që është e vlefshme në histori e bënë vetëm si muslimanë, kurse e gjithë puna tjeter ishte dështim. Ky është fati i tyre i garantuar me Kur'an. Është e mjaftueshme të udhëzohen vetëm në dy ajete, në surenë Ali-Imran 103 dhe në surenë El-Ma'ide, 54. E All-llahu i pëlqeu ata që në gjuhën e tyre t'ua dërgojë Udhëzimin e vet të fundit! E çka kërkojnë ata pas tij?

Për fat të keq të tyrin, me rënien e halifit të katërt lejuan që legjimiteti i halifit të hiqet dhe të zëvendësohet me trashëgiminë e pushtetit sipas gjenealogjisë së gjakut. Ata nuk qenë në gjendje që zgjedhjen e njerëzve udhëheqës, që me sukses u zhvillua në një bashkësi të vogël, ta ngrenë në nivel më të lartë kur u zgjerua bashkësia. Pasoi shkatërrimi i brendshëm politik në raport me qëndrimet ideore të Islamit. Fuqia e shtetit, forca ushtarake, administrata e degëzuar, gjyqësia, vrulli ekonomik, domosdo e ka shpënë gjithë këtë drejt pushtetit më të madh të prijësve të tyre. E pushteti është srovë e madhe të cilës nuk i përballuan. Rrëshqitën, devijuan. *Kërkësat autoritative të Islamit i shndërruan në autokraci të sundimtarit.* Ndërkaq, bashkësia islame nuk gjeti forcë ta pengojë atë arbitraritet, të theksojmë edhe një herë - për fat të keq të saj.

Sundimtarët, të sigurt në pushtetin e vet dhe të mbrojtur nga çfarëdo vërejtje administrative në qeverisjen zyrtare dhe në qeverisjen personale, bënë çka u ra ndër mend dhe çdo gjë për të cilën qenë të disponuar. Në shekullin XIII mbretëroi një korruption i atillë, që solli deri te disfata ushtarake-politike e arabëve dhe gjithçka që tërheq pas veti një disfatë e tillë. Filloi shfarosja e rrëmbyeshme e gjithë asaj që u takonte të nënshtuarve, e po ashtu edhe Islamit. Ndërkaq, këta shfarosës historikë të Islamit, fiset mongole-turkotatare, së shpejti u arsimuan me mëshirën e Zotit, në bartës të përtërirë të Islamit. Kurse ndër ta, osmanlinjve u takoi nderi i bartësve më autoritativë të fuqisë ushtarake, politike, ekonomike, kulturore dhe fuqisë ideologjike të Islamit gjatë shumë shekujve!\*\*

---

\*\* I bëjmë me dije lexuesit që mos të habitet me faktin se qeveria e osmanlinjve ishte monarkiste. Kjo qeveri, gjatë shumë shekujve, pati shumë veti (islame), jashtëzakonisht pozitive. Më vonë, shumë më vonë, kur gjithnjë e më tepër

Sjellja e arabëve në Luftën e Parë Botërore paraqet vetëvrasje të mirëfilltë politike. Derisa disa bënин marrëzira, duke vlerësuar politikisht (kurse nga aspekti islam ai ishte krim i vërtetë, sepse pamëshirshëm i vrisnin edhe të pafuqishmit, të sëmurët dhe ushtarët e robëruar, të cilët me zë binin shehadet),\*\*\* të tjerët as nuk u përpinqën t'i zbrapsin nga luftimet kundër vëllezërve të një besimi, e lëre më të mundoheshin t'i pengonin në këtë drejtim.

Ç'kanë për të thënë vetë arabët për atë që u ndodhi më vonë? Ata mund ta akuzojnë këtë ose atë fuqi koloniale të Perëndimit se i mashtroi tinëzisht, por le të shikojnë në Kur'an dhe do të shohin se vetvetes, individualisht dhe kolektivisht, i sollën të keqen (En-Nisa, 144; El-Ma'ide, 51; El-Enfal, 25, etj.) Dhe sikur të besonin sinqeirisht në Kur'an, nuk do të guxonin të bënin atë që e bënë (Ali-Imran, 100; Ali-Imran, 102; Ali-Imran, 118; En-Nisa, 93 etj).

Arabët e sotëm e shohin pozitën e vet, ndaj në emër të idesë për kombin dëgjohen thirrjet për unitet (që e pranuan nga perëndimorët). Megjithë qenien e tyre, mendimin, ndjenjat, historinë, gjuhën dhe kulturën, ata janë një. Por nuk janë një politikisht. Pse? Atyre këtu madje as besimi nuk u bëhet pengesë.

Kur shikoni hartën gjeografike, menjëherë ju bie në sy se kufijtë e shteteve të tyre janë plotësisht të panatyrshëm. Nuk është e çuditshme: këta kufij janë tërhequr me vizore të shteteve perëndimore në tubimet pranë tavolinave diplomatike. Mirëpo është çudi se si burrat shtetërorë arabë i pranojnë për vete si shenjtëri politike. Shikojeni Magrebin: ai është një tërësi gjeografike, por jo edhe tërësi politike. Shikojeni luginën e Nilit - një tërësi gjeografike. Gadi-shulli Arabik - tërësi gjeografike. Politikisht; njëzet shtete, të cilat janë në grinde të vazhdueshme politike. Nuk janë të rralla as konfliktet e përgjakshme. E shkaqet? Të imtat: kontestet e parregulluara kufitare. Të mëdhatë: ndarjet ideologjike.

Si janë të mundshme këto nëse ata udhëhiqen nga ideja kombëtare? Si është e mundshme që ajo ide nuk është në gjendje që në aspektin politik-shtetëror t'i bashkojë ndaj armikut të njëjtë të jastëm? Ata mburren se po sillen me mençuri dhe i paraqiten botës se

---

mbizotëroi elementi joislam me pasoja të ndërsjellja negative, pasoi shkatërrimi definitiv i kësaj perandorie.

\*\*\* Aluzioni për masakrën mbi ushtarët e plagosur dhe të sëmurë turq në tërheqje, të cilët koloneli anglez Lorens-i me "kryengritësit e vet nga shkretëtira" i mbërriti në Damask.

janë të sinqertë. Ndërsa ata nuk e kuptojnë se janë zhytur në situatë tragjikokomike, sepse nuk duan t'i përgjigjen thirrjes së Kur'anit të bëhen besimtarë të sinqertë, të bëhen muslimanë të ndershëm, dhe kështu aty të gjejnë unitetin e tyre. Ata për diç të këtillë nuk kanë as forcë e as bindje. Ata vetëm shprehen pak a shumë në mënyrë deklarative si pjesëtarë të Islamit.

## Fjala përfundimtare

Kujt t'ia drejtojmë këto fjali të fundit? E kujt tjetër nëse jo rinisë! Tek ata (të rintë) gjithmonë mund të gjendet më së tepërm pastërti për bindje dhe dëshirë për të *mirë*, e kundër të keqes. Edhe bashkësia e parë, e cila u tubua rreth Resulullahut a.s., ishte e përbërë kryesisht nga rinia. Ajo që viente për bashkësinë e atë-hershme, vlen edhe për bashkësinë e sotme. Dhe tërë këtë mund ta gjeni në Kur'an. *Ndërtojeni atë botë!* Le të jetë kjo bota juaj në të cilën do të jetoni dhe do të vdisni. Islami i kapërcen të gjitha kufijtë, nuk shikon as në racë, as në gjuhë, as në prejardhje, as në klasë, as në gjendje ekonomike, as në përkatësi të çfarëdo shteti ose populli qoftë. Islami krijon popullin e *vet* (shprehuni; ummet, kavm, bashkësia, *pax islamica* - si të doni), *popull* në parimin e pranimit të Kur'anit. Në surenë Ali-Imran, 110, kjo veçanërisht pohohet: “*Jujeni populli më i mirë nga të gjithë të cilët janë paraqitur ndonjëherë: kërkoni të bëhen vepra të mira, kurse largohuni nga njerëzit e këqij dhe besoni në All-llahun*” etj. Kjo është e vërtetë kur'anore, është nga All-llahu dhe me të ne duhet të takohemi në Ditën e gjykimit.

*Prandaj, idetë e Islamit le të bëhen ideologja juaj!*

Armiq do të ketë në të gjitha anët. Ata tanimë janë aty dhe me vigjilencë shikojnë në ju. Këta janë ata, të cilët të gjitha fatkeqësítë, mjerimin dhe mynxyrat e muslimanëve (e për këtë jo rrallë edhe vetë kanë qenë iniciatorë) ia përshkruajnë me shprehje të përbuzjes ekstreme ‘fatalizmit musliman’, ndërsa kur muslimanët bëjnë ose nisen të bëjnë ndonjë të *mirë*, ndizen flakë urrejtja dhe akuzat kundër ‘fanatzimit musliman’. Këta armiq të fesë do t'u ofrojnë çdo pëkrahje atyre edhe më të rrezikshëmve - duke filluar nga ata të fshehtit deri tek ata të hapur botërisht, të cilët sikurse disa bimë

kacavjerëse helmuese mbështllen në mënyrë vdekjeprurëse rrëth radhëve muslimane.

Mos u ligështon shpirtërisht!

All-llahu u ka premtuar mbrojtje, ndihmë dhe shpërblim të madh luftëtarëve të sinqertë në rrugën e Tij. E All-llahu është i plotfuqishëm! Ai nuk e mohon premtimin e Vet.



# **PROCESI I SARAJEVËS ‘83 - MONTIM OSE JO**

---

## **Përgjigje gazetares Nagorka Idrizoviq**

Informacioni i gazetares Nagorka Idrizoviq lidhur me *Procesin e Sarajevës ‘83* i publikuar në vazhdime në “Oslobodjenje”, në fillim të vitit 1990, është tepër i pakripë, sepse është qëllimi i njëanshëm: autorja është mbështetur në dokumentet hetimore dhe në deklaratat gjyqësore, që shkonin në favor të akuzës publike.

Kjo krijoj një bindje krejtësisht të shtrembëruar për atë, që vërtet ndodhi edhe në hetime edhe në gjyq, njësoj sikurse seriozisht t'i merrnim deklaratat dhe pohimet e Mesjetës për gratë e akuzuara se ishin magjistare ose shtriga dhe si të tilla digjeshin. Në të vërtetë, inkvizicioni mesjetar në dokumentet e veta në detaje sjell se në çfarë rrëthanash e mundimesh janë dhënë ato pohime, mirëpo ky i sotmi, i periudhës sonë orveliane, nuk e ka njoftuar gazetaren Nagorka se nën çfarë kushtesh janë dhënë pohimet dhe ‘pranimet’ e fajeve dhe ngarkimet e miqve më të mirë. Gazetarja Nagorka ka pasur rast, së paku në gjyq, të shohë se çfarë drame po luhej edhe me të akuzuarit edhe me dëshmitarët, megjithatë, krahas kësaj ajo kalon heshtazi dhe pa ndonjë kokëçarje. Dhe jep informacionin e vet në kuptimin: nuk do të thotë se kanë qenë të pafajshëm... mirëpo, ja, instancat më të larta gjyqësore, madje u sollën me admirim ndaj të akuzuarve!

Kuptohet qartë se gazetarja Nagorka qëndron larg nga kreu profesional dhe politik, ku janë projektuar akuzat, aktakuzat dhe

aktgjykimet, ndaj as lexuesve të fejtonit gazetaresk në “Osollobo-gjenje” nuk ka mundur t’ua thotë të vërtetën se ç’ka ndodhur në Procesin e ‘83-shit. Autores as që i ka shkuar ndërmend që këtë ta pranojë haptas. Sepse, gazetarja Nagorka ka harruar se në këtë aferë është ndërthurur një masë e gjerë njerëzish dhe për të gjithë ka qenë e qartë se fjala është për një kurdisje politike, të veshur në petk juridik, në një mënyrë aq joprofessionale saqë as urdhërdhënësit e as ekzekutuesit nuk mund ta fshihnin se bëhet fjalë për një proces të montuar.

## Jeta si humor i zi

Si njëri ndër të gjykuarit në këtë proces, po sjell disa hollësi në mënyrë që gazetarja Nagorka ta shohë se realiteti është shumë më i çuditshëm sesa tekstet gazetareske, të cilat shkruhen për mbrojtjen e nomenklaturës sunduese. Ndërsa si hyrje për t’i kuptuar më mirë gjërat po ju sjell dy anekdota, të cilat tregohen brenda mureve të burgut.

**Anekdota e parë:** Në Leningrad e nxjerrin para gjyqit një inxhinier, duke e akuzuar se ka dëgjuar radiostacionet e huaja. I akuzuari mbrohet: “Kjo nuk është e vërtetë. Unë nuk kam fare radioaparat!” Gjykatësi: “Sikur të kishe radio, do t’i dëgjoje!” dhe e dërgon në punë të dhunshme shumëvjeçare në Sibir.

**Anekdota e dytë:** Në Duvno priftërinjve ua marrin një pjesë të sipërfaqes banesore dhe lokalet ndihmëse për formimin e kooperativës bujqësore. Priftërinjtë heshtin. Nuk flasin, çile gur gojën, as bardh as zi. Mirëpo, një ditë të bukur njëri ndër priftërinjtë më të vjetër dhe më përgjegjës u gjend në bankën e të akuzuarve. Gjykatësi e pyet: “A është e vërtetë se ti ke thënë se në kooperativën bujqësore kuajt i ushqejnë aq dobët saqë nga uria nuk mund të qëndrojnë në këmbë, ndaj katër njerëz me ndihmën e trarëve të fortë përpinqen t’i drejtojnë që të qëndrojnë në këmbë.”

Prifti përgjigjet: “Unë këtë nuk e kam thënë, unë këtë e kam shikuar nga dritarja ime.” Dhe u dënuua me 4 vjet dënim - punë pëmirësuese.

E gjithë kjo tingëllon si humor i zi, por bëhet fjalë për ngjarje të vërteta të cilat kanë ndodhur qëmoti, supozoj se para se të jetë lindur gazetarja Nagorka. (Le të më falë nëse është ndryshe!).

Tani është në radhë tregimi i tretë. Procesi i Sarajevës i ‘83-shit zgjoi interesim në tërë botën. Kurrsesi nuk ndalej zhurma. U ngrit pluhur i madh. Aktorët supremë të këtij procesi tanë, në kohën e publikimit të fejtonit të Nagorkës, u gjendën në situatë që t'i arsyetojnë dënimet drakoniane. Ndër të parët u gjend Hamdija Pozderci.

## Argumentet e Hamdija Pozdercit

Flet pa kurrfarë ngurrimi atë që ka në mendje dhe në zemër. Dënimet janë krejtësisht të arsyeshme, pohon ai. Ja argumenti i tij:

Të dënuarit, sipas edukatës së tyre, arsimimit, mentalitetit, bindjeve dhe mënyrës së jetesës, janë armiq të këtij ‘realiteti tonë socialist’. Këta janë besimtarë dhe nuk i fshehin bindjet e veta fetare. Më në fund, Pozderci ofron shpjegim kulminant... ç’do të ndodhë, sikur të ndodhte... Ky është argument orvelian. Argument se është e drejtë gjithë ajo që regjimi e ushtron ndaj njerëzve. Ky argument del nga përfundimet orveliane për lidhjet shkak-pasojë për mendimet e këqija, fjalët e këqija dhe për veprimet e këqija. Qëndrimi i Leninit “ai që s’është me ne, është kundër nesh”, në këtë kontekst është aktgjykim, që ju rri mbi kokë si shpata e Damokleut. Se kur do t’ju bie mbi kokë, nuk varet nga funksionimi juridik i shtetit, ky është vetëm një vendim politik i kreut më të lartë. Rregulla e dërguar “Nuk je yni, je fajtor!” është ligj në emër të të cilit u eliminuan miliona njerëz. Për komunistët ky ishte qëndrim plotësisht i drejtë. Aktgjykimet për ta ishin thjesht formale, madje ngarkesë e panevojshme.

Gazetarja Nagorka di për zhdukjen brutale të miliona njerëzve në spastrimet staliniste, në revolucionin kulturor kinez ose menjëherë në fillim të regjimit të Pol Potit, vetëm sepse ‘më i mençuri ndër të mençurit’ vlerësoi se është koha për qërimin e hesapeve me ata, të cilët, sikur t’u ofrohej rasti, do të ishin në gjendje të bënин vepra armiqësore. Mirëpo, sa u përket (keq)rrethanave tona, kjo për Nagorkën nuk është e njëjta gjë.

Në fushatën e përgjithshme të ‘83-shit kundër të arrestuarve, të shënuar si intelektualë muslimanë, nacionalistë dhe fundamentalistë (nëpërmjet shtypit, nëpërmjet hetimeve dhe gjyqit), vijimisht theksohej se nuk jemi përgjegjës pse jemi besimtarë, se ky nuk është

të gjykim i fesë, por sepse e kemi tejkaluar ekspozimin e bindjeve tona fetare të lejuara me ligj.

## Gjykimi i fesë; deri ku shtrihet ekspozimi i fesë

Mustafa Spahiq, njëri nga të arrestuarit, e pastaj edhe ndër të akuzuarit, në shqyrtimin e hetuesit, i cili e ngarkonte se në veprimtarinë e vet të imamit e ka kaluar kufirin e asaj që është e lejuar me ligj, kërkoi nga hetuesi ta definojë se deri ku shtrihet ky kufi.

Hetuesi i përgjigjet: “A, jo, jo! Ju vetë do ta caktoni deri ku shtrihet ai kufi.” Kjo është ajo rregulla. Kjo është rregulla themelore e pushtetit orvelian. Ajo ofron mundësi t’ju akuzojë në mënyrën më absurde kurdo që e sheh të nevojshme, dhe ju kurrë nuk jeni të sigurt se jeni të mbrojtur juridikisht. E gjithë kjo është e planifikuar. Vazhdimesht ju përcjell frika dhe e mundoni vetveten me autocensurë.

Personalisht mua, shtypi i atëhershëm ma veshi edhe këtë mëkat: se paskam qenë i indinjuar, ngaqë ndër muslimanë, me rastin e varrimit, po futen zakone joislame. Çudë përmbi çudë! Dhe mëkat i madh! Tekefundit, ai është mendim imi intim me të cilin nuk e kam shqetësuar askë. Për shërbimin e sigurimit nuk ka qenë vështirë të nxjerr përfundim të këtillë, meqenëse unë publikisht jam deklaruar si besimtar. Ndërkaq, regjimit i ishte nevojitur që nga kjo të krijojë problem politik pér mjedisin në të cilin gjendesha unë. SPB-ja gjeti edhe një besimtar (pérndryshe mik imi), i cili kuptohet ka pasur krejtësisht të njëjtin qëndrim dhe diskutimet tona të ndërsjella i ka shndërruar në objekt akuzimi publik. Atë e ka bërë dëshmitar, kurse mua fajtor.

Në shkrimet e njëanshme të shtypit, ku mori pjesë gazetarja Nagorka, bëhej përpjekje që ekspozimit tonë fetar t’i jepej një pamje sa më e tmerrshme dhe e neveritshme dhe me këtë që më parë të arsyetohet dënimi i parapërgatitur. Mua më pritnin 5 vjet burg.

Hetuesi im (emrin e kishte Sllobodan, kjo është krej që di pér të) ishte hetues edhe i vëllait tim.

Vazhdimesht më thoshte: “Do të bëhet ajo që ne do ta shkruajmë këtu. Ta dish se vëllai yt do të dënohet me 15 vjet burg. Ka pasur fat që nuk i kemi gjetur armë.”

Pas shumë vitesh kur vëllai doli nga burgu dhe kur i tregova për këtë, më tha se i njëjtë hetues i ka thënë për mua se do të dënohem me 5 vjet burg.

E ju, gazetare Nagorka, do të dëshironit t'i vini në dyshim rrëfimet për procesin e montuar, apo jo. Sipas jush, gjyqësia jonë është e pavarur në vendimet e veta!

## Gjykimi i armës trofe

Një ditë, kur erdhën të më arrestonin mua, para se të fillonin bastisjen, punëtorët e sigurimit më thanë: "Mos t'i kërkojmë armët, dorëzoi vetë!..."

Te Et'hem Biçakçiqi nuk patën nevojë as të kërkojnë e as të gropojnë shtëpinë në kërkim të armëve. Ajo ishte eksposuar në shkallë të shtëpisë. Në të vërtetë, ajo ishte armë trofe, pushkë e zbuluar dhe e punuar me argjend, të cilën i ati i tij i ndjerë e kishte pranuar më 1934 në Bruksel, në shenjë shpërblimi të gjuetarëve evropianë për sukseset e tij në gjueti, ndaj ishte e eksposuar aty me trofetë tjera më të rëndësishme.

Meqenëse atë mëngjes nuk e gjetën Et'hemin në shtëpi, me këtë pushkë e fotografuan nënën e tij.

Sipas gjasave, këtë fotografi nuk ia kishin treguar gazetares Nagorka. Tërë kjo ngjarje sot merr karakter komik, por në ato momente, për dikë kjo fotografi përfaqëson triumf.

Edhe pushka shkoi në burg, por nuk u paraqit në gjyq. Familjes Biçakçiq iu kthye pushka vetëm pas disa viteve të kërkimit këmbëngulës. Në vendimin definitiv me shkrim që pushka t'i kthehet familjes së pronarit, qëndronte edhe vendimi që nga pushka të hiqet gjilpëra goditëse.

Të nesërmen, pas arrestimit të vëllait tim dhe bastisjes së banesës së tij, gruan e tij e thërrasin në SPB. E pyesin: "Çfarë thike është ajo në vitrinën e librave?" Ajo përgjigjet: "Ajo është suvenir që e kam blerë në botën e jashtme. Shërbën për të çelur letra. Ja, edhe tash është në vitrinë, po ju pret, mund ta merrni!."

Kunata shton: "Ky nëpunës linte përshtypjen e një shqetësimi të plotë. Nuk mund ta fshihte kurrsesi se sa rëndë i erdhi kjo përgjigje e imja."

Posa jam arrestuar, përkundër të gjitha dispozitave ligjore, është hapur procesi i largimit tim nga shkolla, ku kam punuar. Më larguan brenda afatit njëzetditësh, që në fillim të fazës hetimore.

Pushimi nga puna është mbështetur në *shkrimin e shtypit* (kjo kështu qëndron në vendimin për pushimin nga puna), prej të cilit shihet se jam nationalist musliman. Të gjitha parashtresat dhe ankesat se kjo është e paligjshme, pa gjykim të plotfuqishëm të Gjyqit suprem, askush nuk i mori në shqyrtim. Ndërsa sot të gjithë arsyetoohen: “Na është dashur, na është urdhëruar nga lart.” Funksionimi i sistemit komunist reduktohet vazhdimesht në kufizimin e të gjitha të drejtave (të individëve dhe të grupeve) që u janë siguruar me ligj. Urdhëruesit dhe ekzekutuesit e këtyre veprimeve të paligjshme nuk çanin kokë për asgjë, sepse asnjeherë askush (në mbretërinë e paligjshme orveliane), nuk është përgjigjur për veprime edhe më të shëmtuara, e lëre më për diç të këtillë. Përkundrazi, të kërkosh dhe të angazhohesh që nomenklatura qeveritare t'i respektojë ligjet të cilat i ka shpallur vetë, do të thotë ta dënosh veten në humnerë - në shkatërrim.

## **Edhe kjo ndodh në “Shtetin juridik” - paguhet ai që nuk punon**

Në këtë rast ndodh edhe një ngjarje paralele, e cila e bën çështjen edhe më të pazakonshme. Shtypi në mënyrë qortuese dhe kërcënuese bënte pyetjen si ka mundur të ndodhë që një ish i dënuar politik, madje edhe besimtar, të vijë në kontakt pune me fëmijët, qoftë kur është puna edhe me lëndën e matematikës. Në të njëjtën kohë, në tetëvjeçaren “Salko Pezo” të Mostarit punonte si arsimtar i gjuhës frëngje, po ashtu një ish i dënuar politik. Jemi njohur qysh në Zenicë. Ka qenë i dënuar shtatë-tetë vjet. Aktakuza e ngarkonte në emër të propagandës, për veprim politik në kuadër të grupit të orientimit demokrat dhe në favor të rregullimit të shtetit dhe të shoqërisë sipas kritereve të Perëndimit. Tani është thirrur në ‘vendin kompetent’ dhe i është kumtuar që ta braktisë klasën, të shkojë në shtëpi, me ç'rast në fillim të çdo muaji të vijë në shkollë për të marrë të ardhurat e veta personale.

Një gjendje e këtillë e parëndomtë zgjati disa vjet, e pastaj ky arsimtar e normalizoi gjendjen e vet. Doli në pension rrugës nor-

male. Erdhi dita kur u takova me të. E pyeta se si ndjehej psikikisht në atë hallakamë?

Ndërsa ai qeshi, ndoshta pikërisht për atë se ajo i takonte të kaluarës, ndaj më tha: "Nuk ishte edhe aq keq. Nuk punoja, por e merrja rrogën!"

Kam dëgjuar nga kolegët e tij, nga e njëjta shkollë, se si sille-shin ndaj tij lidhur me këtë ngjarje. Ata çuditeshin me vetveten: "Dhe askush prej nesh nuk kishte marrë guximin të shtrojë pyetjen se si është e mundshme kjo sipas ligjit dhe vetëqeverisjes."

Ky rast u ishte i njobur të gjithë punëtorëve të arsimit në Mostar. Edhe pse kjo temë ishte e përshtatshme dhe e nevojshme për penën e gazetarit, megjithatë shtypi nuk tha asnjë fjalë.

Vërtet jam kureshtar se a keni ditur diç për këtë ju Nagorka? Supozoj se nuk keni ditur, e nëse keni ditur zyrtarisht, kjo për ju nuk ka ekzistuar. Mendoj se ju nuk u takoni atyre personave naivë, të cilët i dorëzohen kureshtjes personale dhe me veticiniativë pyesin tek eprorët e vet, se çfarë është 'qëndrimi zyrtar' për këtë rast jo të rëndomtë dhe si duhet ai të shikohet dhe përpunohet. Supozoj se çdo epror i juaj do t'ju përgjigjej: "A keni dëgjuar ju për këtë problem nga eprorët tuaj? Nuk keni dëgjuar!"

Të gjithë heshtin për këtë. Dhe ja, ky për ju është qëndrimi zyrtar.

Sikur 'regjisori i madh' të kishte sukses që nga mbledhja e njobur e njëzet e tetëve në krye me Gjillasin në Francuska 7 në Beograd, të bëjë skenë të atillë çfarë u bë nga "fundamentalistët islamë të Sarajevës", është e qartë se ndërmarrja e tij orveliane tanë e paralajmëruar, gjithnjë e më tepër do të rritej, e pastaj edhe ju Nagorka do të kishit fituar rast të shkruanit për këtë ngjarje të pazakonshme të zënë ngojë të mikut tim dhe të arrestuarit të dikurshëm. Si do të shkruanit?

Në këtë punë Ju tanimë jeni dëshmuar dhe argumentuar, në mënyrë profetike të lajmëroni dhe të arsyetonit atë që e pret - *burgu*.

## Parapërgatitja për procesin e '83-shit për Salko Behmenin

Disa muaj para arrestimit ndodhën tri ngjarje, të cilat vetveti janë të parëndësishme, mirëpo në kuadër të asaj që ndodhi më vonë,

janë mjaft karakteristike. Nga dy prej tyre kuptohej se një kohë të gjatë diç është përgatitur.

**Ngjarja e parë:** Një mëngjes në punën time, në një tollovi të përgjithshme, në minutat e fundit para se të fillonte mësimi, derisa disa hynin në sallën e arsimtarëve, ndërsa të tjerët dilnin me ditarë në dorë, takohem me një njeri. Nuk arrita as ta lëviz kokën bashkë me fjalën përcjellëse “*tungjatjeta*”, ndërsa ai personi shikoi drejt në mua dhe pa dyshim, nën përshtypjen e fortë të diçkasë, si rrufeja për së kthjellti m'u drejtua: “Mos u çudit për asgjë se ç'do të ndodhë me ty. Mbaje mend mirë, ky është vend ateist!” dhe kaloi përskaj meje. Në moment të parë as nuk e kuptova se ç'ka ndodhi. Më vonë fillova të mendoj.

Në vendin e punës duke i ikur çfarëdo grindjeje jam përpjekur që të mbaj marrëdhënie korrekte me të gjithë. Mund të lëvdohem se nuk jam fjalosur kurrë me askënd. Prandaj as me këtë person. E këtu, në këtë shkollë, kam punuar me vite. Kam mundur krejt gjakftohtë dhe i qetë të kërkoj prej tij të më sqarojë se për çka është fjalë. Mirëpo, nuk e bëra këtë. Vetvetiu m'u imponuan disa sqarime të ndryshme, në disa kombinime. Megjithatë, as sot e kësaj dite nuk e kam të qartë a ishte ai transmetim i një porosie të menduar apo çështje e rastit, ose mendim personal i fituar në ndonjë ndejë miqësore në momente të atypëratyshme ‘ky kështu-ai ashtu’.

**Ngjarja e dytë:** Një ditë, vajza ime, në atë kohë nxënëse e shkollës së mesme, tepër e tronditur më tha: “Më ka kapë tmerri. Ja, Branko Mikuliqi foli se si po përgatiten iftarët.” Do të ishte krejt normale që të kisha pyetur për disa hollësi, mirëpo duke pandehur se bëhet fjalë për veprime të përditshme dhe të palogjikshme, të zakonshme të regjimit, i cili njëkohësisht flet për liritë fetare, ndërsa shfrytëzimin e këtyre lirive e konsideron si akt antishtetëror, u përpoqa ta qetësoj fëmijën, duke mos i dhënë ndonjë rëndësi kësaj deklarate të Mikuliqit. Nuk ka qenë Ramazan fare. Nga ai i vjetmi kishte kaluar një kohë, ndërsa për të ardhmin (Ramazanin e sivjetëm) kishte mbetur edhe aq kohë.

Ndërsa, kur më kanë arrestuar, qysh para fillimit të hetimeve zyrtare, më shtruan pyetjen në formë pohimi dhe me ton akuzues: “Ti një ditë ke përgatitur iftar në shtëpinë tënde!” Nuk e di se me çfarë çehre kam reaguar në fytyrë, por punëtori i sigurimit u tërroq dukshëm dhe shpejtoi të thotë: “E di, e di, nuk e ke bërë ti këtë qëllimi. Në vizitë të ka ardhur vëllai dhe Alia Izetbegoviqi, e ti rastësisht u ke përgatitur iftar!”

Në vetvete mendoja: Do të ishte e kotë t'i shpjegoja diç. Ky s'ka haber as ç'është darka, as ç'është iftari, as ç'është Ramazani, mirëpo duket qartë se ka marrë për detyrë të më ngarkojë me burg. Pastaj refuzoi të insistojë për atë iftar. Kaloi në pyetje tjera, që nuk ishin aspak më të pakripë, por edhe aspak trillime dhe montime më të rrezikshme.

**Ngjarja e tretë:** Hyj në sallë. Janë të pranishëm rreth pesëmbëdhjetë kolegë të mi. Njëri diç fliste dhe përpiquej t'i jepte ton qesharak. Të tjerët me kureshtje e dëgjonin. I afrohem raftit me ditarë, e marr ditarin tim dhe nisem të dal. Ndërkohë e kuptova se për çka fliste ai - jep mendimin e Millovan Iliqit i quajtur Minimaks për grusht shtetin ushtarak të gjeneral Jaruzellskit në Poloni dhe për jehonën e kësaj ngjarjeje në botë, duke cituar fjalët e Iliqit: "Edhe te ne po ndjehet era e lules polake." Qeshje në sallë. Ndërsa shumica e të pranishëmve ishin ose ihtarë të partisë ose spinë të SPB-së. Dal nga salla, e as nuk kthehen t'i dëgjoj. Kur më sollën në SPB, njëra nga pyetjet e para ishte kjo: "A ka folur dr. Tarik Muftiqi se si edhe te ne po përgatitet grusht shteti ushtarak si në Poloni?" Pothuaj më ra ndërmend mendimi shpirtlig dhe t'ua kthej - po dr. Muftiqi nuk është punëtor arsimi!

## Si u trilluan dëshmitarët

Nga ana tjetër, as. dr. Muftiqi nuk është lënë në qetësi. Më 23 mars 1983, dita e sulmit të madh të punëtorëve të sigurimit, pesë punëtorë të sigurimit ia bastisën shtëpinë. Të nesërmen, pas 24 orë kujdestarie në spital u ftua nëpërmes telefonit të vijë në SPB. Iu dha karrigia të ulet dhe pastaj 33 orë pandërprerë u mor në pyetje (në përpunim).

Pastaj u lirua që të shkojë e në shtëpi ta kalojë natën, ndërsa të nesërmen përsëri të vijë. E gjithë kjo përsëritej 12 orë pandërprerë.

Më 9 maj e njëjtë gjë 10 orë pandërprerë.

E gjithë kjo bëhej me qëllim që ai të bëhet dëshmitar kundër meje, të thotë vetëm aq, se si unë kam thënë se ekonomia jonë nuk bën.

Ja se si dr. Muftiq i paraqet ato biseda informative:

- Ty Salih Behmeni të ka thënë se si nuk bën ekonomia jonë.
- Jo, nuk më ka thënë.

- E përse keni biseduar kur jeni takuar?
- Për sëmundjen e tij.
- Ndoshta nuk keni folur vetëm për këtë.  
Ai para nesh ka pranuar se ka folur edhe për ekonominë tonë.
- E atëherë, përse po më pyetni mua?  
Ja ku e keni atë dhe pranimin e tij.
- Prano edhe ti! Ai para nesh ka pranuar se ka folur edhe para teje.

- Para meje jo. Tekefundit, çfarë lidhje ka ai me ekonominë tonë. Unë kur dua të njostohem për të, kërkoj mendimin e ekspertëve përkatës.

- Ku? Cilët janë ata?

- Nëpërmjet televizionit. Ne dëgjojmë për çdo ditë se si gjendja në ekonomi është gjithnjë e më e vështirë. Edhe ekspertët e ekonomisë edhe personalitetet udhëheqëse politike flasin haptas për këtë.

Ja, në këtë mund të përblidhet kuptimi dhe përbajtja e asaj bisede informative, që ka zgjatur 55 orë.

Disa ditë pas nënshkrimit të vendimit zyrtar për arrestim dhe fillimin e hetimeve, u solla para gjykatësit hetues Haxhikariqit. Lënda e hetimeve ishte e formuluar në gjashtë pikë. Kur u bë fjalë për vëllain tim, ndodhi një incident karakteristik.

Në kërkesën që t'i tregoj “lidhjet” me vëllain, këtë e bëra këshfu: “Më 1949 kemi rënë në burg, jemi gjykuar me dënim shumëvjeçar si pjesëtarë të Muslimanëve të rinj. Pas tetë vjet e gjysmë unë jam liruar për në shtëpi, ndërsa ai ka qëndruar gati edhe tre vjet pas lirimit tim. Menjëherë pasi është liruar ka shkuar në shërbimin ushtarak, pas ushtrisë shkoi në studime në Sarajevë, ndërsa me kryerjen e studimeve është martuar dhe është familjarizuar në Sarajevë. Tre vjet ka qenë në botën e jashtme, në punë, në Libi. Gjatë tërë kësaj kohe unë kam qenë me nënën në Mostar. Kohë pas kohe vëllai ka ardhur dhe e ka vizituar nënën.”

Gjykatësi hetues i diktonte daktilografit: ...”kohë pas kohe vinte vëllai dhe më sillte raport.” I bëra vërejtje: “Unë ashtu nuk kam thënë.” Gjykatësi hetues reagoi në mënyrë korakte, kërkoi nga daktilografi që ta shlyejë atë për të cilën bëra vërejtje dhe kërkoi që unë personalisht t'i diktoj daktilografit.

Kur u krye kjo, në sytyrën e gjykatësit hetues u paraqitën grimasat (rrudhat), që shprehnin një hamendje të madhe. Nuk kishte

‘asgjë në dorë’. Me gjysmë zëri shtoi mendueshëm: “E po mirë, do t’i vazhdojmë hetimet.”

Dhe vërtet, hetimet vazhduan, por jo para tij. Të gjitha lidhjet me familjen u ndërprenë. Avokat nuk kam pasur. Në hetime filloj thyerja psikike e njerëzve, maltretimet e të arrestuarve ditë e natë, shkurt porositësve të procesit kundër ‘nacionalistëve islamë’ u solli fryte të kalbura. Se ishte kjo një marri politike, kjo ka mund të vlerësohet menjëherë. Mirëpo, nga aspekti juridik, së shpejti do të dëshmohet se kjo ishte thjesht një anarki.

Shikoni, gazetare Nagorka, sot Jugosllavinë e brejnë nacionalizmat nga të gjitha anët.

E ku është tanë nacionalizmi musliman dhe çka i sjell ai kësaj rrëmuje!

Asgjë, sepse as nuk ka ekzistuar kurrë. Ku janë ata mbrojtës të rremë të vëllazërim-bashkimit (në të cilët bëni pjesë edhe ju Nagorka), ç’kanë bërë dhe ç’po bëjnë që këto nacionalizma lugetër të mos e bëjnë atë më të keqen? Askund nuk shihen këta mbrojtës, as ata e as dashuria e tyre patriotike. Ndërsa kur u desht njëherë të shpejtohet takimi me vdekjen, kurse grupi i grumbulluar të dënoshet me 90 vjet burgim, dy dëshmitarë të dalin mendsh, ndërsa të tjerët në mënyrë më të paturpshme t’i torturojnë dhe publikisht t’i poshtërojnë - atëherë nationalistët i trilluat ndër m(M)uslimanët.

Për çdo verë i kaloja disa ditë në fshat, jo fort larg prej Llukavcit, te miku M.A. Me të jam njoftuar në burgun e Zenicës gjatë vuajtjes së dënit me burg. Kurse tash, në këto hetime punëtori i sigurimit më pyet se ç’kemi biseduar në tërsi. I përgjigjesh: “Për gjëra të rëndomta.” Punëtori i sigurimit insiston në hollësi, kurse unë nuk kam se çka t’i them me cilën gjë ai do të kënaqej. Atij nuk i interesojnë këto gjëra të rëndomta. Tani punëtori i sigurimit e humbi durimin dhe bërtet: “Do të thotë, se ju dy keni ndenjur njëri pranë tjetrit tri ditë dhe asgjë tjetër nuk keni biseduar, por vetëm njëri-tjetrin e keni pyetur: Si je, si je, si je...?”

M.A. ishte i caktuar për dëshmitar, por para se të fillonte gjykimi ishte dërguar në spitalin psikiatrik.

Në fillim të gjykimit, pas raportit mjekësor për gjendjen shëndetësore të këtij dëshmitari, përfaqësuesja e padisë publike pa *përpelje të mëdha* hoqi dorë nga ky dëshmitar dhe nga deklarata e tij dhënë organeve hetuese. Avokati im pothuaj ishte i impresionuar me këtë gjest të saj, këtë ma ka thënë personalisht. Ndërsa, në të vërtetë, ajo tanimë e kishte caktuar dëshmitarin rezerv F.B., vërtet

me vonesë që ta publikojë në akuzën zyrtare, por me kohë për procesin gjyqësor. Më vonë, kur dola nga burgu, F.B. më ka kërkuar “të më sqarojë” se çka ka ndodhur gjatë hetimeve. Bisedat tona të palidhura për ndonjë gjë i kanë paraqitur në procesverbalin sikur unë kam qenë i vetmi bisedues, ndërsa ai (F.B.) vetëm dëgjues i këtyre bisedave.

Ai ka bërë vërejtje në një procesverbal të tillë, e atëherë i është thënë: “Mos na detyro tash të shkruajmë procesverbal të ri – nënshkruaj. Ky le të shkojë kështu, kurse në gjyq ti thuaj se si ka qenë.” Në gjyq deklarata e tij ishte e shkurtër dhe kishte të bëjë me disa formalitete. Gjykatësi R.H. u kap kryesisht për deklaratën time kinse revolucioni i Iranit do t’i vë në lëvizje vendet që nga Maroku e deri te Gjiri Persik në bashkimin e tyre politik. Gjykatësi insistonte që F.B. të japë deklaratë a kam thënë atëherë “vendet arabe” ose “vendet muslimane”! Dëshmitari përgjigjet: “Po kjo është njësoj”. Gjykatësi ia kthen se nuk është njësoj dhe shpjegon se mund të thuhet “vendet arabe”, mirëpo në kundërshtim me ligjin konsiderohet nëse kam thënë “vendet muslimane.” U shkaktuan disa ndërhyrje të paqarta reciproke. Në një moment gjykatësi pyet: “Kush e tha këtë?” Dëshmitari: “Unë e kam thënë:”

Gjatë hetimeve nuk e kam parë asnjë dëshmitar, por hetuesi m’i lexonte pjesët e deklaratave të tyre. Në to nuk kam mundur ta njoh as veten as ata. Më ra në sy uniformiteti i këtyre deklaratave, varfëria e çuditshme e fjalorit, e veçanërisht paraqitja e fjalëve, të cilat unë personalisht kurrë nuk i përdor. I kam refuzuar nga vetja të gjitha. Hetuesi me zë të lartë: “Si mund t’i mohosh kur të gjithë këta dëshmitarë nga Tuzlla, nga Sarajevo, nga Mostari, të gjithë flasin njësoj për ty, të githa deklaratat janë të njëjta.”

Vërtet, të gjitha deklaratat e njëjta! Më me dëshirë këtij profesionalisti, i cili ma prente fatin e të burgosurit, do t’ia ktheja: “Sikur ta kisha thënë unë këtë, do ta thoja me fjalët e mia.”

Diku nga fundi i hetimeve, duke shfletuar raportin tim, hetuesi m’u drejtua: “A thua de, ti ke mbrojtur qëndrimin se nxënësit e medresesë duhet të fitojnë arsimim sa më të gjerë?” Ia ktheva: “Tani edhe këtë ma ngarkoni në kokë!” U shqetësua i vogli! E ndali shikimin në mua. Megjithatë, nuk lejonte të habitej në kryerjen e punës së vet *profesionale* me të cilën përndryshtë lavdërohej. Madje më ka profetizuar qartë se si unë, pas takimit me dëshmitarët në gjyq, personalisht do t’ia pranoj me fjalët: “Vërtet kishit të drejtë.” Mirëpo,

ky profetizim atij nuk iu realizua, siç iu realizua ai se sa vjet burg do të dënohem i vëllai dhe unë.

Pas mbarimit të hetimeve nuk e kam parë më. I shtroj vetit pyetje se a thua ky njeri ndonjëherë, qoftë edhe për një çast, e pranon në vete, se e tërë ajo punë që kanë bërë, ka qenë një turp i ndyrë.

O, si dinë të bëhen të sjellshëm këta njerëz kur ua përgatisin qullin e hapsanës.

E pas disa vjetësh, madje këta të parët ju përshëndesin dhe me zemërbutësi kërkojnë falje: “Ç’ti bësh, ajo kohë ishte e tillë.” Por, pyes, a thua këta njerëz qenë ndonjëherë të singertë apo janë cinikë të rëndomtë.

## Inkriminime absurde

Mua më janë bërë inkriminime (ngarkim i fajeve), kinse kam pohuar se gazetat duhet lexuar “ndërmjet rreshtave”:

Një aktakuzë e këtillë në vitin ‘83, kur te ne filloj të shkruhet në mënyrë fushate gjithçka për gjithkë, vërtet ishte plotësisht absurditet. Mirëpo, si lindi një ide e këtillë?

Për mua i vetmi shpjegim ishte i lidhur për një ngjarje të para katër dekadave. Më 1949-ën, duke u gjendur në gjyqin e burgut të Mostarit dhe duke pritur gjykimin me rrëth njëzet njerëz të ngjeshur në një hapësirë të vogël, pata njohur njëfarë Ahmeti nga Hercegovina Perëndimore. E mbante qoshkun me gazeta dhe ishte i akuzuar për shkak se i kishte porositur blerësit që gazetat t’i lexojnë ‘ndërmjet rreshtave’. Meqë ishim në të njëjtën gjendje të palak-mueshme që zgjatej në pakufi, kur dikush ankohej në monoton, i dyti edhe veten edhe tjetrin “e kurajonte” se pas kësaj, megjithatë, do të vijë edhe ai ‘mëngjes i zi’ (kur do të dalim para gjyqit).

Kështu unë përpinqesha të bëj shaka me këtë gazetashitës. I them: Dëgjo Ahmet, kur të vijë drejtori i burgut në inspektim të rregullt dhe pas raportit kur të pyet se ç’ka të re, ti paraqitu dhe kérko që të na japid së paku gazetat që ta vrasim këtë kohë monotone. Në qoftë se drejtori thotë se gazetat për ju janë të ndaluara, ti thuaj: “E po ne nuk do të lexojmë atë që shkruan në to, ne do t’i lexojmë ndërmjet rreshtave.” Në këtë nuk reagoi askush. Mirëpo, nuk e kisha harruar absurditetin e këtij rasti, dhe më vonë e kam zënë ngojë

shpesh, që kuptohet qartë se u kishte ra në vesh. Dhe ata, tani fjalët e tij (të Ahmetit) m’i ngarkuan mua.

Ky është qëndrim karakteristik i tyre. Njëherë para nëpunësit të SPB në vetë burgun e Foçës zura ngojë mendimin e nënës sime të ndjerë për UDB-ën e dikurshme, që ajo ua tha ubashëve në fytyrë, ndërsa ky i njëjti nëpunës në Foçë, në një interval të shkurtër kohor, ma hodhi mua si fjalë timen, me qortim: “Ti ke thënë se nuk na do neve.”

## Njerëzit janë si thneglat - luftëtarë dhe punëtorë

Gjatë vuajtjes së dënimit të parë na ra në dorë libri “Jeta e thneglave dhejeta e termiteve”, kryevepër e Moris Meternikut. Vëllai im ishte impresionuar me një lloj thneglash luftëtare, të cilat biologjikisht ishin të paafta për punë, madje as nuk mund të ushqeshin e të mbaheshin vetë. Ato i mbytnin thneglat tjera, sulmonin foletë e tyre, mblidhnin larvat dhe vezët e tyre, dhe me këtë siguronin skllevër, të cilët do të punonin për to dhe do t’i ushqenin ato. Mirëpo, këtyre llojeve të paracaktuara të jenë skllevër, nuk u është lënë mundësia për reproduksion biologjik natyror. Meqenëse ngordhja e tyre normale duhej të kompensohej me fuqi të re punëtore, këto ishin vazhdimesh në ekspedita të luftërave vrasëse dhe plaçkitëse. Dhe triumfi i thneglave luftëtare në një trevë përkatëse, paraqiste edhe fundin e tyre. Mbeteshin pa ushqyes dhe ngordhnin nga uria.

Vëllai im vazhdimesh fliste për këtë ngjarje, ndërkaq kur u gjend në burgun hetues më 1983, punëtorët e sigurimit ia bënë me dije se dinin për ato tregime të tij. Dhe ajo që ishte më qenësore, ata ishin të goditur me këto tregime: e gjithë kjo për ta paraqiste një aluzion në sistemin e tyre, të cilët çdo njeri të gjallë donin ta shndërronin në spiun. Ngadhënjimi i plotë i sistemit të spiunëve, por me kuptim të shtrembëruar për punë, në të vërtetë të gjithë vetëm jo-punëtorë, do të kuptonte edhe fundin e sistemit komunist.

Për këtë nuk u bë fjalë as në padi as në gjyq, mirëpo, është e qartë se punëtorët e sigurimit edhe këtë ia kishin kalkuluar në peshën e dënimit. Fitoi plot kandarin, madje edhe më tepër se i akuzuar i parë.

#### **‘Liria e vizitës’ dhe e vërteta e fëmijës**

Burgu i Foçës ishte i tipit gjysmë të hapur, mirëpo beneficionet e tij, megjithatë të burgosurit politikë nuk i shfrytëzonin aq lehtë. Falë rezistencës së familjeve tona, të cilat protestuan dhe shtruan kërkesa në të gjitha anët e instancat, në disa gjëra lëshuan pe. Kështu unë në një dhomë të caktuar fitova dy orë në muaj ‘vizitë të lirë’. Kjo vizitë do të thoshte të jeshë vetëm me familjen tënde dhe pa praninë e personit zyrtar. Kuptohet, ta konsiderosh këtë vizitë vërtetë të lirë, do të ishte naivitet ekstrem. Jo vetëm që na kanë përgjuar, por është plotësisht e sigurt se edhe na kanë vrojtuar. Dhe me rastin e vizitave krijuar qesharake, mirëpo në ato rrethana i kuptionim si diçka krejtësisht e arsyeshme. Të gjitha ato biseda tona ishin të përbëra prej fjalive të pacaktuara, të përcjella me gjeste, me grimasa dhe me lëvizjen e buzëve pa zë, e gjithë kjo bëhej për shkak të frikës, që mos ta shtie në flakë as veten as të tjerët. Mund ta sillni në burg dikë, i cili mund të jetë i akuzuar rrejshëm për çkado qoftë, ndërsa në të vërtetë për shkak se ju ka dërguar të fala nëpërmjet familjarëve tuaj, kurse përkëtë të mos jetë i vetëdijshëm as ai e as ju.

Biri im, ende fëmijët i mitur, e kuptoi këtë lojë si një gjë normale. Në një rast, m’i vari duart rrëth kokës dhe m’i afroi buzët në vesh. Ishte tepër afër që të mund të kuptoj diç, mirëpo si shenjë se po e kuptoj kam tundur kokën. Nuk desha ta dëshpëroj ose ta shqetësoj. Ndërkohë, nëna i ndërhyri me pyetjen: “Përse po të flet ai?, e pastaj duke kapur një fjalë shtoi: “Ah, e di përse po të flet.” Në atë çast vogëlushi u kthye kah ajo dhe me çehre ofenduese në fytyrë me qortim ia ktheu: “Shih këtë, shih këtë, e do të të fusin në qeli”, dhe atë duke i rënë me grusht të shtrënguar të njërsës dorë grushtit të shtrënguar të dorës tjetër.

Ç'thuani për këtë, gazetare Nagorka? Unë personalisht, akuzë më të rëndë kundër këtij regjimi nuk kam dëgjuar deri më tash, sepse doli nga goja e fëmijës pesëvjeçar.

Në burg shpesh ju thërrasin në bisedë. Nga fundi i 83-shit isha i thirrur te një epror. Biseda zgjati shumë, mirëpo, tema qendrore qe dënim i dëshmi dhe si u bë që rashë në burg.

I shpjegova se si pas dënitit të parë jam ruajtur shumë që të mos më godet i dyti. Nuk kam pasur shoqëri. Puna dhe familja kanë qenë fusha e obligimeve dhe e interesave të mia. Duke shqyrtuar

aktakuzën dhe aktgjykimin, thashë se këto janë gënjeshtra ose shtrembërime të fjalëve, dhe kam shtuar: “Tekefundit, të gjitha këto inkriminime nuk janë as e dhjeta pjesë e asaj që shkruhet nëpër gazeta.” Atëherë ai më sqaroi se kur dikush prej udhëheqësve tanë thotë se me ekonominë tonë nuk është diç në rregull, atëherë kjo kritikë bëhet me dëshirë që ekonomia jonë të jetë më e mirë, ndërsa kur unë e them të njëjtën gjë, atëherë kjo është e thënë *me qëllim të keq*, ky është delikt verbal, se këtë e ngërthen neni 133 i LP që të siguron deri më 10 vjet burg.

## **Ne - fjalë e privilegjuar, unë - përvujtni e vërtetë**

Në një takim me edukatorin, në bisedë për rastin tonë, ai më ndërpren: “Ti nuk ke të drejtë të flasësh me “Ne.” Ti mund të flasësh vetëm në emër tënd.”

Ndërsa kush ka të drejtë të flas me “ne”, së shpejti do ta mësoj.

Milka Pllaninc paraqitet në TV në cilësi të kryetares së KEF-it dhe sqaron situatën ekonomike në vend dhe thotë: “Pyesin se kush është fajtor për një gjendje të këtillë. Po të gjithë *ne jemi fajtorë*”. Mirëpo, nga zëri i saj nuk hetohet as kujdesi, as turpi, as ndjenja e fajit. Ajo është plot vetëbesim. Asaj nuk i kërcënohet kurrfarë rreziku që të thirret para gjyqit për shkak të fajit të këtillë.

Të gjithë ata që e kanë shkatërruar ekonominë e Jugosllavisë, nuk do të përgjigjen juridikisht për këtë, sepse janë të mbrojtur me atë “ne.” Mua, që nuk bëj pjesë ndër ata “ne” dhe që me asgjë nuk i kam kontribuar këtij shkatërrimi ekonomik, ma kanë ngarkuar mëkatin, kinse i kam solur mikut me pëshpëritje për atë që e tërë bota e fliste me zë të lartë.

Dikush do të më thotë, dhe vërtet ka ndodhur kjo:

“E përse të zgjodhën pikërisht ty në mesin e gjithë asaj turme? Megjithatë, ka ndonjë arsyе.”

Nuk e di, por përse nuk ma kanë thënë këtë arsyе?

Tekefundit, gjykimi nuk bëhet për ndonjë arsyе, por për shkak të veprave. Në të vërtetë arsyaja ekziston, sipas saj edhe është montruar ky proces, kjo qëndron në vendimin e kreut më të lartë politik. Kreut politik i është nevojitur procesi. Në vendin tim ka mund të jetë dikush tjeter, mirëpo unë kam qenë fajtor kujdestar i asaj kohe, me cilësi të kërkura, nga tabori përkatës i qëllimkëqijve.

Një aparat i madh propagandues u vu në veprim kundër intelektualeve muslimanë, ‘nacionalistëve’ dhe ‘fundamentalistëve’ në mënyrën më tipike staliniste. Askush nuk merrte guxim, por as nuk mundej me goditjen e parë të sjellë logjikë në atë zallahi. Këtu më s’kishte kurrfarë kufizimesh. Përpinqeshin ta hidhëronin turmën. Ata, të cilët qëllimi i kishin ndezur mendimin publik kundër të arrestuarve, e pastaj të akuzuar dhe të dënuar, edhe vetë u bënë viktimitë e intrigave dhe shpifjeve të veta. Tahmishçiqi, anëtar i Kryesisë së Degës së Sarajevës të Shoqatës së Shkrimitarëve të Bosnjë e Hercegovinës, kur flet për aktgjykimet e shkrimitares M. Salihbegoviq, poetit Xh. Latiq dhe të tjerëve, thotë: “... e sa më përket mua, unë do t’i mbaja në burg të pérjetshëm...” E, po mirë, por përsë? Atij, ashtu si edhe gazetares Nagorka, dënimet u duken tepër të buta! Për ta le të jetë ashtu, por për çfarë veprash të liga i akuzojnë ata?

## Në Zenicë/Foçë kur nisem unë

Pas shqyrtimit në Gjyqin Suprem të Sarajevës, ku morën pjesë të gjithë të dënuarit, ‘zenicasit’ dhe ‘foçasit’ para nisjes në Zenicë dhe në Foçë u përshëndetën ndërmjet vete. Të gjithë ishim nën përshtypjet e dënimeve shumëvjeçare, me gjasa të vogla për diçka më të mirë. Duke shikuar mënyrën se si përshëndeteshim, njëri nga kryeshefat e Burgut qendror të Sarajevës, i quajtur Stanko (përndryshe njeri shumë i zhdërvjelltë), nuk mundi të përmbahej pa na hedhur fjalët: “Edhe ju thoni se nuk jeni grup!” Do të dëshiroja ta di se ç’mendonte për aktgjykimin e Gjyqit Federativ të Beogradit, i cili refuzoi aktakuzën se bëhej fjala për një ‘grup’ (grup komplotist) dhe tërë këtë e reduktoi në biseda, në delikt verbal.

Gazetarja Nagorka nuk la pa shfrytëzuar rastin e të mos e theksojë gjestin, të cilin e kishte bërë përfaqësuesja e akuzës publike ndaj Xhemal Latiqit, duke e qerasur me tortë për ditëlindjen e tij. Gjithsesi sjelljet e këtilla meritojnë mirënjohje në krahasim me sjelljet me të cilat na pritën me rastin e arrestimit para katër dekadave. Takimi me hetuesin atëherë ishte larg çdo mirësjelljeje. Në takimin e parë më priti me sharje “Ja ku e keni ...”, duke e përcjellë me gjest të primitivizmit ballkanik dhe duke ia ndajshuar fjalën adekuatë vulgare. E pastaj me të njëjtin ton, duke plotësuar: “Ne komunistët nuk e japim pushtetin!” Mirëpo, ja për këto dyzet vjet

kemi përparuar në sjellje, qofshin këto edhe pjesërisht raste të vemuara. Megjithatë, gazetare Nagorka, duhet të pranojmë se ende nuk kemi arritur deri në shkallën e gjakatarëve mesjetarë, të cilët para se t'ua prisnin kokën viktimave, kërkonin falje dhe gjunjëzoheshin para tyre.

Tekefundit, nga përfaqësuesja e padisë publike askush nuk ka kërkuar as nuk ka pritur gjeste të këtilla, mirëpo detyra e saj *juridikisht ka qenë qëndrimi korrekt*. Megjithatë, ajo ka qenë larg nga ajo. Vetë i ka shkelur normat ligjore të lejuara në ndjekjen kinse të kundërvajtësve të ligjit. Kur vëllai im në fjalën përfundimtare tha se disa dëshmitarëve të vet ua falë gabimin, e pastaj për një moment iu drejtua përfaqësueses së padisë publike, shtoi: "... por vërtet ka pasur goditje të ulëta", e kam përcjell shprehjen e fytyrës së saj. Ajo e shikonte me trashamani sikur të mos kuptonte asgjë përsë fliste. Ajo plotësisht ishte mësuar me padrejtësitë e veta që i kishte bërë. Kjo për të ishte krejtësisht gjë normale.

Shpirtin e vet, 'unin' e vet, ajo kaherë ia kishte shitur partisë për atë "ne." Më vonë, kur u bë fjalë në shtyp për këtë proces, ajo tha se nuk turpërohet për atë që kishte bërë, se përsëri do të vepronte në të njëjtën mënyrë. Ngjarja ishte tepër e freskët që të merrte guximin të thotë çkado qoftë tjetër, kurse tepër larg nga një kohë e ardhme kur eventualisht do të mund të thuhej: "Ne atëherë kemi gabuar."

Po, ashtu disi, por gjithsesi me atë "ne." Madje ndoshta: "Ka gabuar partia..." Partia e pagabueshme ka gabuar? Pse jo!? Paj ndoshta nuk do të thonë: "Partia këtë e ka montuar." Mund të fajësohen personat, të cilët kanë humbur përkrahjen e partisë, ose të cilët tanimë janë në varr. Edhe diçka, duke e trilluar nacionalizmin musliman dhe duke krijuar nga ky problem të rëndësishëm shtetëror, pikërisht urdhërdhënësit e Procesit të Sarajevës i kanë fryrë zjarrit të pasioneve të sotme nacionaliste të gabuara.

Mirëpo, ata askush nuk i thirri në përgjegjësi, ata janë të mbrojtur me atë "ne."

## Në burg

Në burg jemi mbështetur njëri në tjetrin, që është krejtësisht e arsyeshme. Porsonat zyrtarë shpesh na tërhoqin vërejtjen me ton

kërcënues: "Ju përsëri bashkë!" Ne do t'u përgjigjeshim: "Këtë e keni bërë ju. Ne këtë nuk e kemi bërë derisa kemi qenë jashtë (në liri)." Në sistemin e mbikëqyrjes së përgjithshme dhe të dyshimit, për ta ishte e padurueshme të shihnin dy veta bashkë e të mos e dinë se çka flet njëri ose tjetri.

Ndërsa ne vazhdimisht i shqyrtimin rastet tona. Shqyrtimi juridik i rastit tonë zhvillohej ngadalë. Shpesh supozonim me hamendje, çfarë ishin motivet reale të procesit tonë.

Gjithçka na binte ndërmend:

- Gjendja ekonomike gjithnjë e më e vështirë. Skadimi i afatit të borxheve, kurse ata nuk kanë para...

- A je shqetësuar për atë se si do t'i kthejnë borxhet? Mos kisavet! Ata kurrë nuk kanë menduar t'i kthejnë borxhet. Kjo na shtynte të qeshnim edhe pse nuk e kishim punën për të qeshur.

- Nuk është vetëm kjo, por nga frika para trazirave filluan të na frikësojnë. Hall i madh për ne, sepse së pari e nisën me ne. Porosia ishte e qartë: Popull, qetësohu dhe mblidh mendtë!

Më mirë edhe i uritur, por në liri, se sa në burg!

Ndoshta mendonin t'u bënин shantazh kapitalistëve. Për një shumë të mirë parash do t'i lironin të burgosurit politikë.

- Kapitalistët nuk kanë aq para, sa këta mund të burgosin njërejt. Merreni me mend sikur të na dëgjonin se çka bisedojmë. Të gjitha këto do t'i kualifikonin si inkriminime.

- Do t'u shpjegonim atyre. Ne që më parë jemi dënuar për këtë. Tash po e plotësojmë borxhin, që të mos na mbeteni borxh.

Shtypin arrinim ta siguronim rrugës së rregullt, ose si parapagues, ose në sallën e leximit të burgut. Nuk mund ta merrnim vetëm shtypin fetar, dhe për çudi të madhe, gazeten "Komunist!"

Njëherë morëm vesh se "Komunisti" kishte shkruar për rastin tonë, dhe i porositëm familjet tona që të na dërgojnë atë numër. Mirëpo, drejtoria e burgut refuzoi që të na e dorëzojë. Nëpunësi përgjegjës kërkesën tonë e komentoj:

"E dimë ne përse e keni kërkuar!" Të burgosurit politikë gjithnjë kanë qenë nën mbikëqyrjen e spionëve. Spiunimi i të burgosurve politikë ishte puna më profitable për ta. Gjatë leximit të shtypit, fshehnik ç'na interesonte në shtyp, çka lexojmë.

Shtypi vlonët nga përbajtjet shtanguese. Parapaguesit e gazetave nuk mund të përbaheshin e të mos nënizonin me laps atë që ishte e pabesueshme se do të ndriçohej ndonjëherë te ne. Mirëpo, kohë pas kohe dikush konstatoi se nuk mund t'i gjejë më gazetat e

veta. Është dashur të mendoni më të keqen se spiunët i kishin futur në dorë dhe ia kishin dorëzuar drejtorisë. Me ta nuk ka shaka. Ky është rast ideal që në bazë të nënvizimeve tuaja ta formulojnë padinë. Në të vërtetë, në burg mund të fitonit dënimin e ri.

Një të akuzuar me fat të këtillë, avokatin Zharko Aleksiqin nga Doboji, e kam njohur personalisht. Ai si i burgosur fitoi edhe një dënim prej një viti për delikt verbal. Kur i vuajti bashkë të dy dëni-met, të vjetrin dhe të riun, shkoi në Beograd dhe atje vazhdoi të jetojë. Në Beograd hapi zyrën e avokaturës. Meqenëse gjithnjë e më tepër në botë flitej për të burgosurit politikë në Jugosllavi, e kështu pra edhe për ne, filloi të flitet se si lehtë do të mund të vihem i në qendër të komunikimeve publike. Mirëpo, as zyrtarët shtetërorë nuk rrin duarkryq. Një ditë filluan të na thërrasin një nga një në drejtori.

Ishim të dërguar në bisedime te nëpunësit e SPB-së. Nga SPB-ja e Sarajevës ishin nëpunësit Munir Alibabiq dhe Manojlloviq, ndërsa nga SPB-ja e burgut të Foçës nëpunësi, emrin e vërtetë të të cilët askush nuk e dinte sepse vazhdimisht prezentohej me emër tjetër. Me mua zhvilloi bisedë Manojlloviqi, ndërsa dy të tjerë kryesisht heshtnin. Kur kaluan në pyetjet lidhur me aktakuzën time, unë vetëm thashë: “E gjithë kjo, prej fjalës së parë deri te e fundit është e trilluar.” Manojlloviqi më tha: “A do ti të shkosh në Zenicë?” Unë: “E gjithë kjo, që nga fjala e parë deri te e fundit është e trilluar.”

Manojlloviqi: “A do ti të shkosh në Zenicë?” Dhe kështu kjo u përsërit disa herë, derisa unë nuk heshta përfundimisht. Ishte plotësisht e pakuptimtë t’u tregosh për padrejtësi atyre të cilët pikërisht ata e zbatuan dhe e zbatonin edhe më tej. Porosia ishte e qartë: Duhet të jeshë i kënaqur që ta vuash dënimin në Foçë. Burgu i Zenicës ishte në zë për të keq, njëri ndër burgjet më të këqija në vend. Xhemal Latiqi dhe Mustafa Spahiqi, janë sëmurë nga sëmundja e mushkërive në kushet e vështira të Zenicës.

## Çmendia - kërcënëm të burgosurve politikë

Një ditë derisa gjendesha nën hetime, na dhanë nga një copë letër dhe nga një laps, duke kërkuar prej nesh që të shkruajmë çdo gjë që do të na binte ndërmend. E kisha të qartë se për çka është

fjala - test për psikiatrin. Testi - argument se jeni të pjekur për bankën e të akuzuarve. Më me dëshirë këtë do ta refuzoja nga zemërimi dhe hidhërimi, por nuk guxoja. Në perandorinë komuniste një gjë është më e keqe se burgu: çmendia për kundërshtarët e ‘patole-rueshëm’ politikë. Ky është shkatërrimi i mirëfilltë. Aty nuk keni, madje as kurrfarë mbrojtjeje teorike. Për këtë qarkullonin tregimet më të këqija trishtuese. Aty çdo veprim që bëni, është dëshmi e çmendurisë suaj.

Në burg është ndryshe, ju aty vetëm flisni se jeni të pafajshëm. Kjo nuk do të thotë se ‘ata’ shqetësohen për këtë, por megjithatë ‘ata’ e dinë se aty ka diç të vërtetë. ‘Krimineli’ politik më tepër është njëfarë preventive, sesa pasojë e veprës. Megjithatë edhe ‘përt’ kjo është e pakëndshme. Ndonjëherë!

Dhe shkrova një ose dy anekdota për djalin e dajës tim, piktorin e njohur mostaras, Mustafë - Ici Volevicin. U përpoqa që këto t'i shkruaj sa më bukur, përkundër rregullave të përgjithshme të njohura dhe të pranuara në ushtri dhe në burg - mos shit mend! (ndërsa kjo në Perandorinë Orveliane komuniste i vinte njësoj).

Në fund të fundit nuk e dija se ç’po na përgatisin në të vërtetë, burgun, çmendenë, apo plumbin në zverk. Në burgun e Foçës më është thadruar mirë në kujtesë takimi me psikologun. Nuk kishte aspak pamje autoritative. Kësaj nuk i kam dhënë rëndësi, sepse e dija sesa mund të mashtrojë takimi i parë, mirëpo më ka habitur veprimi i tij i mëtejshmë. Më pyeti se çfarë ishin përshtypjet e mia, kujtimet nga dënim i ‘parë’.

“Sa s’ka më keq!” - ia ktheva unë.

“Kurrë më mos i thuaj kështu askujt!” - klithi ai. Psikolog! Ndërsa më parë do të mendoja se është dhiar, i cili i dëbon ujqit nga dhitë e veta! Ai vazhdoi bisedën dhe kërkonte prej meje që ta ngarkoj me faj vëllain tim. Nga tërbimi nuk isha në vete. Kur u arrestua herën e parë vëllai im kishte 19 vjet, ndërsa e dënuan me 20 vjet burg. Ndërsa tani kur u moshua, edhe 15 vjet të tjera. Ç’kérkojnë më prej tij?

Pikërisht njerëz të këtillë si ky psikolog, për partinë dhe qëllimet e saj janë më të përshtatshëm. Për ta partia gjithmonë ka të drejtë. Çështja se nesër mund të ndodhë diç krejtësisht ndryshe nga ajo që kërkon partia sot, kjo për ta nuk ka rëndësi. Ushtarë besnikë të partisë. Dhe sa më keq që punonte partia, kjo për ta ishte një argument më tepër për korrektësinë e saj, madhështinë dhe mençu-

rinë. Aq më të mëdha e më të zëshme ishin ovacionet dhe duartrokitjet e tyre.

## Ku është drejtësia absolute?

Gazetare Nagorka, në këtë keni marrë pjesë edhe ju personalisht! Si duket, kjo juve aspak nuk ju shqetëson. Për ihtarët e partisë ky është proces i rëndomtë historik - është progres, të cilin vetëm duhet spikatur dhe pranuar.

A keni dëgjuar ndonjëherë se ndokush në gjykatë është liruar nga aktakuza, dhe se atëherë në gjykatore kanë jehuar duartrokkitjet? Jo, këtë nuk e keni bërë, ju - ndërtues të perandorisë orveliane.

Ju u keni duartrokitur gjakatarëve kur para syve të shastisur të tē afërmve të tyre i tërhoiqnin zvarrë viktimat e veta në kazamate.

Nagorka, a thua keni menduar ndonjëherë ju se duhet patjetër të ekzistojë e drejta absolute?

Gazetare Nargoka, a thua ka mundur së paku për një çast ndonjëherë juve t'ju shkojë ndërmend një mendim i këtillë; ç'do tē bëniti ju sikur tē ishit personalisht në burg?!

Jam kureshtar se si do tē reagonit në një mendim të këtillë. Mundësi ka mjaft. E para që më bie ndërmend është se ju e ofenduar do tē ma kthenit: "Kjo është e pamundur. Kjo është për banditë! Ndërsa unë e dua vendin tim!"

Vetëm, këtë mos e thoni!

Të gjitha bisedat informative me rojtarët e shkëlqyer tē sistemit komunist fillojnë me pyetjen për këtë dashuri, ndërsa argument më i fortë për këtë dashuri është tē pranoni detyrën e spiunit. Ky është virtyti më i lartë në sistemin orvelian!

Nuk dëshiroj tē dëgjoj që edhe ju tē flisni në mënyrë tē pamenduar për këtë dashuri, sepse nuk dëshiroj që më parë tē krijoj bindje tē keqe për cilindro qoftë, ndaj as për ju. Në qoftë se thoni se jeni qytetar i vendit, i cili në mënyrë lojale u përbahet normave ligjore - kjo është diç për tē cilën mund tē bisedohet.

Mirëpo, po ju theksoj, tē gjithë ata që janë dënuar në Procesin e '83-shit tē Sarajevës u janë përbajtur normave ligjore, pa marrë parasysh se ç'është shkruar atëherë për këtë, dhe pa marrë parasysh se ç'mondoni ju personalisht për këtë, ndërsa ata, tē cilët nuk u janë përbajtur dispozitave ligjore, pikërisht kanë qenë nga nomenkla-

tura sunduese. Në të vërtetë, kjo nomenklaturë kësaj as nuk i është përbajtjat kurrë. A thua nuk është për ju fakt i çuditshëm, se pikërisht nga radhët e komunistëve të perandorisë komuniste, para gjyqit janë nxjerrë njerëzit me akuzat më absurde, që pas pak kohe të vërtetohet se kanë qenë të pafajshëm.

Jo vetëm të pafajshëm në kuptimin e njëfarë gabimi gjyqësor, por si rezultat i një djallëzie të trilluar politike nga kreu më i lartë. Të gjithë ne jemi dëshmitarë të gjallë se si realiteti ynë është i pasur me kthesa të këtilla të papritura, ndërsa ata, të cilët i kriojnë, nuk kujdesen aspak për njohuritë themelore të logjikës njerëzore, por as për nderin e vet njerëzor. Ata sillen sikur të ishin plotësisht të operuar nga këto koncepte. Gazetare Nagorka, a thua Ju veten ashtu pa kokëçarje e inkuadroni në këtë shoqëri?

Kundër meje, personalisht Ju në "Oslobodjenje" më 25 shkurt 1990, keni paraqitur (keni përfolur) akuzën në diç më pak se 20 fjalë, ndërsa më 8 prill 1990 aktgjykimin në më pak se 40 fjalë. Kjo është rezultat i praktikës së vjetër. Atë që e ka paraqitur aktakuza, e pastaj aktgjykimi, askush nuk ka mundur ta mënjanojë nga ajo që shtypi komunist i lejonte vetes ta zbrazë mbi kokat e të akuzuarve.

Qëllimisht ndiqej kjo rrugë që të krijohet pamja e diçkaje të tmerrshme, e jo pamja reale.

Dhe ju mendoni se kështu mund të qeveriset 'juridikisht' me shtetin?

Dikur mund të dëgjoheshin zëra për socializmin me fizionomi humane. Vërtet, këta zëra janë intonuar gabimisht. Humaniteti, falja, dashuria, kalimi në sferën transcendentale, i përkasin krejtësisht një sfere tjeter - sferës religjioze. Ndërsa nga shteti kërkohet *drejtësia*. Kjo është ajo prej së cilës ideologjia komuniste dhe shteti i saj kanë hequr dorë që më parë. Këtu gjendet filli i shkatërrimit të kësaj ideologjie dhe shteteve të këtilla. Kjo çmenduri u reflektua në fatkeqësi të mëdha të masave të gjera popullore. Për komunistët kjo ishte pak. Ata tërë popullin e shtynin në krim. Donin që çdo njeri të gjallë ta bënин pjesëmarrës në këtë krim. Në një mënyrë të çuditshme, gati se do të arrinin.

## Jam i pafajshëm

Shumë njerëz të afërt nuk kam mundur t'i bind se jam plotësisht i pafajshëm edhe ndaj vetë ligjeve komuniste. "Ama përse i ke nxitur! E ke ditur se çfarë janë." Shpeshherë nuk më mbetej tjetër, pos të mbrohem në këtë mënyrë:

"Të jesh i lumtur që kjo më ka goditur mua. Po të mos bija në burg unë, do të kishe rënë ti. Ata doemos do të gjenin viktimë!"

Disa ma hedhnin se diku patjetër e kam tejkaluar kufirin. I kam pyetur, nëse është e vërtetë se ai nuk ka qenë sulm i mirëfilltë në fe, dhe nëse ata personalisht (bashkëbiseduesit e mi) kanë qëndruar në kufijtë e caktuar dhe i janë përmbajtur asaj që është e lejueshme me ligj, atëherë përse ata vetë (sipas pranimit të tyre), ishin plot frikë dhe për shkak të kësaj frike e ndërprenë shkuarjen në xhami!

Natyrisht, çdo njeri kishte mundësi të bindet lehtë se njerëzit nuk mund të jenë të prishur deri në palcë, pa marrë parasysh kërkkesat e nomenklaturës. Ndeshim në njerëz, të cilët kanë edhe arsyë edhe dije. Bashkëshortja më ka rrëfyer më vonë, gjatë kohës derisa ajo bredhte nëpër dyert e institucioneve tona juridike, në ditët e para të arrestimit tim, për një rast jo të zakonshëm: është gjendur para një njeriu, i cili ishte mjaft korrekt. Kur shfryu gjithë mllefin që e kishte në shpirt, dhe kur është nisur kah dera, duke e mbajtur fëmi-jën për dore, në moment duke dalë prej dere është kthyer prapa kah njeriu. Ai rrinte i shtangur pranë tavolinës, sytë i ishin mbushur me lot... Përse është tronditur? A thua ishte ky një pësim dhe vuajtje e një familjeje? Apo ndoshta fati i vet personal? Ndoshta diku në thellësi të shpirtit i ka mbetur diçka njerëzore, diçka e zgjuar për një çast, apo ndoshta e ka kuptuar se është dashur të shkatërrojë në unin e vet aq shumë vlera njerëzore për hir të ruajtjes së pozitës.

Në një rast u gjenda në një vend të vogël bregdetar, në pushimorë të pensionistëve. Qetësi, pa kurrfarë tollovie, një vend i shkretë, ku ende nuk kishte filluar sezona verore. U njoftova me një familje. Ishim krejtësisht të panjohur njëri për tjetrin. Gratë shpejt u njoftuan ndërmjet vete, gjetën tema për bashkëbisedim, ndërsa ne burrat qëndronim më të matur dhe pak më larg njëri-tjetrit. Këta të saponjohur u vendosën, mirëpo burri nuk ishte i kënaqur me banesën. Nuk kishin çka të shikonin nga dritarja - grumbuj të gurëve ngrihen menjëherë pranë dritares, ndërsa burri kërkonte pamje kah deti. Vazhdimisht bërtiste: "Kjo është si në burg, ky është

burg!” Edhe pse pas këtij kundërshtimi arriti të sigurojë dhomën me pamje kah deti, ndjenja e ofendimit dhe zemërimi nuk i kalonin. Ndonëse nuk hyra në kurrfarë komentimi, megjithatë ai një ditë ndjeu nevojën që gjithë atë zemërim ta nxjerr nga shpirti dhe me gjysmë zëri e në besim më tha: “Ju nuk dini se ç’është burgu! Unë e di. Kam qenë... Kam qenë polic.” Heshtja, por e dëgjoja me kujdes. Ai vazhdoi: “Është detyrë e rëndë ajo. Merreni me mend rastin e këtillë: U hyni njerëzve në shtëpi në gjysmë të natës dhe bëni bas-tisjen. Të gjithë anëtarët e familjes çohen në këmbë. Ndërsa para agimit, të zotit të shtëpisë i thoni: Vishu! Ti duhet të vish me ne! Ndërsa fëmija i tij i vogël i kapet për pantalone. Sytë i ka plot frikë. Belbëzon: “Ku po shkon baba?”

Përpinqesha që as me frymëmarrjen më të vogël të mos e ndër-preja rrëfimin e tij. Ai vazhdoi: “Me ditë të tëra nuk qetësohesha. Natën nuk mund të flija, me gëzim e kam pritur ditën e pensionimit.” Ju e shihni se në njerëz ekziston edhe e mira edhe e keqja, por regjimi orvelian është tmerr i vërtetë, i cili i detyron njerëzit të bëhen të këqij. Vetëm si të këtillë mund të mbijetojnë. Ndërsa ata që tregohen dhe dëshmohen në (jo) vepra si më të këqij, arrijnë në pozita më të larta. Edhe ky është njëri nga shpjegimet ç’ë solli në falimentim të çuditshëm sistemin komunist. Nën barrën e dhunës së vet personale, regjimi e shkatërrroi strukturën e vet të brendshme.

Gazetare Nagorka, ju mund t’i keni qëndrimet dhe pikëpamjet tuaja personale për tërë atë që ndodh, por nuk do hedhur poshtë pérjetimin e përvojës shekullore të popullit, i cili shumë nga këto vuajtje që i ranë në kokë i duroi dhe i farkoi në urtinë e tij: “Zoti duron kufrin, por nuk duron zullumin!”<sup>\*</sup> Për këtë vlen të mendohet.

---

\* Zoti duron kufrin, përdoret në kuptimin se All-lahu xh.sh. në mëshirën e vet njeriut në botë i ka lënë kohë të mjaftueshme që t’i qërojë hesapet me mendimet e veta të këqija, me ndjenjat dhe mëkatet edhe ndaj Zotit edhe ndaj të tjerëve, edhe ndaj vetes, dhe se i ka lënë kohë të mjaftueshme për t’u penduar, ndërsa llogarinë e vërtetë për besimin, gjegjësisht për mosbesimin e ka lënë

---

për Ahiret. Sa i përket drejtësisë së mosbesimit, Ai nuk do ta lë pa satisfaksion të drejtë përkates - ashtu siç i ka hije Atij - edhe në këtë botë. E po ashtu as zullumin, nga çfarëdo anë që të ushtrohet.

## PASTHËNIE

---

Në fund të viteve gjashtëdhjetë, filloj njëfarë rënie e tensionit të ideologjisë komuniste. Husein ef. Gjozo, kryetar i Shoqatës së Ilmisë së Bosnjë e Hercegovinës, u angazhua që ta gjallërojë sado pak jetën fetare, e cila ishte shpënë deri në kufijtë e një zhdukjeje të plotë. Për ne, ish të dënuarit nga radhët e Lëvizjes së Re Muslimane, kjo ishte një sprovë e madhe. A t'i bashkohemi dhe në ç'masë punës së institucioneve fetare, duke pasur parasysh se ato ishin nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të regjimit dhe të njerëzve të dëgjuar të tij, të cilët me ndërgjegje të qetë pranonin detyrat, duke e penguar veprimtarinë e mirëfilltë.

Për këtë arsyе disa ishin të mendimit se duhet qëndruar larg nga e gjithë kjo punë. Regjimi momentalisht dëshironte ta përmirësojë pasqyrën e keqe përvete, dëshironte t'i fshehë argumentet e zhveshura përmungesën e lirive elementare në vend. Mirëpo, një ditë e gjithë kjo do të dëshmohet si një provokim i rëndomtë që kishte përqëllim të zbulojë ndërmarrësit, që të spikatet rrjedha e rrymës ideore të Islamit në popull, e atëherë komunistët në mënyrën e vet specifike do t'i shkatërrojnë që në themel.

Përkundër njerëzve të këtillë me parashikime të zymta, kishte edhe të tjerë me pikëpamje të vlefshme e pozitive, duke konsideruar se megjithatë diç po lëvizë në drejtim të mirë, ndaj këtë moment duhej shfrytëzuar. Kjo është shumë larg nga ajo që ne do ta dëshironim, por në kushte të këtilla ‘bën çka mund të bëhet’!

Personalisht e kam përkrahur mendimin se këtë mundësi duhet pranuar, madje edhe po që se një ditë do të dëshmohet se është

pnuar për "pranverën e rrejshme." Doemos duhet pranuar njëfarë rreziku. "Lampedem tradere."

Për gjeneratat e vjetra ishte e padurueshme të shikonin se si gjeneratat e reja vinin njëra pas tjetrës dhe rritheshin në një xhehalet (xhahilijet) të plotë. Apo, në ç'mënyrë figurative e tha këtë njëri nga radhët e muslimanëve të rinj, I.K., duke përfunduar mendimin e vet për rrezikun e shkapërderdhjes së shoqërisë muslimane në këto troje me konstatimin: "Nuk është vështirë të vdesësh, por më vështirë është të shuhesh fare."

Me sugjerimin e vëllait tim dhe nxitjet e disa shokëve të mi të afërm, fillova të shkruaj. Ata mendonin se kam prirje për diç të këtillë dhe se patjetër duhet vepruar kështu. Nisma e Husein ef. Gjozos na ofroi mundësi që në lokalet e *Preporod-it*, në Tribunën e Rinisë në Xhaminë e Mbretit, në mesxhidin e Tabakëve, në vjetarin *Takvim*, në gazeten *Preporod* të inkuadrohemi edhe ne vetë në përtëritjen ideore të jetës islame dhe në mbrojtjen e vlerave islame në jetën e individit dhe në jetën e shoqërisë.

Ne nuk ishim të shumtë që merreshim me shkrime, edhe pse dalloheshim ndërmjet vete në mënyrën e qasjes së temave të ndryshme dhe të përpunimit të tyre, megjithatë te njerëzit që gjendeshin jasht rrethit tonë të ngushtë, vepronim si një grup i unifikuar. Shqyrtimet tona dalloheshin nga shqyrtimet e rëndomta, ndaj si të këtilla edhe ranë në sy. Kritikat tona ose zgjidhjet e ofruara për problemet e caktuara, apo synimet e paqarta të paralajmëruara, apo kërkesat e qarta, te *shumica* nuk nxitën ndonjë admirim të veçantë. Këtu nuk kishim të bëjmë me pushtetin. Përafërsisht e dinim se ç'mendonte pushteti për ne dhe për idetë tona, sepse na përcillnin vazhdimisht dhe na shikonin me sy të keq. Këtu nuk duhej të mashtrohemi. Mirëpo, prej atyre që ishin të obliguar të na ofronin përkrahje, nuk kishim përgjigje përkatëse. Mosbesimi, xhelozia, kapitullimi politik para regjimit, ndërsa diku edhe kapitullimi ideologjik, pastaj shërbimi i spiunazhit në favor të regjimit ateist ose thjesht frika nga komunistët, sepse e dinin se e tërë kjo atyre nuk u shkonte për qejfi. Si çdokund gjetiu edhe këtu kishte gjithçka, e përkëtë më së miri e di All-lahu xh.sh., ndërsa neve na mbetet vetëm të supozojmë se për çka është fjala dhe të merremi me gjëra të papëlqyeshme.

Nga kjo periudhë ekziston një anekdotë karakteristike: Njërit nga Ilmija më e re i kishin rënë në sy disa artikuj të botuar në *Takvim*, në të vërtetë këta ishin artikuj tanë të panënskruar ose të

nënskruar me pseudonime. Ai e pyeti njërin nga gjenerata më e vjetër:

- Kush po i shkruan këta artikuj?
- Ata!
- Kush janë ata?
- Pyet, kush janë ata!

Emri ynë, emri Muslimanët e Rinj, deri në procesin e Sarajevës më 1983, ishte tabu-temë, kështu që në burgun e Foçës e përjetova që poeti i ri Xhemaludin Latiq, tani poet i afirmuar, një ditë të më pyesë se kush ishin Muslimanët e Rinj. Ne kemi menduar në të rinjtë, në ata që janë të paprishur në ndjenja, në mendime dhe në vepra. Për ta kemi shkruar: "Lampedem tradere."

Veprimitaria e Husein ef. Gjozos gjendej ende në suazat modeste për nevojat islame të botës sonë në këto hapësira, mirëpo parandjehej mundësia e një vrulli të madh fetar, e veçanërisht në gjirin e brezit të ri. Ndaj edhe vetë kjo parandjenjë për komunistët ishte diç e patolerueshme. E larguan Husein ef. Gjozon nga vendi përgjegjës i punës dhe tërë veprimitaria e tij, që ai e kishte vënë në veprim dhe e kishte mbrojtur me ngulm, u vu në dyshim. (Njeriu, i cili pranoi këtë punë kriminale në ambicien e vet të verbër personale, nuk kishte llogaritur se komunistët një ditë edhe vetë atij do t'i përgatitnin të njëjtën vepër të shëmtuar siç i kishin përgatitur Husein ef. Gjozos). Në këto rrethana, ne nuk mund të vazhdonim më me praktikën e deriatëhershme.

Vëllai im insistonte vazhdimisht që unë ta grumbulloja materialin tim të publikuar deri më atëherë dhe ta publikoja në tërësi në një libër të veçantë. Me këtë do të dilte në dritë vlera e plotë e këtij materiali. Materiali ishte i uniformuar në krijimin e një qëllimi islam. Ndërkaq, kështu i shpërndarë dhe i fshehur në një mal materialesh tjera, në një pjesë të mirë mbetet i pahetuar nga lexuesit.

E hartova regjistrin e këtyre artikujve në dy kopje: njérën kopje ia dhashë vëllait, ndërsa tjetrën e ndala për vete. Ndërkaq, në pranverë të vitit 1983 pasoi sulmi i Sigurimit, sulmi ideologjik i komunistëve kundër Islamit, goditje të cilën ata orvateshin ta paraqitnin si qërim hesapesh ligjore me veprimitarinë e paligjshme politike të "armiqve të popullit." Ndër të tjera na inkriminuan edhe ata dy regjistra, ku ishin të regjistruar artikujt.

Tani në këtë vit, më 1990, u shtrua përsëri çështja e grumbullimit të artikujve. Vështirësi e veçantë ishte se artikujt ishin me pseu-

donime të ndryshme ose pa kurrfarë nënshkrimi, e shpesh edhe me shkurtesa të nduarduarta.

Për këtë shumëkush më bënte vërejtje. Dola shkurtpamës, sepse kurrë as nuk kam parandier se e gjithë kjo një ditë do të bëhet aktualitet. Është dashur që me kohë tërë ai material të kompletotohej dhe të ruhej me kujdes në vend të sigurt. Ndërsa kështu...

Çdo gjë që është marrë nga SPB-ja, për ne ishte e humbur. Njerëzit disa gjëra, nga frika që të mos gjenden tek ata, i kanë zhdukur vetë. Natyrisht, disa gjëra edhe vetë më kanë humbur nga syri. Shumica më këshillonin me admirim që përsëri të përpinqem ta grumbulloj atë material. Ndërkaq, vëllai im (Omer Behmeni) dhe Hasan Çengiqi ishin më këmbëngulës e të pakompromis dhe vërtet u angazhuan ndërgjegjshëm për këtë vepër. (“Ti vetëm na ofro atë material dhe mos çaj kokën për të” - thoshin ata).

Edhe diç tjetër: Ata ishin këmbëngulës në kërkesën e tyre që librin ta publikoja me emër e mbiemër të plotë. Për këtë më sillnin argumente mjaft të forta. Më në fund pranova pa ndonjë entuziazëm të madh.

Që nga fëmijëria e hershme më kanë mësuar të bëj *mirë*, por në këtë mënyrë t’i shmangem faktit që të mos bie në sy të botës, me këtë koncept edhe jam rritur dhe jam familjarizuar bukur shumë.

Më së tepërmë më ka munduar kërkimi i origjinalit ose së paku i kopjes së plotë të “Njohuritë shkencore dhe Kur’ani.”

Kërkimet zgjatën me muaj dhe vetvetiu ky ishte një rrëfim i pazakonshëm. Dhe më në fund, pas 17 vjetësh, përsëri e kisha origjinalin në duar.

Në *Takvimin* e vitit 1969 ishte publikuar artikulli i panënskruar: *A mund të shihet përfundimisht fundi i fasilei-hilafetit?* Më interesonte përpunimi i artikullit, kështu që vendosa që autorit të artikullit t’i shkruaj një letër në të cilën do të viheshin në pah pamundësitë e zgjidhjes së çështjes që e kishte menduar autor i artikullit, dhe shfaqa mendimin që të niset krejtësisht në drejtim tjetër, i cili është rrugë e vetme që shpie drejt zgjidhjes, sado që të na duket e vështirë dhe e mundimshme. (Atëherë polemika publike dhe publikimi i asaj letre nuk vinte parasysh). Shfaqa interesimin te Husein ef. Gjozoja se kush ishte autor i atij artikulli. Isha tepër i befusuar kur mësova emrin e tij. Ky, ndërmjet dy luftërave ishte bukur i njobur ndër muslimanët e arsimuar. Lavdëronte rrugën e Kemalit të Turqisë së re. Shkruante dhe bënte vërejtje që muslimanët të përvetësonin mënyrën e jetës liberale të Perëndimit, me të cilën ne

nuk entuziazmoheshim. Gjatë luftës u komprometua plotësisht për shkak të bashkëpunimit jo të zakonshëm me lëvizjen çetnike të Drazha Mihajloviqit, ndaj pas luftës u dënuar rëndë. Gjatë vitit 1951/52 në burgun e Mitrovicës së Sremit u takova me një burrë të ri, musliman, i cili më tregoi se kishte pasur kontakt me këtë autor dhe se nuk kishte mundur të mos kundërshtojë dhe me keqardhje të mos spikasë, se për tërë atë që e kemi përjetuar (regjimin komunist dhe të gjitha vuajtjet personale dhe tragedinë e bashkësisë sonë), duhet falenderuar edhe propagandës së tij para Luftës së Dytë Botërore. Ky burrë më rrëfeu se ky autor ishte i shqetësuar thellë për këtë qortim.

Unë personalisht kurrë nuk e kam njojur e as nuk jam takuar fare me këtë shkrimtar, por duke vlerësuar në mbështetje të artikullit Fasilei-hilafeti, që e kishte publikuar në *Takvim*, supozoj se ai më vonë i ka korrigjuar pikëpamjet e veta. Mirëpo, nga ajo që ai vetë e konstatonte, kam dyshuar se do të arrija diç më tepër, ndaj hoqa dorë që t'i shkruaj. Që tani, pas dy dekadas, m'u dha mundësia ta publikoj përgjigjen ndaj mendimit të tij për çështjen përkatëse.

\*  
\* \* \*

Të gjithë këta artikuj janë frysht i kohës së tyre, do të thotë për atë që mund të flitej atëherë. Sot jam i vetëdijshëm për disa gjëra që atëherë nuk i kisha parasysh apo për njojuritë e mëvonshme në shkencë, osc gjërat e ndjeshme për të cilat atëherë domosdo u dasht të heshtet. Po sjell disa shembuj:

Në kuadër të “*Njohurive shkencore dhe Kur’ani*” do të ishte i dobishëm përpunimi i dy fakteve: se njeriu është e vetmja qenie e gjallë që përdorë *zjarrin* dhe *shkrimin*.

Të sugjerosh se ç’kuptim kanë këto argumente për njeriun, nga njëra anë, për rëndësinë e tyre për zhvillimin e civilizimit njerëzor dhe të një pjese të mirë të kulturës, ndërsa nga ana tjeter ashtu siç flet Kur’ani për *zjarrin* dhe *shkrimin* si bekime hyjnore, kjo domosdo i imponohet mendjes së njeriut.

Po ashtu në ndërkohë kam hasur edhe në veprën (në përkthim) “*Kozmosi*” të Karl Saganit, vepër kjo që meriton të flitet për të. Karl Sagani *a priori* ndërmerr qëndrim ateist.

Ndërkaq, në jetë nuk më kujtohet një libër i tillë që në mënyrë aq të befasishme të më ketë bindur se Zoti ekziston! Pikërisht përkëtë, me kënaqësi do të merresha me analizën e këtij libri!

\*  
\* \*

Është çështje e ditur se sa durim kërkon Islami nga pjesëtarët e vet, ndihmë dhe ndalim të zilisë e të smirës, të urrejtjes dhe të asaj që sjell çfarëdo të keqe. Ndërkaq, përvoja jonë është diç krejtësisht tjetër. Të gjithë jemi dëshmitarë të gjallë se me sa urrejtje armiqësore dinë të gjakosen muslimanët ndërmjet vete ose të luftojnë përinteresa të huaja. E ku janë këtu ndjenjat e tyre vëllazërore dhe ku është dashuria e përbashkët ndaj Islamit dhe e interesit të përbashkët të muslimanëve? Ku është këtu dëshmia islame për të cilën të gjithë flasim?

Ne vetëm flasin përkëtë, kurse në realitet jemi larg saj, edhe ne sot, por edhe shumë të tjerë nga e kaluara e largët dhe e afërt e Islamit. Ku qëndron zgjidhja? Ky mendim më mundonte. Dhe një ditë u hepova në shpalimin e këtij problemi. Fillova të shkruaj. Por sa shkrova një faqe, u stepa i shtangur. Çdo gjë më shpiente në përfundim, se përkëtë nuk mund të shkruhej publikisht. (Më në fund edhe kjo faqe u gjend para këshillit të gjyqit të vitit 1983 - kjo faqe ishte e mjaftueshme përgjykatesit që të përpinqeshin të nxirrin se çfarë idesh fshiheshin në të). Përfundimi imponohej: Muslimani në aspektin ideor nuk mund t'i takojë kurrfarë ideologje, por mund t'i takojë vetëm Islamit. Kurrfarë politike që mund t'i shpie muslimanët në konflikte dhe në gjakderdhje të ndërsjella nuk vjen parasysh.

Ekziston vetëm një politikë: *islame*, *muslimane*, kurse të gjitha të tjerat bien poshtë. Mirëpo, përvoja historike është thjesht demoralizuese. Një jetë të këtillë mund të jetojnë individët dhe grupet e vogla, mirëpo ç'ndodh me bashkësitë e mëdha?

A thua jemi në gjendje t'i mbizotërojmë dëshirat tona personale, familjare, fisnore, rajonale, momentale, materiale, të kësaj bote në favor të botës së amshuar?

A ekziston në ne bindja e mirëfilltë se një ditë do të gjendemi para Krijuesit tonë?

Kjo botë vërtet është një sprovë e madhe.

Megjithatë, fati i njeriut nuk është i pashpresë. Besimi na jep shpresë dhe ngushëllim. Ta krahasojmë këtë me ndalesën e ushqimit të ndaluar në Kur'an. Nëse fatkeqësisht jemi të shtrënguar, por

jo në mënyrë të shkujdesur dhe xhahiliste, t'i shkelim urdhrat e Zotit, All-lahu na premton falje.

Duhet të jemi modestë. Jeta është plot kurthe dhe ngarkesa të rënda, kurse njeriu është tepër i dobët. Gabon shumë dhe duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë, ndaj duhet lutur vazhdimesht All-lahun për mëshirë dhe falje.

*Autori*



## Shënimë biografike për autorin

---

Autori i veprës *Përgjigjet Islame*, Salih Behmen u lind më 12 shkurt 1922 në Mostar, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin e njohur të Mostarit. Duke vendosur të studiojë matematikën dhe fizikën në Shkollën e Lartë në Sarajevë, ai këto lëndë ua ligjëroi gjeneratave të bashkëvendasve të vet. Duke mos pritur publikimin e kësaj vepre, autori kaloi në ahiret më 27 tetor 1990 në Sarajevë, ndërsa të nesërmen pas faljes së namazit të xhenazes u varros në vendlindjen e vet - në Mostar, në haremin e Shkariqit. Qysh herët, më 1949 si pjesëtar i Lëvizjes së Muslimanëve të Rinj për rilindjen fetare dhe jetën kulturore të muslimanëve, u dënuar më 12 vjet burg, duke i vuajtur plot 8,5 vjet në burgun famëkeq të Zenicës. Për shkak të përcaktimeve të veta jetësore, për shkak të erudicionit të vet, bindjeve dhe qëndrimeve të tij nga aspekti islam, përsëri ra në sy të establishmentit shtetëror të Bosnjë e Hercegovinës, ndaj në procesin e montuar të Sarajevës ndaj të të ashtuquajturve “nacionalistë muslimanë” dhe “fundamendalistë islamë”, ndër të cilët bënin pjesë Alija Izetbegoviq, Xhemaludin Llatiq, Hasan Çengiq, Melika Salihbegoviq si dhe vëllai i tij, Omer Behmen, në vitin 1983 përsëri u dënuar me 5 vjet burg, duke i vuajtur 3,5 vjet të këtij dënimini të padrejtë në Foçë. Pas kësaj punoi si magazinier në spitalin e Mostarit, pastaj si nëpunës në hekurudhë, e pas gjithë këtyre peripecive i kthehet përsëri profesionit të vet, ligjërimit të matematikës dhe fizikës. I mësuar me jetën në rrëthin politiko-shoqëror i cili, thënë më butë, kishte disponim armiqësor përfshirë manifestimi publik të ndjenjave fetare, veçanërisht tek intelektualët muslimanë, Behmeni pjesën dërrmuese të artikujve të vet e publikoi

me pseudonime të ndryshme, të cilat jo vetëm që nuk e mjegullojnë, por përkundrazi, hedhin edhe më tepër dritë në emrin e vërtetë të Salih Salko Behmenit si autor i këtij libri.

# Përbajtja

<b>PARATHËNIA E BOTUESIT NË BOSHNJAKISHTË.....</b>	<b>5</b>
<b>NDËRMJETTHËNIE .....</b>	<b>9</b>
<b>NJOHURITË SHKENCORE DHE KUR'ANI.....</b>	<b>15</b>
<i>Dialog ndërmjet mësimit islam dhe ateizmit.....</i>	<i>15</i>
<b>HYRJE.....</b>	<b>17</b>
Apel i fesë drejtuar arsyes njerëzore .....	20
Dukuria e verbërisë .....	22
Interpretime të gabuara të fakteve eksperimentale .....	24
Gjurmimi i shkaqeve të ndodhive. Çështja e kritereve tona.....	28
Nuk kemi të bëjmë me të kuptuarit, por me të mësuarit .....	30
Ç'është ligji kulminant i ngjarjeve .....	34
Paqëndrueshmëria e interpretimeve ateiste .....	34
Mohimi i paarsyeshëm i botës tjetër .....	44
<i>Mbi shpirtin .....</i>	<i>51</i>
Ateizmi nuk ka doktrinë të veten .....	56
E vërteta fetare .....	58
Ku duhet kërkuar të vërtetën fetare .....	60
Paqëndrueshmëria e teorisë mbi evolucionin e mendimeve religioze .....	64
Me ç'kriter ta çmojmë njeriun .....	65
Mbi religjiozitetin .....	66
Islami .....	68
Dyshimet ateiste dhe përgjigjet në to .....	70
Realiteti i përvojës sonë kujt duhet t'i falënderohet për ekzistencën e vet .....	72
Ateizmi pa materializëm .....	76
Zanafilla e ateizmit .....	77
Burimet e mendjemadhësisë .....	79
<i>Vetëharresa e njeriut .....</i>	<i>81</i>
<i>Faktet udhëzojnë në modesti.....</i>	<i>82</i>
<i>Ardhmëria e pasigurt tërheq vërejtjen.....</i>	<i>85</i>
<i>Katastrofat kërcënuese sinjalizojnë .....</i>	<i>88</i>
“Pushtimi” i kozmosit .....	91
<i>Kur'ani tërheq vërejtjen .....</i>	<i>94</i>
<b>SUGJERIM REDAKSISË “PREPOROD”.....</b>	<b>99</b>

<b>DISA SHPREHI TONA TË KËQIJA.....</b>	<b>101</b>
Betimi .....	101
Falënderimi .....	102
Të lavduarit.....	104
Mallkimi .....	105
Nderimi i prindërve .....	107
Sjellja e ndërsjellë .....	110
Përfundim.....	111
<b>VËSHTRIM ROMANIT “DERVISHI DHE VDEKJA” .....</b>	<b>113</b>
<b>DISA FJALË PËR XHAMITË TONA .....</b>	<b>121</b>
<b>BISEDË GJATË RRUGËS.....</b>	<b>137</b>
<i>Taksi-biseda nga shiriti i magnetofonit .....</i>	137
<b>LETËR E HAPUR.....</b>	<b>155</b>
<i>Sinodit të Kishës Ortodokse Serbe, Beograd.....</i>	155
<b>NDJENJA JONË E INFERIORITETIT .....</b>	<b>161</b>
<b>PERSONALITETI DHE ISLAMI (Ligjëratë e mbajtur në Tribunën e Rinisë në Xhaminë e Mbretit në Sarajevë).....</b>	<b>171</b>
<i>Islami si fe.....</i>	179
<b>JE I OBLIGUAR QË ATË QË E PRET PREJ TJETRIT, TA BËSH VETË .....</b>	<b>187</b>
<b>NË Ç'DREJTIM T'I ANGAZHOJMË MENDIMET TONA .....</b>	<b>193</b>
<b>IMANI DHE DËSHMIA E TIJ .....</b>	<b>205</b>
Falënderimi .....	207
Sabri (Durimi).....	207
Veprat e mira .....	208
Ngecja e sotme shpirtërore.....	211
<b>ILMIJA SOT DHE ROLI I SAJ NESËR .....</b>	<b>215</b>
<b>PËR NJË INTERPRETIM BASHKËKOHOR TË ISLAMIT .....</b>	<b>235</b>
<b>ÇËSHTJA E HILAFETIT SOT .....</b>	<b>249</b>
<i>Vërejtjet tona .....</i>	259
<i>Vërejtje plotësuese .....</i>	267
<i>Fjala përfundimtare .....</i>	272

<b>PROCESI I SARAJEVËS '83 - MONTIM OSE JO .....</b>	<b>275</b>
<i>Përgjigje gazetares Nagorka Idrizoviq.....</i>	275
<i>Jeta si humor i zi.....</i>	276
<i>Argumentet e Hamdija Pozdercit.....</i>	277
<i>Gjykimi i fesë; deri ku shtrihet ekspozimi i fesë.....</i>	278
<i>Gjykimi i armës trofe .....</i>	279
<i>Edhe kjo ndodh në "Shtetin juridik" - paguhet ai që nuk punon .....</i>	280
<i>Parapërgatitja për procesin e '83-shit për Salko Behmenin .....</i>	281
<i>Si u trilluan dëshmitarët .....</i>	283
<i>Inkriminime absurde .....</i>	287
<i>Njerëzit janë si thneglat - luftëtarë dhe punëtorë .....</i>	288
<i>'Liria e vizitës' dhe e vërteta e fëmijës .....</i>	289
<i>Ne - fjalë e privilegjuar, unë - përvujtni e vërtetë .....</i>	290
<i>Në Zenicë/Foçë kur nisem unë.....</i>	291
<i>Në burg.....</i>	292
<i>Çmendia - kërcënëm të burgosurve politikë.....</i>	294
<i>Ku është drejtësia absolute? .....</i>	296
<i>Jam i pafajshëm .....</i>	298
<b>PASTHËNIE .....</b>	<b>301</b>
<b>Shënimë biografike për autorin.....</b>	<b>309</b>

Salih Behmen  
**PËRGJIGJET ISLAME**

*Redaktorë gjuhësorë*  
Liljana Jajaga - Meshiq  
Fatmire Ajdini - Hoxha

*Korrektor*  
Fatmire Ajdini - Hoxha

*Përgatitja kompjuterike*  
Gazmend Hoxha

*Boton*  
SH.B. Logos-A  
II Mak. brigada, Q.T. "Treska" X/7  
91000 Shkup  
Tel./Fax: (091) 611-508

Според мислењето на Министерството за култура бр. 07-6643/2 од 16.11.1998 за книгата *Исламски одговори* се плаќа повластена даночна стапка.

Sipas mendimit të Ministrisë për Kulturë nr. 07-6643/2 të datës 16.11.1998, për librin *Përgjigjet islame* bëhet pagesa e lehtësuar tatimore.

**ISBN 9989-601-82-8**

Copyrighted material